

**RRUGA  
E RE**

*për Kosovën*

**PROGRAMI  
POLITIK  
I LIDHJES  
DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS**

**BOTIMI I TRETË**  
Dhjetor 2024



# I. RRUGA E RE: KONCEPTI POLITIK





# I. RRUGA E RE: KONCEPTI POLITIK

Dr. Lumir Abdixhiku

HYRJE

---

4

Në prill të vitit 2022, gjashtë muaj pas fitores së zgjedhjeve lokale, kam mbajtur Konventën e Parë programore “Lidhja për të Ardhmen”. Në këtë konventë, në shtatë grupe diskutimi, kemi shtruar sfidat e Republikës, të reja e kronike pa dallim dhe pikëpamjet e tona fillestare për adresim të tyre.

Nga kjo Konventë, janë krijuar të 27 grupet e profesionistëve, të brendshëm e të jashtëm, në një angazhim të ri – gjithsesi masiv, për hartimin e programit të ri politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në kohën e formimit të grupeve, kam konsideruar se fotografia e vërtetë e gjendjes sonë shoqërore duhet të merret nga komunikimi me qytetarë dhe akterë të ndryshëm të jetës publike; dhe se përtej dijes së gjithmbarshme profesionale që ekspertët tanë e të jashtëm mund të kenë, e vërteta dhe vizioni për të ardhmen qëndron mes familjeve tona, individëve punëtorë të kësaj shoqërie, mes ndërmarrësve e përfaqësuesve të mendimeve të ndryshme shoqërore.

Si rrjedhojë, nga maji i vitit 2022 deri në maj të vitit 2023, pra përgjatë gjithë dymbëdhjetë muajve, kemi organizuar platformën e vetme të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarë “LDK ju dëgjon”. Kemi organizuar takime të hapura, të lira e me përplot mendime, nëpër secilën Komunë të Kosovës; nga Kryeqyteti, Prishtina, deri te komuna më jugore, Dragashi.

Në po këtë kohë, kemi vizituar edhe ndërmarrës, inovatorë, individë me suksese të jashtëzakonshme. Kemi parë potencialin e madh që ka Kosova. Mbi të gjitha, kemi kuptuar sfidat që secili nga ta ka

Në qershor të vitit 2023, si pasojë e gjendjes së rëndë të brendshme në vend e si pasojë e përplasjes së pamenduar më parë ndërkombëtare të Kosovës, kemi paralajmëruar nisjen e një platformë politike që ofron jo vetëm zgjidhje për problemet e reja e kronike të Republikës; jo vetëm si një platformë që shpërthen izolimin ndërkombëtar të Kosovës, por si një platformë që na përbashkon në një ide përtej partiake e shpëtimtare për Republikën e Kosovës.

Kemi marrë këtë nismë për dy arsye. E para, sepse ndanim bindjen se vendi ynë po kalonte nëpër një etapë të paprecedentë historike, të një ecjeje të vetme e përplasje brenda dhe jashtë pa dallim. Dhe e dyta, sepse ndanim bindjen e detyrimit për veprim si brez që trashëgon barrën e vendimmarrjes në vend. Kjo vendimmarrje, fatmirësisht për demokracinë e fatkeqësisht për peshën tonë, nuk i takonte vetëm partisë sonë politike. Kjo vendimmarrje i takonte secilit intelektual, mendimtar e veprimtar publik, ndërmarrës e punëtorë pa dallim, që ka menduar të trashëgojë një Kosovë euro-atlantike te brezat që vijnë; nga familjet tona, tek fqinjët tanë, e tek çdo qytetar i yni.

Në këtë vijë, kemi organizuar katër takime konsultative me akterët kryesorë të vendit. Në takimin e parë kemi takuar mediat, gazetarët dhe opinionistët publikë të vendit. Në takimin e dytë kemi takuar shumicën e organizatave joqeveritare që veprojnë në Kosovë. Në të tretin kemi takuar ligjëruesit universitarë e diplomatët e Republikës së Kosovës. Në takimin e katërt kemi takuar sektorin privat në vend; përkatësisht përfaqësuesit e ndërmarrjeve që përbënin mbi tetëdhjetë për qind të vlerës së ekonomisë vendore.

Të gjitha këto takime, me qytetarë e akterë të shoqërisë nga të gjitha fushat, na kanë shërbyer për të kuptuar e ndërtuar një vizion tonin politik, që sot mban emrin “Rruga e Re”. Ky vizion, i kaluar nëpër tre cikle konsultative me ekspertët e të 27 grupeve punuese, është zberthyer në projekte të detajuara në secilin sektor. Idetë janë përbrendësuar e ndërthurur në një program qeverisës, me karakter të qendrës së djathtë, me synim të kapërcimit të madh drejt së ardhmes.

Në nëntor të vitit 2023, pothuajse 1 vit e gjysmë pas nisjes së këtij procesi, ky proces do të finalizohet me prezantimin e programit politik “Rruga e Re” në Konventën e radhës Programore të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Në vijim, tre krizat kryesore nëpër të cilat po kalon Republika e Kosovës, dhe pikëpamjet e tona konceptuale dhe programore për adresimin e sfidave të kohës.

## **TRE KRIZAT E KOSOVËS**

Në narrativen zhvillimore të kombeve, çdo vend, në momente të ndryshme të trajektores zhvillimore, përballet me sfida që përcaktojnë frymën, qëndrueshmërinë dhe fatin përfundimtar të vetë shoqërisë. Për Kosovën bashkëkohore, një trifekt i krizave të sotme hedh një hije të rëndë mbi potencialin tonë për të prosperuar në dekadën në vijim.

Së pari, polarizimi i shfrenuar i shoqërisë jo vetëm që ka thyer kohezionin thelbësor për rritjen e vet shtetit, por gjithashtu ka mbytur frymën kolektive të vet shoqërisë; siç dhe ka mbytur aspiratat individuale të secilit. Ajo që dikur ishte

një shoqëri e lidhur për nga historitë dhe aspiratat e përbashkëta, tani e gjen veten në grackën e retorikës përçarëse dhe të hendekut ideologjik. Kakofonia e disonancës kërcënon harmoninë shoqërore që është thelbësore për ndërtimin e shtetit.

Sfida e dytë urgjente është gërryerja e vetë fundamentëve mbi të cilat u parashikua dhe u ndërtua shteti i Kosovës. Kur shtyllat themelore të lirisë, demokracisë dhe identitetit pro-perëndimor të shtetit janë nën sulm, vetë fibri i shoqërisë kosovare është duke u ridefinuar; dhe kjo në vetë bart gjithë rrezikun e theqafjes për brezat e tanishëm dhe të tjerë që do të vijnë. Gjallëria e shprehjes së lirë sot është e turbullt nga frika; institucionet demokratike, të krijuara për të qenë kontrollues dhe balancues të pushtetit, po ngufaten; gjersa angazhimi i vendit ndaj integriteteve strategjike euroatlantike duket se po zbehet në vendnumërim, duke rrezikuar pozicionin tonë në teatrin më të madh global.

Së fundi, një boshllëk në politikat publike po e gjymton marshimin e vendit drejt një të ardhmeje premtuese. Në vend të strategjive proaktive për të adresuar sfidat bashkëkohore, e në vend të shfrytëzimit të mundësive që kjo epokë këtij brezi i jep, në vendin tonë ka një stagnim të dukshëm, jo vetëm të vullnetit për të bërë diçka, por dhe të ambicies për të ëndërruar shumë. Diskursi, në vend që të jetë i rrënjësor në aspiratat e së nesërme, është futur në kurth në konfliktet e së shkuarës. Kjo paralizë e politikave jo vetëm që kushton kohë të çmuar, por gjithashtu nxit një eksod dëshpërues të talentit dhe potencialit, pasi shumë kosovarë po kërkojnë horizonte më të ndritura diku tjetër.

Në përmbledhje, përderisa Kosova ka plot potencial, këto tri kriza të ndërthurura - polarizimi shoqëror, minimi i primeve themelore shtetare dhe një vakum politikash publike - shpërfaqen si sfida urgjente që kërkojnë veprim dhe përtëritje.

## I. Polarizimi shoqëror

Shoqëria kosovare sot është e polarizuar. Është e ndarë, është e përçarë e me armiqtë brenda-shoqërore nga më të ndryshmet. Kjo ndasi ushqehet nga populizmi si mjet i ekzistencës politike - ekzistencë e fuqishme dhe jo vetëm mbijetuese. Për shkak të fuqisë që shpërfaqë, polarizimi është shndërruar edhe në matës të vitalitetit partiak në vend. Ata që arrijnë të mobilizojë bazën e vetë drejt polarizimit, kanë dhe forcë politike të theksuar. Pra, thënë ndryshe, të jesh 'kundër' diçkaje e jo 'për' diçka është shndërruar në vetvete si mendim kritik dhe masë vlerësuese e aktivitetit politik.

Gjatë dekadës së fundit, kjo qasje ka qenë bazë e dhënies së alternativës opozitare. Gjersa në tri vitet e fundit, antagonizmi dhe gjithë tendenca e prodhimit të armiqtësive ndërshoqërore - janë shndërruar dhe në politika zyrtare të Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesve të saj në të gjitha nivelet - brenda dhe jashtë vendit pa dallim. Veçse, në këtë rrethanë, të mbështjella më jo si mendime opozitare, porse si vendime shtetare, ato kanë prodhuar pasoja katastrofale për vetë fatin e Republikës dhe brezit që e jeton atë.

Pushteti populist ka arritur ta ndajë shoqërinë kosovare në tabore; dhe më pas të ushqejë në vazhdimësi - e fatkeqësisht, si synim të vetëm të

angazhimit politik - dhe ndasitë në mes tyre. Ky ushqim, ndër të tjerash, është bërë nëpërmjet qëndrimeve e vendimeve zyrtare, nëpërmjet propagandës qeveritare dhe nëpërmjet mobilizimit urrejtjenxites nëpërrjete sociale.

Përfaqësuesit politikë të popullit të Kosovës janë ndarë jo më në bindje ideologjike e dallime programore, por në grupe që ose i përkasin ‘të shkuarës’ ose pushtetarëve ‘të tashëm’. Të parët, në këtë mendësi artikulimi, kanë pasur qëllime të këqija ndaj Kosovës - nga përfitimet personale e deri te tradhtia kombëtare; të dytit, ndërkaq, po në këtë vijë artikulimi, kanë vetëm qëllime të pastra. Së këndejmi, gjithnjë në këtë diapazon mendimi, çdo mjet arsyeton veprimin; dhe çdo keqveprim i tanishëm ka një arsyetim e një amnistim brenda vetë qëllimit të (parapërcaktuar si të) mirë. Në rrethana të tilla, në një ndarje kaq të thellë konsensusi politik, edhe për tema madhore për shtetin është pamundësuar. Në raste të dhëna, sidomos në përballje me Serbinë, mungesa e konsensusit politik jo vetëm që ka dobësuar pozitën e Republikës, por ka shkaktuar humbjen e memories institucionale në një ballafaqim themeltar për shtetësinë. Në rrethana të tilla, dhe ndërtimi i bashkëpunimit pozitë-opozitë në nivel qendror - e i kundërt - në nivel lokal, nuk ka qenë i mundur.

Polarizimi shoqëror është reflektuar dhe ne grupe të tjera të interesit. Më i theksuari është ai me sektorin privat dhe me mediat. Politika e përçudnuar majtiste e pushtetit populist, ka arritur të barazojë termin ‘biznes’ me ‘plaçkitje’ dhe ‘ndërmarrësinë’ me ‘hajni’; duke kurthuar kështu partneritetin shtet-sektor privat në kufijtë ekzistencialë, kundrejt një potenciali të jashtëzakonshëm që s’lejohet të marrë frymë. Në një rrethanë të tillë, udhëheqës të politikave ministrore, nuk janë të prirë drejt angazhimit për një ambient të pëlleshëm konkurrues e biznesor, por drejt ndërtimit të politikave atakuese ndaj secilit që qëllim ka krijimin e profitin - praktikisht ndaj vetë ekonomisë e pjesëmarrësve të saj.

Me të njëjtën gjuhë e qasje, janë trajtuar dhe mediat e gazetarët. Përveçse të etiketuara nën petkun e tradhtisë kombëtare e të profilizuara si përfituese financiare të shteteve me synime zhbërëse ndaj Kosovës, ato janë bërë shënjestër e persekutimit institucional deri në mbyllje. Çuditërisht, mediat kosovare kanë qenë platforma kryesore e artikulimit të propagandës publike ndaj vet tyre (dhe të tjerëve), nga eksponentë pro pushtetit.

Polarizimi shoqëror është praktikuar edhe ndaj grupeve të ndryshme shoqërore. Ndaj mësimdhënësve - si profesion madje jo vetëm si të punësuar publik; ndaj punëtorëve të administratës publike, ndaj mjekëve, gjyqtarëve, prokurorëve e secilit tjetër që ka mbrojtur pikëpamjet, bindjet e interesat vetanake - dhe së këndejmi shoqërore - përballë pushtetit. Polarizimi si mjet, ka kaluar edhe kufijtë e Kosovës. Ai është shtrirë si qasje zyrtare e Kosovës dhe në raport me fqinjët tanë, kryesisht në Shqipëri e Maqedoni të Veriut; por dhe në raport me shqiptarët në rajon - në veçanti të atyre në Luginë.

Pra, ndarja dhe jo përbashkimi janë sot vlerë. Propaganda dhe jo angazhimi janë sot mjet. Në një shoqëri kaq të ndarë, potenciali përparimtar e prosperues është jo vetëm i pashfrytëzuar, por dhe i mbytur deri në

përmasa të papërdorshmërisë për një kohë më të gjatë edhe pas kapërcimit të populizmit. Shërimi i shoqërisë nga populizmi është misioni parësor i “Rrugës së Re”.

## II. Shtyllat themeltare të Republikës

Republika e Kosovës po rrezikohet në fundament. Përveç se udhëhiqet nga mosbesues ideologjikë të saj që të ardhmen e shtetit e projektojnë në pasiguri ose fare hiç, ajo po udhëhiqet nga parime që atakojnë vlerat qenësore mbi të cilat shoqëria kosovare ka vendosur jo vetëm të mbajë veten por dhe të projektojë të ardhmen – e barabartë mes popujve evropianë. Liria, demokracia e vetë orientimi euroatlantik si trashëgimi e përpjekjes pas pavarësisë, sot janë në peshoren e fateve të zareve të pushtetit.

**Liria** individuale dhe kolektive është në rrezik. Vlerat themeltare si liria individuale, liria e fjalës, liria e shtypit, tregu i lirë dhe e drejta për mendimin ndryshe janë në rrezik. Mendimet dhe veprimet që janë në shpërputhje me bindjet e pushtetit, janë pjesë e linçimit publik dhe në raste jo të rralla edhe të persekutimit institucional me orkestrim partiak. Si rrjedhojë, akterët kosovarë sot jetojnë në frikë të përndjekjes e atakimit publik, së këndejmi dhe pa zë edhe kur sulmohen institucionalisht grupet që ata përfaqësojnë apo janë të ngjashme me ta.

Mendimi kritik e i pavarur sot është pothuajse i mbytur edhe kur Kosova përballet me përplasje që s’mund të merreshin me mend pak vite më parë. Në mungesë të mendimit substancial, diskursi publik kosovar vazhdon të ushqehet me kontaminim urrejtës e të thatë nga akterët e mbetur, që në kthim përfundojnë sërish me ushqim të frikës. Pra frika ka zëvendësuar lirinë; dhe për më tepër, diskursi alternativ është po ashtu frikë. Frika, megjithatë, nuk mundet me frikë. Mundet me shpresë. Prandaj dhe alternativa e frikës duhet të jetë e nesërmja; e lirë dhe prosperuese për individin fillimisht, dhe gjithë shoqërinë përfundimisht.

**Demokracia** kosovare vazhdon të durojë sulmet e pandërprera të tendencës autokratike po provon të instalohet në Kosovë. Parimet themelore të demokracisë mbështeten në parimin e kontroleve dhe ekuilibrave, ku degët e ndryshme të qeverisë dhe institucionet e pavarura funksionojnë në harmoni, secila mbikëqyr tjetrën për të parandaluar çdo keqpërdorim ose tejkalim të pushtetit. Në Kosovë, megjithatë, trajektorja e demokracisë duket të jetë në rrezik, e rrezikuar nga një sërë politikash dhe veprimesh qeveritare që vënë në dyshim përkushtimin e saj ndaj këtyre parimeve themelore.

Në qendër të këtyre shqetësimeve janë sulmet e vazhdueshme ndaj institucioneve të pavarura, më së shumti ndaj Gjykatës Kushtetuese. Historikisht, gjykata të tilla funksionojnë si roja të strukturës kushtetuese të një kombi, duke siguruar që ligjet dhe politikat të përputhen me parimet e mishëruara në dokumentin suprem të vendit. Kur subjektet qeveritare tentojnë të minojnë apo diskreditojnë institucione të tilla, kjo jo vetëm që kërcënon stabilitetin e një kuadri demokratik, por paraqet edhe rrezik për të drejtat dhe liritë e qytetarëve.

Për më tepër, kthimi i përsëritur i ligjeve nga ana e Gjykatës Kushtetuese zbulon një çështje më të thellë. Në vend që të ilustrojë paaftësinë e gjykatës



për të kuptuar ose mbështetur vizionin e qeverisë, ajo tregon për një mentalitet shqetësues brenda strukturës politike - një mendim që mund të jetë i gatshëm të braktisë mandatet kushtetuese për përfitime afatshkurtra ose interesa partiake. Një mendim i tillë jo vetëm që rrezikon kuadrin aktual legjislativ, por gjithashtu u hap rrugën tendencave të mundshme autokratike, ku qeveria mund të ndihet e guximshme për të miratuar ligje pa respektimin e duhur për parimet demokratike.

Po aq shqetësuese janë edhe sulmet ndaj prokurorisë. Në një demokraci funksionale, gjyqësori dhe prokuroria shërbejnë si shtylla të drejtësisë. Ata sigurojnë që sundimi i ligjit të ruhet dhe individët ose subjektet që veprojnë kundër interesave të kombit ose të drejtave të qytetarëve të tij mbahen përgjegjës. Duke sulmuar prokurorinë, ekziston një rrezik i madh për të krijuar një shoqëri ku drejtësia bëhet e përealizueshme dhe mosndëshkimi bëhet normë. Një skenar i tillë do të gërryente më tej besimin e publikut, duke çuar në zhgënjim dhe cinizëm të përhapur ndaj vetë institucioneve që synojnë t'i mbrojnë ato.

Pra, pse është kaq thelbësore mbrojtja e shoqërisë nga këto sulme?

Së pari, shëndeti dhe vitaliteti i një demokracie varet nga besimi që qytetarët e saj kanë në institucionet e saj. Nëse ky besim gërryhet, mund të çojë në një varg pasojash negative, nga mosangazhimi i qytetarit, deri te ngritja e elementëve ekstremistë që përfitojnë nga pakënaqësia mbizotëruese.

Së dyti, demokracia nuk është thjesht një sistem qeverisjeje; është një kontratë sociale. Kur qytetarët votojnë, ata ua besojnë përfaqësuesve të tyre fuqinë për të marrë vendime në emër të tyre. Ata e bëjnë këtë me shpresën se këta përfaqësues do të veprojnë brenda kufijve të përcaktuar nga kushtetuta dhe në interesin më të mirë të qytetarëve. Kur ky besim tradhtohët, ai jo vetëm që e neutralizon fuqinë qytetare, por gjithashtu mund të çojë në trazira dhe paqëndrueshmëri sociale.

Për më tepër, një demokraci e qëndrueshme dhe funksionale vepron si një fanar, duke shfaqur përfitimet e qeverisjes demokratike për rajonet dhe vendet fqinje. Duke pasur parasysh historinë e trazuar të Ballkanit, një Kosovë demokratike mund të shërbejë si shembull pozitiv për kombet e tjera në afërsi. Përkundrazi, një demokraci e lëkundur mund të destabilizojë më tej një rajon tashmë të brishtë.

Së fundi, një strukturë e dobësuar demokratike e bën një komb të prekshëm ndaj ndikimeve të jashtme. Pa kontrolle dhe balanca të forta, subjektet e huaja me interesa të caktuara mund ta kenë më të lehtë të ndikojnë në vendimet qeveritare, duke rrezikuar potencialisht sovranitetin dhe interesat kombëtare.

Si përfundim, përderisa pasojat e menjëhershme të tejkalimit të qeverisë dhe sulmeve ndaj institucioneve të pavarura në Kosovë janë evidente, pasojat afatgjata mund të jenë edhe më të thella. Si e tillë, është e një rëndësie të madhe të mbrohet infrastruktura demokratike e shtetit. Mbrojtja e shtyllave të demokracisë nuk ruan thjesht një sistem qeverisjeje, siguron që të drejtat, liritë dhe aspiratat e qytetarëve të saj të mbahen dhe

të ushqehen. Është ky premtim i demokracisë që Kosova duhet të përpiqet ta mbajë, për hir të brezave të saj të tanishëm dhe të ardhshëm.

**Orientimi euroatlantik i Kosovës**, historikisht, është konsideruar si një bosht shprese, duke sjellë një vizion të integritetit, stabilitetit dhe avancimit bashkëpunues të kombit.

Triumfet e Kosovës janë një ode e bashkërendimit Perëndimor.

Nuk mund të përshkruhet historia e arritjeve të Kosovës pa i bërë homazh aleancës tonë të thellë me Perëndimin. Rrugëtimi ynë, nëpër momentet më të rëndësishme historike – nga beteja e vështirë për liri, procesi i mundimshëm i shtet-ndërtimit, deri te shpallja e guximshme e pavarësisë dhe njohjet e mëvonshme ndërkombëtare – janë thurur në mënyrë të ndërlikuar me fijet e mbështetjes së palëkundur nga forcat perëndimore.

Shtetet e Bashkuara, me fuqinë e tyre diplomatike dhe përkushtimin e palëkundur ndaj demokracisë globale, kanë qenë një aleat i domosdoshëm, duke mbrojtur kauzën e Kosovës në skenën botërore dhe duke u dhënë rëndësi aspiratave tona. Aleanca ushtarake e NATO-s, përmes ndërhyrjeve të saja shpëtimtare dhe pranisë së qëndrueshme ushtarake, ka pasur rol jetik në ruajtjen e integritetit territorial të Kosovës dhe sigurimin e evoluimit tonë si një entitet i sigurt dhe stabil. Ngjashëm, Bashkimi Evropian jo vetëm që ka qenë një fener frymëzimi për reformat institucionale dhe shoqërore të Kosovës, por gjithashtu ka luajtur një rol kyç në rrugëtimin tonë drejt integritetit ndërkombëtar; të barabartë mes kombeve evropiane. Këto aleanca nuk kanë qenë thjesht komoditete diplomatike; ato kanë qenë themeli mbi të cilin Kosova ka ndërtuar ëndrrat e saj, duke i kthyer ato në realitete të prekshme. Në këtë përpjekje të ndërlikuar të marrëdhënieve ndërkombëtare, ecja harmonike e Kosovës me Perëndimin ka qenë performanca jonë më ndjellëse, duke dhënë progres dhe vlerësime që kanë transformuar fatin e vendit.

Megjithatë, politikat e fundit të zbatuara nga Republika e Kosovës hedhin një hije të zymtë mbi këtë trajektore, duke rrezikuar potencialisht vendin e kombit në konstelacionin euroatlantik.

Për të dalluar peshën e kësaj telashe, duhet vetëm një vështrim në vigjilencën e shtuar të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës. Masat e fundit të vendosura nga BE – pra pasojat e përkushtimit të lëkundur të Kosovës ndaj dialogut – shërbejnë si një kujtesë e ashpër e natyrës së brishtë të besimit ndërkombëtar. Kur pika kyçe e diskutit diplomatik, mekanizmit thelbësor për zgjidhjen e kompleksiteteve ndërmjet shteteve sovraane, minohet, pasojat rrallë kufizohen në zemërimin e thjeshtë diplomatik. Në vend të kësaj, ato kanë potencialin për të valëzuar strukturën e një kombi, duke ndikuar në sigurinë, ekonominë dhe pozicionin eventual në skenën ndërkombëtare. Për një shtet në konsolidim e sipër ndërkombëtar sikurse Kosova, ky ndikim është fundamental; dhe po që se është në kundërshti, edhe fatal.

Në këtë mjedis delikat, ngritja e diskurseve populiste në Kosovë paraqet një sfidë tjetër të frikshme. Populizmi, nga vetë natyra e tij, shpesh merr

frymë në emocione të zjarra dhe jo në mendime racionale. Kur flaka e një populizmi të tillë ndizet, ai pa dashje mund t'i shtyjë masat të vënë në dyshim, madje edhe të sulmojnë shprehimisht, institucionet që tradicionalisht kanë qenë bastione të stabilitetit dhe bashkëpunimit tonë kombëtar – sikurse është gjendja e tanishme e shoqërisë kosovare kundrejt aleatëve tradicionalë. Veprime të tilla pasqyrojnë një zemërim që rrezikon aspiratat e Kosovës për integrim më të thellë euro-atlantik.

Trajektorja e një kombi është e lidhur në mënyrë të pashmangshme me përkatësitë e tij ndërkombëtare. Institucionet euroatlantike nuk janë thjesht entitete simbolike; ato përfaqësojnë një konglomerat kombesh që kanë arritur arritje të jashtëzakonshme në qeverisje, aftësi ekonomike dhe mirëqenie shoqërore. Që Kosova të distancohet nga këto institucione, qoftë përmes politikës qeveritare apo ndjenjës publike, është e ngjashme me braktisjen e pasurisë së njohurive, mbështetjes dhe mundësive që ato ofrojnë; siç është dhe braktisja e mirënjohjes për historinë e përbashkët dhe të suksesshme që është arritur nëpër kohë.

Për më tepër, rajoni i Ballkanit Perëndimor ka qenë një teatër i ndryshimeve transformuese në dekadat e fundit. Ndërsa vendet fqinje e përshpejtojnë marshimin e tyre drejt shtrirjes euro-atlantike, duke shfrytëzuar mundësitë dhe përgjegjësitë që ajo ofron, qëndrimi aktual i Kosovës rrezikon ta lërë atë në një harresë anakronike. Rërat e kohës nuk presin askënd, dhe ndërsa rrëshqasin nëpër orën e rërës, kombet që nuk arrijnë të përshtaten dhe të rreshtohen me forcat progresive e gjejnë veten pa ndryshim të zbritur në periferi.

Në përmbledhje, ndërsa sovraniteti mbetet e drejta e pacenueshme e çdo kombi, zgjedhjet që burojnë prej tij mbartin implikime të thella. Kosova ndodhet në një udhëkryq – një pikë ku ajo duhet të analizojë thellë në lidhje me llojin e së ardhmes që parashikon për veten. Nëse lejon që politikat kalimtare dhe ndjenjat populiste të diktojnë kursin e saj, ajo rrezikon jo vetëm të largohet nga komuniteti euroatlantik, por edhe të rrezikojë perspektivat e saj në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur dhe konkurruese.

Për elitën politike, intelektuale e vepruese të Kosovës, barra është e rëndë. Ato mbajnë peshën jo vetëm të së tashmes, por edhe të ëndrrave dhe aspiratave të brezave të ardhshëm. Shpresa është që mençuria, largpamësia dhe përkushtimi për të mirën kolektive do t'i udhëheqin vendimet e tona, duke siguruar që Kosova të përqafojë vendin e saj të merituar brenda komitetit të kombeve përparimtare.

Dhe “Rruga e Re” ka këtë synim. Të bëjë dhe rrumbullakimin e projektit të shtetësisë, me integrim të plotë ndërkombëtar, sikurse të ndërtojë shtylla të qëndrueshme të fqinjësisë së mirë me secilin shtet veç e veç.

Projekti “Kosova shtet i pavarur e sovran, i anëtarësuar në NATO dhe BE, e me miqësi të përhershme me SHBA-të” nuk është i përfunduar. Ndonëse kemi arritur – me aleatë – lirinë e pavarësinë; ndonëse po përpiqemi në vazhdimësi shtrirjen e sovranitetit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës; do të na duhet një ringritje kombëtare për t'i dhënë frymë dhe

shpejtësi anëtarësimit euroatlantik dhe përmbylljes së obligimeve të kësaj gjenerate.

### III. Politikat publike drejt zhvillimit

Dilema kronotopike e Kosovës mbetet e kaluara si prolog për një të tashme të braktisur. Kosova sot nuk ka politikë publike. Ë kurthuar në diskutime mbi të shkuarën, e ardhmja nuk po bëhet dot. Një vend e një shoqëri që përmend më shumë vitin 2013 se sa vitin 2030 nuk ka as mendjen as energjinë ta bëjë të ardhmen.

Kjo mangësi jo vetëm që pengon trajektoren e vendit drejt rritjes dhe stabilitetit, por gjithashtu fut në grackë diskursin e tij publik në një unazë të vazhdueshme të retrospektionit historik.

Ndërsa historia e një kombi ofron mësim të paçmueshme dhe një ndjenjë identiteti, një preokupim i tepruar me të kaluarën mund të pengojë aftësinë e shoqërisë për të trajtuar sfidat e tanishme dhe mundësitë e së ardhmes. Diskursi publik i Kosovës duket se është bllokuar pikërisht këtu. Në vend të nxitjes së diskutimeve rreth çështjeve bashkëkohore, pjesa më e madhe e bisedës mbetet e rrënjosur në ngjarjet e dikurshme si material politik për mbijetesën e tashme. Ngecja në të shkuarën ka shkaktuar dhe varfërinë e aspiratave, e vetë kërkesës për më shumë.

Dhe është pikërisht varfëria e aspiratave, e besimit e vetë ambicieve - se Kosova mund të bëhet më mirë - që mbetet si parandalues i kërkesës për ndryshim. Si rezultat i varfërisë së ambicieve, diskursi publik është më i pirru të flasë e t'i përqafojë idetë më të vogla, e t'i përbuzë ato të mëdhatë.

Implikimet e kësaj perspektive të prapambetur janë të dyfishta, duke çuar në gërryerjen e dy prej aseteve më të çmuara të Kosovës: kohën dhe popullsinë tonë. Koha, nuk pret asnjë komb. Çdo moment i konsumuar nga jehona e së shkuarës, është një moment i humbur për krijimin e një të ardhmeje më të ndritshme dhe më të begatë.

Largimi i kapitalit njerëzor nga Kosova është thellësisht shqetësues. Individë të rinj, të arsimuar dhe të aftë - që shpesh përmenden si shtylla kurrizore e çdo kombi progresiv - po kërkojnë gjithnjë e më shumë mundësi jashtë vendit sepse koha nuk po ecë me pritjet që kanë. Eksodi i tyre është nxitur nga mungesa e perceptuar e diskutimeve dhe veprimeve thelbësore mbi politikat që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën dhe të ardhmen e tyre në Kosovë. Pra, mbi krijimin e shpresës ku ëndrrat dhe pikëpamjet e tyre për veten, familjen e kombin formësohen.

Politikat publike - projektet infrastrukturore, reformat arsimore, shëndetësore, fiskale e ekonomike - janë jetike për çdo vend në zhvillim. Ato jo vetëm që nxisin rritjen ekonomike përmes krijimit të vendeve të punës, por gjithashtu rrisin lidhjen e popullsisë me vendin. Në mungesë të politikave publike, me kalimin e kohës, kjo lidhje zhbëhet.

Politika publike është gurthemeli i përparimit të çdo kombi. Si tërësi, politikat publike sigurojnë drejtim, ngjallin besim dhe formësojnë vetë

të ardhmen. Dhe Kosova ka më së shumti nevojë për politika të tilla. Si vendi më i varfër në kontinent, me numrin më të madh të papunëve, me infrastrukturë më të vjetruar, vendi ynë thjeshtë ka nevojë për “kapërcimin e madh”.

Në këtë kapërcim, Kosova duhet të ndryshojë natyrën e mendimit. Të nisë të besojë dhe rrjedhimisht të kërkojë projekte të mëdha transformuese. Si një Republikë krenare, ne njohim forcën që rrjedh nga historia jonë e pasur; qoftë si vlerë, qoftë si mësim i vështirë. Megjithatë, për të siguruar një të ardhme të begatë, ne duhet të kemi fokusin në politika publike zhvillimore.

## RRUGA E RE PËR KOSOVËN

Të tri krizat e tanishme nuk janë të vetmet. Ato janë më të reja, porse gjithsesi shtresohen mbi krizat paraprake që i ka pasur Kosova. Korrupsioni, kapja e shtetit, dhe eksperimentimet me ide të rrezikshme kushtetuese e shtetare, sikurse ajo e riorganizimeve territoriale, kanë mbajtur në të shkuarën Kosovën në nivele ngufatëse. Kjo ngufatje jo rrallëherë ka zbehur në perceptim dhe sukseset e jashtëzakonshme të Republikës dhe popullit të Kosovës; nga liria, te pavarësia, konsolidimi ndërkombëtar e vetë ndërtimi i demokracisë.

“Ruga e Re” synon adresimin e krizave të tanishme, por jo me qëllim të kthimit tek ato paraprake. Përkundrazi, “Ruga e Re”, duke ruajtur me xhelozi vlerat më të mira të së kaluarës, synon ndërprerjen e theqafjes së tashme, sikurse synon evitimin e politikave të gabimeve të shkuara fatale. Angazhimi i sotëm nuk është për kthim në të shkuarën; përkundrazi, si mjet e si qëllim është ndërtimi i të ardhmes – prandaj dhe “Ruga e Re” për Kosovën.

Si parti politike, bartëse e kësaj platforme, do t’i kultivojmë e mbrojmë tutje vlerat, trashëgiminë dhe idetë identitare që përbëjnë vetë konstruktin e tonë partiak e ideologjik. Në pikëpamjet tona, dhe të popullit të Kosovës, sukseset më të mëdha të vendit kanë arritur falë platformës politike të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e cila me kohë u bë program kombëtar i popullit të Kosovës. Dhe sot, synojmë që platformën “Ruga e Re” ta ndërtojmë si mjet për afrimi përtejpartiak; si një mobilizim shoqëror e kombëtar në një moment kritik për vendin.

Lidhja Demokratike e Kosovës mbetet besnike orientimit të vet origjinal, të qendrës së djathtë, të filozofisë politike rugoviste, të mbështetjes së proceseve integruese euro-atlantike, të zhvillimit e prosperimit, të kujdestarimit pa kompromis mbi Republikën e Kosovës si projekt përfundimtar i përpjekjes së qytetarëve të Kosovës. LDK do të ndjekë këto orientime edhe në periudhën e ardhshme të veprimit të saj politik; brenda organizimit parlamentar dhe jashta saj.

Në rrafshet e historisë, ku kombet ngrihen dhe bien, dhe shoqëritë evoluojnë dhe përshtaten, kriza e ndryshimit nuk është kurrë konstante. Megjithatë, pasuria e vërtetë e një kombi mbetet aftësia e tij për të reflektuar, për t’u rigrupuar dhe për të reformuar. Ne besojmë se populli i Kosovës dhe shoqëria kosovare ka një aftësi të tillë; gjersa “Ruga e Re” është udhërrëfim për realizimin faktik të një potenciali të tillë.

## Shërimi i polarizimit shoqëror

Në vazhden e polarizimit të shtuar, ne duhet të pranojmë se ndarjet janë veçse sipërfaqësore. Poshtë saj, ne mbetemi qytetarë të të njëjtit atdhe, duke mbajtur ëndrra dhe aspirata kolektive. Polarizimi që dëshmojmë sot është një manifestim i një frike të rrënjosur thellë, të përhapur dhe të përforcuar nga retorika përçarëse publike.

Si shtetarë, përgjegjësia jonë e parë është të udhëheqim me shembull - të komunikojmë me përkujdes e të angazhohemi me ndjeshmëri. Mbi të gjitha, të kemi gjithëpërfshirje në trajtimin e çështjeve politike; qoftë me spektrin politik, ashtu dhe me grupet e interesit e palët e treta.

“Ruga e Re” thekson kthimin në ligjërim politik të respektueshëm dhe konstruktiv. Duke vendosur korniza që nxisin debatet civile dhe shmangin retorikën agresive, ne vendosëm një ton për komunikim që u jep përparësi interesave kombëtare mbi përleshjet partiake apo dhe ideologjike. “Ruga e Re” mbron iniciativat e edukimit politik që synojnë të nxisin mirëkuptimin midis njerëzve tanë. Duke sjellë fraksione të ndryshme shoqërore në dialog, ne hapim një rrugë për respekt dhe mirëkuptim të ndërsjellë; dhe me këtë dhe rezultate jo vetëm më të mira, por njëkohësisht dhe më të qëndrueshme.

Synimi ynë politik nuk do të jetë ngecja në të shkuarën; përfshirë dhe të tashmen që bëhet e tillë, por në mbylljen e dallimeve kombëtare me qëllim të fokusimit drejt të ardhmes. Nëpërmjet një diskursi të tillë politik, ne do të konceptojmë dhe vitalitetin tonë partiak - në qeverisje - jo pra më si aftësi e nxitjes së masave drejt kundërshtarëve ideologjikë e politikë, por drejt shpresës e besimit për një Kosovë që mundet më mirë.

## Mbrojtja e themeleve shtetare

Ndonëse Lidhja Demokratike e Kosovës mban epitetin e një force që promovon politikën institucionale, që respekton veprimet dhe vendimet e secilit institucion edhe kur ato drejtohen drejtpërsëdrejti kundrejt nesh apo bindjeve tona, angazhimi ynë publik për mbrojtje të lirisë, lirisë së shprehjes e vet demokracisë do të marrë rol edhe më aktiv.

Shoqëria kosovare është e kontaminuar për një kohë të gjatë me gjuhë të frikës e me politika institucionale kundrejt trupave të pavarura. Shoqëria kosovare është e ngarkuar për një kohë të gjatë me apetit për një gjuhë të tillë. Do të udhëheqim me shembull të një maturie komunikimi publik, dhe me shtytje të diskutimit publik drejt mbrojtjes së lirisë dhe vet demokracisë.

Politikat shtetërore – sidomos vendimet shtetare – do të respektojnë kornizat kushtetuese të Republikës jo vetëm pasi ato të aktivizohen shprehimisht me vendime përkatëse; por do të respektojnë si frymë e besim.

Përtej lirisë dhe demokracisë, orientimi pro-perëndimor i Kosovës, si bazament kryesor i funksionimit tonë shoqëror, do të marrë kthesën e nevojshme. Është thelbësore të pranohet se orientimi i një kombi nuk



është thjesht një çështje e qëndrimit diplomatik – ai është një pasqyrim i vlerave, aspiratave dhe vizionit të tij për qytetarinë e tij. Të largohesh nga rruga euro-atlantike do të thotë t'u mohosh qytetarëve të Kosovës vendin natyral që kanë në këtë komunitet kombesh, sikurse t'u mohosh përfitimet e panumërta që vijnë nga të qenit pjesë e një komuniteti që përkrah demokracinë, të drejtat e njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

“Rruga e Re” synon kthimin në këtë drejtim. Dhe për këtë duhet të punojë në tri drejtime elementare, të cilat ndikojnë në njëra-tjetrën njëtrajtësisht:

- **Së pari**, të riparojë pozicionin ndërkombëtar të Kosovës, në kohë të zhvillimeve monumentale në kontinent. Ky pozicion i yni nuk përkon me zhvillimet strategjike e diplomatike të një çerek shekulli më parë; dhe këtë gjë duhet ta kuptojë shoqëria jonë në radhë të parë. Pikëpamjet e komunitetit euro-atlantik ndaj regjionit të Ballkanit Perëndimor nuk favorizojnë Kosovën më shumë se vendet tjera tashmë. Në një moment të ri historik, angazhimi ynë kombëtar duhet të bëhet edhe si garë për arritje sa më parë në familjen euro-atlantike, por edhe si bashkëpunim ndër-rajonal si parakusht për këtë arritje. Mes balancit të garës dhe bashkëpunimit, mes mbrojtjes së interesave tona nacionale dhe një integrimi rajonal, mjeshtëria jonë diplomatike e politike synon të rizbulojë veçimin e pozicionit tonë në teatrin evropian si një vend demokratik, faktor stabiliteti, shtet zhvillimor e shoqëri me vlera progresive.

Sulmi verbal ndaj institucioneve ndërkombëtare do të zëvendësohet me komunikim të shëndoshë me po këto institucione të cilat Republika e Kosovës synon anëtarësim. Do të synohet në veçanti anëtarësimi në Këshill të Evropës dhe marrja e statusit të vendit kandidat në BE. Do të synohet anëtarësimi i shpejtë në organizata ndërkombëtare të sigurisë, veçmas në Interpol e Europol.

Mbi të gjitha, Kosova do të synojë anëtarësimin sa më të shpejtë në aleancën ushtarake të NATO-s; si parakusht i stabilitetit rajonal dhe si vazhdimësi e rrugëtimit tonë historik që nga nisja e përpjekjes sonë kolektive për liri, pavarësi e demokraci. Thellimi i partneritetit dypalësh me NATO-n, deri në anëtarësim të plotë në aleancë do të vazhdojë të jetë instrument kryesor i politikës së sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Kosovës, në aspektin diplomatik dhe ushtarak. Partneriteti strategjik me SHBA-të mbetet thelbësor dhe i përhershëm në këtë kontekst.

Në relacione ndërkombëtare, “Rruga e Re” nuk synon kthimin e politikës sonë të jashtme në mjet të pranimit pasiv të ideve dhe zgjidhjeve të të tjerëve. Përkundrazi, ne synojmë realizmin e qëllimeve tona kombëtare nëpërmjet një politike të jashtme aktive e nëpërmjet shtrimit të argumenteve shtetare në rast të pikëpamjeve të ndryshme.

- **Së dyti**, për të hapur dyert e rrugëtimit euroatlantik, Kosova duhet të angazhohet në procesin e dialogut politik me Republikën e Serbisë. Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj cilitdo prej fqinjëve të vet dhe pret të njëjtën pozicion dhe politikë

nga shtetet fqinje. I gjithë mjedisi rajonal i Ballkanit Perëndimor do të përmirësohet më tutje përmes njohjes reciproke të shtetësisë midis Kosovës dhe Serbisë, e cila adresohet përmes dialogut, si një proces i vazhdueshëm i moskonfrontimit dhe integritimit evropian.

Kosova i ka të qarta synimet e Serbisë, si një faktor destabiliteti, sponsorizues i aktiviteteve terroriste, e pengues i integritimit rajonal. Kosova po ashtu e ka të qartë dhe ndikimin e këtij investimi destabilizues brenda territorit të vet. Një investim i tillë e pamundëson funksionimin normal e demokratik të Republikës së Kosovës në gjithë territorin e vet. Ndërprerja e një ndikimi të tillë është interes kombëtar i Republikës së Kosovës.

Pra qëndrimi i Kosovës ndaj Serbisë është i formësuar nga hijet e zymta të historisë sonë të përbashkët dhe sfidave aktuale. Perspektiva jonë është e rrënjosur në përvojat tona të një Serbie agresive, me tendenca zhbërëse ndaj Republikës së Kosovës, e me veprime mbështetëse të aktiviteteve terroriste brenda kufijve tanë sovranë. Dallimet mes nesh nuk janë vetëm historike, por edhe vlerore, pasi ne duket se dallojmë ndjeshëm në respektimin tonë ndaj vlerave themelore njerëzore dhe aspiratave tona euroatlantike.

Megjithatë, përkundër dallimeve substanciale, përfshirja jonë e përbashkët evropiane thekson domosdoshmërinë e dialogut.

HYRJE

16

Ky dialog, në fakt, nuk është vetëm me Serbinë, por në thelb edhe me komunitetin më të gjerë ndërkombëtar, në veçanti me komunitetin euro-atlantik. Ndërsa qëllimi ynë përfundimtar është njohja reciproke, është gjithashtu thelbësore të pranojmë se rezultatet në procesin dialogues hapin rrugën tonë drejt anëtarësimit në NATO dhe BE.

Prandaj Kosova duhet të shfrytëzojë këtë momentum; jo duke u bërë faktor refuzues i dialogut, por përkundrazi, duke qenë prijës i vet adresimeve thelbësore që dy shtetet kanë. Në këtë formë, duke qenë proaktiv, pjesëmarrës e me pozicion të përmirësuar ndërkombëtar, Kosova jo vetëm që adreson çështjet e saj në raport me një shtet agresiv, por edhe komunikon përkushtimin e saj për një Evropë të qëndrueshme, të bashkuar dhe të begatë.

Për të bërë një gjë të tillë, Kosova e ka të pamundur të largohet nga detyrimet ndërkombëtare të prodhuara nga procesi paraprak i dialogut; nisur nga marrëveshjet e vitit 2013 e 2015 e deri tek Marrëveshja e Ohrit e vitit 2023. Ndonëse Lidhja Demokratike e Kosovës ka kundërshtuar elementet e Marrëveshjes së Ohrit, ne veçanti ato që lidhen me a) mosarritjen e njohjes de jure; b) karakterin bazë e jo përfundimtar të marrëveshjes; dhe c) elementet e papërcaktuara të instrumentit vetmenaxhues për komunitetin serb në Kosovë; ne njohim detyrimin ndërkombëtar ndaj Republikës së Kosovës të lindur nga po kjo marrëveshje, pavarësisht karaktereve qeverisëse të kohës.

Angazhimi ynë do të mbetet brenda kornizave implementuese



të kësaj marrëveshje, me të gjitha pjesët e saja integrale, përfshirë dhe Asociacionin Kushtetues, duke mos bërë asnjë kompromis me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, integritetin territorial të Kosovës e karakterin unitar të shtetit tonë. Në këtë rrugëtim, dhe paraprakisht, Kosova do të nisë një proces të ngushtë konsultativ me aleatët tanë – në veçanti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky proces për qëllim ka jo vetëm sigurimin e mbështetjes në nisjen e implementimeve të obligimeve ndërkombëtare të Kosovës e Serbisë, por dhe marrjen e garancive mbështetëse për rrugëtimin tonë diplomatik më pas; në veçanti në arritjen e një marrëveshjeje ligjërishit të obligueshme që ka njohjen në qendër të saj; sikurse dhe procesin e sigurimit të njohjeve nga pesë vendet mosnjohëse brenda Bashkimit Evropian.

- **Së treti**, shoqëria kosovare duhet të nisë të mendojë për integrimin e plotë të të gjitha komuniteteve jo shumicë, në veçanti të serbëve të Kosovës. Serbët e Kosovës të ardhme kanë Prishtinën. Ky shtet është i tyre po aq sa i secilit qytetar tjetër në Kosovë. Si shumicë na takon të përpiqemi më shumë se sa që përpiqet një pakicë për integrimin e vërtetë dhe të plotë në jetën publike. Çështje e vërteta, Kosova ka të drejtat më të avancuara minoritare, në rregullimin Kushtetues të saj, se sa secili shtet tjetër në rajon dhe më gjerë. Njëtrajtëshit, megjithatë, Kosova ka një pjesë të popullsisë, kryesisht në veri të vendit, tërësisht ose në masë pothuajse të plotë të paintegruar në sistemin juridik, shoqëror dhe demokratik të vendit. Veriu i Kosovës shfaqet i shkëputur nga peizazhi më i gjerë socio-politik, madje edhe krahasuar me komunat tjera me shumicë jo shqiptare. Kjo shkëputje nuk është vetëm gjeografike; është ekonomike, kulturore dhe, më e rëndësishmja, psikologjike. Mënyra se si sillemi në raport me serbët lokal, do të përcaktojë dhe përmasën e shkëputjes në të ardhmen; veçanërisht për fëmijët e rritur në një ambient të tillë. Çështja e integritetit të serbëve të Kosovës nuk ka të bëjë vetëm me akomodimin e një pakice etnike – ka të bëjë me thurjen e tyre në strukturën e identitetit tonë shtetar dhe të ardhmes kolektive. Ky nuk është thjesht një detyrim ligjor apo politik; është një imperativ moral, i rrënjosur në idealet e të drejtave të njeriut, barazisë dhe ndërtimit të kombit.

Tani, barra e tejkalimit të këtyre ndarjeve i takon kryesisht shumicës – shqiptarëve të Kosovës. Sepse në çdo shoqëri demokratike, shumica zotëron fuqi dhe ndikim të rëndësishëm, jo vetëm politik, por edhe social dhe kulturor. Me këtë fuqi vjen përgjegjësia për të siguruar që çdo qytetar, pavarësisht nga përkatësia etnike, fetare apo gjuhësore, të ndiejë një interes të barabartë në të ardhmen e vendit. Është thelbësore të pranohet se Republika e Kosovës i përket të gjithëve. Institucionet dhe narrativat e shtetit duhet të pasqyrojnë këtë pronësi të përbashkët.

Rruga drejt integritetit të vërtetë është e shumanshme dhe njëkohësisht e mundimshme. Si parakusht i këtij integrimi është largimi i bandave kriminale që kanë mbajtur peng të përplasjes e urrejtjes popullsinë civile në veri. Por largimi i këtyre bandave duhet të zëvendësohet

shpejtë me institucione demokratike që reflektojnë jo vetëm ligjet në letër, por dhe vullnetin demokratik të banorëve në veri. Prandaj komunikimi politik atje është i pazëvendësueshëm.

Integrimi ekonomik është po aq jetik. Veriu, si shumë pjesë të tjera të Kosovës, përballet me sfida të mëdha ekonomike. Duke investuar në rajon dhe duke nxitur bashkëpunime ekonomike që përshkojnë linjat etnike, ne mund të krijojmë një mjedis ku varësia reciproke çon në respekt dhe mirëkuptim të ndërsjellë. Mundësitë e punësimit, zhvillimi infrastrukturor dhe sipërmarrjet e biznesit në veri duhet të promovohen, duke siguruar që rajoni të mos mbetet prapa në marshimin e Kosovës drejt progresit.

Gjersa jemi në majë të formësimit të një Kosove euroatlantike, është thelbësore të kuptojmë se forca e një kombi nuk qëndron në homogjenitetin e popullsisë së vet, por në diversitetin e tij. Republika e Kosovës është një ëndërr e përbashkët, një përpjekje kolektive dhe është koha e fundit që ne, shumica, të marrim drejtimin për të siguruar që çdo qytetar, përfshirë serbët e Kosovës, veçanërisht ata në veri, ta shohin këtë ëndërr si të tyre. Çdo hap drejt integritetit është një hap drejt një Kosove më të fortë, më harmonike dhe më prosperuese.

- **Së katërti**, në organizimin policentrik të shqiptarëve në Ballkan, Kosovës, më shumë se çdokujt, i takon të ushtrojë kujdes ndaj shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të Kosovës, në shtetet që kanë dalë nga shpërbërja e Jugosllavisë.

Përderisa Republika e Shqipërisë e ka të normuar në Kushtetutë përkujdesjen ndaj shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë; për shkak të gjithë konteksteve historike të 100 viteve të fundit, i takon njësoj Kosovës, mbase edhe më shumë se Shqipërisë, të ushtrojë këtë përkujdes.

Kjo për faktin se Kosova ka qenë e përbashkëta historike e shqiptarëve që kanë jetuar dikur në shtetin e përbashkët të Jugosllavisë. Nën rrethanat kur Shqipëria ka qenë e izoluar dhe e paqasshme nga jashtë, gjatë periudhës, identitetet e shqiptarëve jashtë kufijve të Shqipërisë janë zhvilluar tutje duke ndërvepruar me vendndodhjen më kompakte territoriale të shqiptarëve, që ka qenë dhe është Kosova. Këtu duhet shtuar po ashtu dhe faktin e natyrshëm të lidhjeve të forta familjare që shqiptarët në Kosovë kanë sot me shqiptarët që sot jetojnë në territoret e Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Luginës së Preshevës. Për këto dhe arsye të tjera të vetëkuptueshme, Kosova duhet të ketë rol bartës dhe kujdes të veçantë për shqiptarët jashtë kufijve të saj shtetëror.

## Politika zhvillimore

Programi qeverisës “Rruga e Re” parasheh adresimin e problemeve kryesore kronike dhe të reja në Republikën e Kosovës. Por, para së gjithash, ky program synon të rijetësojë ambiciet e mëdha të shoqërisë kosovare. Këto ambicie,

kryesisht për shkak të aferave të shumta korruptive në të shkuarën dhe njëtrajtësisht për shkak të mungesës së vizionit dhe punëve konkrete – të mëdha – në të tashmen, janë zvogëluar në ambicie minimaliste e mbijetuese. Në një ambient të tillë, mirëqenia individuale dhe ajo kolektive, nuk është më në fokus.

Kosova duhet të ëndërrojë shumë. Kosova duhet të besojë në veten dhe potencialet që ka. Kosova është një vend i pasur, me potenciale më të mëdha sesa shumica e shteteve në rajon. Kurthimi në zymtësinë politike të tashmen, dhe vetëmjaftueshmëria me fokus për të shkuarën, nuk sjellë mirëqenie më të mirë.

Kosova, ky shtet me potencial të jashtëzakonshëm, është futur në kurthin e praktikave korruptive, vizionit të mangët dhe mundësive të humbura për një kohë të gjatë. Peizazhi ynë politik është dëmtuar nga një qeverisje e zhytur në populizëm dhe e preokupuar me hijet e së kaluarës, duke e lënë popullsinë të ndihet e braktisur. Projektet e mëdha, të cilat duhej të premtinin ngritjen e Kosovës në horizonte të reja, janë zbehur në sfond. Entuziazmi dhe aspirata e prekshme që dikur karakterizonte shpirtin kosovar është e humbur.

“Rruga e Re” nuk është vetëm një plan, por një zotim – një zotim për të rigjallëruar ambiciet e fjetura të Kosovës dhe të popullit të saj.

Dokumenti “Rruga e Re”, programi qeverisës, është i strukturuar në 22 kapituj dhe i shkruar nga rreth 300 profesionistë të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe jo vetëm. Ky dokument përmban zgjidhje konkrete për shumicën e sfidave në vend. Me investime kapitale shtesë prej 5 miliardë eurove për katër vite mandat, me mbi 120 projekte të mëdha në vend, ky projekt synon të japë përgjigje në sfidat e ekonomisë, drejtësisë, energjisë, sigurisë, infrastrukturës, teknologjisë, arsimit, shëndetësisë, familjes, mirëqenies, politikës së jashtme e vet integritimit euroatlantik.

Programi politik “Rruga e Re” nuk është vetëm një masë reaktive për të adresuar sfidat e Kosovës. Është një strategji proaktive, një përgjigje e fortë ndaj mungesës së politikave publike dhe një përpjekje serioze për të kompensuar inercinë e viteve.

Si dokument i gjallë, ky plotësohet e përditësohet. Por si dokument bazë, ai shërben për të projektuar Republikën e Kosovës në dekadën e ardhshme; si një vend modern, i pasur e zhvillimor, me ambicie të mëdha e me ëndrra identitare, si një shtet i pavarur e sovran, i anëtarësuar në NATO e BE e me miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në vijim, së bashku me Vizionin dhe Vlerat e Lidhjes Demokratike të Kosovës, në 22 kapitujt e Programit Qeverisës “Rruga e Re” janë shtruar të gjitha politikat tona zhvillimore.

Prishtinë, 2023

# II.

## VIZIONI DHE VLERAT E LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS





## II.

# VIZIONI DHE VLERAT E LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS

Lidhja Demokratike e Kosovës, në gjithë rrugëtimin e saj politik dhe shtetndërtues, njeh si vlerë nacionale të Kosovës përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për liri dhe pavarësi që nga fillimi, lëvizjen nacionale të viteve 1990, të udhëhequr nga themeluesi dhe Presidenti Historik i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova dhe LDK-ja, si dhe luftën çlirimtare të Kosovës.

Lidhja Demokratike e Kosovës veprimtarinë e saj e mbështetet në vlerat demokratike, si: respekti për traditën, liria, demokracia, drejtësia dhe toleranca, përgjegjësia dhe transparenca, liria e të shprehurit, si dhe liritë individuale dhe ato kolektive.

HYRJE

22

Tri vlera themelore për të cilat LDK-ja punoi që nga themelimi i saj janë: Liria, Pavarësia dhe Demokracia. Sot, LDK-ja vazhdon të angazhohet për një Kosovë sovranë, të integruar në NATO e BE dhe me miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

LDK-ja angazhohet që qytetari ta përjetojë lirinë në familje, në vendin e punës, në kohën e tij të lirë, në vendin ku jeton, në komunë dhe në shtet. Arritjet dhe prona e çdonjërit duhet të respektohen dhe të mbrohen. Liria e vërtetë e bën çdo individ të përgjegjshëm për veprimet e tij, të ndërgjegjshëm për komunitetin të cilit i takon dhe për brezat e ardhshëm. Liria, së bashku me solidaritetin dhe me përgjegjësitë për sigurimin e mirëqenies së përgjithshme, mbetet edhe sot synim i rëndësishëm i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Jetësimi i lirisë kërkon edhe drejtësi sociale dhe mundësinë e jetesës sipas vendimeve personale. LDK-ja beson se liria e vërtetë është bashkim i personalitetit të pavarur dhe i përgjegjësisë.

Pavarësinë dhe sovranitetin e vendit në tërë territorin e tij, LDK-ja e konsideron të përfunduar dhe që nuk mund të negociohet me të tjerët. Shtrirja e sovranitetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, funksionimi i ligjit, kontrolli i kufijve dhe përmbushja e kriteve nga marrëveshjet ndërkombëtare, janë sfida në rrugën e forcimit të pavarësisë dhe të shtetëndërtimit. LDK-ja punon për zgjidhjen me dialog të problemeve me fqinjët, pa e prekur sistemin kushtetues, rregullimin e brendshëm dhe kufijtë, duke ofruar të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët.

Zhvillimin demokratik të vendit LDK-ja e vlerëson si një proces jetik për

zhvillimin ekonomik dhe social, për forcimin e shtetit ligjor dhe për procesin e integrimi euroatlantike.

LDK-ja e ka objektiv ndërtimin e një Kosove evropiane, në të cilën forcohet demokracia qytetare, sundon ligji dhe respektohen të drejtat e njeriut, promovohet mirëqenia e qytetarit dhe zhvillimi ekonomik, stimulohet tregu i hapur dhe lëvizja e lirë e qytetarëve dhe e ideve, mbështetur në arsimimin modern dhe në shoqërinë e dijes, në të cilën respektohen vlerat dhe traditat e qytetarit të Kosovës.

Kosova e lirë dhe e pavarur, si një synim themelor i LDK-së, sot është realitet i njohur ndërkombëtarisht, ndërsa tani LDK-ja punon për ta forcuar dhe demokratizuar shtetin e Kosovës, për të ruajtur dhe forcuar miqësinë e përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për integrim e tij në strukturat e Bashkimit Evropian dhe në NATO.

Zhvillimi socio-ekonomik i qëndrueshëm dhe forcimi i shtetit ligjor janë parakusht për integrim të suksesshëm në këto struktura. Vetëm në këtë mënyrë Kosova, me rastin e integritit, do të ishte një vlerë e shtuar në këtë familje të madhe.

Lidhja Demokratike e Kosovës beson se dinjiteti i çdo qenie njerëzore, si parim dhe e drejtë themelore, mund të mbrohet vetëm përmes barazisë së të gjithë qytetarëve dhe mundësive të barabarta për të gjithë, pavarësisht gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe fetare. LDK-ja ndan vlerat e familjes së madhe të partive popullore evropiane, si: vlera e dinjitetit personal, e lirisë dhe përgjegjësisë, e barazisë, drejtësisë, ligjshmërisë, solidaritetit dhe subsidiaritetit.

Vizioni i LDK-së për shoqërinë është vizion për vlerat si:

a) **Promovimin e dinjitetit të çdo qenie humane për:**

- Kreativitet të lirë të qytetarëve në të gjithë sektorët dhe jetën sociale;
- Rolin e familjes, edukimit dhe jetën në komunitet;
- Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve minoritare, solidaritetin me grupet e cenushme dhe të moshuarit;
- Respektin për jetën në të gjitha format dhe moshat;
- Respektimin e dinjitetit human në mjekësi dhe rregullave etike gjatë aplikimit të rezultateve shkencore.

b) **Mbështetja e familjes, e të rinjve dhe e gruas**

Familja luan rol kyç në ndërtimin e një shoqërie demokratike, prandaj LDK-ja, si parti e qendrës së djathtë, angazhohet për fuqizimin e këtij institucioni. Brenda familjes mësohen virtytet sociale, obligimet reciproke, besimi dhe përgjegjësia. Vlerat familjare janë themelore për zhvillimin e individit, por edhe për unitetin social.

Brenda familjes, LDK-ja angazhohet për barazi të plotë gjinore.

LDK-ja është e bindur se rinia është pasuria më e madhe e Kosovës, rinia është burimi kryesor i zhvillimit ekonomik dhe potenciali kryesor për ndërtimin e shtetit demokratik e të qëndrueshëm.

Për më tepër, LDK-ja angazhohet për mbrojtjen efektive të të drejtave të fëmijëve, duke krijuar kushte të përshtatshme që ata të mund ta shpalosin personalitetin e tyre dhe të ushtrojnë virtytet e mësuara, të kenë institucione, të cilat do të funksionojnë në mënyrë të përshtatshme, duke i përgatitur në rrugën e edukimit dhe arsimimit në një ambient të sigurt.

LDK-ja e synon një Kosovë të njerëzve të lirë dhe të përgjegjshëm, të aftë që të ndërtojnë të ardhmen, të zgjedhin punën, të vendosin për ngritjen e familjes dhe rritjen e fëmijëve të tyre, bazuar në idetë dhe vlerat e tyre. Ne synojmë një shoqëri në të cilën të gjithë njerëzit e rinj, kanë mundësi të shkollohen dhe të marrin edukim dhe dije cilësore. Ne dëshirojmë një shoqëri në të cilën njerëzit e rinj kanë punë, që atyre ua mundëson që të jenë të pavarur dhe të ngrisin familjet e tyre. Ne dëshirojmë një shoqëri në të cilën asnjëri nuk mbetet prapa, sepse çdo njeri ka vlera të paçmueshme dhe sepse mirëqenia e çdo qytetari është mirëqenie e të gjithë qytetarëve dhe mirëqenie e shoqërisë në përgjithësi.

LDK-ja beson veçanërisht në veprimin afirmativ, i cili siguron barazi efektive ndërmjet burrave dhe grave, për të siguruar qasje të gruas në jetën publike, në punë dhe në pozitat dhe përgjegjësitë më të larta. Barazia më e madhe efektive ndërmjet burrave dhe grave, e bën vendin tonë edhe më të drejtë, por edhe më perspektiv.

### c) **Ekonomia e tregut dhe zhvillimi**

LDK-ja beson se iniciativa private, konkurrenca dhe tregu i hapur janë forcat kryesore që sigurojnë prosperitet ekonomik. Në këtë aspekt, roli i Parlamentit dhe i Qeverisë është të ofrojnë një kornizë ligjore brenda së cilës zhvillohen këto aktivitete. E drejta për ndërmarrësi të lirë dhe për të realizuar fitim gjithashtu involvon edhe obligimin apo solidaritetin ndaj të gjithë atyre që përfshihen direkt ose indirekt në atë aktivitet ndërmarrës. Përmes interaksionit të ndërmarrësve me shtetin, institucionet financiare, arsimore dhe trajnuese dhe politikave sociale, mundësohet kohezioni i brendshëm i ekonomisë dhe i shoqërisë.

Bazuar në këtë, LDK-ja angazhohet fuqishëm për forcimin e ekonomisë së tregut në Kosovë, për promovimin e konkurrencës dhe integrimin në tregje rajonale dhe globale. Fryma e ndërmarrësisë, që është pjesë e filozofisë dhe e mbijetesës së popullit të Kosovës ndër vite, duhet të promovohet në të gjitha politikatat.

Politikat ekonomike të LDK-së do të krijojnë kushte për përmirësim të cilësisë së jetës të të gjithë qytetarëve. Zhvillimi ekonomik do të zë vend qendror në politikatat e qeverisjes së LDK-së. Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të përfitojnë nga sistemi gjithëpërfshirës zhvillimor në vend. Ofrimi i shërbime publike cilësore dhe ndërtimi i institucione transparente mbeten çështje parimore në qeverisjen e LDK-së.

Sfida kryesore për qeverisjen e ardhshme mbetet transformimi i ekonomisë së Kosovës nga një ekonomi e bazuar në import, në një ekonomi të bazuar në prodhim vendor, promovim të eksportit dhe të dijes. Në këtë drejtim, fokusi do të drejt fuqizimit të sektorëve me këtë potencial.

Politikat ekonomike të LDK-së synojnë krijimin e kushteve të barabarta për



investime, përmes infrastrukturës rrugore, teknologjisë informative, energjisë dhe ujit, edukimit a aftësimin, shtetit ligjor e të drejtë, në mënyrë që të krijohen kushtet për një zhvillim harmonik dhe që të tejkalohen diferencat regjionale të Kosovës.

Po ashtu, investimet e huaja luajnë rol kyç në rritjen e potencialeve prodhuese të ekonomisë kosovare. LDK-ja beson se rritja e kapaciteteve prodhuese, krijimi i vendeve të punës, përmirësimi i bilancit tregtar, si dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe i shërbimeve arrihet më shpejt përmes politikave që e bëjnë Kosovën vend-destinim për investitorë të jashtëm.

LDK-ja angazhohet për eliminimin e barrierave ligjore dhe burokratike, që e pengojnë zhvillimin e hovshëm të biznesit, duke promovuar lirinë e lëvizjes së njerëzve, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve. Korniza ligjore duhet të vlerësohet në baza të rregullta për efektet e saj dhe të ndryshojë në përputhje me zhvillimet në treg.

LDK-ja vlerëson se tatimet e larta dekurajojnë investimet produktive dhe dëmtojnë punësimin. Tatimet duhet të jenë aq sa nevojitet për të mbuluar funksionet thelbësore të shtetit, duke i lënë qytetarët dhe bizneset të vendosin vetë për formën e investimit të të ardhurave të tyre. Aplikimi i një sistemi të thjeshtë tatimor mbetet prioritet i LDK-së, duke respektuar parimet e drejtësisë dhe trajtimit të barabartë të tatimpaguesve nëpërmjet shpërndarjes së barrës tatimore proporcionalisht.

#### d) **Forcimi i shtetit dhe integrimi euroatlantik**

Shteti i Kosovës duhet të forcohet për qytetarët e tij, t'i mbështesë ata në përpjekjet e tyre fillimisht për të siguruar të ardhura, të sigurojë që asnjë qytetar të mos mbetet pa qasje në arsim, shëndetësi, përkujdesje sociale dhe shërbime të tjera publike; e më pas dhe të ndihet dhe jenë të barabartë mes popujve të komunitetit euro-atlantik.

Kosova ka nevojë ta zërë hapin me zhvillimet evropiane në secilin drejtim. Prandaj forcimi i shtetit, brenda dhe jashtë pa dallim, është prioritar.

LDK-ja angazhohet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare mbi baza të interesave ekonomike dhe shtetërore. Interesat tona kombëtare përputhen me integrimin e plotë të Republikës së Kosovës në NATO dhe BE.

Prandaj, sigurimi i njohjeve nga pesëshja e shteteve të BE-së, anëtarësimi në Këshill të Evropës, në organizata të rendit e sigurisë (INTERPOL e EUROPOL), marrja e statusit të vendit kandidat fillimisht, hapja e kapitujve e anëtarësimi i plotë në BE përfundimisht, sikurse dhe anëtarësimi sa më i shpejtë në NATO, e marrja e ulëses në OKB mbesin prioritete identitare të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Kosova, si një shtet i ri evropian, ndihet pjesë e familjes evropiane dhe, si e tillë, kultivon vlerat e paqes, demokracisë, prosperitetit, zhvillimit dhe bashkëpunimit rajonal. LDK-ja angazhohet për arritjen e kriterëve të përcaktuara nga BE-ja për integrimin e Kosovës.

LDK-ja beson se promovimi dhe krijimi i institucioneve profesionale dhe

efikase, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e pakicave, do ta përshpejtojë integrimin e Kosovës në BE dhe në NATO dhe në marrjen e ulëses në OKB. LDK-ja angazhohet që shteti i Kosovës të harmonizojë politikat e veta me ato të komunitetit euroatlantik.

LDK-ja angazhohet për zhvillimin e kapaciteteve që do të sigurojnë kredibilitetin e Kosovës në skenën politike dhe ekonomike ndërkombëtare. Suksesi në procesin e njohjeve mund të arrihet vetëm me institucione të forta, efikase dhe të afta për të përfaqësuar interesat shtetërore ndërkombëtarisht dhe për ta arsytuar luftën e drejtë të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi, si dhe me përkrahjen e miqve tanë të përhershëm. Pjesëmarrja dhe anëtarësimi i Kosovës në organizma shumëpalësh mbetet prioritet për LDK-në.

LDK-ja angazhohet që Kosova, si një vend sovran dhe i pavarur, të kontribuojë në fuqizimin e bashkëpunimit rajonal, me qëllim të promovimit të stabilitetit dhe prosperitetit rajonal, në frymën e synimeve për integrim evropian. Fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi konkret rajonal janë vlera të promovuara dhe të kultivuara përherë nga LDK-ja dhe paraqesin themelin e dimensionit të ri ndërkombëtar të Kosovës.

Politika e jashtme e LDK-së dhe e Kosovës, që nga fillimi, është e lidhur me partnerin e përhershëm strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Partneriteti forcohet me Bashkimin Evropian nëpërmjet procesit të integritimit. Politika e jashtme e LDK-së dhe e Kosovës duhet të jetë e koordinuar me Republikën e Shqipërisë, duke pasur parasysh interesat strategjike të shqiptarëve, në rajon dhe në Evropë.

#### e) **Shteti ligjor, mbrojtja dhe lufta kundër kriminalitetit**

LDK-ja është e vendosur për luftimin e pakompromis të kriminalitetit, korrupsionit, krimit të organizuar, krimit ekonomik, trafikimit të qenieve njerëzore dhe formave dhe llojeve të tjera të kriminalitetit.

LDK-ja është e përkushtuar për mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të Kosovës, të mishëruara në Kushtetutë dhe në konventa e akte të tjera ndërkombëtare, që janë drejtpërdrejt të aplikueshme në Kosovë. Barazia e qytetarëve para ligjit, gjykimi i drejtë, mosdiskriminimi, e drejta pronësore, liria e siguria, dinjiteti i njeriut dhe të drejtat e tjera qytetare janë themelet e rendit kushtetues e ligjor në Kosovë.

LDK-ja synon që sistemi i drejtësisë dhe i sigurisë që në Kosovë të jetë funksional, profesional, i depolitizuar, i integruar dhe i shtrirë në tërë territorin e vendit, në përputhje me standardet evropiane në fushën e ligjit dhe të sigurisë. Sistemi i drejtësisë dhe të sigurisë duhet të jenë në shërbim të të gjithë qytetarëve.

LDK-ja angazhohet për reformimin e vazhdueshëm të sistemit gjyqësor drejt një sistemi të pavarur, efikas dhe kredibil, që është garant i sundimit të ligjit dhe i mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive qytetare, të garantuara me ligjin vendor dhe ndërkombëtar. LDK-ja angazhohet për ngritjen dhe profesionalizimin e gjyqtarëve dhe garantimin e mirëqenies dhe të sigurisë së tyre.

LDK-ja angazhohet për reformimin e vazhdueshëm të organit të akuzës dhe fuqizimin e saj, si parakusht për luftimin efikas dhe efektiv të kriminalitetit.

LDK-ja është e përkushtuar për një prokurori të pavarur dhe të paanshme, me qëllim që, pa kompromis, t'i luftojë të gjitha format e kriminalitetit, duke mbrojtur vlerat më vitale të qytetarit dhe të shoqërisë. LDK-ja është e angazhuar për mbështetjen e profesionit të pavarur të avokatit.

LDK-ja angazhohet që forcat e sigurisë dhe të policisë të kenë ngritje të vazhdueshme profesionale dhe modernizim me pajisje konform standardeve të NATO-s dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë përkatës. LDK-ja angazhohet për ruajtjen e interesit publik dhe sigurisë kombëtare përmes mbështetjes të një inteligjence të profesionale dhe të depolitizuar. Për shkak të ndjeshmërisë së sferës së sigurisë, LDK-ja angazhohet për rregullimin dhe kontrollimin demokratik të sistemit të sigurisë, duke e harmonizuar atë me konventat ndërkombëtare nga kjo fushë.

## f) **Energjia dhe ambienti**

LDK-ja është e vetëdijshme për rëndësinë e energjisë për zhvillimin ekonomik. Dhe, mbi të gjitha, LDK-ja është e vetëdijshme se energjia, para se të jetë çështje ekonomike, është çështje e sigurisë.

Prandaj, pavarësia energjetike e Kosovës, sikurse dhe orientimi energjetik drejt aleatëve strategjik, mbetet prioritar. LDK-ja angazhohet për një shfrytëzim optimal të burimeve energjetike që ka Kosova, si një e mirë publike edhe për brezat e ardhshëm, duke përmbushur kriteret evropiane ambientaliste. Përtej burimit tradicional të thëngjillit, LDK-ja angazhohet dhe në përdorimin e gazit, të ujit, diellit, erës dhe burimeve të tjera të përtëritshme për prodhim të energjisë.

Në sektorin e minierave, LDK-ja angazhohet për qasje strategjike të shfrytëzimit të pasurive minerale. Vendimet për të ardhmen e minierës së Trepçës dhe minierave të tjera të rëndësishme strategjike, do të bazohen në strategji të qartë që reflektojnë interesat ekonomike dhe shtetërore të Kosovës. LDK-ja konsideron se vendimmarrja për të ardhmen e pasurive natyrore të Kosovës, shfrytëzimin dhe menaxhimin e tyre duhet të jetë përgjegjësi e Parlamentit të Republikës së Kosovës.

Ruajtja e ambientit është një obligim dhe zotim për mirëqenien e brezave të ardhshëm. LDK-ja angazhohet për strategji që përcakton vlerat kufitare për lirin e gazrave, kriteret për mbrojtjen e ujërave, ajrit dhe të tokës nga ndotja dhe përdorimi i teknologjisë që mbron klimën. Kursimi i energjisë, ngritja e efikasitetit të energjisë dhe shfrytëzimi i energjisë riprodhuese do të jenë shtylla bartëse të politikës sonë për mbrojtje të ambientit dhe të klimës. LDK-ja do të angazhohet edhe për strategjitë të përshtatshme të shfrytëzimit të tokave nën kushte të ndryshueshme klimatike. Ruajtja e pasurive pyjore dhe investimet në gjelbërimin e zonave, do të jetë me prioritet të veçantë.

## g) **Shoqëri e dijes dhe teknologjisë**

Vizioni i LDK-së është që Kosova të zhvillohet drejt një shoqërie të dijes, të integruar në rrjedhat evropiane të arsimit dhe të shkencës. Një shoqëri e tillë ndërtohet përmes mundësive të barabarta për arsim dhe zhvillim personal për të gjithë qytetarët. LDK-ja angazhohet për një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe të shoqërisë.

LDK-ja do të ofrojë mundësi që të rinjtë të bëjnë zgjedhjen për arsim të përgjithshëm ose profesional, në përputhje me objektivat dhe interesin e tyre dhe tregun e punës.

LDK-ja do të përkrahë zhvillimin e sektorit privat në arsim në të gjitha nivelet, përfshirë dhe sidomos fokusuar në trajnime profesionale, dhe do të zhvillojë politika të një konkurrence të fortë ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, duke respektuar vlerat evropiane dhe ato botërore të arsimit.

LDK-ja vlerëson se duhet të promovohet shkencën dhe hulumtimet, të mbështeten projektet dhe publikimet e instituteve shkencore dhe të përkrahen hulumtimet shkencore të institucioneve të pavarura shkencore dhe të atyre të arsimit të lartë. LDK-ja njeh zhvillimet e fundit në drejt të Inteligjencës Artificiale, dhe e sheh këtë zhvillim si një mundësi të madhe të vendit për kapërcimin e madh në relacion me veten dhe me shtetet rajonale.

Karshi sfidave të kohës dhe vizionit për shoqëri të dijes, LDK-ja njeh domosdoshmërinë e digjitalizimi të plotë të shkollave, sikurse dhe domosdoshmërinë e krijimit të standardeve për vlerësim dhe monitorim të brendshëm të cilësisë së arsimit.

LDK-ja angazhohet për rritje permanente të buxhetit të arsimit, duke marrë parasysh popullsinë e re të Kosovës dhe nevojat më të mëdha për edukim dhe aftësim. Pjesëmarrja e shpenzimeve për arsim në Bruto Produktin Vendor (BPV) dhe në shpenzimet e përgjithshme qeveritare duhet të sillet mbi mesataren evropiane, për shkak të specifikave demografike të Kosovës.

HYRJE

28

LDK-ja angazhohet për zgjidhjen e drejtë dhe avancimin e statusit të punonjësit të arsimit në të gjitha nivelet dhe të bëjë përmirësim rrënjësor të kushteve të punës.

## h) **Shëndeti dhe përkujdesi**

LDK-ja e ka prioritet të lartë zhvillimin dhe avancimin e sistemit shëndetësor. Bazuar në standardet evropiane, LDK-ja promovon një sistem shëndetësor efikas dhe të mbështetur në resurse të qëndrueshme, që siguron qasje të barabartë në shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët.

LDK-ja angazhohet për një menaxhim të integruar të shëndetësisë në të gjitha nivelet, me sisteme të qarta dhe efikase të referimit. LDK-ja vlerëson se Kosova ka nevojë për një reformë thelbësore në shëndetësi; reformë që do të sigurojë shpërndarje adekuate të infrastrukturës mjekësore dhe të kuadrit mjekësor në gjithë territorin e vendit. Ndërtimi i një sistemi informatik funksional për shëndetësi që integron të gjithë aktorët është hapi i parë drejt kësaj reforme.

Financimi i qëndrueshëm i shëndetësisë, do të sigurohet përmes zgjerimit të burimeve financiare, nëpërmjet shtimit të fondeve publike për shëndetësinë, aplikimit të skemës së sigurimeve shëndetësore, si dhe promovimit të partneritetit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat. LDK-ja beson se skema e financimit duhet të reflektojë rritjen e cilësisë së shërbimeve, të cilat do të jenë të përballeshme për qytetarët.

LDK-ja angazhohet për integrim të tërësishëm të sistemit shëndetësor në të gjithë vendin, si dhe arritje të standardeve ndërkombëtare sa i përket numri të personelit mjekësor në raport me popullatën. Mbi të gjitha, LDK-ja angazhohet për infrastrukturë moderne shëndetësore si parakusht i shërbimeve të mira.

LDK-ja promovon forcimin e ekonomisë së tregut dhe zhvillimin ekonomik si mjet kryesor për zbutjen e varfërisë dhe të papunësisë. Megjithatë, LDK-ja është e vetëdijshme se sa është i nevojshëm të sigurohet një solidariteti ndërshoqëror, përmes politikave ekonomike rishpërndarëse të të ardhurave. LDK-ja angazhohet për politika aktive sociale dhe promovon ndërmarrësinë për të zvogëluar varësinë, nga skemat sociale. Prandaj, si mjet për zbutjen e papunësisë dhe rrjedhimisht varësisë nga programet sociale, do të promovohen iniciativat ndërmarrëse të të rinjve dhe të grave.

Për të siguruar një mbrojtje sociale të qëndrueshme, skema pensionale duhet të organizohet në format të ri, që jo vetëm që ofron qëndrueshmeri financiare, por dhe ofron garancion gjithëpërfshirës dhe dinjitet përfitimi për të gjithë.

## i) **Kultura dhe sporti**

LDK-ja angazhohet për ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore më përfaqësuese kombëtare dhe për këmbime të këtyre vlerave me komunitetin e madh evropian, në radhë të parë, por edhe me kulturat e tjera.

Në strategjinë e zhvillimit të kulturës, LDK-ja do të përfshijë komplementaritetet me Shqipërinë dhe trojet e tjera shqiptare. LDK-ja promovimin e vlerave kulturore brenda vendit do ta realizojë si nevojë shpirtërore, por edhe si nevojë të arsimimit kulturor, duke ruajtur dhe kultivuar identitetin kombëtar.

LDK-ja angazhohet të krijojë një model të ri qeverisës për kulturën, në përputhje me praktikat më të mira evropiane. Në menaxhimin e institucioneve lokale dhe qendrore kulturore dhe në vendimmarrjen e këtyre institucioneve, do të rritet pjesëmarrje e njerëzve të kulturës.

LDK-ja do të përkrahë dhe të nxisë krijuesit e rinj, organizatat profesionale dhe joprofesionale kulturore me qëllim të masivizimit të veprimtarisë kulturore. Forcimi i relacioneve me shtetet e tjera dhe i projekteve të përbashkëta, përmes së cilave promovohen vlerat kulturore të Kosovës dhe përmirësohet imazhi i vendin do të jenë me prioritet për LDK-në.

LDK-ja do të shtojë investimet në infrastrukturën kulturore dhe në zhvillimin e institucioneve të kulturës në Kosovë. LDK-ja angazhohet për politika institucionale, të cilat afirmojnë dhe kultivojnë librin dhe veprimtarinë botuese, sidomos botimin e veprave kapitale të trashëgimisë nacionale të Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi.

LDK-ja angazhohet që, përmes sportit, të përfaqësohet dhe të afirmohet më tej shteti i Kosovës në botë, si dhe të forcohet kohezioni nacional.

LDK-ja angazhohet për masivizimin e sportit përmes investimeve në infrastrukturën sportive, në mbështetjen e iniciativave të të rinjve dhe të talentëve të rinj.

LDK-ja angazhohet për promovimin e sportit shkollor dhe universitar, si mjet i masivizimit të sportit. LDK-ja angazhohet në zhvillimin e sistemit të sportit në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe Kodit të Etikës në Sport dhe promovon pjesëmarrjen në sporte dhe në gara ndërkombëtare.

## j) **Shqiptarët në rajon dhe mërgatë**

LDK-ja, me Presidentin Rugova, e zhvilloi dimensionin politik të shqiptarëve në një program nacional, i cili synonte lirinë për vete dhe për të tjerët, jetën në paqe dhe harmoni. LDK-ja parimet e saj i mbështet në stabilitetin politik rajonal dhe në perspektivën integruese. Këto parime mbeten shumë aktuale edhe sot.

LDK-ja, që nga themelimi, ka promovuar politika demokratike në botën shqiptare. Edhe tash e në të ardhmen, LDK-ja do të promovojë integrimet demokratike shqiptare në të gjitha fushat e jetës: ekonomi, arsim, kulturë dhe politika të përgjithshme integruese që paqtojnë shqiptarët dhe rajonin tonë.

LDK-ja do të angazhohet për bashkëpunim të ngushtë me partitë politike shqiptare në Kosovë, në Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Medvegjë, Preshevë dhe Bujanoc, si dhe me bashkatdhetarët tanë jashtë vendit, për këmbimin dhe afirmimin e vlerave demokratike kombëtare, si pjesë të demokracisë evropiane. LDK-ja vlerëson thellimin e marrëdhënieve ndërshtetërisht si faktor thelbësor për ruajtjen dhe kultivimin e traditës, historisë, gjuhës, feve dhe në këmbimin e këtyre vlerave me popujt e tjerë në Evropë dhe në botë.

LDK-ja e sheh si pasuri kombëtare mërgatën tonë. Kontributi i saj historik dhe i tashëm, ndiqet me një potencial të jashtëzakonshëm profesional tek gjenerata e tretë në mërgatë. Këtë potencial LDK-ja e sheh si pasuri të cilën duhet ta shfrytëzojë.

Po ashtu, LDK-ja e sheh organizmin e arsimit plotësues në gjuhën shqipe, aktivitetet kulturore në kryeqendrat botërore, kontributin diplomatik të mërgatës tonë, sikurse dhe investimet në Kosovë, si prioritet kombëtar të Kosovës dhe së këndejmi të qeverisjes së LDK-së.



# III.

## PROGRAMI QEVERISËS I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS







# PËRMBAJTJA

---

<b>1.</b>	<b>EKONOMI DHE FINANCA</b>	<b>40</b>
1.1	RRITJE EKONOMIKE 5%	43
1.2	BUXHET 5 MILIARDË EURO	43
1.3	KOEFICIENT 150	43
1.4	PRIVATIZIM I TELEKOMIT DHE LIBERALIZIM I TREGUT	44
1.5	ZHVILLIMI I QENDRËS SË SKIJIMIT NË BREZOVICË	44
1.6	ZHVILLIMI I QENDRËS SË SKIJIMIT NË PEJË	44
1.7	INSPEKTORATI I PUNËS	45
1.8	AVIOKOMPANI KOMBËTARE	45
1.9	POLITIKAT TATIMORE	45
1.10	NDRYSHIM I LIGJIT TË PROKURIMIT	45
1.11	PRIVATIZIMI	46

---

<b>2.</b>	<b>ENERGJIA</b>	<b>50</b>
2.1	NDËRTIMI I CENTRALIT ME GAZ 500 MW	53
2.2	GAZIFIKIMI I KOSOVËS	53
2.3	REHABILITIMI I TERMOCENTRALIT KOSOVA B	53
2.4	ENERGJIA E RIPËRTËRITSHME	53
2.5	EFIÇENCA ENERGJETIKE	54
2.6	INFRASTRUKTURA REZERVË	54
2.7	MBYLLJA E KOSOVËS A	55
2.8	INTEGRIMI RAJONAL DHE LIBERALIZIMI I TREGUT ENERGJETIK	55
2.9	PLAN KOMBËTAR PËR VETURA ELEKTRIKE	55
2.10	ZERO TVSH NË ENERGJI	55
2.11	DYFISHIMI I PROJEKTIT TË KOOGJENERIMIT	56

---

<b>3.</b>	<b>DIGJITALIZIMI DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE</b>	<b>60</b>
3.1	AFTËSIM I FUQISË PUNËTORE	63
3.2	TECH FONDI	63
3.3	PARKU TEKNOLOGJIK	64
3.4	REFORMË LIGJORE	64
3.5	ANGAZHIMI I SEKTORIT NË PUNËT PUBLIKE	64
3.6	INTELEJENCA ARTIFICIALE	65
3.7	LIGJI PËR ANGEL INVESTORS	66
3.8	PRANIMI I TRAJNIMEVE SI INVESTIME	67
3.9	THEMELIMI I MINISTRISË SË TEKNOLOGJISË	67

---

<b>4.</b>	<b>INFRASTRUKTURA</b>	<b>72</b>
4.1	PËRFUNDIMI I TË GJITHA MAGJISTRALLEVE AKTUALE	75
4.2	PËRFUNDIMI I AUTOSTRADËS SË PEJËS	75
4.3	PËRFUNDIMI I AUTOSTRADËS SË ANAMORAVËS	75
4.4	NDËRTIMI I UNAZËS SË JASHTME TË KRYEQYTETIT	75
4.5	NDËRTIMI I 200 VENDNDALJEVE RAJONALE	76
4.6	VAZHDIMI I AUTOSTRADËS "IBRAHIM RUGOVA" DERI NË MERDAR	76
4.7	UJI DHE UJËRAT E ZEZA	76
4.8	INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE	76

---

<b>5.</b>	<b>FAMILJA DHE MIRËQENIA</b>	<b>80</b>
5.1	5000 EURO PËR FËMIJËN E TRETË	83
5.2	SKEMA PËR TË POSALINDURIT	83
5.3	FORMIMI I MINISTRISË SË FAMILJES DHE MIRËQENIES	83
5.4	INCENTIVA PËR BANIM	84

---

**6. SHËNDETËSIA 86**

6.1	QENDRA E RE SPITALORE	91
6.2	FONDI I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE	91
6.3	SISTEMI INFORMATIV SHËNDETËSOR	92
6.4	PAJISJE TË REJA MJEKËSORE	92
6.5	DECENTRALIZIMI I SHSKUK	92
6.6	MENAXHIM I KONTRAKTUAR	93
6.7	LISTA E PRITJES	93

---

**7. ARSIMI 102**

7.1	PROGRAMI KOMBËTAR PËR EDUKIM TË HERSHËM	105
7.2	KLASË ME 20 NXËNËS	105
7.3	PILOT PROJEKTII MËSIMI TËRËDITOR	105
7.4	PROGRAMI KOMBËTAR PËR DIGJITALIZIM	106
7.5	RIORGANIZIMI I RRJETIT TË SHKOLLAVE	106
7.6	PROVIM KOMBËTAR PËR MËSIMDHËNËS TË RINJ	107
7.7	TRAJNIMI I MËSIMDHËNËSVE AKTUAL	107
7.8	FORCIMI I FAKULTETIT TË EDUKIMIT	108
7.9	KODIMI SI LËNDË E SHKOLLAVE FILLORE	108
7.10	SHKOLLA NË QENDËR	109
7.11	PERFORMANCA E MËSIMDHËNËSVE	109
7.12	ARSIMI PROFESIONAL DHE TREGU I PUNËS	109
7.13	RANGIMI DHE PROFILIZIMI I INSTITUCIONEVE	110
7.14	FONDI PËR HULUMTIME SHKENCORE DHE FONDI I EKSLENCËS	110

---

**8. MBROJTJA 114**

8.1	PARTNERITETI PËR PAQË DHE INTEGRIMI NË NATO	117
8.2	RRITJA E BUXHETIT NË 2% TË BRUTO PRODUKTIT VENDOR	117
8.3	RISTRUKTURIMI I FSK-SË	117
8.4	ARSIMIMI USHTARAK NË SHKOLLA CIVILE	117
8.5	NDËRTIMI I 4 KAZERMAVE USHTARAKE	118
8.6	NDËRTIMI I VENDBANIMEVE PËR PERSONELIN USHTARAK	112
8.7	SMART DEFENCE	118
8.8	KRIJIMI I KAPACITETEVE PËR OPERACIONE NDËRKOMBËTARE	119
8.9	ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË LUFTËS KIBERNETIKE	120
8.10	PENSIJONIMI DHE TRANZICIONI I PJESËTARËVE TË FSK-SË	120

---

**9. RENDI DHE SIGURIA 124**

9.1	RISTRUKTURIMI I POLICISË SE KOSOVËS	127
9.2	POLICIMI NE BASHKËSI	129
9.3	INFRASTRUKTURA POLICORE	129
9.4	RISTRUKTURIMI I MPB-së	130
9.5	RISTRUKTURIMI I IPK	131
9.6	AME DHE RREGULLIMI I STATUSIT TË ZJARRFIKËSVE	132
9.7	PËRFORCIMI I KËSHILLIT TË SIGURISË SË KOSOVËS	132

---

**10. DREJTËSIA 136**

10.1	VETINGU NË SISTEMIN E DREJTËSISË	139
10.2	INTEGRITETI I SISTEMIT TË DREJTËSISË	140
10.3	QENDRA SHTETËRORE E HETIMIT	140
10.4	DIGJITALIZIMI I PROCESEVE NË DREJTËSI	141
10.5	GJYKATA ADMINISTRATIVE DHE E KONTESTEVE TË PUNËS	142
10.6	AVANSIMI I PROFESIONEVE TË LIRA	142
10.7	FUQIZIMI I SHËRBIMIT SPROVUES	143
10.8	FUQIZIMI I SHËRBIMIT KORREKTUES	143
10.9	VRASJET POLITIKE	144
10.10	DOKUMENTIMI DHE TRAJTIMI I KRIMEVE TË LUFTËS	145

# PËRMBAJTJA

---

## 11. INTEGRIMET EUROATLANTIKE 148

11.1	RITHEMELIMI I MINISTRISË PËR INTEGRIM EVROPIAN	151
11.2	KËSHILLI KOMBËTAR PËR INTEGRIM	151
11.3	INSTITUCIONET PËR INTEGRIME EVROPIANE	151
11.4	ANËTARËSIMI RAJONAL	152

---

## 12. POLITIKA E JASHTME 156

12.1	FORCIMI I SUBJEKTIVITETIT NDËRKOMBËTAR	159
12.2	ANËTARSIMI NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE	159
12.3	THEMELIMI I 5 QENDRAVE KULTURORE	159
12.4	RRITJA E KAPACITETEVE DIPLOMATIKE	160
12.5	DIPLOMACIA DIGJITALE	160
12.6	REFORMA DHE RIORGANIZIMI I SHËRBIMIT	161
12.7	REFORMA LEGJISLATIVE	162

---

## 13. SPORTI 166

13.1	NDËRTIMI I QËNDRËS KOMBËTARE TË SPORTIT	169
13.2	NDËRTIMI I STADIUMEVE RAJONALE	169
13.3	FONDI SPORTIV SHKOLLOR	169
13.4	THEMELIMI I NDËRMARJES SPORTIVE	169
13.5	PALESTRAT RAJONALE	170
13.6	LOJRAT OLIMPIKE MESDHETARE	170

---

## 14. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE MJEDISI 174

14.1	PËRDITËSIMI I PLANIT HAPËSINOR DHE HARTËS ZONALE	177
14.2	PLANET MENAXHUESE PËR ZONAT E MBROJTURA DHE TË VEÇANTA	177
14.3	MBIKËQYRJA RIGOROZE E NDËRTIMEVE	178
14.4	INVESTIMET ME INTERES STRATEGJIK	179
14.5	INSPEKTIMI I OBJEKTEVE	179
14.6	DIGJITALIZIMI I PLOTË I PROCESIT TË NDËRTIMIT	180
14.7	LICENCIMI I ARKITEKTËVE DHE INXHINIERËVE	180
14.8	AMANDAMENTIMI KUSHTETUES PËR MJEDIS TË SHËNDETSHËM	181
14.9	STANDARDET KOMBËTARE TË MJEDISIT	181
14.10	THEMELIMI I EKO-FONDIT	182

---

## 15. BUJQËSIA 186

15.1	SUBVENCIONET BAZUAR NË OUTPUT	189
15.2	GRANTET	189
15.3	FINANCIMI I NORMËS SË INTERESTI	189
15.4	HEQJA E AKCIZËS NË NAFTË	189
15.5	CILËSIA E USHQJMIT	190
15.6	SISTEMI I UJITJES	190
15.7	SIGURIMET BUJQËSORE	190
15.8	PYJET	191
15.9	MBROJTJA DHE SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I TOKËS BUJQËSORE	191
15.10	MBROJTJA DHE VALORIZIMI I RESURSEVE PYJORE	191
15.11	DIVERSIFIKIMI RURAL DHE KRIJIMI I VENDEVE TË REJA TË PUNËS	191

---

<b>16. KULTURA</b>	<b>196</b>
16.1 TEATRI I OPERAS DHE BALETIT	199
16.2 NDËRTIMI I OBJEKTIT TË TEATRI KOMBËTAR TË KOSOVËS	199
16.3 NDËRTIMI I MUZEUT TË ARTIT BASHKËKOHOR	199
16.4 THEMELIMI I QËNDRËS SË LIBRIT	199
16.5 THEMELIMI DHE NDËRTIMI I MUZEUT TË PAQËS DHE TË REZISTENCËS	200
16.6 PAVARËSIMI I INSTITUCIONEVE KULTURORE NË KOSOVË	200
16.7 TRASHËGIMIA KULTURORE E KOSOVËS	200
16.8 QËNDRA MULTIFUNKSIONALE PËR ART DHE KULTURË	201
16.9 EDUKIMI I HERSHËM PËRMES ARTIT DHE KULTURËS	201

---

<b>17. ADMINISTRATA PUBLIKE</b>	<b>204</b>
17.1 STRUKTURA E QEVERISË	207
17.2 SHËRBIME TË INTEGRUARA DHE TË DIGJITALIZUARA	207
17.3 REKRUTIM I CENTRALIZUAR	208
17.4 NGRITJE E KAPACITETEVE TË SHËRBIMIT CIVILË	208
17.5 THEMELIMI I INSPEKTORATIT SHTETËROR	208
17.6 PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SË ADMINISTRATËS PUBLIKE	209

---

<b>18. QËVERISJA LOKALE</b>	<b>212</b>
18.1 PROGRAMI KOMBËTAR PËR QËVERISJE LOKALE	215
18.2 GRANTI I INVESTIMEVE KAPITALE	215
18.3 VENDIMMARRJA KOMUNALE	216
18.4 RISHIKIMI FUNKSIONAL	216

---

<b>19. MËRGATA</b>	<b>220</b>
19.1 THEMELIMI I AGJENCISË PËR DIASPORË	223
19.2 MËSIMI SHQIP	223
19.3 KORNIZA E INVESTIMEVE NGA DIASPORA	223
19.4 SHKËMBIMI I NJOHURIVE	223
19.5 AMBASADORËT KULTURORË	224
19.6 POLITIKAT INTEGRUESE DHE TË KTHIMIT	224
19.7 DIASPORA NË KOSOVË	224
19.8 BASHKËPUNIMI ME SHOQATAT SHQIPTARE	224

---

<b>20. TREGTI DHE INDUSTRI</b>	<b>228</b>
20.1 HAPJA E TREGTISË ME TREGJE TË REJA	231
20.2 ZYRET MBËSHTETËSE NË MISIONET DIPLOMATIKE	231
20.3 POLITIKA FISKALE DHE ZHVILLIMI INDUSTRIAL	232
20.4 TRUPA MONITORUESE TREGTARE	232
20.5 POLITIKË E RE INDUSTRIALE	233
20.6 UNIONI I BIZNESEVE TË DIASPORËS	234
20.7 INTEGRIMI EKONOMIK RAJONAL BRENDA PROCESIT TË BERLINIT	234

---

<b>21. POLITIKA SOCIALE DHE PENSIONALE</b>	<b>238</b>
21.1 PASTRIMI I LISTËS SË PENSIONEVE	241
21.2 ARKITEKTURË E RE PENSIONALE	241
21.3 HAPJA E TREGUT PENSIONAL	242

---

<b>22. SEKTORI FINANCIAR</b>	<b>246</b>
22.1 QËNDRA KOMBËTARE PËR PROCESIMIN E PAGESAVE	249
22.2 LIGJI PËR FONDET INVESTIVE	249
22.3 SISTEMI I PAGESAVE	249
22.4 FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE	250
22.5 TREGU I SIGURIMEVE	253

PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# EKONOMI DHE FINANCA







# EKONOMI DHE FINANCA

## KONTEKSTI

Mungesë e investimeve kapitale, mungesë e projekteve të mëdha transformuese të vendit, deficit i lartë tregtar, papunësi e lartë e të rinjve dhe e grave, rritje rekorde e çmimeve e rritje e papërballueshmërisë, mungesë e konkurrueshmërisë së bizneseve në sektorin privat në raport me bizneset rajonale – janë disa nga karakteristikat e ekonomisë kosovare sot. Ajo vazhdon të nënperformojë dhe, në çdo parametër matës, të jetë në nivelet më të ulëta në rajon. Derisa një pjesë e problemeve ekonomike të Kosovës ka natyrë strukturore, kryesisht të shtresuar nëpër vite, një pjesë e madhe e sfidave ekonomike të vendit tonë janë të krijuara nga paaftësia e Qeverisë për realizimin e projekteve dhe politikave adekuate për vendin.

Përgjatë tri viteve të fundit, investimet kapitale në vend kanë shënuar nivelet më të ulëta historike. Realizimi i tyre është në jo pak dikaster qeverisës, investimet janë në shifra krejtësisht njëshifrore. Mungesa e investimeve të tilla, e shoqëruar me mungesë vizioni transformues të vendit, ka sjellë një cikël problemesh ekonomike, që nisnin nga ulja e konkurrueshmërisë së bizneseve vendore e deri tek ikja masive e fuqisë punëtore. Kosova nuk ka sot një vizion të qartë e të guximshëm transformues, që do ta dërgonte atë në nivele të reja zhvillimore, me kthim në përmirësimin e standardit të jetesës së qytetarëve dhe marrjen e produkteve e të shërbimeve më kualitative.



Deficiti tregtar në Kosove vazhdon të jetë rreth 5 miliardë euro; rritja ekonomike në nivele të pamjfatueshme (2-3% në mesatare), përderisa ekonomia kosovare vazhdon të varet nga remitencat (rreth 1.2 miliardë euro) dhe skemat sociale (rreth 600 milionë euro).

Bizneset vendore vazhdojnë të jenë më pak të konkurrueshme në tregje rajonale, përderisa fuqia punëtore vazhdon – në shkallë të madhe – të mos marrë aftësitë e domosdoshme të kohës.

Aktiviteti ekonomik në vend është shoqëruar me qasje armiqësore të qeverisë ndaj ndërmarrësisë si e drejtë, bizneseve si aktorë dhe e konceptit të profitit si filozofi ekonomike. Investitorët privatë e bizneset vendore janë bërë cak i sulmeve politike nga udhëheqës shtetëror e udhëheqës të dikastereve qeverisëse. Sulmi ndaj tyre ka dekurajuar jo vetëm aktivitetin ekonomik në vend, por dhe të drejtën individuale e njerëzore për të pasur e për të bërë aktivitetet lirshëm, në pronën e lirë dhe shtetin e tyre. Lidhja Demokratike e Kosovës ka mision të vetin politik që të inkurajojë fillimisht iniciativën private në rend të parë të bartësit të zhvillimit ekonomik.

# PLANI YNË PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Plani ynë për ekonominë është i orientuar drejt partneritetit të fortë me sektorin privat në vend. Si parti e qendrës së djathtë, LDK-ja e konsideron sektorin privat si gjenerator të aktivitetit ekonomik, si burim kryesor të krijimit të vendeve të reja të punës dhe si shtytës qenësor të prosperitetit e mirëqenies kombëtare. Roli i shtetit në ekonomi, në pikëpamjet e LDK-së, është i një rregullatori në situata të mungesës së konkurrencës dhe i një krijuesi të një ambienti të sigurt për investime.

Disa nga projektet tona kryesore në fushën e ekonomisë dhe të financave janë të përfshira në kapitujt e energjetikës; infrastrukturës rrugore, sektorit financiar e në bujqësi. Në këtë kapitull ne shtrojmë planet tona të ndërlidhura kryesisht me buxhetin e vendit, pagat në sektorin publik, trajtimin e sektorit privat, si dhe menaxhimin e aseteve publike, për të kaluar në stadin e ri zhvillimor të vendit. Për të fuqizuar sektorin privat, si gjenerator i punësimit, do të ndërmerren këto masa: rritja e formalitetit përmes skemës së kthimit të një pjese të TVSH-së qytetarëve; mbështetja financiare e sektorit të ICT-së; rritja e kapaciteteve të inkubatorëve të biznesit, në veçanti për firmat në sektorin e shërbimeve; mbështetje për ndërmarrjet e orientuara drejt eksportit; ndihmë e drejtëpërdrejtë ndërmarrjeve në certifikim të produkteve, përmes skemës së vaucherëve; riorganizimi i Fondit për Inovacione për të ofruar grante për investime për NVM që bëjnë inovacione; rritja e kapacitetit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, funksionalizimi i zonave industriale nëpërmjet avancimin të menaxhimit të tyre nga ana e vetë bizneseve; përkrahje financiare për biznese për të rinjtë, femrat dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë, si dhe fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të Autoritetit të Konkurrencës, për të fuqizuar konkurrencën në treg. Synimet tona janë:

## 1.1 RITJE EKONOMIKE 5%

Lidhja Demokratike e Kosovës synon që në mesatare Kosova të shënojë rritje reale ekonomike nga 5% çdo vit; duke sjellë vlerën e Bruto Produktit Vendor të Kosovës në rekord të ri prej 13-14 miliardë euro. Një rritje e tillë ekonomike do të arrihet kryesisht duke zhbllokuar potencialin investues të Kosovës nëpërmjet investimeve publike dhe atyre private. Projektet e mëdha kapitale në vend, nga infrastruktura e deri tek energjetika, nga sporti deri te kultura, nga arsimi deri te shëndetësia e nga partneritetet publiko private e deri te grantet ndërkombëtare, do të jenë infuzion i rëndësishëm i ekonomisë vendore në katër vitet që kap ky plan. Po ashtu, krijimi e prodhimi vendor, në veçanti në industri me vlerë të lartë të shtuar, do të rrisë eksportin e shërbimeve (kryesisht në fushën e IT) dhe mallrave të Kosovës.

Kjo rritje ekonomike, nuk do të përkthehet vetëm në vlerë të re të koncentruar të ekonomisë së Kosovës, por do të përkthehet në vende të reja të punës – në veçanti për të rinjtë e të rejtat.

## 1.2 BUXHET 5 MILIARDË EURO

Lidhja Demokratike e Kosovës synon që në fund të mandatit të parë dhe të plotë qeverisës, Buxheti i Republikës së Kosovës të arrijë në 5 miliardë euro. Me një rritje reale mesatare ekonomike prej 5% në vit, vlera e ekonomisë së Kosovës pritet të jetë rreth 13-14 miliardë euro. Në proporcion të deritanishëm një me tre të buxhetit me ekonominë e vendit, vlera e gjithmbarshme e buxhetit pritet të jetë rreth 5 miliardë euro, nën supozimet e një inflacioni jo më të lartë se 2%.

Një buxhet i tillë siguron mbulueshmëri të mirë të të gjitha projekteve kapitale të parapara në planin tonë. LDK-ja synon që investimet kapitale si proporcion të buxhetit të gjithmbarshëm t'i mbajë në nivel prej 30%, në vijë me mesataren e vendeve në rajon. Në këtë proporcion, nga buxheti i gjithmbarshëm për katër vite prej 16 miliardë eurove, rreth 5 miliardë euro do të ndahen për investime kapitale, mjaftueshëm për të mbuluar investimet më të mëdha të paraqitura në këtë plan.

## 1.3 KOEFICIENT 150

Duke marrë parasysh që gjatë mandatit të fundit kemi pasur ngritje enome të çmimeve, derisa pagat nuk kanë ndryshuar, Qeveria e LDK-së që në javën e parë të qeverisjes do ta ndryshoj koeficientin e pagave nga 110 euro sa është sot në 150 euro.

Në vitin e parë të qeverisjes pjesëmarrja e faturës së pagave në buxhetin e tërësishëm do të jetë rreth 29%, por kjo do të ulët në vitet vijuese, duke marrë parasysh faktin se programi ynë parasheh rreth 5 miliardë euro investime kapitale të cilat do të kenë efekte pozitive në sektorin privat dhe në të hyrat buxhetore. Një rritje e tillë e pagave, krijon kushte më të mira për shërbyes civil dhe tërë administratën publike, gjë që mandej do të përkthehet në shërbime më të mira publike, me theks të veçantë në shëndetësi, arsim, rend dhe ligj.

Po ashtu, nuk do të ketë asnjë pension nën 150 euro.

## 1.4 PRIVATIZIM I TELEKOMIT DHE LIBERALIZIM I TREGUT

LDK-ja shtetin nuk e sheh si aktor biznesi; përkundrazi, e sheh si ndërtues dhe garantues i kushteve të tregut. Së këndejmi, plani ynë parasheh privatizimin e aseteve publike, që janë shndërruar jo vetëm në barrë shtetërore për shoqërinë, por njëkohësisht nuk po arrijnë të ofrojnë kushte konform zhvillimeve teknologjike të kohës.

Ndër asetet – dhe rrjedhimisht – tregjet me potencial në nënvlerësuar është edhe ai i Telekomit të Kosovës. Një aset publik me kaq shumë pjesëmarrje në treg, nuk arrin t'i ofrojë Kosovës as për së afërmi shërbimet dhe përfitimet financiare që ky treg ofron gjithandej nëpër rajon dhe Evropë. Prandaj, plani ynë parasheh privatizimin e Telekomit të Kosovës në përmasën prej 51%, përderisa pjesa prej 49% do të mbetet në pronësi publike. Dhe jo vetëm kaq, dy vite pas privatizimit, plani ynë parasheh liberalizimin e tregut me futjen e së paku dy operatorëve të rinj në treg, me qëllim të krijimit të konkurrencës së mirëfilltë të operatorëve në vend. Kjo konkurrencë do të ofrojë shërbime shumëfish më të mira dhe më të lira për qytetarët tanë.

Përfitimet nga privatizimi dhe njëkohësisht nga liberalizimi i tregut, nëpërmjet dy licencave të dhëna, do të përdoren për investime kapitale në sektorë të tjerë, me qëllim që brezi aktual i shoqërisë kosovare t'i ketë përfitimet e merituar për një standard më të mirë jetese dhe një mirëqenie më të lartë kombëtare.

## 1.5 ZHVILLIMI I QENDRËS SË SKIJIMIT NË BREZOVICË

Një ndër resurset me potencialin më të madh zhvillues turistik, ai i Brezovicës, vazhdon të mbetet pa investime kapitale të nevojshme për transformim rrënjësor, që do ta shndërronin në qendrën më të madhe të skijimit në vend, në atraksion turistik dhe ofrues të shërbimeve për qytetarët e Kosovës.

Plani ynë parasheh investime private në këtë qendër, në vlerë prej rreth 80 milionë eurove, me qëllim të modernizimit të kompleksit. Këto investime parashihen për zgjerimin dhe krijimin e shtigjeve të reja të skijimit, në standardet më të larta evropiane; pajisje me teleferikë të rinj dhe modernë, si dhe qendra përcjellëse hotelierike. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve do të sigurohen nga sektori privat, nëpërmjet Partneritetit Publiko-Privat. Pas aranzhimeve financiare, rreth 25% e pronësisë në këtë park do të mbetet në pronësi publike.

## 1.6 ZHVILLIMI I QENDRËS SË SKIJIMIT NË PEJË

Qendra Turistike e Skijimit në Pejë do të jetë një destinacion i mrekullueshëm për të gjithë dashamirësit e skijimit, snowboarding-ut, çiklizmit dhe natyrës. Pozicioni gjeografik i Qendrës Turistike në Pejë është një avantazh i madh për qytetarët dhe për turistët që do ta vizitojnë. Është vetëm 900 metra larg qendrës së qytetit të Pejës, çfarë e bën atë një destinacion të arritshëm lehtë për banorët e qytetit dhe vizitorët nga rajoni dhe më tej. Më e rëndësishmja është se kapaciteti i qendrës ofron aktivitete të ndryshme për të gjitha stinët e vitit. Nga ski dhe snowboarding në dimër, deri te ecjet në natyrën e bukur të Bjeshkëve të Nemuna në verë, ky projekt do të ofrojë mundësi për të gjithë pa përjashtim. Brenda mandatit parashihet që në këtë qendër të investohen rreth 50 milionë euro.

## 1.7 INSPEKTORATI I PUNËS

Kosova sot ka numrin më të ulët të inspektorëve të punës. Me vetëm 40 inspektorë, të shpërndarë në gjithë Kosovën, mbikëqyrja e kushteve të punëtorëve dhe kompensimi i drejtë i tyre, sipas Ligjit të Punës, është i pamundur. Plani ynë parashihet rritjen e pesëfishit të numrit të inspektorëve të punës përgjatë katër viteve të para. Të 200 inspektorët e rinj, të shpërndarë në tërë vendin, do të sigurohen që të punësuarit në sektorin privat kanë kontrata pune dhe që kompensimi i tyre bëhet konform planit 40 orë në javë; me pagesë shtesë për cdo orë përtej kësaj vlere.

Shtimi i numrit të inspektorëve është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e trajtimit të punëtorëve në sektorin privat, që punojnë në jo pak raste deri në 7 ditë në javë, pa kompensime shtesë, dhe pa pushime respektive të përcaktuara sipas ligjeve përkatëse në vend.

## 1.8 AVIOKOMPANI KOMBËTARE

Plani ynë parash themelimin e aviokompanisë së parë kombëtare, me një flotë avionësh prej 4 deri në 8 sosh. Kjo aviokompani – në pronësi publike dhe private – do të sigurojë fluturime të rregullta mes Aeroportit të Prishtinës dhe vendeve me diasporë të theksuar shqiptare.

Kostoja e gjithmbarshme e blerjes së avionëve të rinj, marrjes me qira dhe themelimit të vet kompanisë do të jetë rreth 70 milionë euro, kontribut i Qeverisë. Rreth 100 milionë euro të tjera do të sigurohen nga investimet private, që do të bëhen pjesë e këtij konzorciumi.

## 1.9 POLITIKAT TATIMORE

Politikat tatimore do të avancohet, me qëllim që të sigurojë mbledhje efikase të të hyrave, shpërndarje të barabartë të barrës tatimore dhe luftim të informalitetit. Pakoja Fiskale 2.0 do të përfshijë lehtësira të metutjshme për të gjitha bizneset, në veçanti për bizneset prodhuese dhe eksportuese. Kjo pako do të merret me krijimin e strukturave për mbledhjen e TVSH-së brenda vendit; avancimin e sistemit të rimbursimeve; nxitja e bizneseve që të veprojnë në sektorin formal duke thjeshtuar procedurat e deklarimeve tatimore dhe rritur përfitimet e operimit në sektorin formal.

Rritja e formalitetit përmes skemës së kthimit të një pjese të TVSH-së qyteatrëve do të jetë prioritet i planit tonë. Ky projekt do të jetë i digjitalizuar, ku në secilën blerje përmes një QR, kodi blerësit do të mund të marrin mbrapa 2% të TVSH-së, kjo do të ndikojë në rritjen e formalitetit dhe krijimin e një ambienti për konkurrencë të drejtë në vend.

Heqja e TVSH-së për shportën bazë të konsumit dhe heqja e TVSH-së në energji elektrike.

## 1.10 NDRYSHIM I LIGJIT TË PROKURIMIT

Prokurimi në vendin tonë është një nga pengesat kryesore, në ekzekutim të investimeve kapitale, furnizim me mallra e shërbime dhe mbështetje të kompanive vendore. Po ashtu, ligji aktual as nuk shquhet për transparencë, as mungesë të mundësive për manipulim dhe korrupsion. Programi ynë synon që të ndryshojë ligjin, duke rritur transparencën, efikasitetin dhe efektivitetin e procedurave të prokurimit, si dhe krijimin e mbështetjes së kompanive vendore aty ku ka mundësi.

## 1.11 PRIVATIZIMI

Rishikimi i legjislacioni që rregullon funksionimin e AKP-së. Përcaktimi i një afati kohor kur duhet të përmbyllet procesi i privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore. Do të hartohet një strategji kombëtare, të cilën do ta aprovojë Kuvendi i Republikës së Kosovës, për përdorimin e fondeve të grumbulluara nga privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore. Gjithashtu do të bëhet rishikimi i bazës ligjore për të ngritur efikasitetin e trajtimit të kërkesave të kreditorëve potencialë.





PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TE KOSOVES

# ENERGJIA



RRUGA E RE  
*për Kosovën*



## KONTEKSTI

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, energjia është çështje e sigurisë, siç është dhe çështje e stabilitetit furnizues. Rrjedhimisht, përveç ngritjes së kapaciteteve gjeneruese, që do të jepnin më pas garanci për një stabilitet afatgjatë furnizimi, energjia do të trajtohet dhe nga prizmi i kontrollit të burimeve të prodhimit dhe importeve eventuale të lëndës së parë për prodhim; gjithmonë në përputhje me interesat kombëtare të Kosovës.

Gjenerimi momental i energjisë elektrike në Kosovë nuk plotëson nevojat e konsumit vendor në të gjitha sezonet, veçanërisht në sezonin e ftohtë të vitit. Së këndejmi, mungesa e energjisë elektrike, si ndër faktorët themelorë dhe të domosdoshëm të aktivitetit ekonomik, po frenon zhvillimin ekonomik në vend. Kjo mungesë e bën sektorin privat prodhues dhe shërbyes jokonkurrues me sipërmarrjet rajonale, evropiane dhe ato globale.

Termocentralet e stërvjetëruara të Kosovës (Kosova B rreth 60 vjet, Kosova A rreth 40 vjet), kapacitetet e ulëta të energjisë së ripërtitshme dhe kriza energjetike në kontinentin evropian, filluar në sezonin e ftohtë 2021/2022, ka bërë edhe më të qartë dhe më të domosdoshme nevojën e Republikës së Kosovës për furnizim të qëndrueshëm dhe të përballueshëm me energji elektrike, që kërkon planifikim të duhur dhe veprime konkrete. Nevojat momentale në sezonin e ftohtë arrijnë deri në 1.400 MWh, ndërsa kapacitetet ekzistuese nuk mund të furnizojnë rrjetin me më shumë se 900 MWh, në rastin e përdorimit të plotë të tyre.

Për më tepër, projeksionet energjetike të Kosovës nuk mund të bëhen në bazën aktuale të prodhimit. Me rritjen e aktivitetit ekonomik të Kosovës, në veçanti

me rritjen e bazës e presupozuar të prodhimit në vend, si rezultat i zhvillimit të ardhshëm ekonomik të Kosovës, vendi ynë duhet të ketë kapacitete prodhuese që arrijnë stabilitet dhe siguri deri në prej 1800-2000 MWh.

Strategjia e tanishme Energjetike nuk parasheh ndonjë ndryshim substancial në kapacitetet gjeneruese të Kosovës. Ajo madje nuk merr për bazë as domosdoshmërinë e sigurimit të stabilitetit energjetik në periudhë afatmesme. Projekti i vetëm aktual, i rëndësisë së veçantë, është ai i baterive energjetike, financuar nga Millenium Challenge Corporation (MCC), i cili pritet të funksionalizohet nga fundi i vitit 2029. Dhe atëherë bateritë nuk zëvendësojnë prodhimin. Ato janë veçse depo e mbledhjes së energjisë elektrike, që duhet të prodhohet diku tjetër fillimisht. Kosova ka nevojë për prodhim.

Përveç kësaj, Kosova prodhon mbi 90% të energjisë së saj ekskluzivisht nga qymyri - përkatësisht linjiti - një burim i ndotjes së ambientit në përmasa shqetësuese për banorët e regionit të Prishtinës. Rrjedhimisht, tranzicioni energjetik drejt burimeve të ripërtrishme energjetike mbetet i pazëvendësueshëm. Kjo, jo vetëm si kërkesë e rrugëtimit euroatlantik të vendit - normuar tashmë nëpërmjet Agjendës së Gjellbër, Procesit të Berlinit e Traktatit të Komunitetit të Energjisë - por dhe si domosdoshmëri e kohës dhe nevojave të qytetarëve tanë. Prandaj, përtej sigurisë e stabilitetit, programi ynë synon dhe pastërtinë energjetike si qëllim afatgjatë i Republikës së Kosovës.

Çështja e energjisë s'mund të trajtohet ndaras prej çështjes së ngrohjes. Sot, rreth 80% e energjisë elektrike që konsumohet nga amvisëria përdoret për ngrohjen e ujit dhe hapësirave të banimit, kurse energjia termike nga ngrohja qendrore mbulon vetëm rreth 3-5% të kërkesës për ngrohje. Për më tepër, Kosova ka një intensitet të lartë energjetik që është rreth katër herë më i lartë se mesatarja e Bashkimit Evropian. Pra, ndërtesat, kryesisht pa izolim, janë joefiçente, rrjedhimisht ato shpenzojnë shumë lëndë djegëse për të arritur shumë pak ngrohje. Prandaj, ngrohja duhet të jetë pjesë e pandashme e konceptit të zgjidhjes energjike në Kosovë.

# PLANI YNË PËR ENERGJINË

Plani ynë parasheh rritjen e kapaciteteve gjeneruese në nivele të vetëqëndrueshme për nevojat e amvisërisë dhe të industrisë, jo vetëm për nevojat momentale, por veçanërisht për dekadat në vijim. Furnizim i bollshëm, cilësor dhe i përballueshëm me energji elektrike për të gjithë qytetarët dhe bizneset në Kosovë është qëllimi ynë. Njëkohësisht, planifikojmë dhe rritjen e pjesëmarrjes së burimeve së ripërtrishme në miksin energjetik. LDK-ja synon tranzicion të drejtë energjetik, duke pasur interesat e qytetarëve në qendër të politikave. Plani ynë parasheh po ashtu ulje të konsumit të energjisë elektrike përmes zhvillimit të programeve për efikasitet të energjisë. Projektet prioritare që do të sigurojnë sasi, cilësi dhe vetëqëndrueshmëri të gjenerimit të energjisë elektrike të përballueshme janë:

Ndërsa Kosova ndodhet në këtë pikë kyçe, familja mbetet simboli i saj më i fuqishëm i unitetit, qëndrueshmërisë dhe shpresës. Ne besojmë se duke kuptuar sfidat me të cilat përballen familjet dhe duke i mbështetur ato në mënyrë proaktive, ne mund të hartojmë një rrugë drejt një të ardhmeje jo vetëm të begatë, por edhe të rrënjosur thellë në vlerat dhe traditat që kanë përcaktuar gjithmonë kombin tonë. Këto janë politikat ona kryesore:



## 5.1 5000 EURO PËR FËMIJËN E TRETË

Në qendër të politikave tona, “Paketa Financiare për Fëmijun e Tretë” shfaqet si një simbol i fuqishëm i përkushtimit tonë për të rigjallëruar peizazhin demografik të Kosovës. Duke njohur sfidat financiare me të cilat përballen familjet në ekonominë e sotme dinamike, kjo paketë nuk ka të bëjë vetëm me ofrimin e mbështetjes ekonomike, por edhe me ngjalljen e optimizmit dhe shpresës. Një grant prej 5000 eurosh për çdo fëmijë të tretë nuk është thjesht një përfitim monetar, por një deklaratë. Ai tregon një prioritet kombëtar dhe një vlerë shoqërore që u vendoset familjeve, veçanërisht atyre që aspirojnë të rriten.

Me kalimin e viteve, kufizimet ekonomike shpesh kanë ardhur në rrugën e dëshirës së natyrisht të familjeve për t’u zgjeruar. Kostot e lidhura me rritjen e fëmijëve, nga arsimi te kujdesi shëndetësor, janë rritur vazhdimisht, ndonjëherë duke tejkalluar të ardhurat mesatare të familjes. Duke ofruar këtë paketë financiare, ne po trajtojmë një shqetësim të prekshëm me të cilin përballen shumë prindër. Por, përtej lehtësimit ekonomik, ne po dërgojmë një mesazh të qartë: Kosova i vlerëson familjet e saj dhe është e përkushtuar të investojë në të ardhmen e saj. Kjo paketë ka të bëjë sa me të tashmen, sa i përket lehtësimit financiar, aq edhe të së ardhmes, duke siguruar që çdo i treti fëmijë i lindur të shihet si një shenjë shprese dhe prosperiteti.

Rreth 30-35 milionë euro vlerësohet të jetë kostoja e kësaj pakoje.

## 5.2 SKEMA PËR TË POSALINDURIT

Mirëpritja e një anëtari të ri në familje është një rast i jashtëzakonshëm gëzimi, por vjen edhe me një numër sfidash. Duke njohur një mori kostosh fillestare me të cilat përballen prindërit, nga pelenat dhe pajisjet për fëmijë te kujdesi shëndetësor dhe ushqimi, “Skema e Mbështetjes Thelbësore për të Porsalindurit” është krijuar për të lehtësuar këto barra. Viti i parë i jetës së një fëmije nuk është vetëm themelor për rritjen e tij fizike dhe njohëse, por është gjithashtu një periudhë përshtatjeje dhe lidhjeje për të gjithë familjen. Presionet financiare nuk duhet t’i lënë në hije këto momente të çmuara.

Duke ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse gjatë kësaj faze, Lidhja Demokratike e Kosovës synon të sigurojë që viti i parë i çdo foshnjeje të shënohet me rehati, siguri dhe gëzim. Kjo politikë nuk ka të bëjë thjesht me ndihmën ekonomike, por me prioritizimin e mirëqenies së qytetarëve tanë më të rinj. Ajo u dërgon një sinjal të fortë prindërve se shteti qëndron me ta, krah për krah, ndërsa ata lundrojnë në sfidat dhe gëzimet e prindërimit. Duke zbutur vështirësitë financiare, ne aspirojmë të krijojmë një mjedis ku prindërit mund të fokusohen në lidhjen, edukimin dhe sigurimin e kujdesit më të mirë për të porsalindurit e tyre.

Rreth 30 milionë euro vlerësohet të jetë kostoja e kësaj pakoje.

## 5.3 FORMIMI I MINISTRISË SË FAMILJES DHE MIRËQENIES

Duke e njohur rëndësinë parësore të mirëqenies familjare dhe individuale, Lidhja Demokratike e Kosovës propozon formimin e Ministrisë së Familjes dhe Mirëqenies. Kjo ministri do të shërbejë si pikë qendrore për të gjitha politikat,

nismat dhe programet me në qendër familjet dhe mirëqenien e përgjithshme shoqërore.

Duke institucionalizuar përkushtimin tonë ndaj familjeve, ne synojmë të sjellim një qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar për të adresuar sfidat e shumëanshme që ato përballen. Nga hartimi i politikave që mbështesin familjet më të mëdha, duke ofruar përfitime ekonomike, duke garantuar shëndetin dhe arsimin, të promovimi i mirëqenies psikologjike dhe emocionale, ministria do të jetë një fener shprese, mbështetjeje dhe udhëzimi.

Për më tepër, kjo ministri do të bashkëpunojë me departamente të tjera qeveritare, duke siguruar që perspektiva e familjes të jetë e integruar në të gjithë sektorët, qoftë në strehim, arsim, shëndetësi apo punësim. Duke i përqendruar politikat tona rreth familjeve dhe mirëqenies së tyre, ne po hartojmë një rrugë për një Kosovë të begatë, kohezive dhe elastike.

#### 5.4 **INCENTIVA PËR BANIM**

Një shtëpi/banesë nuk është vetëm objekt ndërtimor, por një vend i shenjtë, një vend kujtimesh dhe një themel për të ardhmen. Familjet e reja, të mbushura me ëndrra dhe aspirata, shpesh e shohin pronësinë e shtëpisë/banesës një sfidë të frikshme. “Incentiva e Pronësisë së Shtëpisë për Familjet e Reja” është krijuar për ta transformuar këtë ëndërr në një realitet të arritshëm. Normat e reduktuara të interesit, paketat speciale të hipotekave dhe subvencionet direkte, do të sigurojnë që familjet me fëmijë të vegjël të mund të sigurojnë një shtëpi pa u ngarkuar me borxhe të pakapërcyeshme.

Përtej përfitimit të menjëhershëm të zotërimit të një shtëpie, kjo politikë adreson një nevojë më të gjerë shoqërore. Strehimi i qëndrueshëm ndikon pozitivisht në shëndetin, arsimimin dhe mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve. Duke lehtësuar pronësinë e shtëpive, ne nuk po u mundësojmë familjeve vetëm të kenë një çati mbi kokë; ne po sigurojmë që ata të kenë një mjedis të qëndrueshëm e të sigurt ku fëmijët mund të lulëzojnë, prindërit mund të gjejnë paqe dhe familjet mund të rriten së bashku.

Rreth 15 milionë euro vlerësohet të jetë kostoja e kësaj pakoje.



PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# SHËNDETËSIA





# SHËNDETËSIA

## KONTEKSTI

Shëndetësia vazhdon të jetë njëra nga sfidat kryesore të qytetarëve të Kosovës. Mungesa e investimeve thelbësore, fondet e ulëta publike, mungesa e menaxhimit të duhur shëndetësor, së bashku me neglizhencën e treguar ndër vite për këtë sektor jetik, e kanë çuar këtë fushë të rëndësishme publike në prag të kolapsit të përgjithshëm.

Mungesa e investimeve në shëndetësi ka bërë që qytetarët e Kosovës të shpenzojnë çdo vit mbi 100 milionë euro për shërim jashtë vendit, me fokus të veçantë në Maqedoni të Veriut, Turqi, Serbi e Shqipëri.

Sot, vendi ynë, ka nivelin më të ulët në Evropë të shpenzimeve për shëndetësi, si proporcion të Bruto Produktit Vendor. Me vetëm 3.3% pjesëmarrje në BPV, sektori i shëndetësisë është pothuajse dyfish më pak financa se sa niveli i vendeve evropiane, apo dhe disa shtete të rajonit.

Duhet theksuar se Kosova nuk ka ende sigurime shëndetësore, siç dhe nuk ka as sistem të informimit shëndetësor. Të dy këto nisma janë përfolur si alternativë politike ndër vite, por të njëjtat, si parakushte të përmirësimit të gjendjes, nuk janë funksionalizuar asnjëherë.

Sistemi shëndetësor në Kosovë, sidomos pas krijimit të SHSKUK-së, është centralizuar dhe në një vend me buxhet të vogël për shëndetësi, pa sistem të informimit shëndetësor e bënë edhe më jo efikas dhe jo cilësor këtë shërbim.

Një ndër problemet më emergjente në sektorin të shëndetësisë është ai i largimit masiv të mjekëve. Kushtet më të mira për punë në Evropë, sikurse dhe mungesa

e ambientit të qëndrueshëm në vend, kanë bërë largimin e mjekëve nga Kosova proces sa të zakonshëm aq edhe shqetësues për të ardhmen e vendit. Vetëm gjatë pesë viteve të fundit, numri i mjekëve ka rënë për më tepër se një e treta dhe numri i mjekëve dhe stafit tjetër shëndetësor për pacientë është në radhën e më të ultëve në Evropë.



# PLANI YNË PËR SHËNDETËSI

Pas mbi dy dekadave neglizhencë, është domosdoshmëri e kohës që i gjithë fokusi institucional të drejtohet në shëndetësi, për të nisur kështu transformimin rrënjësor të këtij sektori. Ndonëse të vetëdijshëm se i gjithë sektori i shëndetësisë nuk mund të rregullohet brenda një mandati 4-vjeçar, Lidhja Demokratike e Kosovës planifikon ndërmarrjen e një sërë hapash që avancojnë dukshëm jo vetëm financimin e këtij sektori, por dhe nivelin e dhënies së shërbimeve në spitalet e Kosovës. Synimi kryesor i LDK-së është rritja e shpenzimeve publike në shëndetësi deri në 5% të Bruto Produktit Vendor. Në këtë drejtim, projektet tona kryesore janë:

## 6.1 PËRKUJDESJA PRIMARE SHËNDETËSORE

Përkujdesja primare do të jetë një nga shtyllat kryesore të planit tonë për përmirësimin e sektorit të shëndetësisë. Në strategjinë tonë, ky është themeli i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për popullsinë, veçanërisht për sëmundjet kronike dhe parandalimin e sëmundjeve.

Do të investojmë në modernizimin e infrastrukturës dhe paisjeve duke rritur numrin e mjekëve dhe infermierëve në çdo komunë. Objektivi ynë është që të rritet numri i mjekëve të familjes në raport me popullsinë, duke afruar standardit evropian prej 1 mjek për çdo 1,500 banorë deri në fund të mandatit 4 vjeçar. Gjatë kësaj periudhe do të shtojmë 500 infermierë të rinj në sektorin e përkujdesjes primare.

Një nga komponentët kryesorë të reformës do të jetë implementimi i modelit të kapitationit për mjekësinë familjare. Aktualisht, sistemi i financimit nuk i motivon mjekët dhe qendrat e mjekësisë familjare për të përmirësuar më tutje cilësinë e kujdesit që ofrojnë. Me modelin e kapitationit, financimi do të bëhet bazuar në numrin e pacientëve që qendra mbulon dhe cilësinë e shërbimeve që ofron. Kjo do të thotë që më shumë fonde do të shkojnë tek ato qendra që tregojnë përmirësim të vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve

## 6.2 ZHVILLIMI I SPITALEVE TË PËRGJITHSHME DHE QENDRAT E EKSELENCËS

Do të investojmë në modernizimin dhe zhvillimin e 7 spitaleve ekzistuese të përgjithshme në Kosovë, duke u siguruar që ato të ofrojnë shërbime të plota të kujdesit dytësor për pacientët në rajonet përkatëse. Përveç rolit të tyre si spitale të përgjithshme që mbulojnë nevojat bazike shëndetësore, ne do të zhvillojmë një strategji specifike për transformimin e tyre në qendra rajonale të ekselencës.

Në vitin e parë të planit tonë, do të eksplorojmë dhe analizojmë nevojat shëndetësore të secilit rajon, duke identifikuar specializimet më të nevojshme dhe fushat me mungesa. Kjo do të përfshijë një vlerësim të infrastrukturës, pajisjeve mjekësore dhe burimeve njerëzore, me fokus në përmirësimin e kapaciteteve të spitaleve për të ofruar shërbime cilësore. Për këtë fazë, do të alokojmë një buxhet për analizë dhe planifikim të detajuar të spitaleve, përfshirë konsultimet me ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë.

Duke nisur nga viti i dytë, spitalet e përgjithshme do të fillojnë të transformohen në qendra të specializuara të ekselencës, me specializime të caktuara sipas nevojave të definuara rajonale. Procesi i transformimit të spitaleve në qendra ekselence gjatë katër viteve të ardhshme do të kërkojë investime në modernizim të infrastrukturës, pajisje mjekësore dhe trajnime të stafit, me një buxhet të përafërt prej 100 milionë eurosh. Investimet do të përfshijnë edhe ndërtimin ose rinovimin e objekteve, me synimin që secili spital të përmbushë standardet moderne të spitaleve në rajon.

Qendrat e ekselencës do të përcaktohen pas një vlerësimi të plotë dhe në përputhje me nevojat specifike të secilit rajon dhe pacientëve që ata shërbejnë. Më poshtë disa shembuj ilustrues që nuk përfaqësojnë vendime përfundimtare.

**Spitali i Prizrenit:** Qendra e Ekselencës për kardiologji, duke u fokusuar në diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve kardiovaskulare. Ky spital do të jetë lider në trajtimin e pacientëve me sëmundje të zemrës në të gjithë rajonin.

**Spitali i Pejës:** Qendra e Ekselencës për kirurgji të avancuar dhe ortopedi. Ky spital do të ofrojë shërbime kirurgjikale të specializuara për trajtimin e pacientëve me probleme ortopedike dhe nevoja të tjera kirurgjikale komplekse.

**Spitali i Gjakovës:** Qendra e Ekselencës për shërbime diagnostikuese. Me fokus në pajisjet moderne dhe teknologjitë më të fundit, ky spital do të ofrojë shërbime të avancuara diagnostike për sëmundje të ndryshme, duke mbështetur trajtimin e specializuar në të gjithë Kosovën.

**Spitali i Gjilanit:** Qendra e Ekselencës për kujdes paliativ. Ky spital do të specializohet në trajtimin dhe mbështetjen e pacientëve me sëmundje kronike dhe faza të avancuara të sëmundjeve, duke ofruar kujdes paliativ cilësor dhe me ndjeshmëri ndaj pacientëve.

### 6.3 PËRDITËSIMI I LEGJISLACIONIT PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT MJEKËSOR

Në kuadër të zhvillimit të gjithanshëm të sistemit shëndetësor, modernizimi i legjislacionit është një hap kyç për të përshpejtuar progresin në sektorin publik dhe privat shëndetësor në Kosovë. Legjislacioni i ri do të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e spitaleve dhe qendrave shëndetësore në përputhje me standardet bashkëkohore, si dhe për të garantuar një treg të liberalizuar dhe të qasshëm për specialistët mjekësorë.

Një prej reformave më të rëndësishme do të jetë liberalizimi i tregut për specialistët mjekësorë, që do të mundësojë:

- **Lehtësimin e procedurave të licencimit** për specialistët mjekësorë, duke u krijuar kushte më të favorshme për punësimin dhe praktikën private. Licencimi do të bëhet më transparent dhe më i shpejtë, duke përmirësuar kohën e procesimit dhe hequr barrierat burokratike.
- **Harmonizimin e standardeve për praninë të specialistëve të huaj**, me qëllim të nxitjes së emigracionit të specialistëve të kualifikuar drejt Kosovës dhe zbutjes së mungesës së mjekëve në fusha të specializuara. Do të krijohet një kornizë ligjore që lejon specialistët nga jashtë të ofrojnë shërbime në vend për periudha afatgjata ose afatshkurtra, pa pengesa administrative.
- **Më shumë liri për specialistët në sektorin privat** për të zhvilluar klinikat e tyre dhe për të ofruar shërbime në mënyrë të pavarur ose në partneritet me sektorin publik, duke u dhënë atyre më shumë fleksibilitet në tarifat dhe shërbimet që ofrojnë.

Për të përmirësuar konkurrencën dhe për të nxitur zhvillimin e shpejtë të sektorit mjekësor, legjislacioni i ri do të përfshijë:

- **Përditësimin e standardeve të infrastrukturës për spitalet publike dhe private.** Të gjithë operatorët shëndetësorë do të duhet të përmbushin standardet

e BE-së për sigurinë dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor. Kjo do të sigurojë një nivel të lartë shërbimesh në përputhje me normat ndërkombëtare.

- **Lehtësimin e investimeve private në sektorin shëndetësor**, duke thjeshtuar procesin e krijimit dhe licencimit të spitaleve private. Do të krijohet një sistem lejesh dhe inspektimesh më efikas për ndërtimin dhe funksionimin e spitaleve private.

- **Partneritete publiko-private** për ndarjen e kostove të modernizimit të pajisjeve dhe infrastrukturës, duke përfshirë investimet për tërheqjen e specialistëve të huaj dhe krijimin e qendrave të ekselencës.

Legjislacioni i ri do të lehtësojë gjithashtu Mbështetjen e Inovacionit dhe Teknologjisë në Shëndetësi:

- **Adoptimin e teknologjive të reja në shëndetësi**, duke integruar zgjidhjet IoT për monitorimin e pacientëve në distancë. Pajisjet IoT do të mundësojnë ndjekjen e gjendjes shëndetësore të pacientëve me sëmundje kronike në kohë reale, duke mbledhur të dhëna mbi parametrat jetësorë dhe duke ndihmuar mjekët në vendimmarrje. Do të ketë rregullore specifike që inkurajojnë përdorimin e këtyre pajisjeve të ndërlidhura për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të trajtimit.

- **Mbështetjen për telemjekësinë dhe konsultimet virtuale**, duke siguruar një kornizë të qartë ligjore për ofrimin e shërbimeve mjekësore në distancë, të kombinuara me pajisje IoT. Kjo do të lehtësojë qasjen në kujdes shëndetësor për pacientët që jetojnë në zona të largëta dhe për ata që kanë nevojë për monitorim të vazhdueshëm, pa qenë e nevojshme të vizitojnë fizikisht mjekët. Pajisjet e ndërlidhura do të ndihmojnë në përballimin e mungesës së specialistëve në rajone të caktuara, duke ofruar mundësi për konsultime në kohë reale dhe monitorim të vazhdueshëm.

## 6.4 PROGRAMI PËR SHPËRNDARJEN E BARNAVE GJENERIKE FALAS PËR PACIENTËT ME SËMUNDJE KRONIKE

Një nga shtyllat kryesore të reformës sonë shëndetësore do të jetë ofrimi falas i barnave gjenerike për pacientët me sëmundje kronike. Ky program me prioritet, që do të fillojë të zbatohet që në vitin e parë të mandatit, do të koordinohet dhe financohet nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Qëllimi është lehtësimi i barrës financiare për pacientët dhe sigurimi i qasjes së vazhdueshëm në barnat e nevojshme për trajtimin e sëmundjeve kronike.

Programi do të fokusohet te pacientët që vuajnë nga sëmundjet më të zakonshme kronike, përfshirë:

- Diabeti
- Hipertensioni
- Sëmundjet kardiovaskulare
- Astma dhe sëmundjet e tjera respiratore kronike
- Sëmundjet reumatike
- Sëmundjet e tiroides
- Sëmundjet e sistemit nervor qendror

Pacientët që diagnostikohen me këto sëmundje nga specialistët e sistemit publik ose privat do të kenë të drejtën e marrjes falas të barnave gjenerike përmes një recete formale të lëshuar nga mjekët specialistë të licencuar.

Barnat gjenerike falas do të shpërndahen përmes një mekanizmi të mirë-përcaktuar që do të përfshijë:

- **Recetat nga specialistët publik dhe privat:** Mjekët specialistë të licencuar, qofshin ata të punësuar në sektorin publik apo privat, do të kenë mundësinë të lëshojnë receta për barnat gjenerike falas. Recetat duhet të jenë të bazuara në diagnoza të dokumentuara dhe të lëshuara nga qendrat shëndetësore të licencuara.
- **Shpërndarja përmes farmacive të miratuara:** Pacientët do të marrin barnat në farmaci të përzgjedhura që janë pjesë e programit dhe të kontraktuara nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Ky sistem do të monitorohet për të siguruar shpërndarje cilësore dhe në kohën e duhur.
- **Zhvillimi i një softueri të përkohshëm:** Deri në zhvillimin e Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH), do të krijohet një softuer i përkohshëm që do të lidhë farmacitë e licencuara, mjekët specialistë të autorizuar, dhe Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Ky softuer do të mundësojë ndjekjen në kohë reale të lëshimit të recetave, aprovimin e mbulimit financiar nga fondi i sigurimeve dhe shpërndarjen e barnave të pacientët, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në proces.

SHËNDETËSIA

94

Ky program do të jetë i financuar dhe i koordinuar nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Fondi do të mbulojë koston e barnave gjenerike dhe do të sigurojë që farmacitë pjesëmarrëse të jenë plotësisht të mbështetura për të përmbushur kërkesat e pacientëve me sëmundje kronike. Duke e filluar që në vitin e parë, do të bëhet një alokim i duhur financiar nga buxheti i shtetit për këtë program, me synimin që të mbulojë plotësisht nevojat e pacientëve për barna esenciale.

Programi do të përfitojë nga një mekanizëm mbikëqyrjeje të fortë për të siguruar shpërndarje të drejtë dhe efikase të barnave. Ky mekanizëm do të përfshijë:

- **Regjistrimi i pacientëve me sëmundje kronike:** Një sistem elektronik i përmirësuar do të krijohet për të regjistruar pacientët që marrin barna falas, në mënyrë që të sigurohet që barnat të shpërndahen vetëm për përfituesit e përshtatshëm.
- **Rishikimi i listës së barnave:** Lista e barnave gjenerike të mbuluara do të rishikohet çdo vit për të shtuar medikamente të reja dhe për të hequr ato që nuk janë më të nevojshme apo të efektshme.

## 6.5 PLANI PËR MBAJTJEN E MJEKËVE TË RINJ NË VEND DHE RITJEN E NUMRIT TË STUDENTËVE TË MJEKËSISË

Një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballlet sektori shëndetësor në Kosovë është largimi i mjekëve të rinj drejt vendeve të tjera për shkak të mungesës

së mundësive profesionale dhe punësimit. Për të adresuar këtë problem dhe për të ndihmuar në mbajtjen e mjekëve të rinj në vend, do të ndërmarrim një sërë masash që do të përfshijnë përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e numrit të studentëve të mjekësisë:

- **Rritja e pagave dhe përfitimeve për mjekët e rinj:** Do të zgjerojmë dhe përmirësojmë paketat e kompensimit për mjekët e sapodiplomuar që punojnë në sektorin publik, duke siguruar paga konkurruese në krahasim me vendet e tjera të rajonit.

- **Punësimi brenda 6 muajve nga përfundimi i studimeve:** Të gjithë mjekët e rinj do të kenë garancinë se do të punësohen brenda 6 muajve pas përfundimit të studimeve të tyre mjekësore. Kjo do të sigurojë një tranzicion të shpejtë nga studimet drejt punësimit aktiv në sistemin shëndetësor publik, duke u mundësuar atyre që të kontribuojnë menjëherë në kujdesin shëndetësor.

- **Specializimi me pagë brenda dy viteve nga përfundimi i studimeve:** Mjekët e rinj do të kenë mundësinë të fillojnë specializimin e tyre me pagë të plotë brenda dy viteve pas përfundimit të studimeve. Kjo do të eliminojë pritjet e gjata për specializim dhe do të sigurojë që mjekët të vazhdojnë zhvillimin e tyre profesional në Kosovë

- **Mundësi të vazhdueshme për zhvillim profesional:** Do të krijojmë programe të rregullta të trajnimit dhe specializimeve brenda vendit dhe përmes partneriteteve ndërkombëtare, për t'u dhënë mjekëve të rinj mundësinë të avancojnë profesionalisht pa qenë të detyruar të emigrojnë për specializime.

Me qëllim mbajtjen dhe rritjen e kapacitetit të sistemit shëndetësorë në afatëgjatësi, në bashkëpunim me fakultetin e mjekësisë, do të ndërmarrim masa për të shtuar numrin e studentëve të mjekësisë, si më poshtë:

- **Rritja e kuotave për pranimin në Fakultetin e Mjekësisë:** Do të zgjerojmë kuotat e pranimit në programet e mjekësisë, përfshirë mjekësinë e përgjithshme, infermierinë dhe specializimet e tjera të kërkuara.

- **Mbështetja financiare për studentët e mjekësisë:** Do të krijojmë bursa dhe skema financimi për studentët që synojnë të ndjekin studimet e mjekësisë, duke përfshirë mbështetje financiare për studentët nga rajonet rurale dhe ato me më pak përfaqësim në sektorin e mjekësisë.

- **Krijimi i programeve të mentorimit:** Do të zhvillojmë programe të mentorimit që lidhin studentët e mjekësisë me mjekë me përvojë, duke ofruar mbështetje për zhvillimin e tyre profesional dhe përfshirje në projekte mjekësore praktike.

Në kuadër të liberalizimit të tregut të specialistëve mjekësorë, do të ofrojmë një mjedis konkurrues për tërheqjen e mjekëve të huaj duke krijuar incentiva për mjekët e huaj të cilët duan të punojnë në Kosovë, duke u siguruar licencimin e shpejtë dhe përfitime të tjera për t'i inkurajuar të kontribuojnë në zhvillimin e sektorit shëndetësor kosovar.

## 6.6 QENDRA E RE SPITALORE

Kapacitetet e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) janë të vjetëruara dhe të pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat për shërbime moderne spitalore. Me një sipërfaqe prej 140,000 m<sup>2</sup> dhe 38 klinika, hapësirat ekzistuese janë të mbipopulluara dhe nuk ofrojnë më standardet bashkëkohore për kujdes shëndetësor. Kosova ka raportin më të ulët të shtretërve për banor në rajon, një situatë që ndikon negativisht në cilësinë e shërbimeve spitalore dhe detyron qytetarët të kërkojnë trajtime jashtë vendit, shpesh në vendet fqinje. Kjo gjendje përbën një sfidë të rëndësishme për sistemin shëndetësor të Kosovës, duke pasur parasysh rritjen e kërkesës dhe nevojën për shërbime më të avancuara në dekadat e ardhshme.

Me synimin për të përmirësuar kujdesin terciar dhe për të përballuar nevojat shëndetësore të popullsisë për 50 vitet e ardhshme, plani ynë përfshin ndërtimin e një Qendre të Re Spitalore, e cila do të zëvendësojë, zgjerojë dhe modernizojë kapacitetet ekzistuese të QKUK-së. Ky projekt ambicioz synon të përmirësojë cilësinë e kujdesit shëndetësor duke siguruar një infrastrukturë më të mirë dhe më efektive për pacientët dhe stafin mjekësor.

Objektivi kryesor i këtij projekti është modernizimi dhe rritja e kapacitetit të shtretërve, në mënyrë që të përballohet kërkesa në rritje për shërbime spitalore. Qendra e re spitalore do të ketë dhoma moderne me maksimum dy shtretër për dhomë, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për kujdes të specializuar. Ndërtimi i hapësirave më të mëdha dhe më pak të ngjeshura do të krijojë një ambient më të rehatshëm për pacientët dhe stafin, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe ulur mbingarkesën në klinikat ekzistuese të QKUK-së. Kjo do të ndihmojë gjithashtu në përmirësimin e raportit të shtretërve për banor dhe do të lehtësojë mbingarkesën në spitalet publike.

Një nga sfidat më të mëdha për Qendrën e Re Spitalore do të jetë përballimi i nevojës për më shumë personel. Për ta tejkaluar këtë sfidë, plani ynë përfshin disa zgjidhje inovative që synojnë optimizimin e burimeve njerëzore përmes teknologjisë dhe dizajnit të hapësirave të reja. Këto përfshijnë:

- Dizajni optimal i hapësirave të reja, i cili do të lehtësojë qarkullimin dhe menaxhimin e pacientëve, duke rritur efikasitetin e stafit mjekësor.
- Dixhitalizimi i proceseve: Integrimi i sistemeve digjitale të menaxhimit të pacientëve dhe shërbimeve të kujdesit në distancë do të ndihmojë në optimizimin e shërbimeve dhe uljen e ngarkesës mbi stafin mjekësor. Teknologjitë digjitale do të lejojnë një ndjekje më të saktë dhe më efektive të pacientëve, duke reduktuar kohën e administrimit dhe duke përmirësuar rezultatet shëndetësore.
- Përdorimi i inteligjencës artificiale (AI) në diagnostikim dhe menaxhimin e kohës dhe pacientëve do të rrisë efikasitetin dhe do të lejojë stafit mjekësor të fokusohet më shumë në kujdesin direkt ndaj pacientëve.

Ndërtimi i Qendrës së Re Spitalore do të kryhet në dy faza, të cilat do të sigurojnë që ky projekt ambicioz të përfundojë brenda një afati të menaxhueshëm kohor dhe buxhetor. Pasi të përfundojë, Qendra e Re Spitalore do të jetë një nga institucionet kryesore shëndetësore në rajon.



- **Kohëzgjatja totale: 6 vite**
- **Buxheti total: 500 milionë euro**

Kostoja e plotë për ndërtimin e qendrës së re, përfshirë modernizimin e pajisjeve dhe zgjerimin e kapaciteteve, është parashikuar të jetë 500 milionë euro. Ky buxhet është planifikuar të shpërndahet në dy faza gjatë një periudhe 6-vjeçare, për të siguruar që ngarkesa financiare mbi buxhetin e shtetit të jetë e menaxhueshme dhe e përballueshme.

- **Faza 1: Lokacioni, Projektimi, Ndërtimi dhe Zhvillimi Fillestar (Viti 1-3)**
- **Koha: 3 vite**
- **Buxheti: 250 milionë euro**

Gjatë kësaj faze, do të përqendrohemi në përcaktimin e lokacionit, planifikimin dhe projektimin e detajuar të qendrës së re spitalore. Kjo fazë përfshin gjithashtu ndërtimin e infrastrukturës fillestare, përfshirë klinikat dhe institucionet tjera që ofrojnë shërbime terciarë. Ky ndërtim fillestar do të përgatisë bazën për instalimin e teknologjive të reja dhe për zhvillimin e kapaciteteve të mëtejshme në fazën e dytë.

- **Faza 2: Instalimi i Pajisjeve dhe Funkcionalizimi i Qendrës (Viti 4-6)**
- **Koha: 3 vite**
- **Buxheti: 250 milionë euro**

Në këtë fazë do të përfshijmë instalimin e pajisjeve mjekësore të avancuara dhe përfundimin e ndërtesave. Gjatë kësaj periudhe do të bëhet funksionalizimi gradual i klinikave dhe institucioneve të tjera, një nga një, për të siguruar që shërbimet të transferohen në objektet e reja pa ndërprerje në kujdesin ndaj pacientëve.

## 6.7 **FONDI I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE**

Në planin e LDK-së, funksionalizimi i skemës së sigurimeve shëndetësore do të bëhet që në vit të parë. Bazuar në analizat financiare të deritanishme, vlerësohet se Fondi i Sigurimit Shëndetësore mund të mbledhë rreth 140,000.000 milion euro në vit nga premiumet e kontributdhënësve. Vitin e parë Qeveria do të ndaj 140.000.000 euro për mblkuimine barnave dhe shërbimeve për qytetarët e Kosovës.

Mbledhjen e premieeve do të nisë së aplikuari që në vitin e dytë të planit tonë, në përmasën e 3.5% nga punëdhënësi dhe 3.5% nga punëmarrësi. Shërbimet e vitit të parë të Fondit, do të mbulohen nga një buxhet i ndarë nga buxheti qendror.

Paraprakisht nisjes së mbledhjes së premieeve dhe me ofrimin të shërbimeve, plani ynë parasheh ndërmarrjen e një strategjie komunikuese me publikun, me qëllim të informimit më të drejtë të qytetarëve mbi përfitimet dhe përgjegjësitë nga e ndaj Fondit.

Po ashtu, në vitin e parë përgatitor, do të merren dhe hapat si në vijim:

- Krijimi i rrjetit të ofruesve të shërbimeve shëndetësore, nga vet Ministria e

Shëndetësisë, më qëllim të definimit të qartë numrit të ofruesve shëndetësorë në vend, përfshirë edhe sektorin privat si ofrues të shërbimeve që mbulohen nga Fondi;

- Ndryshimi i mënyrës se financimit të sistemit shëndetësorë ku të gjitha fondet për shëndetësinë përveç investimeve kapitale do e barten në Fond, me vet Fondin si blerës të vetëm të shërbimeve;
- Hartimi i listës së shërbimeve së bashku me çmimoren e shërbimeve me qëllim të definimit të shërbimeve në pakon bazë të cilat do të mbulohen nga Fondi respektivisht kontribuesit në Fond;
- Krijimi i sistemeve të kontrollit dhe raportimit të faturimit dhe shpenzimeve; dhe
- Identifikimi i kategorive që lirohen nga pagesa e premiumeve për Fondin Prioritet do t'i ipet rimbursimi falas të barnave jashtëspitalore për sëmundjet kronike më të shpeshta të pensionuarit, duke e zgjeruar me medikamente të reja në baza vjetore.

## 6.8 **SISTEMI INFORMATIV SHËNDETËSOR**

Mungesa e Sistemit Informativ Shëndetësor mbetet njëra nga hendikepet më të mëdha të sistemit shëndetësor në vend. Ndonëse i nisur si proces që në vitin 2006, i njëjti nuk është realizuar asnjëherë. Mungesa e një sistemi informativ, uniform brenda gjithë sistemit të shëndetësisë, ka bërë që sistemi shëndetësor të menaxhohet në mënyre primitive krahasuar në zhvillimet teknologjike dhe të të dhënave gjatë dy dekadave të fundit.

Një sistem informativ shëndetësor do të mundësonte fillimisht komunikimin më të mirë brenda sektorit, me fokus të veçantë tek ofruesit e shërbimeve shëndetësorë. I njëjti zëvendësues i shënimeve të letrave e mungesës së kategorizimit të të dhënave, do të jepte dhe siguri më të madhe për marrësit e shërbimeve përkatësisht pacientit. Nëpërmjet SISH-it, vendimmarrja për financim, për planifikim, për alokim buxhetor e për analiza të mëtutjeshm kombëtare rreth shëndetësisë, do të ishte shumë më i lehtë.

Paralelisht me funksionalizimin e Sigurimeve Shëndetësore, plani ynë parasheh dhe funksionalizimin e plotë të Sistemit Informativ Shëndetësor. Hapat e ndërmarrë në këtë drejtim janë:

- a) ridizajnim i plotë i Departamentit të SISHit me plotësime adekuate të personelit aty;
- b) themelimi i Grupit Punues me qëllim të mbikëqyrjes së implementimit të procesit e në veçanti, koordinimit të ngushtë ndërinstucional në këmbimin e të dhënave për qytetarët e Kosovës;
- c) dizajnimi dhe ekzekutimi i platformës SISH nëpër të gjitha institucionet përkatëse ofruese të shërbimeve shëndetësore; d) ngritja e kapaciteteve teknologjike tek të gjithë ofruesit e shërbimeve shëndetësore; e) trajnimi I stafit shëndetësor në përdorimin e platformës në \_alë. Kostoja e planifikuar e implementimit të SISH-it, përfshirë dhe pajisjet përcjellëse për funksionalizim

të tij të plotë në gjithë Kosovën, është rreth 30 milionë euro.

## 6.9 TRANSFORMIMI I SHSKUK-së

Plani ynë parasheh një transformim të SHSKUK-së, duke ruajtur rolin e saj si një organizatë kryesore që udhëheq, koordinon dhe ndihmon organizatat shëndetësore të ofrimit të shërbimeve terciarë dhe sekondarë, duke bashkëpunuar ngushtë me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore dhe Ministrinë e Shëndetësisë. SHSKUK do të transformohet në një organizatë e fuqishme që përfaqëson dhe mbron interesat e njësive të saj, duke marrë përgjegjësi ekzekutive në përpilimin dhe implementimin e rregulloreve të brendshme, dhe në mirëmbajtjen e standardeve të larta në trajtimin e pacientëve përmes shërbimeve profesionale si dhe do të ketë një rol kyç në shpërndarjen e barabartë të personelit në njësitë e veta, zhvillimin e shërbimeve dhe kapaciteteve të reja, si dhe në menaxhimin operacional të krizave dhe emergjencave eventuale shëndetësore në nivel kombëtar.

Kjo do të ndihmojë që sistemi të funksionojë në mënyrë efikase dhe të jetë i përgatitur për sfidat e ardhshme, duke përfshirë zhvillimin e shërbimeve të reja dhe modernizimin e kapaciteteve spitalore.

Plani ynë parasheh gjithashtu decentralizimin operacional të SHSKUK-së dhe ndarjen e përgjegjësive në njësi menaxhuese më të vogla, por shumë më efikase. Klinikat e QKUK dhe Spitalet e përgjithshme do të jenë autonome në menaxhimin e tyre të përditshëm operacional, duke u dhënë mundësinë të marrin vendime në lidhje me shërbimet sekondare dhe terciare që ofrojnë. Megjithatë, ato do të vazhdojnë të operojnë nën ombrellën e SHSKUK-së, duke ruajtur përgjegjësinë dhe kontrollin e përgjithshëm të sistemit shëndetësor në nivel qendror përmes standardeve dhe rregulloreve të përbashkëta. Kjo qasje do të rrisë përgjegjësinë lokale dhe autonominë në menaxhimin e shërbimeve shëndetësore, duke siguruar në të njëjtën kohë përputhjen me standardet e larta të vendosura nga SHSKUK.

Në aspektin e organizimit të brendshëm të QKUK-së, do të ndodhë grupizimi i klinikave dhe ndarja e menaxhimit të tyre human dhe financiar. Një shembull i qartë i kësaj është themeli i Klinikës për Nënë dhe Fëmijën, e cila do të përmbledhë të gjitha shërbimet për nënën dhe fëmijën, duke përfshirë Klinikën e Pediatriisë, Kirurgjinë e Fëmijëve, Gjinekologjinë dhe Obstetrikën, dhe Neонатologjinë. Kjo klinikë do të ofrojë shërbime të pavarura nga klinikat e tjera të SHSKUK-së, duke përqendruar burimet dhe stafin në ofrimin e kujdesit të specializuar për këtë grup pacientësh.

Një tjetër komponent i rëndësishëm i planit të decentralizimit është forcimi dhe riorganizimi i shërbimeve kardiovaskulare, përmes fuzionimit të shërbimeve ekzistuese të Kardiologjisë, Kardiokirurgjisë, Kirurgjisë Vaskulare dhe Kardiologjisë Pediatrike. Ky grupim do të lehtësojë ofrimin e kujdesit të koordinuar dhe të integruar për pacientët me sëmundje kardiovaskulare, duke përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e trajtimit.

Brenda procesit të decentralizimit është gjithashtu paraparë forcimi dhe kompletimi i Institutit për Onkologji, me një fokus të veçantë në shtimin e stafit të kualifikuar dhe blerjen e pajisjeve të reja për radioterapi. Gjithashtu, do të nisë aplikimi i kujdesit paliativ për të përmirësuar cilësinë e jetës për pacientët

me sëmundje të avancuara.

## 6.10 **MENAXHIM I KONTRAKTUAR**

Një ndër risitë kryesore në sektorin e shëndetësisë do të jetë dhe ndarja, për herë të parë në historinë e Kosovës, e menaxhmentit shëndetësor nga profesioni shëndetësor. Në pjesën më të madhe të Klinikave dhe Spitaleve në Kosovë, mjekët janë njëkohësisht dhe menaxherë. Jo domosdoshmërisht, ndonëse me përjashtime në raste të rralla, mjekët profesionistë, madje dhe me renome botërore, kanë aftësi menaxheriale. Pra, kompetencat e organizimit të objekteve fizike, të pastërtisë, të furnizimit, rregullit e vet shërbimit, janë çështje menaxheriale para se të jenë shëndetësore.

Në këtë drejtim, si masë emergjente në disa nga klinikat përkatëse, plani ynë parashih angazhimin e kompanive profesionale menaxheriale, që për një periudhë të dhënë kohore do të marrin përsipër menaxhimin profesional të klinikave përkatëse. Gjatë kohës së menaxhimit të tyre, do të synohet ngritja e kapaciteteve vendore për menaxhim afatgjatë.



PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# ARSIMI









## KONTEKSTI

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, arsimi është prioritet qeverisës dhe bazë për zhvillim të kapaciteteve njerëzore profesionale të shtetit të Kosovës. Një arsim i planifikuar dhe me vizion siguron harmoni zhvillimore dhe profesionale, ku secilit qytetar i ofrohet mundësia për arsim dhe aftësim cilësor, të orientuar drejt nevojave të tregut të punës, me qëllim të rritjes së punësimit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Një sistem model i arsimit, që është gjithëpërfshirës, cilësor, autonom, i integruar publik dhe privat, duhet t'u ofrojë qytetarëve qasjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës në përputhje me nevojat dhe aftësitë e tyre.

Me një përfshirje prej rreth 6.9 % të fëmijëve të grupmoshës nën 5-vjeç në shërbimet e edukimit parashkollor Kosova renditet e fundit në Evropë. Sipas të dhënave, shihet se zonat rurale janë ato të cilat më pak kanë qasje në edukimin e hershëm, krahasuar me ato urbane. Kjo gjendje na tregon përpos që kemi numër shumë të ulët të përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm kemi edhe pa barazi gjeografike.

Nxënësit e shkollave publike në Kosovë kalojnë më pak se 20 orë në shkollë. Kjo është pak krahasuar me vendet e tjera Evropiane, ku nxënësit i kalojnë deri në 40 orë duke mësuar në shkollë. Kjo ngaqë nuk ka mjaft hapësira shkollore për të gjithë nxënësit, sidomos nëpër zonat urbane, në mënyrë ata të qëndrojnë në shkollë gjatë tërë ditës. Si rezultat, nxënësit e Kosovës kanë më pak mundësi të zhvillojnë aftësitë dhe dituritë e bashkëmoshatarëve të tyre në rajon dhe në Bashkim Evropian.

Arsimi i lartë ofron studime në institucione publike dhe private, programet e të cilave nuk janë tërësisht në harmoni me nevojat e tregut të Kosovës; nuk ka mbështetje sistemore për lidhjen e studimeve me hulumtime shkencore e projekte inovative, por as absorbim të fondeve ndërkombëtare. Ndërtimi i një rangimi institucional të universiteteve, i cili do të bazohet në performancën akademike, por edhe mbështetja për projekte inovative përmes fondeve do të rrisin cilësinë në arsimin e lartë dhe do të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

Cilësia do të arrihet edhe nëpërmjet zbatimit të procesit të akreditimit në pajtim me standardet ndërkombëtare të cilësisë, ndërlidhjen me nevojat e tregut, krijimit të skemave të performancës dhe stimuluese për stafin akademik dhe për studentët, rritjen e projekteve hulumtuese dhe projekteve ndërkombëtare shkëmbimi. Agjencia e Kosovës për Akreditim do të mbetet barometri i pavarur matës i cilësisë, e cila do të mbështetet në avansimin e sistemit të saj të digjitalizuar dhe mbështetet në kthimin e saj në ENQA dhe EQAR.

# PLANI YNË PËR ARSIM

Për avancimin e arsimit në Kosovë, Programi ynë parasheh ndërhyrje në disa nivele: Rritjen e numrin e çerdheve; riorganizimin e shkollave; kthimin e shkollës në qendër, si njësi organizative; fuqizimin e shkollave profesionale; ndërlidhjen e arsimit me tregun e punës në nivelin e shkollave të mesme të larta dhe universiteteve; themelimit të Fondit të Shkencës dhe Fondit të Ekselencës; rangimit dhe profilizimit të universiteteve dhe Agjencisë për Ndërkombëtarizim të Arsimit. Po ashtu, pjesë integrale e planit tonë për arsimin do të jetë dhe futja e lëndëve të kodimit, të elaboruara në kapitullin e Teknologjisë Informative, sikurse e Mbrojtjes, të elaboruara në kapitullin e Mbrojtjes; dhe të Edukimit Fizik, të elaboruarta në kapitullin e Sportit.

Jetësimi i këtyre projekteve do të sigurojë mundësi përfshirje në sistem publik të fëmijëve që nga mosha 6-mujore dhe do të krijojë mundësi rrugëtimi të suksesshëm në një sistem arsimor që ofron arsim cilësor, avansim meritator, studime inovative dhe punësim të menjëhershëm. Këto janë projektet kryesore të planit tonë në fushën e arsimit:

## 7.1 PROGRAMI KOMBËTAR PËR EDUKIM TË HERSHËM

Programi ynë do ta ketë prioritet çështjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm, duke krijuar një Program Kombëtar për edukimin e hershëm. Ky program do të fokusohet në pjesën infrastrukturore, programore dhe te kuadri arsimor, duke i mundësuar fëmijëve kosovar të përfshihen në sistemin edukativ në moshë shumë më të hershme.

Qeveria e LDK-së do të rrisë buxhetin për ndërtimin e çerdheve 15 milionë euro për vit, me gjithsej 20 çerdhe në vit. Për 4 vite qeverisje do të ndërtohen 80 çerdhe publike të reja me një buxhet prej 60 milionësh. Në vendbanimet ku ekzistojnë shkolla me hapësira të lira do të investohet për përshtatjen e hapësirave ekzistuese për të shërbyer si çerdhe. Me këtë riorganizim do të nisë rrugëtimi afatgjatë (me synim dy mandatesh) i përfshirjes deri në 95% e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në edukimin e hershëm si obligativ.

Do të krijohet një harmonizim edhe me çerdhet private, në mënyrë që ato të funksionojnë në kuadër të Programit Kombëtar për Zhvillim në Edukimin e Hershëm. I gjithë stafi arsimor dhe stafi tjetër i çerdheve do të ketë trajnime shitesë për të siguruar cilësi në ofrimin e programit kurikular parafillor, por edhe qasje të integruar për të identifikuar fëmijët me nevoja të veçanta. Programi ynë do të ofrojë mbështetje të individualizuar për fëmijët me nevoja të veçanta.

## 7.2 KLASË ME 20 NXËNËS

Programi ynë parasheh reduktimin e numrit të nxënësve nëpër klasa të shkollave fillore në jo më shumë se 20 sosh. Ky rregullim do të përcaktohet me ligj. Paraprakisht, në tre vitet e para të qeverisjes, konform analizave përkatëse në edukim, ne do të hartojmë dhe implementojmë Planin Nacional për Infrastrukturë Fizike, që mundëson, sidomos në qendrat urbane, zgjerimin e kapacitetve fizike nëpër shkolla. Për këtë, në planin tonë, ne parashohim të ndajmë rreth 30 milionë euro për ndërtimin e hapësirave të reja shkollore, me qëllim të akomodimit të synimeve tona për klasa me 20 nxënës.

Hapësirat e reja, sidomos në qendrat e ngarkuara urbane, do të përzgjidhen së bashku me komunat përkatëse.

Pjesë e planit tonë për infrastrukturë fizike është dhe bartja e shkollave të mesme në kampuse të përbashkëta jashtë qendrës së qyteteve, me qëllim të lirim të hapësirave të shkollave të mesme me lokacion në qendër, për themelimin e shkollave të reja fillore.

## 7.3 PILOT PROJEKTII MËSIMI TËRËDITOR

Nxënësit e shkollave publike në Kosovë kalojnë më pak se 20 orë në shkollë. Programi ynë synon ta ndryshoj këtë gjendje duke dyfishuar numrin e orëve të prezencës në shkollë. Ne do ta implementojmë mësimin tërëditor duke filluar nga viti i tretë i qeverisjes sonë në 5 pilot komuna të Kosovës, të cilat do të zgjidhen si pjesë e një analize gjithëpërfshirëse.

Implementimi i mësimin tërëditor lidhet ngusht me riorganizimin e shkollave dhe kompletimit të infrastrukturës së shkollave dhe çerdheve; në veçanti me

pjesën e ushqimit dhe aktiviteteve kurrikulare e ekstrakurrikulare në këto shkolla.

Në komunat e përzgjedhura do të ndahen fonde shtesë për ndërtimin dhe adaptimin e infrastrukturës shtesë në shkollat ekzistuese, si dhe ndërtimin e shkollave të reja. Riorganizimi infrastrukturor, varësisht nga komuna, do të realizohet mbi një planifikim të grumbullimit të shkollave në kampuse. Plani ynë parasheh ndarjen e gjithsejtë 20 milionë eurove në këto komuna të përzgjedhura.

Mësimi tërëditor do të kishte ndikim social te fëmijët, do të mundësonte qasje të njejtë dhe kohë të mjaftueshme për mësim shtesë; aktivitete rekreative dhe rriste cilësinë e mësimin në përgjithësi.

#### 7.4 **PROGRAMI KOMBËTAR PËR DIGJITALIZIM**

Digjitalizimi në nivelin parauniversitar është i pjesshëm, i reduktuar në mbledhjen e të dhënave të paintegruara nga shkollat dhe institucionet e tjera edukative dhe arsimore. Këto të dhëna menaxhohen në kuadër të MASHTI-it nga Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA). Një platformë e ofruar nga MASHT-i Shkollat.org është një ueb-faqe nga viti 2018, në të cilën ndërveprojnë dy platforma: Pasaporta e të Nxënësve dhe Microsoft 365 për Edukim. Përdorimi i këtyre platformave nuk është i integruar dhe nuk ofrohet qasje gjithpërfshirëse dhe shumëdimensionale me benefite të nxënësve.

Programi ynë parasheh një proces shumë dimensional digjitalizimi, i cili do të ndikojë në rritjen e efikasitetit të menaxhimit të institucioneve arsimore; rritjen e cilësisë së arsimit por edhe ndërkombëtarizimin e sistemit arsimor parauniversitar. Me Programin e digjitalizimit do të mund të sigurohej: rritja e llogaridhënies; digjitalizimi i teksteve mësimore; mbikqyrja e vijueshmërisë dhe arritshmërisë; matja e performancës; rritja e transparencës; digjitalizimi i të dhënave dhe përditësimi i lidhja me trendet ndërkombëtare.

Për më shumë digjitalizimi forcon mekanizmat për zbatimin e sistemit për sigurimin e cilësisë, zbatimin të kurikulës, vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucioneve arsimore, me fokus ngritjen e cilësisë, dhe shfrytëzimin e rezultateve për vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Digjitalizimi do të mundësojë në vecanti lidhjen mësues-nxënës-prind dhe do të transformojë klasën.

Për ngritjen e rezultateve të nxënësve do të sigurohen edhe qasje digjitale në tekste bashkëkohore në përputhje me kurrikulën si dhe do të sigurohen mjete, materiale dhe burimeve mësimore alternative.

#### 7.5 **RIORGANIZIMI I RRJETIT TË SHKOLLAVE**

Vendi ynë po pëson ndryshim gjithëpërfshirës demografike, përfshirë uljen e numrit të lindjeve, shpërnguljen dhe rritjen e urbanizimit. Kjo ka rezultuar me një numër të shkollave të mbipopulluara në qytet dhe një numër të madh të shkollave pothuaj të zbrazëta në zonat rurale, që ndonjëherë mund të kenë më shumë staf sesa nxënës. Në këtë mënyrë ka alokime joefikase dhe të pabarabarta të resurseve mes shkollave dhe nivele të ndryshme të mësimnxënies. Duke

marrë parasysh këtë që u tha më lart është ë domosdoshme që në vitin e parë të qeverisjes të filloj projekti për Riorganizimin e Rrjetit të Shkollave në nivel vendi. Ky projekt do të implementohet në bashkëpunim të plotë me komunat dhe me prindërit. Projekti ka për qëllim ofrimin e kushteve dhe mundësive të barabarta për mësimnxënie për të gjithë nxënësit, duke fuzionuar disa shkolla. Në rast se shkolla për nxënësit do të largohet me shumë se tri km, komuna do të ofrojë transport të rregullt për nxënësit. Shkollat të cilat do të ngelin të zbraza do të adaptohen dhe shëndrrohen në qerdhe, në mënyrë që të gjithë fëmijet të kenë qasje në edukimin e hershëm dhe atë parafillor.

Rriorganizimi i rrjetit të shkollave do të sigurojë që rrjeti shkollor të përshtatet me realitetin demografik, lokal dhe social. Do të identifikohen mënyrat optimale për përmirësimin e alokimit të burimeve të kufizuara, në mënyrë që të gjitha shkollat fillore të jenë në gjendje të ofrojnë arsim sipas standardeve ndërkombëtare të arsimit, infrastrukturës dhe të legjislacionit. Riorganizimi do të vendosë një sistem të drejtë të arsimit fillor, të krijojë kushte të barabarta mësimore në të gjitha shkollat, të lejojë shkollat të ofrojnë më shumë orë mësimi dhe të sigurojë alokimin efikas të burimeve.

Riorganizimi në nivel komune do të do të bazohet në një indeks të unifikuar që marrin parasysh dimensionin buxhetor, që përfshin pagat dhe shpenzimet e tjera operative; dimension infrastrukturor që përfshirë nevojat për investime; dhe dimensionin arsimor, që përfshin madhësinë dhe strukturën e klasave, performancën arsimore dhe kapacitetet e mësuesve.

Implemtimi i këtij projekti këkon fleksibilitet dhe rishikim të formulës së financimit. Niveli qendror nuk do t'i mbajë komunat peng të fomulave rigjide të financimit të arsimit në nivel komunal.

## 7.6 **PROVIM KOMBËTAR PËR MËSIMDHËNËS TË RINJ**

Duke marrë parasysh se cilësia e mësidhënsëve/meritokracia në procesin e rekrutimit të mësidhënsëve të rinj është vendimtare për rezultate në arsim, MASHT-i brenda mandatit do të ndërtojë Qendrën për Testim Kombëtar të Mësidhënsëve të Rinj. Qendra do të ofrojë pajisje për testim online me kurrikulë të qartë për secilën lëndë. Pas ndërtimit të qendres së testimit dhe përgatijes së testeve sipas kurrikulave respektive “provimi kombëtar” për mësimdhënës do të bëhet kusht për t’u bërë pjesë e stafit mësimdhënës në Kosovë.

Pikët e marra në Provimin Kombëtar do të shërbejnë po ashtu për rangimin e mësimdhënësve në listën e pritjes për punësime. Atyre do t’u ofrohet mundësia e parë për punësim në rast të hapjes së vendeve të reja të punës.

Një qasje e tillë do të eliminojë të gjitha keqpërdorimet eventuale në punësimet e stafit të ri jo rofesionl e joadekuat.

## 7.7 **TRAJNIMI I MËSIMDHËNËSVE AKTUAL**

Zhvillimi dhe trajnimi profesional i mësimdhënësve është i domosdoshëm për të siguruar cilësi në arsim. Një program i vazhdueshëm i MASHTI-it do të fokusohet në trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve në nivel kombëtar. Në këtë projekt qeveria do të përfshijë ekspertë vendës dhe ndërkombëtarë, si dhe donatorë që janë të përfshirë aktivisht në fushën e arsimit. Çfarë e dallon

këtë program nga trajnimet e mëparshme është se ai do të ofrohet dhe do të jetë i obligueshëm për çdo mësues. Trajnimi do të përfundojë me vlerësimin e mësuesve dhe ata që nuk arrijnë sukses do të ofrohet mundësia për pensionim të parakohshëm.

Ministria gjithashtu do të hartojë një sistemi të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve në bazë të kriterëve të qarta do të vlerësohen për punën e tyre në mënyrë objektive dhe të drejtë. Një tjetër aspekt i rëndësishëm që do të shtohet është përdorimi i teknologjisë për të mbështetur trajnimin dhe vlerësimin e mësuesve. Do të zhvillohen platforma dhe mjete digjitale që do të ndihmojnë mësuesit në procesin e tyre të zhvillimit profesional dhe do të lejojnë një vlerësim më të përpiktë të shkathtësive të tyre mësimore.

Programi i trajnimit të mësuesve do të përfshijë një qasje të integruar dhe të holistike ndaj zhvillimit të mësuesve, duke kombinuar trajnimin, vlerësimin e performancës, teknologjinë, në përpjekje të përbashkët për të siguruar një arsim cilësor dhe për të ndihmuar mësuesit të jenë sa më të përgatitur dhe të motivuar që të përmbushin e misionin e tyre.

## 7.8 **FORCIMI I FAKULTETIT TË EDUKIMIT**

Fakulteti i Edukimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës edukon pjesën më të madhe të mësimdhënësve për vendin. Për shkak të problemeve në arsim Në programin tonë kemi paraparë ndërmarrjen e një sërë masash dhe incentivash të reja financiare që të rrisë motivin e të rinjëve për t'u bërë mësimdhënës.

Këto masa fokusohen kryesisht në rritja e pagave përmes rritjes së koeficientit të paraparë në kapitullin mbi zhvillim; bursa për nxënës të shkëlqyshëm me qëllim të orientimit të tyre drejt Fakultetit të Edukimit; si dhe punë e garantuar për studentë të shkëlqyshëm.

## 7.9 **KODIMI SI LËNDË E SHKOLLAVE FILLORE**

Nevojën për lëndë të teknologjisë informative në sistemin edukativ tonin, plani ynë e elaboron dhe në kapitullin për Teknologji Informative. Në këtë kapitull, për arsim, plani ynë elaboron fokusin në lëndën e Kodimit. Kodimi, si lëndë obligative në të gjitha shkollat fillore në Kosovë, do të jetë prioritet i Qeverisjes së LDK-së. Ne besojmë se përgatitja e brezave të rinj me trendët më të fundit globalë, do të vendosë Republikën e Kosovës në ballë të avancimeve shoqërore. Fëmijët kosovarë, duhen të jenë në hap – madje dhe para kohe – me sistemet e shumta evropaine. Këtë qëllim synojmë ta arrijmë me aftësimin e tyre, që nga mosha e hershme, me aftësi profesionale në kodim.

Para implementimit të kësaj lënde, plani ynë parasheh ngritjen e nivelit të infrastrukturës digjitale në të gjithë shkollat e Kosovës. Në këtë kontekst, pajisjet dhe rifunksionalizimi i secilës shkollë me laboratorë kompjuterikë shumëfunksionale është prioritet. Për digjitalizimin e plotë të shkollave tona, pajisjeve të siguruar teknologjike si dhe qasjes së sigurtë në internet, plani ynë parasheh ndarjen e rreth 20 milionë eurove.



## 7.10 SHKOLLA NË QENDËR

Programi ynë do të krijojë mundësi pavarësimi dhe vetmenaxhimi të shkollës dhe lidhje me komunitetin. Do të krijohet sistem në të cilin shkolla do të ketë buxhetin e saj vjetor, i cili do t'i ndahet në një formulë që konsiston në numrin e nxënësve, punën innovative në shkollë dhe performancën e arsimtarëve. Shkollës do t'i mundësohet krijimi i mjeteve vetanake dhe vetëplanifikimi i tyre për aktivitete dhe investime. Menaxhmenti i shkollës do të komplimentohet me rritjen e rolit të drejtorit të shkollës, Këshillit të shkollës e Këshillit të prindërve, të cilët së bashku do të bëjnë implementimin e politikave të rekrutimit bazuar në meritë dhe konkurrencë. Në këtë mënyrë, shkolla shndërrohet në qendër transformuese dhe inkubator të zhvillimit të fëmijëve.

Shkolla do të jetë përgjegjëse edhe për organizimin e mësimin tërëditor. Ajo do të kthehet në qendër të zhvillimeve në komunitet, duke fuqizuar zhvillimin e kompetencave të fëmijës në partneritet me familjen. Shkolla do të monitorojë edhe gjendjen psikologjike të nxënësve, aspekte sociale, arritjet në nxënie, cilësisë në mësimdhënie dhe do të ofrojë shërbime për orientim në karrierë. Do të sigurohen hapësira kreative për aktivitete të lira dhe sociale, si klube për mësim plotësues, për lëndë zgjedhore, si dhe aktivitete jashtëkurrikulare.

## 7.11 PERFORMANCA E MËSIMDHËNËSVE

Programi ynë parashih shqyrtim të matjes së performancës së mësimdhënësve dhe stimulimit të tyre. Në këtë drejtim, duhet të rishikohet sistemi i pagave për të shtuar rëndësinë e performancës dhe përkushtimit. Do të zhvillohet fondi për mësimdhënie inovative dhe për stimulim të performancës në mësimdhënie, grante të vogla, me bazë në shkollë. Do të ngrihen kapacitetet e menaxhmentit të mesëm në shkolla për të ndihmuar punën e mësimdhënësve dhe drejtorit të shkollës. Do të përkrahen koordinatorët e cilësisë. Do të shihen mundësitë për zbatim të testit të obligueshëm shtetëror për të diplomuarit nga fakultetet e edukimit. Do të mbështetet zhvillimi profesional me bazë në shkollë, në përputhje me nevojat dhe projektet individuale të mësimdhënësve.

## 7.12 ARSIMI PROFESIONAL DHE TREGU I PUNËS

Programi ynë parashih rishikimin e profilit të shkollave profesionale, bazuar në një strategji zhvillimore, që merr parasysh kërkesat e tregut të punës në Kosovë. Secila shkollë do të themelojë Qendrën Profesionale e cila do të jetë pikë lidhjeje e shkollës me biznesin duke menaxhuar praktikat profesionale dhe kërkesat për lëndë mësimore të reja. Qendra do të ketë mundësi edhe të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe të krijojë mjete vetanake, të cilat shkolla i menaxhon vetë, por edhe të zhvillojë qendra start-up për nxënësit e shkollës. Do të bashkëpunohet me odat rajonale ekonomike dhe zeytare, si dhe me shoqatat profesionale që ofrojnë profile e shkathtësi ekskluzivisht për nevoja të ndërmarrjeve në rajonet përkatëse.

Për të përforcuar mësimin dual, programi ynë do të synojë të forcojë Qendrat e Kompetencës; do të plotësohen laboratorë adekuatë, të pajisur me materialet e nevojshme shpenzuese për punë laboratorike të rregullt. Do të ndërmerren masa për avancimin e arsimit dhe aftësimin profesional për të rritur punësueshmërinë e të rinjve.

Për të finalizuar procesin e fuqizimit të shkollës profesionale, do të funksionalizojmë dhe rrisim kapacitetet e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve. Do të angazhohemi edhe për krijimin e kushteve për zhvillimin e punës praktike dhe praktikës profesionale (praktika në vendin e punës), si dhe përmirësimin e orientimit dhe këshillimit në karrierë me anë të zhvillimit të një modeli të orientimit dhe këshillimit në karrierë në AAP.

### 7.13 **RANGIMI DHE PROFILIZIMI I INSTITUCIONEVE**

Programi ynë synon që të avansojë cilësinë e arsimit të lartë, duke rritur konkurrueshmërinë në mes të institucioneve e akredituara të arsimit të lartë; duke kërkuar profilizimin e tyre në harmoni me kërkesat e tregut të punës dhe rritur numrin e projekteve hulumtuese. Do të krijohet një skeme rangimi e universiteteve publike dhe private e bazuar në performancën e tyre institucionale. Rangimi do të bazohet në disa kritere, si: proporcioni student-mësimdhënës, investimet vjetore në infrastrukturë për studentë, orientimi në karrierë dhe shkalla e punësimit të të diplomuarve, cilësia e punëve që fitojnë të diplomuarit, pritja për punësim, cilësia e infrastrukturës, integriteti akademik, shërbimet për përkrahjen akademike të studentëve, përkrahja e studentëve me nevoja të veçanta, kriteret e pranimit, numri i studentëve aplikues dhe i atyre të regjistruar sipas programeve, përkrahja për zhvillimin e personelit, numri i publikimeve të personelit, numri i publikimeve/njësive librare nga institucioni dhe të ngjashme.

Universitetet e reja publike, por edhe ato private do të hyjnë në procesin e profilizimit në përputhje me parimet e ligjit, Procesin e Bolonjës dhe kriteret e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. Profilizimi do të bëhet në bazë të një reforme gjithëpërfshirëse bazuar në nevojën për programe të caktuara. Do të përkrahen universitetet aplikative regjionale si Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, si universitet aplikativ për përpunimin e drurit, dhe Universiteti i Mitrovicës, si universitet me profil të qartë në fushën e makinerisë prodhuese, xehëtarisë dhe të metalurgjisë.

### 7.14 **FONDI PËR HULUMTIME SHKENCORE DHE FONDI I EKSELENCËS**

Programi ynë parasheh të themelojë Fondin e Hulumtimeve Shkencore, që do t'iu dedikohet kërkuesve, ligjëruesve, profesorëve e institutive për projekte hulumtuese, të cilat do përdoren si baze për politikëbërje dhe promovim. Ky fond do të jetë në harmoni me standardet evropiane dhe do të jetë në funksion të ndërlidhjes së punës hulumtuese në universitete me industrinë, përmes qasjes së specializimeve të mençura. Fondi do të nxitë krijimin e inkubatorëve inovativ, nëpërmjet të cilëve siguroheh planifikimi i projekteve hulumtuese e inovative dhe përfshien sa më shumë të rinj. Për të ndërlidhur hulumtimin me inovacion dhe rini dhe me qëllim të stimulimit të ndërmarrësisë Fondi i Hulumtimeve inkurajon bashkëpunimin me bizneset. Rezultatet e projekteve nga Fondi i Hulumtimeve mund të përdoren në funksion të politikëbërjes në vend. Fondi do të përkrah edhe ndërtimin strukturor të revistave shkencore të vendit.

Programi ynë parasheh themelimin e Fondit të Ekselencës, i cili do të ndahet për programet inovative në funksion të zhvillimit të universiteteve. Fondi do t'ju jepet edhe: stafit akademik, qendrave hulumtuese, institucioneve e programeve

që kanë ide innovative dhe projekte cilësore të studimeve doktorale. Kriteret për ndarjen e këtyre mjeteve do të bazohen në rezultate në skemat e rangimit të institucioneve të arsimit të lartë, vlerësimet nga Agjencia e Akreditimit, pjesëmarrja në programet Erasmus, numrin e mobiliteteve, funksionalitetin e menaxhmentit, kapacitetin për menaxhim të programeve dhe kritere të tjera. Fondi i Ekselencës do të mbështesë edhe projekte cilësore nga studime të doktoratës dhe studime master, si dhe hulumtime në fushën e aplikimit të teknologjive të reja.

PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# MBROJTJA







## KONTEKSTI

Republika e Kosovës mbron sovranitetin dhe integritetin territorial, duke forcuar dhe përdorur kapacitetet e nevojshme dhe të domosdoshme kushtetuese përballë kërcënimeve, rreziqeve dhe sfidave të brendshme, rajonale dhe globale. Thellimi i partneritetit dypalësh dhe me NATO-n, deri në anëtarësim të plotë në NATO do të vazhdojë të jetë instrument kryesor i politikës së sigurisë dhe mbrojtjes së RKS në aspektin diplomatik dhe ushtarak. Partneriteti strategjik me SHBA-të mbetet thelbësor dhe i përhershëm.

Përmes forcimit, avansimit dhe modernizimit të institucioneve shtetërore ofrohet mjedis i sigurt dhe i mbrojtur, prosperitet dhe mirëqenie qytetare, garantim i lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut, në shërbim të përforcimit të vlerave perëndimore të shtetit tonë. Fuqizim i institucioneve shtetërore garanton sundimin e ligjit, qeverisje të mirë, rend dhe siguri publike, shëndet publik, cilësi në arsim, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, rritje aftësitë konkurruese, siguri energjetike, ofrimin e shërbimeve efikase dhe cilësore për qytetarët, rritje konkurrencës shoqërore dhe politik për interesa shtetërore.

Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj cilitdo prej fqinjve të saj dhe pret të njëjtën pozicion dhe politikë nga shtetet fqinje. I gjithë mjedisi rajonal i sigurisë do të përmirësohet më tutje përmes njohjes reciproke të shtetësisë midis Kosovës dhe Serbisë, e cila adresohet përmes dialogut, si një proces i moskonfrontimit dhe integritetit evropian. Prezenca dhe qëndrimi i NATO-s dhe BE-së mbetet faktor në ndërtimin e paqes së qëndrueshme në rajon; përdërisa synimi historik i Lidhjes Demokratike të Kosovës, për një Kosovë anëtare të NATO-s jep garancën e domosdoshme për siguri.

Kosova ka vendosur dhe thelluar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me tri nga shtetet fqinje të saj. Marrëdhëniet e mira me Shqipërinë, Malin e Zi si dhe me Maqedoninë e Veriut, i shërbejnë sigurisë rajonale dhe si të tilla synojmë ti avansojmë në vazhdimësi.

Agresioni Rus mbi Ukrainën, ndërsa, ka ndryshuar në tërësi ambientin e sigurisë globale me ndikim të theksuar edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kosova është rreshtuar pa ekuivok në anën e Perëndimit dhe politikave të sigurisë të shtruar nga NATO-ja, e prirë nga SHBA-të dhe partnerët evropianë. Ambienti i ri i sigurisë, krijon domosdoshmëri të rritjes së kapaciteteve mbrojtëse në Kosovë. Prandaj shpenzimet e deritanishme në buxhet të mbrojtjes, nuk mund të garantojnë sigurinë e Kosovës.



# PLANI YNË PËR MBROJTJE

LDK-ja synon zhvillimin e Forcave të Armatosura përmes zhvillimit të personelit, menaxhimit të burimeve njerëzore, zhvillimit të komponentës së inteligjencës dhe sigurisë, fushës së operacioneve ushtarake, fushës së mbështetjes logjistike, planifikimit, komunikimit dhe trajnimit. Angazhimet kryesore në fushën e mbrojtjes janë:

## 8.1 PARTNERITETI PËR PAQE DHE INTEGRIMI NË NATO

Nënshkrimi i Partneritetit për Paqe me NATO-n dhe, nga aty, shtrimi i rrugës për anëtarësim të plotë në aleancën veriatlantike, do të jenë prioritete qenësore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të programit tonë politik. Si rrugëtim origjinal e identitar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, për një shtet të pavarur e sovran, të anëtarësuar në NATO, ky proces do të shënonte jo vetëm mbylljen e një kaptine të kaluar të përpjekjes historike, por njëkohësisht dhe hapje e një kapitulli të ri të sigurisë, që do të krijonte stabilitet e siguri në Kosovë e rajon. Si vend i rrethuar me tre shtete të NATO-s, e me prezencë ushtarake të trupave të NATO-s në Kosovë, integrimi në këtë aleancë, mbetet krejtësisht i natyrshëm për Kosovën.

## 8.2 RITJA E BUXHETIT NË 2% TË BRUTO PRODUKTIT VENDOR

Republika e Kosovës shpenzon rreth 1.4% të Bruto Produktit Vendor për mbrojtjen. Një proporcion i tillë është ndër më të ulët në rajon; dhe shumë larg shpenzimeve që vendet e anëtare të NATO-s kanë në mbrojtje. Sipas udhëzimeve të NATO-s, shpenzimet në mbrojtje të vendeve anëtare duhet të arrijnë 2% të BPV-ve të vendeve përkatëse. Plani ynë parasheh që deri në vitin e tretë të qeverisjes, shpenzimet e Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes të arrijnë në 2% të Bruto Produktit Vendor, dhe në atë nivel të mbesin për një periudhë afatmesme. Rritja e BPV-se do të nënkuptonte dhe rritje proporcionale të buxhetit për mbrojtje.

## 8.3 RISTRUKTURIMI I FSK-SË

FSK-ja do të jetë e organizuar dhe e ndërtuar bazuar në vlerësimin e rreziqeve dhe kërcënimeve dhe rekomandimeve që do të dalin nga rishikimi strategjik i sektorit të mbrojtjes (RSM), dhe si e tillë do të jetë e adaptueshme dhe fleksibile për të realizuar një spektër të gjerë misionesh brenda dhe jashtë vendit. Struktura e FSK-së duhet të jetë e standardizuar me strukturat e vendeve anëtare të NATO-s, e krahasueshme dhe e balancuar me vendet e rajonit. FSK-ja do të jetë e kompozuar nga forcat aktive dhe forcat rezervë vullnetare nga e gjithë shoqëria dhe e ndërtuar mbi bazën e standardeve ndërkombëtare e ndërveprueshme me ushtritë e vendeve anëtare të NATO-së. Me qëllime të qarta të pjesëmarrjes në operacione ndërkombëtare, si pjesë e një qëllimi më të gjerë kombëtar të marrëdhënieve të ngushta me NATO-n dhe në fund, të anëtarësimit të plotë në NATO. Përbërja e Forcës në planin tonë parashihet të jetë me 6000 pjesëtarë aktivë (sot janë 4000 sosh), 3000 rezervë aktive dhe 20000 rezervë e përgjithshme.

## 8.4 ARSIMIMI USHTARAK NË SHKOLLA CIVILE

Plani ynë mbështetë idenë e edukimit dhe stërvitjes së nxënësve të shkollave të mesme në fushën e mbrojtjes. Nxënësit e Kosovës do të fitonin shkathtësitë bazike ushtarake që do të ishin në përputhje me nivelin 1 dhe 2 të aftësive ushtarake për ushtarët e rregullt të FSK. Edukimi i nxënësve në këtë fushë do të krijonte një bazë të fortë për rekrutimin e ushtarëve të rinj dhe ata më të dalluarit do të kenë përparësi në përzgjedhjen e kadetëve të rinj për t'u regjistruar në akademinë e mbrojtjes "Wesley K. Clark" të FSK-së dhe nëpër akademitë ushtarake të shteteve partnere të RKS-së.

Në planin tonë, lëndët e fushës së mbrojtjes do të integrohen në plan-programet arsimore të të gjitha shkollave publike të Republikës së Kosovës. Këto lëndë duhet të integrohen në klasat 11 dhe 12 të shkollave të mesme. Të futen dy grup lëndësh mësimore në shkollat tona: a) Bazat e trajnimit individual ushtarak, për klasën e 11-të, ku do të aplikoheshin temat mësimore si: Njohuri mbi ligjet dhe rregulloret ushtarake (përfshirë edhe Ligjet ndërkombëtare të luftës); Familjarizim me armët individuale të FSK, dhe qitje bazike nr. 1, (pistoletë dhe pushkë automatike 5.56 mm); Bazat e navigimit tokësor dhe Ndihma e parë në fushëbetejë; dhe b) Trajnimi bazik i avancuar për klasën e 12-të, ku do zhvilloheshin temat mësimore si: Lidërsip ushtarak bazik dhe ndërtimi i ekipit; Formacionet ushtarake dhe teknikat e lëvizjes; Përdorimi i armëve individuale dhe qitja nr 2 si dhe familjarizim me armët e ekipit; Navigim tokësor dhe mbijetesa në natyrë në rrethana të luftës; Ndihma e parë në fushëbetejë avancuar; Bazat e komunikimit dhe pjesëmarrja e nxënësve të klasës së 12-të në ushtrimet fushore vjetore të njësive të FSK-së.

## 8.5 NDËRTIMI I 4 KAZERMAVE USHTARAKE

FSK-ja është e vendosur në shtatë kazerma: Kazerma “Adem Jashari” në Prishtinë; Kazerma “Skënderbeu” në Ferizaj; Kazerma “Evropianët e Rinj” në Pomozotin; Kazerma “Ushtarët e NATO-s” në Istog; Kazerma “Newborn” në Gjilan; Kazerma “Minatori” në Mitrovicë; dhe Kazerma e EOD në Prizren. FSK-ja do të ngrisë një ekip të ekspertëve për vlerësimin e kazermave dhe instalacioneve ushtarake. Ky vlerësim do të bazohet në përputhje me misionin e FSK-së, strukturën e saj, gatishmërinë e njësive dhe faktorëve të tjerë përcaktues, me theks të veçantë atyre urban, demografik dhe gjeografik.

Plani ynë parasheh se të gjitha objektet ushtarake, të reja si dhe të vjetrat pa dallim, duhet t’i plotësojnë të gjitha kushtet e komandim-kontrollit, logjistikës, aktiviteteve ditore, stërvitjeve dhe trajnimeve, deponimit dhe mirëmbajtjes. Objektet ushtarake të rëndësishme të veçantë, sidomos ato që aktivizohen në situata lufte siç janë Qendrat e Komandimi e Kontrollit duhet të trajtohen me ligj të veçantë. Ky ligj do të trafthohet në dy vitet e para të qeverisjes.

Programi i Lidhjes Demokratike për mbrojtjen parasheh që të bëhet zhvendosja, rikonstruktimi, si dhe ridisnjimi i objekteve ushtarake. Do të riorganizohen kazermat aktuale duke ia përshtatur misionit të FSK-së dhe do të rrisim numrin e kazermave për 4 sosh në regjione të ndryshme të Kosovës. Në Prizren (ish-kazerma e kontingjentit Gjerman të KFOR-it); në Gjinoc të Suharekës (kazerma aktuale e KFOR-it); në Gjakovë (Aeroporti i Gjakovës) dhe në Podujevë. Shuma e gjithmbarshme e investimeve në këtë projekt, pra në përditësimin e kazermave të tanishme dhe në ndërtimin e 4 kazermave të reja, do të jetë rreth 60 milionë euro.

## 8.6 NDËRTIMI I VENDBANIMEVE PËR PERSONELIN USHTARAK

Plani ynë parasheh që të gjitha njësitë e FSK-së të jenë në gatishmëri të lartë. Një ndër faktorët që siguron këtë gatishmëri është dhe koha e alarmimit, mobilizimit dhe grumbullimit të forcave tona. Afërsia fizike e personelit ushtarak me objektet dhe pajisjet ushtarake është determinant në kohën e reagimit. Prandaj, në vazhdim të kësaj, është shumë me rëndësi që afër objekteve ushtarake të ndërtohen lagje ushtarake të cilat do të jenë në shërbim të vendosjes së personelit ushtarak së bashku me familjet e tyre.

Me ndërtimin e këtyre lagjeve kursehet koha si element kryesor, po ashtu edhe shpenzimet e transportit, mirëmbajtjes së automjeteve, minimizohet rreziku i aksidenteve të trafikut nga personeli ushtarak, si dhe ekspozimi i tepërt i tyre në publik. Këto lagje të ndërtohen afër objekteve ushtarake (kazerma), që plotësojnë numrin e mjaftueshëm të ushtarakëve për ndërtimin e lagjeve. Lagjet duhet të jenë tepër funksionale si dhe mirë të organizuara ashtu që të ndahen hapësira të veçanta e të mjaftueshme sikur për ushtarët me numër më të vogël të anëtarëve po ashtu edhe për ata më numër më të madh të anëtarëve të familjes.

Në Planin tonë, parashihet të jepen rreth 50 milionë euro për ndërtimin e lagjeve të tilla; si faze e parë e një projekti e angazhimi shumë më të gjatë.

## 8.7 SMART DEFENCE

Koncepti “Smart Defence” ka të bëjë me shtetet që ndërtojnë siguri më të madhe me më shumë bashkëpunim, më shumë koherencë dhe me një kosto të përballueshme. Ndihma reciproke në mes të aleatëve dhe partnerëve në shumë drejtime të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes do të jetë komponenti kryesor i këtij bashkëpunimi. Zhvillimi i kapaciteteve aktuale dhe avancimi i tyre, si dhe zhvillimi i kapaciteteve të reja nga kërkimi dhe zhvillimi, tek prodhimi, prokurimi, mirëmbajtja dhe trajnimi do të jenë po ashtu elemente qenësore të kësaj komponente. Prioritet do t’i jepet heqjes së barrierave politike, sidomos në blerjen e sistemeve të ndryshme dhe pajisjeve në fushën e sigurisë në mes të partnerëve.

Aplikimi i “Smart Defence” në Ballkanin Perëndimor mund të bëhet në kuadër të iniciativës Adriatik 5+, apo ndonjë initiative të ngjashme. Është i aplikueshëm lehtë në mes të shteteve partnere rajonale me synime të përbashkëta, siç është rasti mbështetës rajonale që janë anëtarë të NATO-s apo kanë synime strategjike për t’u anëtarësuar në këtë aleancë. Ky bashkëpunim mund të aplikohet në shumë drejtime në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, me theks të veçantë në bashkimin dhe ndarjen e kapaciteteve decizive luftarake; krijimin e sistemit të edukimit dhe arsimimit të përbashkët për trupën e oficerëve (shembull Baltic Defence College); zbarkimin e përbashkët në operacione të mbështetjes së paqes; bashkëpunimin në fushën e blerjeve dhe prodhimit për pajisje artikuj tjerë në fushën e mbrojtjes; si dhe bashkimin dhe përdorimin e kapaciteteve të ndryshme të sigurisë dhe mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore.

## 8.8 KRIJIMI I KAPACITETEVE PËR OPERACIONE NDËRKOMBËTARE

FS-ja do të ndërtojë kapacitetet e saj për të kontribuar në operacionet e mbështetjes së paqes si ato të natyrës humanitare, ndërtimit të paqes dhe operacionet në raste të fatkeqësive natyrore. FSK-j si synuese e integritit në NATO do të zhvillojë kapacitete të cilat do të jenë të deklaruara për NATO-n. Këto kapacitete të cilat do të jenë konvencionale dhe të specializuara që do të funksionojnë në kuadër të sistemit të gjenerimit të forcës. Kosova do të dizajnojë njësitë e veçanta dhe adekuate për OMP-në. Krijimi i një njësie batalion i kombinuar, që duhet të jetë i deklaruar si i gatshëm për operacione ndërkombëtare të paqes, do të jetë pjesë e kësaj komponente. Kjo të bëhet me formatin e Gjenerimit të Forcës, (njësi me jetëgjatësi 4-vjeçare, me rotacion modeli SET/TRAIN/Ready-DEPLOY/RE-SET). Në kuadër të këtij projekti ne do të sigurojmë resurset e nevojshme, furnizimin me pajisjet kompatible me ushtritë partnere, si dhe aftësimi i personelit për këto operacione. Vlerësimi fillestar i këtij aktiviteti është rreth 12 milionë euro.

## 8.9 ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË LUFTËS KIBERNETIKE

Në bashkëpunim me SHBA-të dhe forcat ushtarake të aleatëve do të punohet në ngritjen e kapaciteteve luftarake elektronike, kibernetike, kontrollin, zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive të spektrit Elektro Magnetik (EM) për mbrojtje dhe sulme. Kjo formë e avancimit do të krijonte avantazhe strategjike e do të siguronte sukses në operacionet ushtarake. Gjithashtu, bashkë me aleatët, të punohet në sistemet luftarake të informacionit me qëllim të zënies dhe mbajtjes së kontrollit të komunikimeve, radarëve dhe sensorëve tjerë të rëndësishëm. Gjithashtu sigurimi në qasjen drejt satelitëve ushtarak është shumë i rëndësishëm për komunikimin e sigurt dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Për të arritur këtë, plani ynë parasheh rritje të bashkëpunimit me institucionet edukative të vendit dhe ngritje të nivelit të bashkëpunimit publiko-privat, sidomos me kompanitë e teknologjisë informative; sikurse dhe vazhdim të bashkëpunimit profesional me Gardën Kombëtare të IOWA-s si aset i patjetërsueshëm dhe ndër më të rëndësishmit në zhvillimin e forcës sonë.

Po ashtu me partnerët tanë do të mbahet bashkëpunimi i avansimit të njohurive dhe kapaciteteve në operacionet vëzhguese të inteligjencës dhe sulmuese luftarake me fluturaket pa pilot. Asistenca ushtarake që kërkohet nga partnerët tanë, do të e jetë e fokusuar në sigurinë kibernetike, dhe në fushën e luftës elektromagnetike si në pajisje dhe, po ashtu, edhe në edukim dhe trajnim.

Plani ynë parasheh programe të veçanta për mbajtjen e personelit të specializuar në këtë fushë, si dhe të ketë një fokus të veçantë trefishimin e pozitave të lidhura me fusha të sigurisë kibernetike.

Në kuadër të MM-së të krijohet një qendër bashkëkohore e kërkimeve shkencore dhe hulumtimeve në fushën e mbrojtjes e cila do të nxirrte koncepte, bënte analiza dhe rekomandime për zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse të RKS-së në kontekstin aktual bashkëkohore por edhe për investimet afat shkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

## 8.10 PENSIONIMI DHE TRANZICIONI I PJESËTARËVE TË FSK-SË

Sipas ligjit për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, pjesëtarët e FSK-së pensionohen në një moshë relativisht të re. Nënoficerët pensionohen në moshën pesëdhjetë (50) vjeçare, kurse oficerët pensionohen në moshën 55 (pesëdhjetë) vjeçare. Gjatë karrierës së tyre pjesëtarët e -sëpecializohen në fusha të ndryshme, si në mësimdhënie në fushat e sigurisë, Menaxhim, IT, Transport, Mekanik, Kërkim-Shpëtim, Deminim e të ngjashme.

LDK-ja do të zhvillojë programe të tranzicionit për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, që të njëjtit pas pensionimit të angazhohen dhe të integrohen në jetën civile me qëllim të kontributit edhe më tutje në shoqërinë tonë. Këtë do ta arrijë përmes: a) profilizimit dhe trajnimit të pjesëtarëve të FSK-së në fusha të veçanta dhe zhvillimin e tyre në fushat respektive gjatë karrierës ushtarake; b) ndryshimet ligjore që u mundësojnë pjesëtarëve të FSK-së angazhimin në të gjitha fushat e jetës publike përfshirë edhe në FSK-në (si civil), e sidomos në fushën akademike dhe doktrimore edhe pas pensionimit.



PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# RENDI DHE SIGURIA







# RENDI DHE SIGURIA

## KONTEKSTI

Një shtet i fuqishëm kërkon rend, siguri dhe ligj. Një shtet i fuqishëm brenda, është synim i programit tonë politik. Derisa Kosova vazhdon të lundrojë në sfidat shtetare ndërkombëtare, LDK-ja është e përkushtuar që të sigurojë një shoqëri të sigurt dhe të begatë për të gjithë qytetarët.

Sot, Republika e Kosovës vazhdon të përballet me sfida të ndryshme të vënies së rendit dhe sigurisë. Ndër kryesoret mbesin ato të krimit të organizuar; ruajtjes së pronës, sigurisë në shkolla, dhunës në familje e sigurisë në komunikacion.

Çështjet e ambientit, si deponitë ilegale të mbeturinave, ujërat e zeza, ndotja akustike, prerja ilegale e pyjeve dhe rreziku nga zjarret; trafikimi me njerëz, migrimi ilegal, trafikimi i narkotikëve, terrorizimi, krimet kibernetike, si dhe niveli i lartë i armëmbajtjeve pa leje në mesin e qytetarëve, mbesin çështje që rëndojnë seriozisht mbi rendin dhe sigurinë në Kosovë, dhe kështu edhe rrezikojnë rendin shoqëror dhe demokratik të vendit tonë.

Veçanërisht në dy vitet e fundit, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), si bartëse e shumë proceseve në sektorin e sigurisë, u tregua e paaftë për t'i bërë ballë sfidave që e renduan Kosovën, duke filluar me politizimin e skajshëm të të gjitha agjencive në varësinë e tyre, me fokus në Policinë e Kosovës (PK). Ndërhyrja dhe presioni politik i ushtruar ndaj PK-ja është i paprecedent deri më tani. Shkarkimet dhe ndërrimet në PK e kanë rrezikuar seriozisht funksionimin normal të saj, në veçanti fakti se PK-ja, me muaj të tërë, mbeti me Ushtues Detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm.

Problemet kanë lindur edhe si rezultat i fuzionimit të MPB me ish-Ministrinë e Administratës Publike (MAP). Për shkak të menaxhimit të mangët, ky proces i fuzionimit është manifestuar me probleme të konsiderueshme praktike, duke krijuar dualizëm brenda këtij dikasteri, i cili është manifestuar në disa raste edhe me kolizionin e kompetencave. Kjo edhe ka krijuar tepricë të burimeve njerëzore, të cilët nuk kanë portofol të caktuar, por vetëm figurojnë në listën e pagave, për shkak të marrëdhënies së ligjshme të punës.

Kosova vazhdon të ketë numër të ulët të policëve për kokë banori dhe vazhdon të mos e ketë funksional konceptin e policëve të lagjes, të cilët do të ishin përgjegjës për ofrimin e sigurisë në komunitet. Po ashtu, angazhimi disproporcional i Policisë së Kosovës në punë administrative, në vend të terrenit, ka bërë që kapacitetet policore, edhe ashtu të mangëta, të reduktohen edhe më tutje. Mungesa e veturave policore, e uniformave apo edhe mospensionimi i parakohshëm i policisë, ka ulur dukshëm potencialin operacional të kësaj force të rëndësisë më të veçantë të sigurisë.

# PLANI YNË PËR REND DHE SIGURI

LDK-ja do të mbetet e përkushtuar në luftimin e pakompromis të formave të krimit dhe të gjitha formave tjera të rrezikimit të sigurisë së qytetarëve, të cilat e sfidojnë rendin dhe sigurinë publike të shoqërisë sonë ne përgjithësi.

Duke vlerësuar mjedisin e sigurisë në nivel vendi, rajonal dhe global, i cili karakterizohet me një ritëm të shpejtë të evoluimit të natyrës së sfidave dhe kërcënimeve asimetrike, përfshirë edhe ato hibride, Republika e Kosovës ka nevojë imediate të ripërcaktimit të interesave, përfshirë ato të sigurisë, përparësive, qëllimeve dhe objektivave të vendit, si dhe të zhvillojë më tutje gamën e instrumenteve përkatëse, respektivisht ta hartojë Strategjinë e re të Sigurisë, përmbajta e së cilës duhet të jetë në përputhje me nevojat e vendit dhe me trendët e mjedisit të sigurisë vendore, rajonale dhe globale. Strategjia është dokumenti më i lartë i politikave të sigurisë, që përcakton orientimet e kursit të politikave të sigurisë, krijimin e një kornize konceptuale dhe përmbajtjesore, si pikë reference për strategjitë e tjera ministrore, e deri tek ato sektoriale.

LDK-ja e konsideron si fundamentale një reformë gjithëpërfshirëse në fushën e sigurisë kombëtare, ku pjesë integrale është edhe Agjencia Kosovare e Inteligjencës (AKI-ja). LDK-ja do të insistojë në pavarësinë institucionale të AKI-së dhe rregullimin e bashkëpunimit ndërmjet AKI-së dhe agjencive të tjera të sigurisë publike, si dhe bashkëpunimin me partnerët strategjikë. Punësimi dhe rritja e profesionalizmit të personelit të AKI-së do të mbetet i bazuar në kornizën ligjore, duke mëtuar që të ketë rekrutim profesional, e që do të tërheqë dhe motivojë kategoritë më profesionale të shoqërisë të behën pjesë e AKI-së. Do të sigurohemi që sistemi i tanishëm i vetingut të zyrtarëve të Policisë së Kosovës dhe atyre të Inspektoratit Policorë të Kosovës të reformohet, duke u ngritur në një nivel më efikas e më transparent.

Prioritet i LDK-së do të jetë edhe ngritja e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim anëtarësimin e Policisë së Kosovës në organizatat regjionale dhe ndërkombëtare (EUROPOL, INTERPOL dhe mekanizmat e tjerë rajonale dhe ndërkombëtarë), si dhe arritjen e marrëveshjeve bilaterale në fushën e sigurisë dhe bashkëpunimit policorë me shtetet e BE-së, partnerëve tjerë strategjikë, si dhe vendet rajonale. Një kujdes dhe prioritet i veçantë do t'i kushtohet edhe digjitalizimit të të gjitha shërbimeve, si të atyre të brendshme ashtu edhe shërbimeve dhe komunikimit me qytetarët.

Për të realizuar të gjitha këto aktivitete, LDK-ja do të ndërmarr një varg veprimesh konkrete, të cilat do të krijojnë parakushte për luftimin me sukses të këtyre dukurive negative, duke përfshirë adresimin e të gjitha problemeve dhe gjetjen e zgjidhjeve të duhura në institucionet përkatëse të sigurisë publike, disa prej të cilave janë parashtruar me radhë në tekstin e mëposhtëm.

## 9.1 RISTRUKTURIMI I POLICISË SE KOSOVËS

Policia e Kosovës (PK-ja) është njëri ndër institucionet më vitale të Republikës së Kosovës, dhe si i tillë duhet të arrij nivelin më të lartë të profesionalizimit, pavarësimit në çështjet operacionale, depolitizimit, forcimit të integritetit të zyrtarëve policorë, si dhe të parandalimit të korrupsionit brenda PK-së, parakushte këto që kjo agjenci të përmbush misionin e saj për luftimin e dukurive negative që cenojnë rendin publik dhe shoqërinë demokratike. Ngritja dhe përmirësimi i bashkëpunimit, kapaciteteve dhe aftësive të PK-së parashihet edhe në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Policia e Kosovës duhet në vazhdimësi të ofrojë shërbime cilësore, duke vënë në pah prioritetet dhe fokusin në zgjidhjen e problemeve të përditshme të qytetarëve. Avancimi i strukturës organizative, përmes reformës policore, përgatitja e duhur e resurseve të nevojshme, kuadrit udhëheqës profesional dhe të pandikuar politikisht, i gatshëm për përgjegjësi dhe llogaridhënie karshi obligimeve, do të pengonin substancialisht dështimet dhe skandalet, që në vazhdimësi janë duke rënduar funksionimin profesional të PK-së. Për një koordinim më të mirë dhe më efikas, LDK-ja do të normojë që secilit ministër të ri, në bashkëvendim me kryeministrin, t'i mundësohet emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, sapo të marrë mandatin.

Krijimi dhe funksionimi i Taks-Forcave me vendime politike është treguar si një mjet mjaft i dëmshëm dhe joefikas në fushën e luftimit të korrupsionit, e instaluar si rezultat i ndërhyrjeve politike. LDK-ja, si vizion për të ardhmen dhe

në shërbim të pamundësisimit të ndërhyrjeve politike, nga bërthama e tashme e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, do të krijojë Njësitin Unik Financiar (NUF), i cili detyrë kryesore do të ketë luftimin e të gjitha formave të krimeve financiare. Struktura e re do të ketë ndërveprime të ngushta me Njësinë e Inteligjencës Financiare, me Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë dhe me strukturat e tjera përkatëse shtetërore, përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e krimeve ekonomike dhe financiare. Kjo strukturë e re do t'i kushtojë Buxhetit të Kosovës rreth 2,956,882.00 euro, e shpërndarë në katër vite të qeverisjes.

Policia e Kosovës, edhe pse relativisht institucion i ri i sigurisë, vlerësohet të jetë institucioni me moshën më të vjetër mesatare të pjesëtarëve, jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë. Moshë mesatare e të punësuarve në PK është rreth 48-vjeç. Rrjedhimisht, ky trend nuk përfaqëson as moshën mesatare objektive të shoqërisë në përgjithësi. LDK-ja mbetet e përkushtuar qësa më parë të miratojë Ligjin mbi Pensionimin e Parakohshëm për Policinë e Kosovës, që do t'i ndihmojë një reforme substanciale dhe plotësimin të kuadrit profesional të Policisë së Kosovës. Kostoja e këtij ligji do të jetë rreth 41,759,974.00 euro, e shpërndarë në katër vite të qeverisjes. Sipas të dhënave tona, numri i policëve që do të dilnin në pensionim të parakohshëm (mbi moshën 55 vjeçare) është afër 2,000 pjesëtarë.

Për faktin se PK-ja është institucion operacional dhe me përgjegjësi të shumta në fushën e rendit, sigurisë dhe ligjit, prioritet do t'i jepet alokimit të resurseve të PK-së enkas për punë operationale policore, duke reduktuar kështu në maksimum angazhimet e resurseve policore për veprime administrative e teknike, brenda strukturës aktuale të Policisë së Kosovës, në mënyrë që Policia e Kosovës detyrë kryesore dhe të vetme të ketë zbatimin e ligjit, në funksion të ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike. Aktualisht, në veçanti pas ndryshimit të strukturës organizative në vitin 2023, llogaritet se rreth 20% e zyrtarëve policorë ushtrojnë punë administrative për nevoja të PK-së e që do të duhej të kryheshin nga stafi civil i punësuar në PK. Gjithashtu, rreth 670 zyrtarë policorë të PK-së angazhohen për ofrimin e sigurisë fizike për një numër relativisht të madh të objekteve shtetërore (150 objekte qeveritare dhe të Trashëgimisë Kulturore Fetare - TKF), detyra të cilat në të ardhmen do të mund të kryhen nga Kompanitë e Licencuara të Sigurimit. Me ndryshimet e bëra, rreth 400 nga policët për ruajtjen e objekteve të TKF-së janë zhvendosur në Divizionin e Policimit në Bashkësi. LDK do të ndërmarr veprime konkrete për të ndryshuar këtë qasje strukturore në drejtim të reduktimit dhe shkarkimit të punëve jopolicore brenda strukturës së PK-së.

Do të racionalizojmë menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe të përmirësojmë integritetin dhe efikasitetin e shërbimeve mbështetëse, për të mundësuar përmbushjen e detyrave dhe obligimeve. Rekrutimet e reja dhe ruajtja e personelit profesional janë më se të rëndësishme për policinë. Policia e Kosovës në fund të vitit 2022 numëronte rreth 7,816 policë në uniformë (si dhe 883 staf civil), e që është numër i pamjaftueshme për rrethanat dhe numrin e banorëve të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, sapo të miratohet Ligji për Pensionimin e Parakohshëm të Policisë së Kosovës, llogaritet që edhe 2,000 policë të moshës mbi 55-vjeçe do të pensionoheshin. Përkundër kësaj, LDK synon të ngritë këtë numër në 10,000 policë në uniformë. Fakti që rreth 20% e policëve në uniformë ushtrojnë funksione administrative, na shtynë të synojmë lirinë e tyre nga këto



detyra dhe bashkimin e tyre me forcën policore, të cilës kështu do t'i shtoheshin edhe rreth 1,500 policë. Duhet cekur gjithashtu se gjatë vitit 2023 akademinë e kanë përfunduar edhe dy gjenerata, me totalin prej 870 policëve të rinj (420 + 450).

Pra, numrit prej 7,816 policëve i hiqen 2,000 të pensionuar, si dhe i shtohen: 1,500 nga shërbimet administrative; dhe 870 të sapodiplomuar. Me këto ndryshime, arrijmë në numrin prej 8,186 pjesëtarëve. Pjesa tjetër (1,814 policë) do të rekrutoheshin dhe do të trajnoheshin në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në katër afate gjashtë-mujore, duke përfunduar kështu trajnimin e tyre në vitin e dytë të qeverisjes sonë. Shtesa prej 1,814 policëve do t'i kushtonte Buxhetit të Kosovës rreth 7 milionë euro. Duhet cekur se ky numër ndryshon vazhdimisht, për shkak të largimit të policëve nga radhët e PK-së, kryesisht si rezultat i problemeve të numëruara më lartë.

Në total, Policia e Kosovës do t'i ketë 10,000 pjesëtarë aktiv, nën moshën 55-vjeçare.

## 9.2 POLICIMI NE BASHKËSI

Dobësimi i sektorit patrullues shpërfaq keqmenaxhim në të gjitha nivelet, e mbi të gjitha në nivelin qendror. Marrja pa ndonjë analizë e resurseve nga sektorët patrullues dhe transferimi i tyre, si në kuadër të njësive të specializuara operative, ashtu edhe atyre hetimore, ka shkaktuar një situatë të palakmueshme për nivelin lokal (stacionet policore dhe drejtoritë rajonale), në veçanti pasi që vendimmarrja është bërë në mënyrë autoritare nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, me dyshime të favorizimit të interesave të caktuara. Kjo gjithashtu dëmton edhe konceptin e “policimit në bashkësi”, koncept ky i cili duket të jetë anashkaluar thuhet krejtësisht nga Policia e Kosovës. Koncepti bashkëkohor i Sigurisë në Bashkësi/Komunitet është i një rëndësie të veçantë në shtete demokratike, në të cilat siguria si nocion i shërben, i afrohet, ndërlihet dhe ndihmohet në një masë të madhe nga qytetarët e vet, në veçanti në nivelin lokal. Promovimi i parimeve të përgjegjësisë së përbashkët në sigurinë e bashkësisë, si dhe përfshirja e përfaqësuesve të të gjitha komuniteteve e grupacioneve në forumet e sigurisë të nivelit lokal, është një parakusht për një shoqëri bashkëkohore, të sigurt, të qëndrueshme dhe me nivel të kënaqshëm të mirëqenies qytetare. Do të kujdesemi që, veçanërisht në bashkëpunim me komunat e Kosovës dhe kryeqytetin, të forcojmë rolin e policisë në komunitet, si një komponentë kyçe në ngritjen e bashkëpunimit polici-komunitet, përfshirë edhe përmes strukturave si KKSJ-ja, KLSB dhe EVSB-ja, si dhe do të forcojmë kapacitetet në ngritjen e policimit të udhëhequr nga inteligjenca. Policimi në komunitet mund të përdoret në mënyrë efektive edhe drejt përfundimit dhe rikthimit të integritetit dhe kredibilitetit të policisë. Qytetarët do të mund t'i besojnë policisë vetëm kur komuniteti dhe policia do të mund të punojnë dhe veprojnë së bashku.

## 9.3 INFRASTRUKTURA POLICORE

Njëra nga pengesat kryesore të operimit efikas të PK-së është edhe infrastruktura relativisht e mangët, e cila në vazhdimësi shkaktonte probleme për reagimin e shpejt dhe të efektshëm të zyrtarëve policorë. Në këtë drejtim, do të angazhohemi që viktimat e dhunës në familje të trajtohen në mënyrë të veçantë, përfshirë dhoma të ndara për intervistim.



Asnjëherë PK-ja nuk ka arritur të sigurojë numër optimal të veturave, duke u detyruar kështu që në raste emergjente edhe të huazojë vetura nga dikastere të tjera qeveritare, përfshirë edhe komunat. LDK-ja do të angazhohet që numri i veturave të PK-së të ngritet, duke pasur në konsideratë dallimet në mes të veturave operacionale dhe atyre për punë administrative (të pashënuara). Do të synojmë që tek veturat operacionale të zbatojmë kriterin nga ish-administrata ndërkombëtare, e i cili ishte që për tetë zyrtarë policorë të sigurohet një veturë. Nga 1,600 vetura të nevojshme për funksionim optimal, PK-ja posedon vetëm 869 vetura funksionale. Prandaj, LDK-ja do të sigurojë që, në vitin e parë të qeverisjes, të sigurojë 400 vetura, vitin e dytë 300, vitin e tretë 300 dhe vitin e katërt 200 vetura të reja. Ky investim do t'i kushtojë Buxhetit të Kosovës rreth 66 milionë euro. Nga 869 veturat funksionale një numër i konsiderueshëm i tyre do të jetë ende i përdorshëm, në veçanti pasi që do të ristrukturojmë dhe riorganizojmë në tërësi Flotën Operative të PK-së (servisimi).

Në bashkëpunim të ngushtë me faktorin ndërkombëtar, brenda PK-së apo AME-së, do të krijojmë Njësitin e Helikopterëve (NJH) shumëqëllimesh (Multi-Purpose Utility Helicopters), që lehtë adaptohet për qëllime të ndryshme (policore, emergjente dhe shëndetësore). NJH do të furnizohet fillimisht me dy helikopterë të lehtë dhe një të mesëm (Airbus Helicopter: H 120; H 135; dhe H 155), e të cilët do t'i kushtonin Buxhetit të Kosovës rreth 21,200,000.00 euro. Këta helikopterë do të furnizoheshin me pajisjet: e kërkim shpëtimit; e vëzhgimit; mjekësore emergjente (MEDEVAC); e fluturim natën (NVG); e bartjes së peshave të varur nën trup; si dhe ato të mirëmbajtjes dhe pjesët rezervë, e qe buxhetit do t'i kushtonin rreth 2 milionë euro. Marrë parasysh se në aeroportin "Adem Jashari" veçse ekziston një hangar për helikopterë, me disa investime të vogla do të mund të rinovohej dhe adaptohej hangari për tre helikopterë. Shkollimi dhe trajnimi ekipit prej 14 anëtarëve të personelit do të kushtonte rreth një milion euro.

Do të zgjerojmë edhe përdorimin e dronëve. Sot, PK-ja posedon 5 dronë bazik, të cilët përdoren nga njësi i trafikut, si dhe në raste të veçanta edhe njësitet speciale operative. LDK-ja do të sigurojë nga një dron për secilën drejtori regjionale (6), derisa kryeqytetit do të kishte nga një për secilin nga tri stacionet. Pra, 5 dronëve ekzistues do t'u shtohen edhe 4 tjerë e të cilët do t'i kushtonin Buxhetit të Kosovës rreth 60,000 euro.

Po ashtu, në platformën tonë parashohim që policët patrullues të kenë sistemin e kamerave në trup, në mënyrë që të rritet efikasiteti, përgjegjësia dhe transparenca e policisë. Për këtë aktivitet do të tentohet të aranzhohet një bashkëfinancim me partnerët strategjikë të PK-së. Ky aktivitet do të kushtojë rreth 3.5 milion euro; 1 milion euro për policet e trafikut dhe 2.5 milion euro për policët që trajtojnë dhunën në familje.

Synim i ynë do të jetë edhe zëvendësimi i uniformave të tanishme me ato të reja, në mënyrë që të kemi një polici të përditësuar, si nga aspekti i dukjes, ashtu edhe i efektshmërisë, veprim ky i cili do t'i kushtojë rreth 10 milionë euro.

#### 9.4 RISTRUKTURIMI I MPB-së

Si boshti kyç i arkitekturës së sigurisë në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së misionit të saj në krijimin dhe mbikëqyrjen e politikave në fushën e sigurisë publike, MPB-ja duhet t'i nënshtrohet një procesi të reformave

substanciale ligjore, rregulluese, sistemore dhe atyre kadrovike të burimeve njerëzore.

LDK-ja fillimisht do të angazhohet për reformat e domosdoshme ligjore, duke rishikuar thellësisht kuadrin e sotëm ligjor, por edhe duke nxjerrë e aprovuar ligje të reja, në veçanti me fokus në nxjerrjen e ligjit mbi MPB-ja, i cili do të sigurojë funksionimin shumë më të mirë dhe më efikas të ministrisë.

Do të reformojmë edhe strukturën organizative brenda MPB-së, me qëllim të shuarjes së departamenteve dhe njësive të cilat nuk janë dhe nuk ndërlidhen me misionin e saj bazë në shërbim të rendit dhe sigurisë publike, si dhe të krijojmë struktura të cilat do të ndihmojnë ministrinë dhe qeverinë për të prodhuar politika në funksion të rendit dhe të sigurisë publike. Për shembull: Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar do të transferohet në Ministrinë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale; do të fuzionohen në një departament të vetëm, si Departamenti i Reformave dhe ai i Integriteteve Evropiane; Departamenti i Shtetësisë, Azilit dhe Migracionit do të kalojë tek Zyra e Presidentit të Republikës, duke lënë në MPB vetëm Divizionin për Natyralizimin e të Huajve; do të fuzionohen 12 strategjitë në një numër më racional dhe do të rirregullohet statusi dhe kompetencat e Sekretariatit të Strategjive; Departamenti për Siguri Publike do të lirohet nga një gamë e tërë e përzjerjes së kompetencave nga fusha e sigurisë, aviacionit civil, lejeve për armë, licencimit të kompanive private të sigurimit e deri tek riatdhesimi i kosovarëve të kthyer nga luftërat e huaja, duke e orientuar drejt funksionit të tij bazik, hartimit të politikave në fushën e rendit dhe sigurisë publike.

## 9.5 RISTRUKTURIMI I IPK

Edhe Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) do t'i nënshtrohet reformave ligjore në drejtim të pavarësishtit e profesionalizimit të mëtejshëm. Në mes tjerash, reformat synojnë përcaktimin definitiv të statusit juridik të punonjësve të kësaj agjencie, ristrukturimin organizativ, si dhe fuqizimin e kompetencave, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në parandalimin dhe luftimin e veprave penale në Policinë e Kosovës. Në fokus të veçantë do të jenë kushtet dhe procedura për emërimin e Kryeshefit Ekzekutiv, por edhe të pozitive të tjera udhëheqëse në IPK, pasi që këto emërimë kanë qenë deri më tani në masën më të madhe emërimë të ndikuara politikisht. Pikërisht ky është një ndër faktorët më me peshë që ka ndikuar në gjendjen e rëndë në të cilën ndodhet IPK-ja sot, në kuptimin e integritetit dhe efikasitetit personal e profesional.

Për shkaqe të ndikimeve negative të deritashme, do të shohim mundësitë ligjore dhe kushtetuese që t'u ndalojë ish-pjesëtarëve të Policisë së Kosovës të punësohen në IPK. Sfidat, problemet dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet IPK-ja mund të klasifikohen në dy grupe kryesore, respektivisht në sfidat objektive, që janë të lidhura me IPK-në si agjenci ekzekutive në sektorin e rendit dhe të sigurisë, si dhe sfidat subjektive, që janë të ndërlidhura me individët apo grupe individësh që veprojnë brenda IPK-së. Për të shtuar efikasitetin, do të aktivizojmë zyrat rajonale dhe do të krijojmë sistem elektronik për menaxhimin e rasteve në IPK, duke e ndërlidhur atë edhe me sistemet e Policisë së Kosovës, Prokurorisë, Gjykatës dhe agjencive të tjera relevante.

## 9.6 AME DHE RREGULLIMI I STATUSIT TË ZJARRFIKËSVE

Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME) do t'i nënshtrohet reformave të thella strukturore, funksionale dhe kadrovike. Përmes ndryshimeve ligjore, LDK-ja do të krijojë kushte që MPB t'i delegojë kompetencat për zjarrfikës tek niveli i pushtetit lokal, në mënyrë që përzgjedhja, pagat dhe mbikëqyra e njësisë profesionale të zjarrfikësve të kalojë tek komunat, aty ku zjarrfikësit ushtrojnë funksionin e tyre.

Kështu, AME-së do t'i mbetet kryesisht përgjegjësia dhe obligimi i hartimit dhe i mbikëqyrjes së politikave në fushën e emergjencave civile. Gjithashtu, LDK-ja e sheh të domosdoshme që MPB-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes (MM), të funksionalizojë, brenda AME-së, Njësinë e Kërkimit dhe Shpëtimit, apo një njësit të reagimit të shpejtë, me rreth 50 pjesëtarë. Për këtë njësi do t'i sigurohet buxhet solid dhe i qëndrueshëm, me shumën fillestare prej rreth një milion euro për vitin e parë. AME-ja do të ndërtoj kapacitetet e saja në fushën e infrastrukturës kritike, sa i përket hartimit të manualeve për mbrojtjen dhe kujdesin për objektet e rëndësishme të veçantë. LDK-ja do t'i hyjë me urgjencë ndryshimit dhe amendamentimit të Planit (të stërvjetërsuar) të Reagimit Kombëtar, duke iu përshtatur sfidave dhe rreziqeve bashkëkohore e reale.

## 9.7 PËRFORCIMI I KËSHILLIT TË SIGURISË SË KOSOVËS

Në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK), do të riorganizohet ashtu që fillimisht të emërohet një Këshilltari i Lartë i Sigurisë Kombëtare, si pozita kryesore në KSK, pozicion i barasvlershëm me atë të Shefit të Stafit në ZKM, nën kompetencat e të cilit do të bie koordinimi i të gjitha strukturave të arkitekturës së sigurisë, përfshirë Agjencinë Kosovare të Inteligjencës (AKI). Në një proces paraprakisht të disenjatur, Këshilltari i Lartë i Sigurisë Kombëtare do të ketë fjalën kryesore edhe në përzgjedhjen e Sekretarit të Sekretariatit të KSK-së.

Republika e Kosovës, si partnere e Koalicionit Global kundër ISIS-it, ka shprehur vullnetin politik dhe është plotësisht e përkushtuar për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në këtë drejtim, LDK-ja propozon krijimin e një qendre kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, e cila do të ketë mision bashkimin e përpjekjeve të të gjithë aktorëve në nivel strategjik dhe operacional, për të parandaluar e koordinuar veprimet dhe politikat, si dhe për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm e terrorizmin. Qendra do të krijohet në kuadër dhe varësi të ZKM/KSK-së, t'i raportojë drejtpërdrejt kryeministrit, si dhe do të udhëhiqej nga Këshilltari i Lartë i Sigurisë Kombëtare, i cili njëkohësisht ushtron edhe funksionin e Koordinatorit Nacional për Luftë Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmit. Në fazën e dytë të zhvillimit, kjo qendër do të shndërrohet në një "Fusion Centre" (qendër e fuzionit), sipas modelit të SHBA-ve. Qendra do të zhvillonte analiza e shkëmbim informatash, duke ndihmuar agjencitë e zbatimit të ligjit dhe partnerët e sigurisë së vendit në parandalimin, mbrojtjen dhe reagimin ndaj krimit dhe terrorizmit.



PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# DREJTËSIA





## KONTEKSTI

Sundimi i ligjit nuk ka të bëjë vetëm me barazinë para ligjit. Sundimi i ligjit ka të bëjë edhe me profesionalizëm, pavarësi, paanshmëri, kapacitete operative, sistem të adaptueshëm në trendet e vazhdueshme digjitale dhe, përfundimisht, besueshmëri të publikut në institucione të drejtësisë për shkak të përmbushjes së të gjitha objektivave.

Sot, besimi i publikut në institucionet e drejtësisë është i ulët. Pavarësisht të arriturave dhe konsolidimit të institucioneve të drejtësisë për mbi dy dekada në Kosovën e pasluftës, ky sektor mbetet i brishtë. Institucionet mbeten të cënueshme, sidomos në kuptim të integritetit institucional por edhe profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve që evidentohet edhe nga raportet ndërkombëtare.

Në anën tjetër, mungesa e profesionalizmit dhe vonesat për t'i zgjidhur rastet vazhdojnë t'i shqetësojnë qytetarët. Lufta kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit nuk i përmbush pritjet e dëshirueshme për një vend normal demokratik.

Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Akademisë së Drejtësisë, Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencisë për Konfiskimin e Pasurisë, Shërbimit Korrektues të Kosovës etj., paevitueshëm krijon zbrazëti të implementimit efikas të ligjeve në fuqi dhe materializim efektiv të nismave të ndryshme ligjore që prekin këtë sektor.

Përfundimisht, ngritja e integritetit institucional dhe profesional është çelës i avansimit të secilës hallkë në drejtësi. Trajtimi i dinjitetshëm nga sistemi për



të gjithë qytetarët e këtij vendi, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane është rruga e vetme drejt integritit të plotë të sistemit të drejtësisë në pritshmëritë evropiane për sundimin e ligjit në Kosovë.

Zbardhjet dhe dokumentimet e rasteve të krimeve të luftës dhe zbardhjet e vrasjeve politike nuk guxojnë të mbesin vetëm moto politike programore. Zbardhja e vrasjeve politike duhet të jetë përkushtim njëloj edhe mision i institucioneve të drejtësisë. LDK-ja në veçanti vlerëson se pa përmbushjen e këtyre misioneve kombëtare, drejtësia nuk do të jetë kurrë kuptimplotë.

# PLANI YNË PËR DREJTËSI

LDK-ja ka identifikuar shtyllat themelore mbi të cilat do ta fuqizojë sektorin e sundimit të ligjit, institucionet e drejtësisë, luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin. Këto do të ndihmojnë që funksionimi i institucioneve të drejtësisë të jetë përfundimisht më i pavarur, paanshëm dhe efektiv.

LDK-jë do ta ketë parasysh edhe riorganizimin e institucioneve dhe agjencive të drejtësisë në pajtim me objektivat e reja strategjike evropiane. Akademia e Drejtësisë dhe Avokatura Shtetërore do të mbështeten në realizimin e misionit të tyre.

Në kuadër të riorganizimit të agjencive, Agjencia për Ndhmë Juridike Falas do të trajtohet ashtu siç ka qenë me parë, si Agjenci që i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## 10.1 VETINGU NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Ka vite që është kërkuar një Proces i Vetingut (verifikimit) gjithpërfshirës në drejtësi që do të përfshinte të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët si dhe gjithë pozitat drejtuese në sistemin e drejtësisë. Por, Opinioni i Komisionit të Venecias, i kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës lidhur me këtë temë, e vlerësoi të parakohshëm një Veting gjithpërfshirës. Kështu, rekomandoi Veting të pjesshëm, që verifikon vetëm pozitat menaxheriale në drejtësi, duke përjashtuar edhe vlerësimin e performancës. LDK-ja vlerëson që një kufizim i tillë është fatkeqësi dhe keq menaxhim qeveritar i qeverisë të këtij procesi, por si rezultat e ka të qartë se si duhet t'i qaset këtij procesi tani e tutje.

Opsioni i kombinuar apo “mix” nënkupton përmirësimin e gjendjes së sistemit të drejtësisë, si përmes aprovimit dhe zhvillimit të Vetingut, ashtu edhe përmes ndërhyrjeve të tjera ligjore dhe operative që adresojnë elementet e tjera ku stagnon llogaridhënia, performanca dhe efikasiteti i atyre që vënë drejtësinë. Ky opsion përfshin dy nivele/faza të procesit:

Faza e parë, përbën amandamentet kushtetuese, të cilat në përputhje me gjetjet e Opinioni të Venecias lidhur me vetingun, shtrihen në anëtarët e KGJK-së dhe të KPK-së, Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët, me fokus në konfirmimin e aspektit të integritetit personal dhe justifikimit të pasurisë. Kjo fazë mund të nënkuptohet si fazë e Vetingut per se.

Faza e dytë, synon ndërhyrjet ligjore të cilat ofrojnë qëndrueshmërinë e idesë fillestare të vetingut, që nënkupton zberthimin e parimeve bazë mbi të cilat bëhet vlerësimi, gradimi, degradimi dhe përjashtimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve me ligj të veçantë, gjithmonë në përputhje me praktikat më të mira evropiane. Kjo fazë e nënkupton fazën e qëndrueshmërisë së reformës së drejtësisë në gjyqësi dhe prokurori, si dhe synon efektin afatgjatë e gjithpërfshirës.

Për nevojat e këtij opsioni, vetingu nënkupton kontrollin e vazhdueshëm (përhershëm) të integritetit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, me qëllim që të vlerësohet dhe garantohet përshtatshmëria e tyre për të qenë pjesë e sistemit. Vetingu për gjyqtarët dhe prokurorët kryhet nga mekanizmat e brendshëm, pasi që të jetë përmbyllur vetingu për pozitat drejtuese në sistemin e drejtësisë.

Kontrolli i integritetit dhe performancës duhet të zhvillohet në rastet e përcaktuara si vijon: a) me rastin e rekrutimit të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë; b) me rastin e avancimeve; c) me rastin e emërimeve në mekanizmat drejtues (KGJK-ja dhe KPK-ja); ç) vlerësimi vjetor; dhe e) kontrolli periodik çdo pesë vite. Procesi i Vetingut synon që drejtues të institucioneve të drejtësisë, gjyqtarë dhe prokurorët të mbesin vetëm personat me integritet profesional dhe moral, të cilët garantojnë që vendimmarrja e tyre është efektive dhe efikase, në pajtim me ligjin dhe kushtetutën dhe që garantojnë pavarësinë institucionale duke parandaluar ndikimin nga jashtë, duke arritur përfundimisht trajtimin e lëndëve në afate optimale dhe vendosje të drejtësisë në kohë.

Për fund, duhet të përmbillet tendenca e rrezikshme e lëvizjes (në veçanti zvogëlimit) së pagave të pjesëtarëve të sistemit të drejtësisë në mënyrë arbitrare. Pagat në sistemin e drejtësisë duhet të jenë dinjitoze dhe immune ndaj lehtësisë së ndryshimit nga partitë në pushtet.

## 10.2 INTEGRITETI I SISTEMIT TË DREJTËSISË

Kriteret për dhënien e provimit të jurisprudencës, kriteret e ulëta për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si dhe përbërja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kanë treguar që është e domosdoshme që filtrat hyrës të personave në sistemin e drejtësisë të fuqizohen.

Duke qenë se sistemi i drejtësisë është shumëdimensional, ai nuk mund të jetë i plotë pa ngritjen e cilësisë në të gjitha hallkat. Prandaj duhet të ndërmerren edhe veprimet e mëposhtme për të përmbyllur ciklin reformues të sistemit: a) të fuqizohen kriteret për dhënien e Provimit të Jurisprudencës; b) të fuqizohen kriteret për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve, në veçanti të përvoja e punës (aktualisht është tri vite profesionale të punës); c) përbërja e Këshillit Gjyqësor të reflektoj nevojën për së paku 2/3 nga gjyqtarë të nivelit të Gjykatës Supreme dhe të Apelit; ç) të rritet numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe numri i bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjorë. Secili gjyqtar dhe prokuror duhet ta ketë të paktën një bashkëpunëtor profesional.

## 10.3 QENDRA SHETËRORE E HETIMIT

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës nuk ka arritur që të përmbushë mjaftueshëm mandatin e saj në luftën kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit të nivelit të lartë. Njëra prej pengesave kyçe ka qenë fakti se hetimet janë kryer në mënyrën me të mirë nga zyrtarët e Policisë së Kosovës.

Prandaj themelimi i Qendrës Shtetërore të Hetimit si një strukturë e specializuar e Policisë, që do të veprojë nën drejtimin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, do të jetë hap i rëndësishëm drejt pavarësisht të kapaciteteve hetuese të prokurorisë. Qendra Shtetërore e Hetimit ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve hetimore për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale që bien nën mandatin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Në këtë funksion, do të themelohet edhe Këshilli Shtetëror i Hetimit, si trupë koordinuese ndër-institucionale (Drejtori i Policisë, Njësia e Inteligjencës Financiare, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Kryeprokurori i Shtetit, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, etj.), që do të kujdeset që rastet e korrupsionit të lartë zyrtar, të mos trajtohen njëkohësisht nga disa institucione paralelisht, por rastet të adresohen saktë të institucioni kompetent, varësisht nga niveli dhe natyra e shkeljeve ( penale, administrative).

LDK-ja do ta diskutojë me aktorët e sistemit të drejtësisë formatin më adekuat të drejtimit të Qendrës së Hetimit, për të siguruar pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin dhe efikasitetin e saj.

Themelimi dhe organizimi i brendshëm i Qendrës Shtetërore të Hetimit dhe të Këshillit Shtetëror të Hetimit duhet të rregullohet me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës ose me një ligj të veçantë. Kriteret për emërimin dhe strukturën e kësaj Qendre duhet të parashihen me ligj.

LDK-ja vlerëson se Qendra Shtetërore e Hetimit dhe Këshilli Shtetëror i Hetimit duhet të themelon pasi që të ketë përfunduar vettingu në sistemin e drejtësisë, për të garantuar që këto mekanizma, se bashku me prokurorë dhe gjyqtarë të verifikuar, janë në funksion të luftimit të krimit të organizuar dhe të korrupsionit zyrtar.

## 10.4 DIGJITALIZIMI I PROCESIVE NË DREJTËSI

Në kuadër të reformimit të sistemit të drejtësisë, digjitalizimi i proceseve në sistemin e drejtësisë është crucial për suksesin e këtyre reformave. Shtetet që kanë adaptuar e-Justice apo digjitalizimin e sistemit të drejtësisë dëshmojnë që i njëjti ka pasur shumë përparësi. Për këtë, do të krijohet kuadri ligjor që do ta mbështes zbatimin e e-Drejtësisë, dhe do të miratohen ligje që garantojnë sigurinë e transaksioneve elektronike, nënshkrimeve digjitale dhe mbrojtjen e të dhënave.

**Siguria:** Rëndësi cruciale do t'i kushtohet sigurisë dhe privatësisë. Digjitalizimi mund të përmirësojë sigurinë e informacionit, gjithmonë duke pasur në mendje domosdoshmërinë e investimit në sigurinë kibernetike. Siguria do të jetë mision paralel bashkë me adaptimin e digjitalizimit. Sidoqoftë, qasja e lehtësuar në dokumente i mundëson palëve monitorimin e vazhdueshëm të lëndëve të tyre, duke e zvogëluar kështu nevojën që të shkojnë fizikisht në gjykatë për çdo gjë.

**Efikasiteti:** Digjitalizimi është dëshmuar që ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Në shtetet që kanë adaptuar sistemin në e-sistemapo sistem digjital, është reduktuar koha e përpunimit dhe trajtimit administrativ të dokumentacionit. Përtej kësaj, është reduktuar koha e procesimit të rasteve gjyqësore dhe është rritur produktiviteti i gjyqësorit në trajtimin e lëndëve.

**Transparenca:** Disponueshmëria e dokumenteve në platforma publike dhe publikimi i shpejtë i tyre, me përjashtim të rasteve që ligji parasheh ndalesë për një gjë të tillë, rrit besimin e publikut në drejtësi. Kjo i lejon edhe palëve të interesuara ta përcjellin në mënyrë më efektive punën e sistemit të drejtësisë. Sot, disa vendime gjyqësore publikohen, por as në shpejtësinë e as në sasinë e duhur.

**Transkriptimi:** Seancat gjyqësore tani nuk kanë audioinçizues, me përjashtim të pak gjykatave që kanë pranuar donacione, por që ende nuk kanë arritur t'i fusin në përdorim në mënyrë efektive. Transkriptimi digjital i seancave gjyqësore mundëson mbajtje shumë më efektive të seancave gjyqësore, me ç'rast reduktohet edhe koha e zgjatjes së seancave, e si rezultat cilësia në trajtim më të detajuar të rastit.

**Qasja:** Shërbimet online zvogëlojnë nevojën e qytetarëve që të shkojnë fizikisht në Gjykatë për kërkesa apo pyetje të ndryshme të cilat mund t'i adresojnë online. Lejet apo vërtetimet e ndryshme që lëshohen nga Gjykata duhet të merren përmes sistemeve elektronike.

**Komunikimi me avokatët dhe profesionistët e drejtësisë:** sistemi digjital ofron shërbime të specializuara si qasje në shkresa të lëndës, dorëzimin e shkresave, komunikimet për caktimin e seancave gjyqësore, shtyrjen e tyre dhe shërbime të tjera të ngjashme.

Thënë të gjitha më sipër, digjitalizimi i drejtësisë përmirëson efikasitetin, transparencën, përgjegjësinë, analizën e të dhënave dhe përfshirjen në sistemin e drejtësisë. Duke njohur mundësitë e teknologjisë digjitale, sistemi i drejtësisë siguron respektimin më të theksuar të parimeve të demokracisë dhe sundimit të ligjit.

## 10.5 GJYKATA ADMINISTRATIVE DHE E KONTESTEVE TË PUNËS

Sipas strukturës organizative të gjykatave të Kosovës, të përcaktuar në Ligjin për Gjykatat Nr. 03/L-199, Departamenti për Çështje Administrative vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe ka juridiksion për gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Një pjesë e kompetencave aktuale të këtij departamenti janë bartur në kuadër të Gjykatës Komerciale.

Aktualisht ky departament trajton rastet e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të Kosovës, si dhe çdo padi që ushtrohet nga subjektet fizike dhe juridike (përveç shoqërive tregtare). Kontestet nga marrëdhënia e punës në sektorin privat, shqyrtohen dhe zgjidhen në Departamentin Civil. Me rastin e krijimit të kësaj Gjykate, edhe kontestet e punës nga sektori privat do të përfshiheshin këtu duke liruuar kështu divizionin civil të Departamentit të Përgjithshëm. Kjo do të ndikonte pozitivisht në trajtimin më efektiv dhe priorizimin e lëndëve të kësaj natyre, që pavarësisht normave që e prioritojnë trajtimin e tyre me urgjencë, nuk kanë arritur të zbatohen asnjëherë.

Praktika e shumica vendeve të BE-së dhe vendeve të rajonit e kanë Gjykatën Administrative si gjykatë të veçantë, për shkak të kontesteve të mëdha administrative. Rrjedhimisht, themelimi i kësaj gjykate është edhe pjesë e programeve ndërkombëtare dhe për momentin grupet punuese janë duke punuar në këtë drejtim.

Themelimi i kësaj gjykate do të mundësonte ngritjen e kapaciteteve për rastet e konfliktit administrative dhe kontesteve të punës, qofshin të sektorit publik apo privat. Kështu do të përmyllej edhe organizimi i gjyqësorit me ndarjen përfundimtare të gjykatave të rregullta dhe atyre të veçanta, përkatësisht Komerciale, Administrative dhe të Punës.

## 10.6 AVANSIMI I PROFESIONEVE TË LIRA

Avansimi i rolit të Profesioneve të lira (PLL) si Avokatia, Noteria, Përmbartimi dhe Ndërmjetësimi nënkupton në veçanti rishikimin e kornizës ligjore dhe mekanizmave mbikqyrës për të siguruar që këto profesione ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në shërbim të funksionit publik, duke qenë sa më të qasshme dhe të drejta për publikun.

Përgjatë rishikimit duhet të harmonizohet korniza ligjore, që të eliminojë kolizionet eventuale të ligjeve përkatëse dhe amandamentimi eventual me qëllim të saktësimin të kompetencave dhe kompletimin e infrastrukturës logjistike, duke respektuar pavarësinë e plotë operationale të tyre.

Njëkohësisht synohet koordinimi ndërinstitucional në shërbim të zbatimit të plotë të politikave ligjore në kuptim të shfrytëzimit të këtyre të drejtave ligjore nga ana e publikut e në veçanti procedurën e ndërmjetësimin.

Si masë e parë në kuadër të kësaj objektive parashihet zhvillimi dhe konsolidimi i mëtejshëm i ndërmjetësimin dhe procedurave të falimentimit. Duhet të shpeshohen fushatat vetëdijësuese për rolin dhe dobitë e mekanizmave të ndërmjetësimin dhe të falimentimit. Shfrytëzimi i këtyre formave të zgjidhjes së

kontesteve bëhet me qëllim të zgjidhjes sa më të shpejtë të rasteve dhe zvogëlimin e numrit të lëndëve në gjykata. Në kuadër të kësaj mase do të vlerësohet nevoja për shtimin e numrit të përmbartuesve privatë për një shpërndarje më të mirë gjeografike dhe krijimi i një sistemi uniform për mbledhjen e të dhënave për të pasur një pasqyrë më të mirë të performancës së sistemit.

Në kuadër të masës së dytë janë paraparë një varg aktiviteteve, që kanë për qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve të të gjitha PLL-ve. Kjo do të arrihet përmes hartimit/përmirësimit të kurrikulave trajnuese fillestare, të vazhdueshme dhe të specializuara për të gjitha PLL-të mbi bazën e analizave gjithëpërfshirëse të nevojave përkatëse të trajnimit. Këto trajnime do të jenë të obligueshme për PLL-të, me qëllim të rritjes së njohurive dhe shkathtësive të PLL-ve dhe shtimit të besimit të publikut në shërbimet e ofruara nga ta. Kjo do të kërkojë një bashkërendim dhe bashkëpunim efektiv ndërinstytucional, ku rol kyç do të luajë edhe Akademia e Drejtësisë. Përveç trajnimeve, kjo masë parasheh edhe përmirësimin e monitorimit ndaj PLL-ve, përmes hartimit/ndryshimit të Kodeve të Sjelljes, krijimit të standardeve profesionale dhe qartësimit, si dhe fuqizimit të kompetencave dhe kapaciteteve dhe bashkërendimit të aktiviteteve përbrenda strukturave të MD-së. Si masë tjetër përmes së cilës do të arrihet kjo objektive është edhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstytucional (PLL-ve, sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe akterëve të tjerë), përmes krijimit të mekanizmave dhe kanaleve efektive të komunikimit dhe bashkëpunimit.

Përmes kësaj objektive do të arrihet edhe lehtësimi i ngarkesës së punës në gjykata dhe prokurori, si dhe garantimi i ekzistimit të sundimit të ligjit që siguron të drejtën për gjykim dhe shqyrtim të drejtë në një afat të arsyeshëm kohor për qytetarët.

## 10.7 **FUQIZIMI I SHËRBIMIT SPROVUES**

Duke pasur parasysh se SHSK-ja luan rol crucial në monitorimin dhe zbatimin e sanksioneve penale të shqiptuara nga Gjykatat, e posaçërisht edhe rolin primar në zbatimin e programeve të ndryshme rehabilituese pas kryerjes së dënimit, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë ngritjes së kapaciteteve të këtij shërbimi, duke filluar nga: a) korniza ligjore/amandamentimi i ligjit dhe kompletimi i akteve nënligjore; b) rekrutimi i numrit të nevojshëm të punonjësve/zyrtarëve sprovues; c) trajnimi i vazhdueshëm obligativ për stafin; d) trajnimi i përbashkët dhe organizimi i punëtorive të përbashkëta me agjencitë ligjzbatuese të fushës si dhe me gjyqtar e prokurorë, me theks të veçantë ekzekutimi i dënimeve alternative, psh. gjysmë liria; e) ngritja e programeve profesionale të rehabilitimit e risocializimit, p.sh. në fushën e terrorizimit e radikalizmit; f) profilizimi i zyrtarëve të SHSK-së, në: zyrtarë për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për të mitur, zyrtarë për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për madhor dhe profilizimi i zyrtarëve për mbikëqyrjen e t1% liruarve me kusht nga burgu; g) përmirësimi i infrastrukturës logjistike të SHSK-së; h) plotësimi me kuadër profesional në aspekt të mbikëqyrjes elektronike të të dënuarve.

## 10.8 **FUQIZIMI I SHËRBIMIT KORREKTUES**

Plani ynë për fuqizimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës parasheh krijimin e kushteve dhe hartimin e planit të veprimit me prioritet në 4 fusha kryesore: a) infrastrukturë ligjore; b) infrastrukturë ndërtimore; c) procedurat e sigurisë; dhe ç) trajtim e programe rehabilituese.



Tek infrastruktura ligjore plani ynë parasheh rregullimin e procedurave operative përmes akteve nënligjore, e të cilat burojnë nga Ligji i SHKK-së, si rendi shtëpiak, procedura të trajtimeve, programeve-regjimeve të burgosurve, funksionalizmi i njësisë së vlerësimit dhe klasifikimit të burgosurve, njësisë së inteligjencës dhe njësisë ekonomike, si fushë tejet me rëndësi në zhvillimin e SHKK-së;

Tek infrastruktura ndërtimore plani ynë parasheh vlerësimin e objekteve institucioneve korrektuese që nuk i plotësojnë kriteret dhe ndërtimi i burgjeve të reja me kapacitete dhe standarde evropiane, sikurse Qendra e Paraburgimit në Prizren dhe Pejë, renovimi i pavijoneve në Qendrën Korrektuese në Dubravë, analizimi i mundësive për ndërtimin e një spitali të burgut për të burgosurit me probleme shëndetësore dhe rastet psikiatrike. Vlerësimi i rrezikut për Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë i ndërtuar si objekt i ri por me rrezik të madh nga perimetri i jashtëm që mund t'i kanoset nga banesat për rreth si dhe pronave private.

Tek procedura e sigurisë plani ynë parasheh masa që trajtojnë fushat si siguria, operativa dhe transporti i të burgosurve (zbatim të procedurave të sigurisë, kontrole, ambient të sigurtë për staf dhe të burgosur, përcjellja e të burgosurve, transferet nëpër institucione sipas kriterëve ligjore me tretmane dhe rrezikshmëri).

Ndërsa tek trajtimi plani ynë parasheh programet rehabilituese (inkorporimi i programeve të risocializimit dhe riedukimit për të gjithë të burgosurit, angazhimi në procese të punës si brenda ashtu dhe jashtë institucionit korrektues varësisht prej tretmanit), ndikimi përmes programeve me uljen e recidivizmit. Trajtimi, menaxhimi i të burgosurve me vepra që kanë të bëjnë me terrorizmin sipas strategjisë kombëtare për parandalimin e terrorizmit dhe radikalizmit në burgje.

Aktivitetet e tjera që synohen në këto institucioneve varësisht nga nevojat që evidentohen në koordinim të plotë me palët e interesit janë edhe: trajnime të stafit për situata emergjente, avansuese; instalim i sistemit modern të kamerave të sigurisë; instalim i sinjalizuesve me sensor gjatë perimetrit të burgjeve; blerja e automjeteve për përcjelljen e të burgosurve; parandalim kontrabandës; blerje të pajisjeve të sigurisë; vendosja e sistemit të mbylljeve dhe hapjeve elektronike të dymëve në institucione korrektuese; pajisja me armë e stafit korrektues.

## 10.9 VRASJET POLITIKE

LDK-ja vlerëson se zbardhja e vrasjeve me motive politike të personaliteteve politike, ushtarake dhe të jetës publike është e rëndësishme së veçantë, duke marrë parasysh faktin se shumica e këtyre personaliteteve kanë qenë pjesë e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe bashkëpunëtorë të Presidentit historik, Dr. Ibrahim Rugova. Zbardhja e vrasjeve politike duhet të jetë përkushtim i secilit subjekt politik pa dallim, njëjloj edhe mision i institucioneve të drejtësisë. LDK-ja në veçanti vlerëson se pa përmbushjen e këtyre misioneve kombëtare drejtësia nuk do të jetë kurrë kuptimplotë. LDK-ja asnjëherë nuk tërhiqet nga kërkesa legjitime që të zbulohen kryerësit dhe urdhërdhënësit e vrasjeve me motive politike në Kosovën e gjatë dhe të pasluftës.

## 10.10 **FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË AKADEMISË SË DREJTËSISË**

Akademia e Drejtësisë në Kosovë ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve profesionale për sistemin e drejtësisë, por ka ende nevojë për rritje të mbështetjes institucionale dhe përmirësim të infrastrukturës. Për të fuqizuar këtë akademi, është e nevojshme të thellohet bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare dhe të ofrohen mundësi për trajnim të vazhdueshëm të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve, duke adresuar sfidat specifike që ka sistemi i drejtësisë në Kosovë.

Një hap tjetër është rritja e investimeve në teknologji dhe sisteme informatike që mundësojnë një administrim më të shpejtë dhe më të saktë të nevojave trajnuese, duke përmirësuar efikasitetin dhe besueshmërinë e procesit.

## 10.10 **FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË INSTITUTIT PËR MJEKËSI LIGJORE DOKUMENTIMI DHE TRAJTIMI I KRIMEVE TË LUFTËS**

Instituti për Mjekësi Ligjore në Kosovë është institucion vital në sektorin e drejtësisë, i cili ka nevojë për fuqizim të vazhdueshëm.

Përveç rritjes së sigurisë rreth dhe brenda Institutit, duhet të investohet edhe në përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të mjekësisë ligjore, në trajnimin e vazhdueshëm të stafit, licencimet e certifikimet e domosdoshme të Institutit.

Përveç kësaj, forcimi i bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare për shkëmbimin e përvojave dhe avancimin e teknologjive do të ndihmonte në rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së rezultateve të mjekësisë ligjore në Kosovë.

## 10.10 **DOKUMENTIMI DHE TRAJTIMI I KRIMEVE TË LUFTËS**

LDK-ja angazhohet fuqishëm për mbështetjen e institucioneve dhe mekanizmave të drejtësisë për trajtimin e krimeve të luftës dhe vënien para drejtësisë të të gjithë kriminelëve të luftës, që kanë kryer krime ndaj popullatës civile shqiptare dhe të komuniteteve tjera.

PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# INTEGRIMET EUROATLANTIKE



RRUGA E RE  
*për Kosovën*



# INTEGRIMET EUROATLANTIKE

## KONTEKSTI

Ky kapitull trajton çështje disi është fluid, marrë parasysh që Kosova ka raport të veçantë ,e BE-në, si pasojë e mosnjohjes së pesë vendeve të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst, duhet theksuar e përmendur shembujt e ndjekur, si: Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, procesi i Liberalizimit të Vizave etj. Me këtë rast dëshmohet në plotni se Kosova, edhe përkundër faktit që ende nuk është njohur edhe nga pesë vende të Bashkimit Evropian, si rast i veçantë e ka rrugën e trasuar për ecjen tutje drejt proceseve integruese.

Perspektiva evropiane e Kosovës dhe e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor (BP) është konfirmuar në vitin 2003 në kuadër të Samitit të Selanikut ndërmjet Bashkimit Evropian (BE) dhe BP-së. Në marrëdhëniet e saj kontraktuale me Bashkimin Evropian, Kosova ka arritur të nënshkruajë Marrëveshjen për Stabilizim Asociim (MSA) në vitin 2015, që përbën kornizën bazë për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, dokumentet kyçe si Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) kanë ndihmuar vendin në zbatimin e prioriteteve kyçe që dalin nga MSA-ja.

Që nga shpallja e pavarësisë, në vitin 2008, institucionet e Republikës së Kosovës kanë ndërmarrë disa hapa për të përmbushur kriteret politike e ekonomike, por ato nuk kanë qenë të mjaftueshme për të arritur progresin e nevojshëm për avancim në procesin e Integritimit. Sot, problemet kryesore në procesin e integritimit evropian mbesin mungesa e koordinimit ndërinstitutional për plotësimin e kriterëve për anëtarësim, pjesëmarrja tejet e ulët e Kosovës në mekanizmat rajonalë, largimi i stafit të profilizuar nga institucionet përkatëse, si dhe mosarritja e fondeve të mjaftueshme nga Instrumenti për Paraantarësim.

Për më tepër, raportet e vendit të Komisionit Evropian vënë në pah probleme të ndryshme, ndër të tjera, me sundimin e ligjit, reformën e administratës publike, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përpjekjet për të arritur një ekonomi funksionale të tregut, si dhe ato për arritjen e marrëveshjes gjithëpërfshirëse me Serbinë; si parakusht për integrimin e mëtejshëm në Bashkimin Evropian. Si rrjedhojë, bashkë me mosnjohjen nga pesë vende anëtare të Bashkimit Evropian (Qipro, Greqia, Sllovakia, Rumania dhe Spanja), Kosova mbetet kandidat potencial për anëtarësim.

Krahasuar me vendet e tjera të rajonit të cilat kanë shënuar progres në procesin e integritetit viteve të fundit, siç është rasti i Shqipërisë dhe Malit të Zi, të cilat kanë hapur negociatat për anëtarësim në 2022, Kosova ka mbetur prapa. Qytetarët e saj mbesin të vetmit nga rajoni i Ballkanit Perëndimor e të vetmit në perëndim të Rusisë, me përjashtim të Bjellorusisë, të cilët nuk kanë fituar të drejtën për të lëvizur lirshëm brenda shteteve të zonës Schengen. Në anën tjetër, Kosova dhe Bosnja e Hercegovina mbeten vendet e vetme në BP që nuk kanë arritur statusin e kandidatit. Ndërkaq, në mungesë të koordinimit institucional nga ana e qeverisë aktuale, pa arritjen e reformave të nevojshme për zbatimin e MSA-së, si dhe pa siguruar mbështetjen politike nga ana e BE-së, i gjithë procesi i aplikimit për status kandidatit rrezikon të dështojë.

Në kohën kur fondet e Instrumentit për Para-Antarësim (IPA) janë bërë konkurruese që do të thotë se konkurrenca mes vendeve do të përcaktojë cila prej tyre do të marrë pjesën më të madhe të fondeve nga BE-ja, Kosova mbetet e papërgatitur për të tërhequr fondet dhe, jo rrallëherë, ka humbur këto fonde për shkak të mosrealizimit të reformave të nevojshme. Mungesa e kapaciteteve për të absorbuar asistencën teknike bashkë me pjesëmarrjen e ulët në mekanizmat rajonale, të tilla si Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Traktati i Komunitetit të Transportit (TcT), Komuniteti i Energjisë (EnC), Iniciativa Rajonale për Migracion, Azil dhe Kthim të Refugjatëve (MARRI), Zyra Rajonale e Bashkëpunimit të të Rinjve (RYCO), si dhe Fondi për Ballkanin Perëndimor (WBF), si dhe mosanëtarësimi i Kosovës në të gjitha organizatat rajonale e bëjnë atë të pabarabartë me vendet tjera të rajonit.

Mungesa e plotësisht të parakushteve për anëtarësim të tillë si zhvillimi i një sistemi politik demokratik plotësisht funksional, si dhe mosnjohja e vendeve anëtare ka penguar avancimin e Kosovës edhe në raport me organizatat e tjera, si NATO. Në fakt, Kosova mbetet i vetmi vend në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nuk ka marrëdhënie kontraktuale me NATO-n, pavarësisht aplikimit të mëhershëm në Partneritetin për Paqe, përfaqësimit tonë joformal në NATO, anëtarësimin të vendit (status observues) në Asambleshën Parlamentare të NATO-s, dhe natyrisht prezencës së Misionit të KFOR-it në vend që nga paslufta. Ndër faktorët e brendshëm, institucionet e Kosovës nuk kanë treguar vullnet politik për të intensifikuar bashkëpunimin formal me NATO-n në kohën kur gjendja e sigurisë në nivel evropian e më gjerë është lëkundur si pasojë e invazionit rus në Ukrainë. Ndërkaq, kapacitetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) bashkë me buxhetin e kufizuar në sektorin e mbrojtjes paraqesin nevojën për rritjen e kapaciteteve e aftësive ushtarake në përgjithësi.

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, Kosova e integruar në Bashkimin Evropian dhe në NATO do të jetë më mirë e përgatitur për t'u përballur me sfidat dhe kërcënimet e shumta që cenojnë integritetin territorial, sovranitetin, por edhe sigurinë e vendit. Rrjedhimisht, LDK-ja do të punojë fuqishëm për integrimin e mëtejshëm të Kosovës në BE dhe në NATO, për njohje dhe anëtarësim të reja në organizata ndërkombëtare e rajonale dhe kësaj do të angazhohet në konsolidimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.

# PLANI YNË PËR INTEGRIMET

Lidhja Demokratike e Kosovës do të angazhohet për zbatimin e plotë të MSA-së dhe të gjitha obligimeve të Kosovës në procesin e integrimit evropian. Me saktësisht, LDK-ja do të punojë për një qeverisje të përgjegjshme, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane, që e vënë Kosovën në linjë me vendet tjera rajonale dhe evropiane. Besojmë fuqishëm se përmbushja e kriterëve për anëtarësim do të përafrojë Kosovën me BE-në e, njëkohësisht, do të forcojë shtetin e së drejtës, do të garantojë zbatimin e ligjit, të ofrojë shërbime stabile dhe të qëndrueshme për qytetarët, do të krijojë parakushte për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë demokratike ku liria e shprehjes vazhdon të garantohet dhe mbrohet, si dhe do të rrisë bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar të Kosovës.

Duke u nisur nga problemet e identifikuar në raport me integrimin në BE, Lidhja Demokratike e Kosovës në qeverisjen e saj ndër prioritetet kryesore do të ketë:



## 11.1 RITHEMELIMI I MINISTRISË PËR INTEGRIM EVROPIAN

Lidhja Demokratike e Kosovës synon të rikthejë Ministrinë e Integritimit Evropian, në mënyrë që i gjithë procesi i Integritimit Evropian të ketë një adresë të qartë. Përpos kësaj, ka edhe dy arsye shtesë për të pasur një ministri të veçantë. E para, Kosova është ende larg procesit të anëtarësimit të plotë në BE. Rrjedhimisht, i gjithë procesi kompleks i integritimit do të mund të koordinohet nga MEI-ja. E dyta, aktualisht në Kosovë portfolio e integritimit evropian udhëheq bashkë me atë të zhvillimit ekonomik edhe procesin e dialogut; dy procese mjaft të rëndësishme e komplekse. Duke qenë se kjo ministri ka ekzistonte, rikthimi i saj nga aspekti teknik nuk do të jetë i vështirë. Pjesa dërrmuese e stafit që kanë punuar në këtë Ministri janë shpërndarë nëpër Ministrinë tjera dhe bashkë me të diplomuarit e tjerë nga Young Cell Scheme do të mund të përbënin shërbimin civil në kuadër të MEI-së.

Ministria e Integritimit do të mund të menaxhonte dhe të koordinonte edhe procesin e bashkëpunimit rajonal dhe të gjitha iniciativat në kuadër të këtij bashkëpunimi (siç është Procesi i Berlinit). Gjithashtu, Ministri për IE-në ose një zëvendësministër do të shërbejë edhe si koordinator nacional për fondet e IPA-s, që aktualisht adresohet në nivelin e shërbyesit civil. Ndërkaq, një pjesë e stafit të Ministrisë së Integritimit dhe ministrive tjera relevante do të shërbejnë si pjesë e Sekretariatit teknik të koordinatorit kombëtar për IPA-n.

## 11.2 KËSHILLI KOMBËTAR PËR INTEGRIM

Aktualisht në Kosovë Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian (KKIE) i përbërë nga përfaqësuesit më të lartë të institucioneve, kryetarë të subjekteve politike parlamentare, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, është nën menaxhimin e Zyrës së Presidentit të Kosovës, ndërsa me LDK-në do të kthehet nën menaxhimin e Qeverisë së Kosovës. Duke u bazuar në pasivitetin e këtij mekanizmi në të kaluarën, si dhe duke u bazuar në përvojat e vendeve të tjera, si Shqipëria, LDK-ja do të synojë kalimin e KKIE-së nga Presidenti tek Qeveria e Kosovës.

Nën menaxhimin e qeverisë, ky Këshill do të arrijë një koordinim dhe harmonizim më të mirë të gjithë punës së institucioneve dhe akterëve tjerë në procesin e integritimit.

## 11.3 INSTITUCIONET PËR INTEGRIME EVROPIANE

Bashkimi Evropian është ofruesi më i madh i fondeve dhe ndihmës financiare për Kosovën. BE-ja përdor një sërë instrumentesh financiare, nga të cilat më i rëndësishmi është Instrumenti i Para-Antarësimit (IPA). Në kuadër të BE programit IPA-III të BE-së, ku procesi i ofrimit të asistencës do të jetë konkurrues në mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, Lidhja Demokratike e Kosovës do të angazhohet për projekte konkurruese nga ana e institucioneve të Kosovës, të cilat do të ndikojnë në plotësimin e kriterëve në rrafshin politik, institucional, ligjor, administrativ, social e ekonomik.

Më saktësisht, LDK-ja do të sigurojë që shërbyesit civilë përgjegjës për fondet e IPA-s në kuadër të Sekretariatit Teknik të marrin trajnimet e nevojshme për të identifikuar nevojat e institucioneve të veta, për të përpiluar projektpropozime

konkurruese e që do të sigurojnë fonde për Kosovën, si dhe për planifikim, implementim, monitorim dhe koordinim më të mirë të procesit në përgjithësi. Një staf i përgatitur mirë do të asistojë në përdorimin efektiv të asistencës financiare dhe kështu do të përgatisë Kosovën për anëtarësim më të shpejtë në BE. Për më tepër, LDK-ja do të angazhojë ekspertë të jashtëm, të cilët do të involvohen në procesin e përgatitjes së projekt propozimeve me qëllim që Kosova të thithë sa më shumë nga fondet e IPA-s.

#### 11.4 ANËTARËSIMI RAJONAL

Sot, përfaqësimi i Kosovës në mekanizmat rajonalë është vetëm 9%, përfaqësim ky më i ulëti në raport me vendet tjera të rajonit. Përfaqësimi më i madh i Kosovës, sidomos në pozicionet drejtuese të organizatave rajonale ku bën pjesë, do ta vinte Kosovën në një pozicion më të favorshëm si anëtar i barabartë me vendet e tjera të rajonit, si dhe duke qenë më shumë prezentë në këto organizata Kosova do të mundë të ndikojë në përcaktimin e agjendës rajonale.

Lidhja Demokratike e Kosovës, nëpërmjet lobimit të partnerët rajonalë, do të angazhohet për përfaqësim të barabartë të Kosovës në organizatat rajonale të tilla, si: Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Traktati i Komunitetit të Transportit (TcT), Komuniteti i Energjisë (EnC), Iniciativa Rajonale për Migracion, Azil dhe Kthim të Refugjatëve (MARRI), Zyra Rajonale e Bashkëpunimit të Rinjve (RYCO), si dhe Fondi për Ballkanin Perëndimor (WBF) ku aktualisht Kosova bën pjesë. Për më tepër, duke qenë se Kosova ende nuk është anëtare e disa prej organizatave/iniciativave të tjera rajonale, si: Iniciativa Rajonale kundër korrupsionit (RAI), Qendra e Evropës Juglindore për Sundimin e Ligjit (SELEC), Iniciativa Evropës Juglindore për Reformë në Arsim (ERISEE), Grupi Këshillues i Prokurorëve të Evropës Juglindore (SEEPAG) dhe Shoqatën e Evropës Juglindore të Drejtorëve të Policisë (SEPCA), LDK-ja do të angazhohet për anëtarësimin e Kosovës në to, duke qenë se anëtarësimi do t'i hapë rrugë jo vetëm bashkëpunimit rajonal, por edhe atij ndërkombëtar.

Një kontribut të veçantë LDK-ja do ta ofrojë edhe për Procesin e Berlinit, të cilën e vlerëson si një nismë për të mbështetur integrimin në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Lidhja Demokratike e Kosovës ka qenë konsistente ndaj kësaj nisme, përkatësisht ndaj Procesit të Berlinit, të cilën e ka parë si shumë të rëndësishme dhe në funksion të zhvillimit rajonal, si dhe të procesit të integritimit në BE.

Bashkëpunimi ndërmjet shteteve në nivel të barabartësh, në fusha të caktuara dhe në aspekt të lëvizshmërisë, është me interes për qytetarët e të gjitha këtyre vendeve, dhe si i tillë është për t'u vlerësuar.

Duke qenë se Procesi i Berlinit është një përpjekje serioze për të lëvizur drejt BE-së, duke kontribuar drejtpërdrejtë në aspektin e bashkëpunimit rajonal, LDK-ja do të përkushtohet që të jap kontributin e saj maksimal.



PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# POLITIKA E JASHTME





# POLITIKA E JASHTME

## KONTEKSTI

Republika e Kosovës është në dekadën e dytë prej shpalljes se ka shpallur pavarësinë, më 17 shkurt 2008. Gjatë kësaj periudhe, Kosova ka bërë progres dhe ka ecur përpara, duke arritur rezultate si brenda ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Por ky progres mbetet i pamjaftueshëm deri në konsolidimin e plotë të shtetësisë së Kosovës brenda strukturave euro-atlantike dhe marrjes së ulëses në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Vizioni i Lidhjes Demokratike të Kosovës për politikën e jashtme është që të sigurojë që Republika e Kosovës, si vend i pavarur dhe demokratik, të integrohet në Bashkimin Evropian, të ndërtojë marrëdhënie të mira me vendet fqinje, dhe të ruajë e kultivojë miqësi të përhershme dhe partneritet strategjik me Shtetet e Bashkuara.

Përgjatë viteve të fundit, në kohën e ndryshimeve të mëdha globale, politika e jashtme e Republikës së Kosovës është pa vizion për të ofruar zgjidhje për sfidat e shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Qeveria aktuale nuk ka strategji të qartë për politikën e jashtme, si rrjedhojë diplomacia e Kosovës nuk ka arritur objektivat në shumë dimensione të politikës së jashtme. Mungesa e aktiviteteve dhe iniciativave të domosdoshme për të përfaqësuar dhe avancuar interesat e Kosovës jashtë në përgjithësi dhe të qytetarëve të saj në veçanti, është shqetësuese dhe me pasoja të mundshme largvajtëse.

Në kohën kur forcimi i mëtejshëm i pozitës së Republikës së Kosovës në sistemin ndërkombëtar është synim vital, mungesa e njohjeve të reja dhe e anëtarësimeve në organizata ndërkombëtare është nga dështimet kryesore të politikës së jashtme. Po ashtu duhet pasur parasysh që për Kosovën njohja nga pesë vendet

anëtare të Bashkimit Evropian (Greqia, Qipro, Rumania, Sllovakia, dhe Spanja) duhet të jenë prioritet. Kur flitet për arritjen e njohjeve të reja, për Kosovën është me rëndësi angazhimi në secilin vend njohës potencial për të avancuar rrethanat specifike që mund të jenë në secilin vend dhe rajon. Veçanërisht është evidente që përgjatë viteve nuk ka pasur asnjë intensifikim të prezencës në rajone të ndryshme të botës.

Qeveria ka dështuar të aplikojë në mënyrë efektive forma të ndryshme të diplomacisë moderne, përmes të cilave do të avansoheshin interesat e Kosovës dhe të qytetarëve të saj nëpër botë. Qeveria aktuale nuk ka avancuar synimet ekonomike, politike dhe strategjike të Kosovës përmes diplomacisë ekonomike. Qeveria aktuale nuk ka arritur të zbatojë një diplomaci multilaterale për të adresuar synimet e shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare multilaterale. Duke pasur parasysh peshën që duhet të këtë diplomacia publike dhe kulturore në politikën e jashtme të Kosovës, duke përdorur potencialin që kanë qytetarët e Kosovës në këtë fushë, qeveria aktuale, në arenën e diplomacisë publike dhe kulturore, nuk ka arritur as për së afërmi të ofrojë dhe ndërtojë marrëdhënie partneriteti siç do të duhej të bënte Kosova si një aktor serioz evropian dhe global.

Qeveria aktuale ka dështuar të ofrojë vëmendjen dhe përkushtimin për rritur dhe forcuar kapacitetet e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe shërbimit të jashtëm, duke mos e pasur prioritet dhe në fokus të ofrimit të përkrahjes së nevojshme shumëdimensionale. Në kohën kur Republika e Kosovës ka nevojë urgjente për të ndërtuar mekanizma funksionalë dhe fleksibël në politikën e jashtme, qeveria nuk ka ndarë buxhet të nevojshëm për të siguruar zbatim të shpejtë dhe koherent të masave për të arritur qëllimet strategjike të politikës së jashtme.

Përveç mungesës së angazhimeve adekuate në planin ndërkombëtar, probleme të mëdha janë shfaqur në menaxhimin e brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Shkeljet ligjore në këtë ministri janë shndërruar në normë. Vendimet e kundërligjshme, në shkarkimin dhe emërimin e anëtarëve të shërbimit të jashtëm, janë të përditshme. Këto vendime joligjore kanë shkaktuar humbje të mëdha financiare. Për më tej, pasojat e këtyre vendimeve janë të mëdha dhe shumë dimensionale. Për kohë të gjatë misionet diplomatike të Republikës së Kosovës kanë mbetur pa ambasadorë, dhe pa staf esencial dhe profesional diplomatik. Kjo ka pamundësuar dhe rrezikuar mbarëvajtjen e aktiviteteve të domosdoshme për fuqizimin e pozitës së Kosovës në sistemin ndërkombëtar.



# PLANI YNË PËR POLITIKË TË JASHTME

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, politika e jashtme e Republikës së Kosovës është e bazuar në vlerat evropiane të mishëruara në kushtetutën e saj. Orientimi afatgjatë dhe parimi qendror i punës së diplomacisë së Kosovës është një botë e përparuar e bazuar në bashkëpunim dhe ndërtim të aleancave të fuqishme me vendet demokratike. Thellimi i partneritetit të përhershëm strategjik me Shtetet e Bashkuara, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, Mbretërinë e Bashkuar dhe integrimi euroatlantik janë qëllimet kryesore.

Lidhja Demokratike e Kosovës do të zbatojë një politikë të jashtme që avanson në mënyrë të sigurt interesat e Republikës së Kosovës në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në këtë synim, përmes projekteve adekuate, Ministria e Punëve të Jashtme duke zbatuar një diplomaci moderne, do të sigurojë që interesat nacionale të Kosovës, vlerat e saj, dhe interesat e qytetarëve të saj, të përfaqësohen në mënyrë efektive.

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës qëllimet madhore të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës janë:

## 12.1 FORCIMI I SUBJEKTIVITETIT NDËRKOMBËTAR

Për të forcuar subjektivitetin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës angazhimet për njohje të reja, thellimi i bashkëpunimit bilateral me vendet që tanimë e kanë njohur Kosovën dhe anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare do të jenë në qendër të diplomacisë së vlerave të Kosovës. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet pesë vendeve të BE-së (Greqia, Qipro, Rumania, Sllovakia, Spanja) që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Më tej, do të zbatohen aktivitete intensive në vende njohëse potenciale për të avancuar rrethanat për të siguruar njohje të reja në secilin kontinent. Në këtë drejtim, politika e jashtme e Republikës së Kosovës do të përfshijë krijimin dhe zbatimin e një vargu të gjerë të formave bashkëkohore të diplomacisë. Një nga objektivat më të rëndësishme për politikën e jashtme do të jetë përballja me sukses ndaj fushatave destruktive që bën Serbia kundër shtetësisë së Kosovës. Përmes politikës së jashtme, Republika e Kosovës do të tregojë dhe mbrojë të vërtetën historike për Kosovën, dhe me tërë fuqinë diplomatike, do të portretizojë Kosovën dhe sistemin e saj demokratik si storie e suksesit.

## 12.2 ANTARSIMI NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE

Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare është interes nacional i Kosovës në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar. Në këtë kontekst, Kosova do të zbatojë një diplomaci multilaterale të integruar, ku ndërlidhen interesat nacionale, sektorale, politike, të sigurisë, zhvillimore, financiare etj., dhe ku adresohen synimet e shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Prandaj anëtarësimi në organizata ndërkombëtare është objektiv strategjik i Kosovës. Arsyeja për këtë është e dyfishtë: në njërin anë ky forcon njohjen ndërkombëtare të Kosovës si shtet, ndërsa në anën tjetër Kosova kontribuon në mënyrë konstruktive në arenën ndërkombëtare dhe krijon sinergji në sistemin multilateral.

Veprimet prioritare për anëtarësim në organizata ndërkombëtare do të burojnë nga interesat nacionale. Lidhja Demokratike e Kosovës ka prioritet anëtarësimin në organizatat e rëndësishme: BE, NATO, Këshilli i Evropës, UNESCO, Interpol, Institucionet multilaterale financiare dhe në organizata të tjera, duke përfshirë Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB). Po ashtu, do të thellohet bashkëpunimi dhe aktivitetet që lidhen me organizatën e Frankfonisë dhe në kuadër të saj, si në CONFEMEN dhe CONFESJES.

Angazhim të veçantë do t'i kushtohet anëtarësimin në agjencitë e specializuara të OKB-së, si në Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OSSH), Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikimit (ITU), Unionin Postar Universal (UPU), Organizatën për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), si dhe në organizata të tjera. Për më tej, promovimi i bashkëpunimit rajonal dhe Kosovës si faktor stabiliteti në rajon thellimi i marrëdhënieve të mira me fqinjët, si dhe anëtarësimi në organizata rajonale (organizata politike, ekonomike, kulturore, sportive, të sigurisë etj.) janë qëllimet kryesore të politikës së jashtme.

## 12.3 THEMELIMI I 5 QENDRAVE KULTURORE

Diplomacia kulturore do të shërbejë për të rritur qasjen në mundësitë ndërkombëtare për Kosovën, dhe që Kosova të jetë pjesë aktive në pasurimin

e sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare kulturore. Dialogu ndërkulturor si vlerë ndërkombëtare do të jetë pjesë integrale në aktivitetet e diplomacisë publike të Kosovës. Ministria e Punëve të Jashtme do të zbatojë dhe përkrah iniciativat dhe aktivitetet për të ndërtuar kapacitete, për të rritur shkëmbimet kulturore dhe dialogun ndërkulturor, në relacione bilaterale dhe multilaterale, duke përfshirë shoqërinë civile dhe individët e shquar në fushën e kulturës.

Në këtë drejtim, plani ynë parasheh themelimin e 5 qendrave të reja kulturore, saktësisht atyre në New York, Paris, Berlin, Londër dhe në Bruksel.

## 12.4 RITJA E KAPACITETEVE DIPLOMATIKE

Qëllimi kryesor i këtij projekti do të jetë rritja dhe forcimi i kapaciteteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të shërbimit të jashtëm, në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë në mënyrë efektive Politikën e Jashtme të Republikës së Kosovës. Fokusi i këtij projekti do të jetë në kapacitetet institucionale dhe administrative në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Shërbimit të Jashtëm. Ky projekt ka për objekt primar të avancojë organizimin, profesionalizmin, performancën e përgjithshme dhe të secilit punonjës në Ministrinë e Punëve të Jashtme, si dhe të secilit pjesëtar të shërbimit diplomatik të Kosovës.

Në kuadër të këtij projekti madhor do të zbatohet një gamë e gjerë e masave dhe angazhimeve, me fokus të veçantë në a) planifikimi adekuat i numrit të stafit dhe i pozitave që nevojiten, duke u bazuar në qëllimet dhe objektivat e politikës së jashtme; b) aplikimi i avancimit meritot dhe parimit të rotacionit në kuadër të zhvillimit të shërbimit të jashtëm; c) krijimi i pozitës së Ambassador at Large, me qëllim të rritjes së efektivitetit në synime të veçanta të politikës së jashtme; d) rritja e kapaciteteve të Akademisë Diplomatike, për të bërë të mundur që ajo të jetë një institucion i kualifikuar dhe me reputacion përtej Kosovës, ku përveç aktiviteteve në shërbim të Ministrisë do të organizohen aktivitetet ndërkombëtare; e) riorganizimi dhe zgjerimi i rrjetit diplomatik në botë, me fokus në hapjen e ambasadave dhe misioneve diplomatike në vendet e largëta dhe riorganizimin e misioneve diplomatike dhe konsullore në Evropë; f) rritja e kapaciteteve diplomatike në qendrat kryesore evropiane dhe botërore, duke filluar nga burimet njerëzore, të infrastruktures adekuata dhe kushteve për punë, si dhe përdorimin e teknologjive të reja; dhe g) përmirësimi i infrastrukturës së gjithëmbarshme, duke përfshirë blerjen e ndërtesave për vendosjen e ambasadave të Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të kushteve të përshtatshme për punë për të zhvilluar aktivitetet e nevojshme diplomatike;

## 12.5 DIPLOMACIA DIGJITALE

Përmes diplomacisë digjitale, Kosova synon të jetë vend i avansuar në aplikimin e teknologjisë në të gjitha fushëveprimtaritë e politikës së jashtme, si dhe të navigojë trendet e reja në teknologji. Në këtë mënyrë politika e jashtme e Kosovës do të tregohet në hap me vendet e zhvilluara dhe demokratike në përdorimin e formave të diplomacisë digjitale. Si rrjedhim kjo do të mundësojë që Kosova të njihet globalisht si “komb i digjitalizuar”, që përdor në mënyrë të efektshme teknologjinë e mençur në aktivitetet diplomatike dhe jetën e qytetarëve të saj. Për më tepër, diplomacia digjitale do të shërbejë si mjet strategjik për të forcuar prezencën globale online të Kosovës.

Për të qenë koherent me zhvillimet, inovacioni dhe praktikat efektive të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe të diplomacisë digjitale do të

jenë në qendër të përdorimit në të gjitha aktivitetet e politikës së jashtme. Për më tepër, promovimi i brendit nacional dhe aktivitetëve përmes platformave moderne digjitale të përgjegjshme do të jenë formë e përditshme e punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në diplomacinë e Kosovës në përgjithësi.

Në kohën e sotme është i domosdoshëm digjitalizimi i plotë shërbimeve konsullore. Do të aplikohet përdorimi i platformave sociale shumëdimensionale, si instrumente pune të ofrimit të shërbimeve, si dhe strategji për të forcuar prezencën e gjithëmbarshme online të Kosovës. Për të qenë sa më afër qytetarëve tanë, do të bëhet aplikimi i praktikës së konsullatave mobile në kontekste specifike. Në një dimension promovues, do të zbatohen portfolio të diversifikuara të Tech-iniciativave për të promovuar Kosovën, si dhe angazhimi i Tech-Ambassadorëve.

## 12.6 REFORMA DHE RIORGANIZIMI I SHËRBIMIT

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Shërbimi i Jashtëm duhet të jenë organizime funksionale, që arrijnë objektivat e politikës së jashtme në mënyre efektive. Për këtë qëllim, reformimi dhe riorganizimi i shërbimit të jashtëm është prioritet në politikën e jashtme. Në këtë drejtim do të vendoset një sistem menaxhimi cilësor i gjithmbarshëm që siguron që transformimi të jetë konform nevojave dhe prioriteteve të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës.

Në mënyre specifike do të bëhen ndryshime transformuese në numrin e diplomatëve të vendosur në misionet diplomatike dhe konsullata. Për të adresuar sfidat dhe për të rritur efektivitetin e punës së shërbimit diplomatik në përgjithësi, do të rritet numri i diplomatëve në qendrat e mëdha evropiane dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duke pasur parasysh se në të kaluarën numri i diplomatëve në vendet e rajonit është rritur pa arsye të duhur të objektivave të punës, në programin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, kur kemi të bëjmë me numrin e diplomatëve në misionet të caktuara, qëllimi do të jetë të bëhet një ribalancim i kapaciteve. Kjo nënkupton që, në pajtim me nevojat reale, do të bëhet zvogëlimi i numrit të diplomatëve në vendet e rajonit sipas specifikave të vendeve, ndërsa do të rritet numri i diplomatëve dhe zyrtarëve në misionet të caktuara në kryeqendrat evropiane dhe botërore.

Për të forcuar diplomacinë ekonomike do të krijohen pozita për diplomatë me detyrë të veçantë në fushën e diplomacisë ekonomike (sipas specifikave të vendeve përkatëse dhe interesave strategjike të Kosovës (Washington, Bruksel, Berlin, Cyrih, Londër, Paris, Romë, Tokio, Jerusalem, dhe në vende të tjera). Në këto angazhime, Oda Ekonomike e Kosovës do të jetë partnere në diplomacinë ekonomike. Për më tej, do të ofrohet përkrahje dhe bashkëpunim me Oda Ekonomike të ndryshme dhe/apo rrjete biznesi.

Politika e Jashtme e Kosovës synon të bëhet shembull në diplomacinë feministe në rrafsh global. Prandaj, barazia gjinore do të jetë në qendër të qëllimeve të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës. Promovimi i të drejtave të grave dhe avancimi i barazisë gjinore do të jenë prezente në të gjitha aktivitetet diplomatike. Promovimi i gruas do të bëhet në të gjitha forumet vendimmarrëse në fushën e politikës së jashtme. Aktivitete, ndarje buxheti, dhe masa konkrete legjislative do të ndërmerren për të realizuar këtë qëllim.

## 12.7 REFORMA LEGJISLATIVE

Me qëllim të funksionimit efektiv të politikës së jashtme, të rregullimit adekuat organizativ, si dhe të vendosjes së ligjshmërisë në secilin segment të punës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, do të bëhet reformë e thellë dhe rishikim i gjithë korpusit të legjislacionit që lidhet me tërësinë e sistemit të punëve të jashtme. Do të bëhet rishikimi i ligjeve primare dhe i të gjitha akteve nënligjore aktuale. Kjo do të bëhet me qëllimin parë për të siguruar ligjshmërinë, ndërsa në anën tjetër për të mundësuar përditësimin, largimin e barrierave dhe të ngarkesave që dalin nga legjislacioni aktual, që ndikojnë në performancën e përgjithshme në politikën e jashtme.

Legjislacioni i ri do të jetë koherent dhe do të sigurojë që parimet themelore të funksionimit të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, të zbatohen në mënyrë efektive. Për më tej, legjislacioni i ri do të mundësojë ndërtimin e një shërbimi të jashtëm modern, efektiv dhe efikas që do të jetë në gjendje të përballojë sfidat e politikës së jashtme në kohët që po vijnë.



Këto ndryshime do të bazohen në standardet dhe praktikatat më të mira të politikës së jashtme dhe të diplomacisë moderne të vendeve të përparuara, në radhë të parë evropiane dhe Shteteve të Bashkuara. Si rezultat, e gjithë reforma ligjore bëhet me qëllimin madhor për të realizuar vizionin dhe për të zbatuar parimet udhëheqëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të punës në Shërbimin e Jashtëm në shërbim të interesave nacionale të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj.



# SPORTI







## KONTEKSTI

Sporti në Kosovë është pjesë fundamentale e shoqërisë; prandaj si i tillë është pjesë e jetës ekonomike e sociale të vendit. Në Kosovë, në vitin 2023 janë të regjistruara 50 Federata Sportive, 630 klube sportive dhe rreth 30 mijë sportist aktiv nëpër të gjitha grup moshat. Na vitin paraprak atë të vitit 2022, të regjistruan ishin rreth 50 mijë sportist aktiv; duke dëshmuar kështu një rënie drastike në aktivitetin sportiv në vend, e duke ngritur kështu alarmin për rënien potenciale në këtë sektor të rëndësishëm për vendin.

Përkundër mungesës së investimeve të rëndësishme në fushën e sportit përgjatë viteve, Kosova ka dëshmuar megjithatë potencial të jashtëzakonshëm për sukses në sport. Rastet e sukseseve individuale e kolektive të sportistëve tanë, kanë dëshmuar rrugën e mundshme që vendi ynë mund ta ndjekë përpara në çdo disiplinë sportive.

Kosova ka një moshë të re të popullsisë, që shërben njëkohësisht si bazë e mirë për çdo aktivitet sportiv në vend. Po ashtu, Kosova është e anëtarësuar në të gjitha mekanizmat ndërkombëtarë të sportit, si parakusht i depërtimit ndërkombëtar të sporteve tona individuale e kolektive. Mbi të gjitha, me Ligjin e ri për Sponsorizim, frytet e të cilit ende nuk janë venë në funksion të plotë, vendi ynë mund ka dhe burime të bollshme financiare në këtë drejtim.

Por Kosova ka mungesë serioze të infrastrukturës sportive. Në pjesën më të madhe të qytetëseve, stadiumet e futbollit e palestrat sportive janë larg çdo standardi minimal evropian. Kosovës i mungon po ashtu edhe ndërlidhja e fortë në mes aktiviteteve sportive dhe sistemit edukativ në vend. Së këndejmi, për

shkak të mungesës së një ndërlidhje të tillë, vendi ynë ka normën më të ulët të pjesëmarrjes aktive me sport për kokë banori në Evropë.

Përmirësimi i infrastrukturës sportive në qendrat kryesore në vend, së bashku me përmirësimin e infrastrukturës shkollore në çdo anë të vendit, janë parakushte të zhvillimit kombëtar të sportit tonë. Në nivel më të lartë, Kosovës i duhen investime serioze në një qendër sportive që në vete ngërthen të gjitha elementet sportive, të trajnimit, kërkimit e avancimit teknologjik në drejtim të sportit, konform zhvillimeve të fundit botërore.

# PLANI YNË PËR SPORT

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, Sporti, në veçanti ai i futbollit, është prioritet kombëtar; jo vetëm si formë e promovimit të imazhit të vendit jashtë, por edhe si resurs ekonomik i rëndësishëm për vendin që krijon kaq shumë talent. Në këtë drejtim, plani ynë parasheh ndërmarrjen e një sërë investimesh të mëdha kapitale, paralele në gjithë Kosovën, që për qëllim kryesor kanë ndërtimin e infrastrukturës sportive nëpërmjet stadiumeve, nëpërmjet palestrave sportive, nëpërmjet ambienteve të edukimit fizik nëpër shkolla, e nëpërmjet Qendrës Nacionale Sportive. Projektet kryesore të planit tonë janë:

### 13.1 NDËRTIMI I QENDRËS KOMBËTARE TË SPORTIT

Plani ynë parasheh ndërtimin, me prioritet, të Qendrës Kombëtare të Sportit, në Prishtinë, me lokacionin e parapërcaktuar, në Bërnice. Në këtë Qendër Kombëtare të Sportit, parashihet të ndërtohet Stadiumi Kombëtar, Pallati Kombëtar, Pishina Olimpikë, Gaming Hall si dhe Qendra për Trajnim të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe federatave sportive.

Stadiumi Kombëtar pritet të ketë kapacitet prej 25-30 mijë ulëseve, i përcjellë po ashtu me kapacitete të hotelerisë e gastronomisë. Kostoja e gjithëmbarshme për ndërtimin e këtij stadiumi është rreth 60 milionë euro.

Pallati Kombëtar, do të ketë kapacitet prej 8 mijë ulëseve, me të gjitha standardet e një palestere të avancuar e moderne. Në këtë Pallat, do të zhvillohen të gjitha garat ndërkombëtare të të gjitha Federatave përkatëse që aplikojnë sportin në palestër. Ndërsa dy pishina olimpikë do të shërbejnë për zhvillimin e sportit të notit dhe sporteve tjera të ujit, si risi e organizimit sportiv në vend. Kosto e gjithëmbarshme është 20 milionë euro.

Pishina Olimpikë do të ketë kapacitet prej 3,000 ulëseve dhe kosto e gjithëmbarshme e këtij investimi është 8 milionë euro.

Në programin tonë ne parashohim të ndërtojmë dhe “Gaming Hall”, të parën në Kosovë. Kjo sallë përcjellëse e sporteve elektronike, atraksion për rininë Kosovare do të ketë kapacitet prej 2,000 ulëseve dhe kosto e gjithëmbarshme e ndërtimit të kësaj salle moderne do të jetë rreth 8 milionë euro. “Gaming Hall” do të jetë atraksion turistik për të rinjër e rajonit dhe jo vetëm.

I gjithë projekti i ndërtimit të Qendrës Kombëtare të Sportit do të jetë rreth 120 milionë euro dhe do të nisë së ndërtuari qysh në vitin e dytë të planit tonë.

### 13.2 NDËRTIMI I STADIUMEVE RAJONALE

Plani ynë parasheh ndërtimin apo përfundimin e plotë të 5 stadiumeve rajonale, nëpër qytetet kryesore të Kosovës. Këto stadiume do të jenë të kategorive 3 dhe 4, të pranuar nga UEFA; të shpërndara në qendrat kryesore të vendit; dhe me kosto secila nga 12 milionë euro; gjithsejtë, 60 milionë euro.

Përzgjedhja e qyteteve do të bëhet në bazë të nevojave demografike, gjendjes së stadiumeve aktuale dhe elementeve të tjera të karakterit lokal.

### 13.3 FONDI SPORTIV SHKOLLOR

Sporti shkollor i nivelit fillor dhe të mesëm është prioritet i planit tonë. Në këtë drejtim, ne kemi paraparë krijimin e një fondi prej 30 milionë eurove për rigjenerimin dhe plotësimin e të gjitha palestrave sportive në të gjitha shkollat në Kosovë. Ky fond do të kujdeset për krijimin e kushteve moderne sportive nëpër të gjitha shkollat me nivel të lartë frekuentimi të nxënësve kosovar. Këto objekte sportive, më pas, do të përdoren për ushtrime dhe nga klubet sportive profesionale nëpër të gjitha qytetet e Kosovës.

Krijimi i këtij fondi, së bashku me përfundimin e investimeve shkollore në vend, do të krijojë mundësi të rritjes së orëve mësimore, së paku 3 orë në javë, për

lëndën e edukatës fizike.

### 13.4 **THEMELIMI I NDËRMARRJES SPORTIVE**

Një ndër problemet kryesore të kapaciteteve infrastrukturore në vend është dhe menaxhimi i tyre. Shembull i dështimit të mirëmbajtjes është dhe Stadiumi “Adem Jashari” në Mitrovicë, i cili, përkundër investimeve të mëdha infrastrukturore në të, në mungesë të mirëmbajtjes adekuate nga institucione me kapacitete të mjaftueshme mirëmbajtëse, është dëmtuar tërësisht dhe është jashtë funksionit ndonese ka pak vite që është renovuar.

Themelimi i një ndërmarrje sportive, potencialisht në partneritet publiko-privat, nëpërmjet së cilës bëhet apo sigurohet dhe pronësia (e pjesëshme ose e plotë varësisht nga rrethanat e dhëna) e të gjitha stadiumeve e palestrave të ndërtuara nga niveli qendror (te karakterit nacional) do t’i jepte zgjidhje çështjes së mirëmbajtjes së aseteve në Kosovë; dhe së këndejmi, pamundësisë së nivelit lokal, apo dhe klubeve sportive, të sigurojnë qëndrueshmëri në mirëmbajtje të plotë.

### 13.5 **PALESTRAT RAJONALE**

Kosova ka palestra sportive në pjesën më të madhe të qyteteve kryesore të saj, përkatësisht në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjakovë e Ferizaj. Këto palestra sportive të ndërtuara në vitin 1979, në shumë raste, kanë nevojë për investime të reja, sidomos në ngrohje, në qatë dhe në ventillim si dhe për zgjerim të kapaciteteve të përcjellëse në to. Në planin tonë, do të ndahen mbi 7 milionë euro për rigjenerimin dhe përmirësimin e këtyre palestrave egzistuese.

Përveç kësaj, në dy qytete të tjera do të ndërtohen dhe 2 palestra të reja. Lokacioni i tyre do të përcaktohet si pjesë e strategjisë së gjithmbarshme të investimeve infrastrukturore në vend. Investimi i gjithmbarshëm në këto dy palestra do të jetë rreth 15 milionë euro.

### 13.6 **LOJRAT OLIMPIKE MESDHETARE**

Kosova tashme ka marrë përsipër organizimin e Lojërave Mesdhetare në Prishtinë 2030. Kosova do t’i kryejë zotimet e saj për organizimin e Lojërave Mesdhetare duke shfrytëzuar kapacitete aktuale (duke i renovuar ato egzistuese) dhe duke i ndërtuar të reja, sipas kërkesës dhe planit të Organizimit të Lojërave Mesdhetare.

Aplikimi i Lojërave Mesdhetare sipas sporteve do të shtrihet në tërë territorin e Kosovës, si dhe në qytetin e Durrësit. Agjenda e aplikimit të sporteve do të jetë si vijon: a) Fshati Mesdhetar, do të shfrytëzohen konviktet aktuale të studentëve në Prishtinë; b) Atletika, në Stadiumin “Adem Jashari” në Mitrovicë, i cili do të rinovohet; c) Volejboli, në Palestrën e Sporteve në Gjiilan, e cila do të rinovohet; ç) Vozitja me Varka, në Liqenin e Batllavës, do të bëhet improvizimi i tribunës; d) Hendbolli, në palestrën e sporteve në Ferizaj, e cila do të rinovohet; dh) Gjuajtjet me Hark, qendra në Drenas, e cila do të ndërtohet; e) Lundrimi, në Durrës, improvizim i tribunës; ë) Futbollit, në Stadiumin “Fadil Vokrri”, pastja në Gjakovë, Podujevë, Gjiilan dhe atë Stradiumin Nacional; f) Bowls, në Parkun Nacional të Gërmisë, Prishtinë, Ndërtimi i Tribunes; g) Hendbolli, në palestrën e sporteve të Mitrovicës, që do të rinovohet; gj) Xhudoja, Qendra Nationale e Xhudos, Pejë; h) Noti nën ujë, Qendra Kombëtare e Sportit, Prishtinë, që do të ndërtohet; i) Gjimnastika, palestra e sporteve e Prishtinës, që do të rinovohet; j)



Volejboli, palestrat e sportit të Podujevës dhe të Prishtinës, që do të renovohen; k) Mundja, palestra e sporteve e Prizrenit, që do të renovohet; l) Peshngritja - Loja me shpata, palestra e sporteve e Gjakovës, që do të renovohet; ll) Qitja, Qendra e Qitjes në Klinë, që do të ndërtohet; m) Basketbolli 3x3, në qendër të qytetit të Prishtinës, tribuna do të improvizohet.

Aktualisht buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është mbi 57 milionë euro dhe investimi prej mbi 200 milionë eurosh do të jetë investimi i shtetit në Kosovë, i ndarë proporcionalisht në 7 vite (deri në vitin 2030) e ku përfshihet ndërtimi i Stadiumit Kombëtar, ndërtimet apo përfundimet e stadiumeve rajonale, të palestrave rajonale, renovimi i palestrës sëmadhe të Pallatit të Rinisë, ndërtimi i dy pishinave olimpike dhe ndërtimi i dy palestrave sportive, pastaj ndërtimi i kompleksit të tenisit në Prishtinë, ndërtimi i Qendrës së Gjuajtjes me Hark në Drenas, ndërtimi i Qendrës së Qitjes në Klinë, tribuna e improvizuar në Liqenin e Batllavës (1500 vende) për sportin e vozitjes me varka, Bowls me 1200 ulëse Bowling&Golf, Ciklizmi - nëpër Kosovë, me tribunë të improvizuar prej 6000 ulësesh, Basketbolli 3x3 në dy arena në qendër të Prishtinës, me 3000 dhe 1200 ulëse të improvizuara. Qendra e shëndetit dhe e antidopingut në Prishtinë, si dhe sektori i veçantë i qendrave emergjente në qytetet ku aplikohen lojërat. Plani strategjik i hotelerisë, gastronomisë dhe i transportit publik për vizitorët, me theks të veçantë në Prishtinë dhe në qytetet e tjera ku aplikohet lojërat.

E gjithë infrastruktura e ndërtuar apo e renovuar do të mbetet aset i sportit kosovar dhe, rrjedhimisht, për shumë sporte do të behet zgjidhje afatgjatë për organizimin e garave nacionale dhe ndërkombetare, gjë që ndikon direkt në zhvillimin dhe masovizmin e sportit dhe, gjithsesi, në ngritjen e performancës sportive.



PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE MJEDISI





# PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE MJEDISI

## KONTEKSTI

Zhvillimi dhe planifikimi hapësinor në Kosovë, për shumë vite pas luftës, ka ndjekur një trend të parregullt dhe gati në kundërshti me kërkesat e qytetarëve për mirëqenie dhe në disproporcion me standardet ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm. Duke marrë parasysh faktin që ky sektor është ndër më fitimprurësit dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të vendit, Ministria e Planifikimit dhe Mjedisit si bartëse e proceseve kryesore dhe Drejtoritë përgjegjëse në nivelet lokale, kanë dështuar që të kenë kontroll mbi proceset e zhvilluara të ndërtimit. Ato nuk kanë qenë në hap me përditësimin dhe aprovimin e legjislacionit të nevojshëm, si dhe respektimin e implementimin e tij. Rrjedhimisht, sot, Kosova përballlet me kushte të pasigurta të ndërtimit dhe mjaft të rënduara mjedisore.

Në tërësi, procesi i planifikimit hapësinor dhe zhvillimi i mjedisit në Kosovë kalojnë nëpër sfida thelbësore, të cilat janë larg plotësimit të standardeve të kërkuara me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG's) miratuar nga UN në vitin 2015 dhe me EU Green Deal të aprovuar nga Bashkimi Evropian, në vitin 2019.

Legjislacioni aktual, i cili e rregullon fushën e planifikimit hapësinor, ka mangësi bazike, që e pengojnë zhvillimin e një procesi të qëndrueshëm, rezultatet e të cilit do të lehtësonin jetën e qytetarëve të Kosovës. Ligji bazë për planifikim hapësinor, i cili aktualisht është në fuqi, nuk i adreson dhe plotëson as për së afërmi problemet dhe nevojat e kësaj fushe për zhvillim dhe përmirësim të jetës së qytetarëve. Ky ligj duhet që me urgjencë të përditësohet, plotësohet dhe harmonizohet me ligjet për ndërtim, ligjin për trashëgimi kulturore dhe atë për mbrojtje të mjedisit.

Plani Hapësinor i Kosovës, si dokument bazë, i cili e rregullon procesin e planifikimit në territorin e Republikës së Kosovës, është dokument i vjetëruar, i hartuar mbi bazën e të dhënave të dokumenteve të OSBE-së së vitit 2000, ku thuhet se Kosova i ka 2,4 milionë banorë dhe të censusit të vitit 2011. Sipas të dhënave, në këtë dokument është paraparë që në vitin 2050, numri i popullsisë në Kosovë të mbërrijë në 4.5 milion banorë, ndërkohë që të dhënat nga terreni, japin indikacione për ndryshime të mëdha të natalitetit dhe migrimit të popullsisë.

Harta Zonale e Kosovës, si dokument i qeverisjes qendrore, i cili është bazë për orientimin e procesit të planifikimit në nivelin komunal, vazhdon të jetë si draft-dokument që nga viti 2020. Aq më tepër, qeveria vazhdon të aprovojë Harta Zonale Komunale, në kundërshtim me ligjin për planifikim.

Kosovës i mungojnë pothuajse në tërësi Planet Hapësinore për Zona te Veçanta të parashikuara me ligj. Këto zona, në mungesë të planeve hapësinore, bllokohen duke ndaluar pothuajse çdo lloj aktiviteti, gjë që i dëmton ato jo vetëm nga aspekti i mirëmbajtjes, por edhe ai ekonomik.

Edhe në nivelin komunal, legjislacioni në fuqi duhet të përditësohet, përmirësohet dhe të azhurnohet me të dhënat të cilat dalin nga dokumentet e planifikimit të përgjithshëm në nivelin qendror dhe bën ndërlidhjen e zhvillimit të komunave fqinje. Njëjtë si fusha e planifikimit, edhe ajo e ndërtimit ka nevojë për përmirësimin e bazës ligjore primare dhe sekondare. Fokus të veçantë duhet t'i jepet mirëdefinimit të procesit të mbikëqyrjes së ndërtimeve, si një parakusht për përcaktimin e përgjegjësive dhe rregullimit të sektorit.

Po ashtu, është gati jetike ngritja e bazës ligjore për krijimin e platformës digjitale për menaxhimin e lejeve ndërtimore në të gjithë territorin e Kosovës në nivel qendror dhe lokal, e që do të ofronte transparencë dhe përgjegjshmëri të plotë.

Një set i tërë i dokumentacionit, që kërkon zhvillim e aprovim emergjent në fushën e ndërtimit, është plotësimi i Kodit Unik të Ndërtimit, i cili përcakton standardet të cilat duhet të jenë në hap me ato ndërkombëtare.

Kur flitet për sektorin e ndërtimit, ajo që secili qytetar i Kosovës kërkon të kuptojë është nëse shteti/qeveria i ka nën kontroll të gjitha ndërtimet, cilësinë dhe rregullsinë e tyre, por në fakt, numri i aktual i inspektorëve në dispozicion është komplet i pamjaftueshëm për të ofruar këtë siguri për qytetarët, prandaj ndryshimi i legjislacionit që mundëson rritjen e numrit të inspektorëve është mëse i domosdoshëm.

Ndërkohë, kur diskutohet për mjedisin, ndryshe nga shumë vende të tjera të botës, në Republikën e Kosovës e drejta për mjedis të shëndetshëm nuk është e garantuar me Kushtetutë, prandaj kjo duhet të ndryshohet menjëherë, në mënyrë që t'iu garantohet qytetarëve e drejta për mjedis të pastër, me ujë të bollshëm dhe të gatshëm për t'u përballur me ndryshimet klimatike.

Edhe legjislacioni i cili rregullon fushën e mjedisit kërkon përditësim, ndryshim e harmonizim me standardet e BE-së, në mënyrë që të përgatiten në kohë institucionet qendrore dhe lokale për përballje me sfidat e mjedisit jo vetëm ato vendore, por edhe globale.

Përveç sfidës kryesore, që lidhet me zhvillimin e harmonizimin e legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e planifikimit, mjedisit, ndërtimit dhe trashëgimisë kulturore, një sfidë tjetër është ngritja dhe avansimi i kapaciteteve njerëzore në administratën publike në nivelin lokal dhe qendror për të mundësuar implementimin e duhur të legjislacionit dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të tij.



# PLANI YNË PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR DHE MJEDIS

Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila prioritet kryesor ka mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës, do të angazhohet në krijimin e të gjitha kushteve për vendosjen e rendit, sigurisë dhe cilësisë në sektorin e ndërtimit, ngritjen e kapaciteteve njerëzore në institucionet përgjegjëse të mjedisit dhe planifikimit, përcaktimin e saktë dhe të drejtë të përgjegjësive vendimmarrëse, duke pasur në fokus mirëmenaxhimin e proceseve administrative dhe lehtësimin e procedurave për investimet me interes strategjik në Kosovë, digjitalizimin dhe transparencën në vendimmarrje për lejimin e zhvillimeve në sektorin e ndërtimit, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe resurseve natyrore të saj, si dhe avansimin e proceseve për mbrojtjen e mjedisit duke garantuar të drejtën për jetë të shëndetshme për secilin qytetar.

Duke e konsideruar si fushë prioritare dhe me interes kombëtar për zhvillimin social dhe ekonomik, Lidhja Demokratike e Kosovës ka definuar objektivat strategjike për zhvillimin e planifikimit hapësinor dhe zhvillimit e mbrojtjes së mjedisit, bazuar edhe në kërkesat që rrjedhin nga standardet ndërkombëtare. Fushat kryesore të planit tonë në Planifikim Hapësinor e Mjedis janë:

## 14.1 **PËRDITËSIMI I PLANIT HAPËSINOR DHE HARTËS ZONALE**

Procesi i planifikimit hapësinor në Kosovë ngec në thelbin e tij legjislativ e që është ligji për Planifikimin Hapësinor i vitit 2013, i cili kërkon plotësim, përditësim e dhe harmonizim me ligjin e ndërtimit, ligjin për trashëgimi kulturore dhe ligjin për mbrojtjen e mjedisit. Edhe Plani aktual Hapësinor i Kosovës (PHK) është dokument i vjetëruar, i bazuar në të dhëna të vjetruara/të pasakta. Zhvillimet e viteve të fundit, në sektorët e caktuar, si demografik, ekonomik, infrastrukturor dhe vetë kahjet e zhvillimit rajonal në Evropën Juglindore, e kanë bërë tejet të nevojshme dhe urgjente që PHK-ja të përditësohet në një plan të ri, i cili përmbledh zhvillimet aktuale duke ofruar përgjigje për një vizion të ri për vendin dhe pozitën e tij në raport me rajonin.

Lidhja Demokratike e Kosovës do të ngrisë grupet e punës për të hartuar planin e ri hapësinor, i cili bazohet në të dhënat reale të Censurit të vitit 2023/24 dhe i cili reflekton nevojën për zhvillim ekonomik, social dhe infrastrukturor për qytetarët e Republikës së Kosovës. Më tej, do të ndiqen hapa administrativ për aprovimin me prioritet të planit, objektivat e të cilit do të reflektohen në planet zhvillimore të komunave.

Në anën tjetër, Harta Zonale e Kosovës (HZK-ja), është aktualisht dokument i paaprovuar i versionit draft, i cili krijon barrierë për hartimin dhe aprovimin e Hartave Zonale të Komunave të kërkuar sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, përkatësisht nenit 11. Lidhja Demokratike e Kosovës, do ta trajtojë me prioritet përditësimin dhe aprovimin e Hartës Zonale të Kosovës, si një nga dokumentet primare strategjike, që i vendos standardet e planifikimit hapësinor në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe do të sigurohet për implementimin e standardeve të përcaktuara në të, në të gjitha nivelet e planifikimit hapësinor në Kosovë.

## 14.2 **PLANET MENAXHUESE PËR ZONAT E MBROJTURA DHE TË VEÇANTA**

Sot, në Kosovë janë të identifikuar 426 zona të mbrojtura të trashëgimisë kulturore, 52 zona të mbrojtura të trashëgimisë natyrore dhe 45 zona të mbrojtura të veçanta. Zonat e mbrojtura dhe ato të veçanta të mbrojtura, që përfshijnë një territor më të gjerë, duhet të trajtohen me plan të veçantë hapësinor, i cili përcakton mënyrën dhe kushtet e zhvillimit të hapësirave brenda këtyre zonave.

Aktualisht, Plani Hapësinor i “Bjeshkëve të Nemuna”, si një ndër zonat më me rëndësi për zhvillimin turistik e mjedisor të Kosovës, i cili është aprovuar rishtazi, duket larg zbatimit të objektivave të zhvillimit dhe mbrojtjes së resurseve natyrore. Kurse Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar të “Sharrit” i hartuar në vitin 2013 nuk është përditësuar asnjëherë, përkundër standardit të përcaktuar në plan, i cili parasheh përditësimin e tij çdo 5 vite. Kjo situatë pamundëson zhvillimin e këtyre zonave, duke i bllokuar procedurat administrative dhe investitorët strategjik potencial. Ndërkohë edhe zonat e tjera të mbrojtura si rezervatet natyrore, parqet natyrore, monumentet natyrore, e peisazhet e mbrojtura nuk kanë një plan zhvillimi afatgjatë dhe planifikimi i hapësirave rreth tyre i lihet në dorë institucioneve lokale, pa përcjellë një strategji e vizion të përgjithshëm kombëtar.

Lidhja Demokratike e Kosovës do të angazhohet fillimisht në zbatimin me prioritet të objektivave zhvillimore dhe mbrojtëse të Planit Hapësinor të Bjeshkëve të Nemuna, si një parakusht për të hapur mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Më tej, do të rishqyrtohet lista e Zonave të Mbrojtura të Republikës së Kosovës, për të përcaktuar prioritetet e hartimit të planeve të menaxhimit, duke favorizuar zonat me sipërfaqe më të madhe dhe ato me kapacitet zhvillimi natyror e ekonomik.

Lista e Zonave të Veçanta të Mbrojtura, bazuar në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, do të trajtohet me shumë kujdes. Do të inicohet proces i incizimit të gjendjes së tyre aktuale, për të propozuar dhe përcaktuar nevojën për intervenime për mirëmbajtje e përmirësim të kushteve të këtyre zonave, por edhe të zhvillimit infrastrukturor rreth tyre, në mënyrë që të bëhet shumë më e lehtë qasja e vizitorëve.

LDK-ja do të angazhohet që përqindjen aktuale të zonave të mbrojtura vetëm në letër, siç ekziston aktualisht, ta kthejë në mbrojtje reale në terren. Miratimi i Planeve Menaxhuese të dy parqeve ekzistuese kombëtare: Sharrit dhe Bjeshkëve të Nemuna, që në qendër të menaxhimit dhe ruajtjes do të kenë banorin e parkut si partnerin kryesor. Investimet publike për ruajtjen dhe promovimin e parqeve dhe partneritetet publiko-private (PPP), në shërbim të zhvillimit të biznesit dhe rekreacionit. Promovimi i parimeve të ekoturizmit dhe traditës së mikpritjes në parqet kombëtare me fushata informimi, edukimi dhe vetëdijesimi.

### 14.3 MBIKËQYRJA RIGOROZE E NDËRTIMEVE

Sipas Ligjit për Ndërtim, mbikëqyrja e ndërtimeve si një prej pikave më të rëndësishme, e cila do të duhej të garantonte cilësi në procesin e ndërtimit, është e theksuar në titulli e Nenit 4 të ligjit -Mbikëqyrja e Ndërtimeve, por mungon tërësisht si përcaktim dhe definicion brenda ligjit. Edhe në Kreun IX - Mbikëqyrja, është përcaktuar vetëm si nocion i mbikëqyrjes inspektive, por jo edhe ajo kualitative e projektit. Kosovës i mungon edhe legjislacioni sekondar për mbikëqyrjen e ndërtimeve në punishte, çka bën që kjo fushë të jetë komplet e parregulluar dhe vështirë e kontrolluar, duke e lënë në dorën dhe dëshirën e investitorëve, e që shkakton probleme zinxhirore në kualitetin afatgjatë të ndërtimeve.

Në këtë aspekt, Lidhja Demokratike e Kosovës, duke njohur rëndësinë e mbikëqyrjes në efektin zinxhior të marrëdhënieve investitor-klient-institucione, do të angazhohet për hartimin dhe aprovimin e legjislacionit sekondar që adreson Mbikëqyrjen e Ndërtimeve jo vetëm në aspektin inxhinierik, por edhe atë të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, duke definuar kërkesa të sakta për investitorët për mbajtjen e ditareve të ndërtimit dhe atyre të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, duke u bazuar edhe në kërkesat dhe standardet ndërkombëtare.

Për secilin projekt do të kërkohet të deklarohen inxhinierët apo kompaninë mbikëqyrëse të projektit, e cila do të marrë përgjegjësinë për kualitetin e punës ndërtimore para klientëve dhe institucioneve. Po ashtu, bashkë me sistemin e digjitalizimit të lejeve, do të punohet për sistemin e digjitalizimit të ditareve të ndërtimit dhe sigurisë në punë. Do të kërkohet nga investitorët që çdo ditë të deklarojnë numrin e punonjësve në kantier ndërtimi, fazën e punës në të cilën do të punohet dhe pajisjet e nevojshme. Në këtë mënyrë, do të lehtësohet puna e inspektorëve të ndërtimit dhe ofron transparencë në monitorim dhe raportim.



Njëkohësisht, Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila është e dedikuar për të rregulluar këtë sektor shumë sfidues në Kosovë, do të punojë edhe zhvillimin e sistemit për licencimin e inxhinierëve të mbikëqyrjes së ndërtimit, duke ngritur fuqi punëtore të kualifikuara dhe të përgjegjshme me nivel të ekspertizës të barabartë me të gjitha vendet e zhvilluara.

#### 14.4 **INVESTIMET ME INTERES STRATEGJIK**

Lidhja Demokratike e Kosovës i vlerëson si me shumë interes projektet dhe investimet strategjike afatgjata, të cilat kanë efekt të gjerë të ndikimit ekonomik dhe të zhvillimit jo vetëm lokal, por të cilat kanë ndikim në zhvillimin e përgjithshëm të Kosovës. Ndër sektorët me rëndësi e të cilët do të trajtohen me prioritet janë projektet e zhvillimit energjetik e minerar, projektet e infrastrukturës e të transportit, ato të telekomunikimeve, projektet e turizmit, projektet e mbrojtjes dhe trajtimit të mjedisit - trajtimi i mbeturinave dhe mbrojtja e trajtimi i burimeve ujore, projektet e zhvillimit bujqësor dhe projektet e zhvillimit industrial dhe projektet e shëndetësisë.

Lidhja Demokratike e Kosovës do të punojë me intensitet që të krijojë legjislacionin e nevojshëm dhe të ngrisë paralelisht strukturat institucionale për trajtimin, aprovimin dhe mbikëqyrjen e projekteve investive me interes strategjik kombëtar, duke përcaktuar rregulla të sakta dhe transparente për vlerësimin me prioritet të tyre.

Duke pas parasysh se aktualisht investitorët strategjik, projektet e të cilëve mundësojnë punësim në shkallë të gjerë të qytetarëve të Kosovës, trajtohen njëjtë si çdo investitor tjetër, duke ndjekur burokraci e procedura administrative të stërzgatura, LDK-ja do të krijojë strukturën e veçantë One-Stop-Shop, e cila do t'u mundësojë investitorëve strategjik të përcaktuar sipas Ligjit për Investime Strategjike trajtim të veçantë dhe qasje me prioritet në të gjitha informacionet e nevojshme, kalim me lehtësi nëpër procedurat e aplikimit për lejet e nevojshme dhe vendimmarrje të lehtësuara, pa pas nevojë që të kalojnë nga një zyrë në tjetrën në institucionet qendrore e lokale. Njëkohësisht, përmes strukturave shtetërore do të bëhet edhe promovimi i projekteve me rëndësi, në mënyrë që të tërheqin kuadrot më me eksperiencë dhe të edukuara në fushat specifike që i përshtaten fushëveprimtarisë së projektit.

#### 14.5 **INSPEKTIMI I OBJEKTEVE**

Ndër pikat më të dobëta institucionale në monitorimin dhe rregullimin e sektorit të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Kosovë është ajo e mbikëqyrjes inspektive, gjë që e pamundëson një pasqyrë të qartë të cilësisë së këtyre dy sektorëve në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Institucionet qendrore dhe ato lokale e reflektojnë mungesën e kapaciteteve njerëzore, në proporcion me fluksin e ndërtimeve të pajisura me leje ndërtimi.

Në këtë mënyrë, nuk mund të sigurohet inspektim efektiv e cilësor, i cili garanton implementimin e kushteve të lejes së ndërtimit ose asaj mjedisore, duke e lënë këtë në ndërgjegjen e investitorëve, gjë që sjell jo vetëm pasoja afatgjate dhe ulje të cilësisë, por shpesh edhe aksidente me pasoja fatale në kantieret e ndërtimit. Aktualisht, Ministria e Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës, funksionon me divizion për inspektim, i cili zyrtarisht ka 9 punonjës e që nuk plotëson as për së afërmi kërkesën për inspektime të projekteve të reja.

Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila është e përcaktuar për të vënë nën kontroll dhe për të siguruar rregull dhe cilësi në industrinë e ndërtimit dhe infrastrukturës, do të përkushtohet në ngritjen e kapaciteteve njerëzore për të rritur numrin e inspektorëve të ndërtimit, planifikimit dhe mjedisit duke zhvilluar sistem të avansuar të trajnimit profesional dhe caktimit të linjës së veçantë të buxhetit për inspektim në të gjitha nivelet e përgjegjësisë. Në këtë drejtim, LDK-ja do të pesëfishojë numrin e inspektorëve qysh në vitet e para të implementimit të planit tonë; për ta rritur atë më pas, duke iu përgjigjur nevojave të kohës.

Po ashtu, LDK-ja do të angazhohet për të ofruar mbështetje të plotë për nivelet komunale për të ngritur numrin e inspektorëve duke trajnuar kuadro të reja, të cilat do të jenë në dispozicion të institucioneve lokale.

#### 14.6 **DIGJITALIZIMI I PLOTË I PROCESIT TË NDËRTIMIT**

Procesi i aplikimit për leje të ndërtimit dhe leje mjedisore vazhdon të shkaktojë shqetësime për të gjithë investitorët, duke implikuar metoda të stërzgjatura, tejkalime të afateve të vendimmarrjes, mostransparencë dhe keqmenaxhim të punës së profesionistëve në administratën publike e, njëkohësisht, duke krijuar mbetje të mëdha të materialeve të printuara dhe zënë hapësira të mëdha për arkivim. Profesionistët e ministrive dhe komunave janë të mbingarkuar me numër të madh të lëndëve për shqyrtim dhe gjatë gjithë kohës ndërpritet procesi për shkak të kontaktit me palët, i cili e ngadalëson vlerësimin e dokumentacionit dhe e kthen në proces shumë subjektiv.

Një qasje e tillë është e papërshtatshme dhe shkakton probleme e vonesa për të gjitha palët e involvuara. Praktikrat rajonale e ndërkombëtare kanë treguar se digjitalizimi i procesit të administrimit dhe monitorimit të lejeve mjedisore dhe atyre të ndërtimit mundësoi eficiencë dhe transparencë të plotë, prandaj Lidhja Demokratike e Kosovës fillimisht do të angazhohet për hartimin dhe aprovimin e legjislacioni për digjitalizim, e më pas në implementimin e gjithë procesit në praktikë. Njëkohësisht do të punohet në ngritjen e sistemit elektronik për pranimin e dokumentacionit, shqyrtimin, komunikimin e vendimmarrjes, monitorimin dhe raportimin e procesit të lejeve, duke filluar nga niveli qendror e duke e shpërndarë më pas edhe në nivelet komunale, duke përdorur shembujt më të suksesshëm ndërkombëtarë për maksimalizim të sistemit dhe gjithëpërfshirje të shërbimeve.

Krijimi i sistemit qendror për menaxhimin e lejeve do të rritë kualitetin e punës dhe do të krijojë efikasitet në vendimarrje e, po ashtu, krijon një databazë qendrore që ndihmon për planifikime afatgjata të zhvillimeve hapësinore, duke lehtësuar procesin e inspektimeve dhe njohjen e gjendjes në terren në kohë reale. Përveç përgatitjes së legjislacionit të nevojshëm dhe sistemit elektronik, LDK-ja do të angazhohet edhe në trajnimin e stafit të administratës publike, për të mbyllur të gjithë ciklin e implementimit dhe raportimit të këtij procesi.

#### 14.7 **LICENCIMI I ARKITEKTËVE DHE INXHINIERËVE**

Për ndryshim prej të gjitha vendeve të rajonit e, normalisht, edhe vendeve të BE-së, Kosova, edhe 23 vite pas luftës vazhdon të ketë të angazhuar në procesin e projektimit e të ndërtimit profesionistë të pa licencuar, të cilët janë vështirë

të menaxhueshëm e të monitorueshëm për veprimtarinë e tyre, e cila i përket profesioneve të rregulluara sipas Ligjit për Profesione të Rregulluara dhe bartin përgjegjësi të lartë publike për shërbimet që ofrojnë.

Licencimi i arkitektëve dhe i inxhinierëve në fushën e ndërtimit është një proces të cilin rregullon ligji, por i cili nuk është përmbyllur ende. Kjo situatë ka shkaktuar kaos në fushën e planifikimit e ndërtimit, duke i dhënë të drejtë personave të pakualifikuar të marrin përsipër projektimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të ndërtimit dhe duke e bërë këtë sektor të shërbimeve të çënueshëm në raport me tregun e punës së vendeve të rajonit.

Lidhja Demokratike e Kosovës do ta avansojë këtë temë me prioritet, duke u mobilizuar që të ngrisë dhe trajnojë strukturat për zhvillimin e avansimin e procesit të licensimit dhe duke krijuar sistemin digjital për mirëmbajtjen e të dhënave të profesionistëve të licencuar, duke barasvlerësuar kategoritë e licensimit, me ato të pranuar ndërkombëtarisht sipas direktivave të BE-së.

Për më tepër, procesi i licensimit të personave fizik dhe juridik të cilët do të hartojnë raportet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM dhe VSM), si kusht për lejedhëniet mjedisore, do të rishqyrtohet dhe digjitalizohet me qëllim të zvogëlimit të dëmit dhe degradimit që i është bërë mjedisit të Republikës së Kosovës, shkaktuar edhe nga një proces jotransparent dhe jofunksional i licensimit ndër vite.

## 14.8 **AMANDAMENTIMI KUSHTETUES PËR MJEDIS TË SHËNDETSHËM**

Mjedis i shëndetshëm duhet të jetë një e drejtë kushtetuese e secilit banor të Republikës së Kosovës. Në kohën kur Green Deal e miratuar nga Bashkimi Europian në vitin 2019 është udhërrëfyese mjedisore i të gjitha vendeve të zhvilluara për vitet në vazhdim, Kosova nuk mund të bëjë përjashtim. Principi themelor i “European Green Deal” mëton t’iu ofroj qytetarëve ajër të pastër, ujë të pastër, tokë pjellore e të shëndetshme dhe biodiversitet.

Për të respektuar nivelin e të drejtës së qytetarëve të Republikës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, Lidhja Demokratike e Kosovës do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm legjislativ që të sigurojë atë me të drejtë kushtetuese. Do të propozohet amandamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht Nenit 52, për të përfshirë edhe të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si një prej të drejtave themelore të njeriut, e rregulluar ndërkombëtarisht me Rezolutën Nr. A/76/L.75 të OKB-së të datës 28.07.2022.

Puna legjislative për implementimin e propozimit do të realizohet në bashkëpunim me ekspertët juridikë (kombëtar dhe ndërkombëtar) dhe konsultimet me publikun dhe palët e interesuara për amandamentin do t’i paraprijnë aprovimit të amandamentit në Kuvendin e Kosovës.

## 14.9 **STANDARDET KOMBËTARE TË MJEDISIT**

Fillimisht do të bëhet vlerësimi i detajuar i zbatimit të politikave dhe standardeve të përcaktuara sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës. Më tutje, do të bëhet propozimi për modifikimin, aprovimin dhe monitorimin e implementimit të

standardeve të propozuara. Orientim programor do të jetë ngritja e standardeve kombëtare ligjore për cilësinë e ujit, ajrit, dheut dhe ruajtjes së biodiversitetit drejt arritjes së standardeve të BE-së.

Do të bëhet analizë e indikatorëve të shkallës së zbatimit të të gjitha strategjive mjedisore sektoriale (ujë, ajër, biodiversiteti, mbeturina, etj.) dhe planeve të veprimit e që do të përfshijë dokumentet në zbatim e sipër, si dhe ato që kanë skaduar e nuk janë reviduar. Studimi mbi shkallën e zbatueshmërisë do të ndikojë në orientimet mbi dokumentet që duhen reviduar dhe ato të skaduara që duhen të pasohen nga dokumentet e reja politike-strategjike, të cilat adresojnë parimet dhe objektivat për zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

LDK-ja do të angazhohet po ashtu për analizën e dokumenteve strategjike, duke përfshirë ekspertizë teknike e profesionale për të përafëruar strategjitë me EU Green Deal. Analiza e përputhshmërisë me EU Green Deal do të adresojë prioritetet për rishikimin e politikave sektoriale mjedisore (ajri, uji, dheu, biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura, mbeturinat dhe ekonomia qarkore, energjia e ripërtitshme, industria e gjelbër, mobiliteti i qëndrueshëm, eko-agrikultura, mbrojtja nga zhurma, eko-turizmi etj.).

Lidhja Demokratike e Kosovës është e përkushtuar për të përfshirë dhe për t'iu përmbajtur principeve të EU Green Deal në programin e saj. Në këtë drejtim, do të angazhojë ekspertizë teknike vendore dhe ndërkombëtare për revidimin e Strategjisë së Mjedisit dhe hartimin e Planit të Veprimit të Kosovës në Mjedis. Ky proces përfshin shumë konsultime intensive me të gjitha palët e interesit dhe me publikun. Do të punohet që strategjinë e re 10-vjeçare ta aprovojë Kuvendi i Kosovës, si dhe Planin 5-vjeçar të Veprimit në Mjedis ta aprovojë qeveria, që do të përcillen me planifikimet buxhetore për zbatim të projekteve prioritare, të cilat garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm.

Nga ligjet respektive, përmes ekspertizës teknike vendore dhe ndërkombëtare, LDK-ja do të angazhohet për të bërë rishikimin e standardeve ekzistuese të ajrit, ujit dhe tokës dhe harmonizimin e tyre me standardet ndërkombëtare për mjedis dhe zhvillim të qëndrueshëm. Standardet e rishikuara do të aprovohen nga Qeveria për zbatim në kushtet socio-ekonomike dhe teknologjike të Republikës së Kosovës.

#### 14.10 **THEMELIMI I EKO-FONDIT**

Brenda mandatit të saj të parë qeverisë, Lidhja Demokratike e Kosovës me ligj të veçantë do të ideojë dhe funksionalizojë Eko-fondin mbi principet e funksionimit të fondeve të ngjashme në Kosovë (p.sh. Fondi për Eficiencën Energjetike, Fondi për sigurimet shëndetësore) dhe praktikave të mira ndërkombëtare mbi fondet ekologjike.

Fondi themeltar për Eko-fondin në themelimin e tij do të jetë 50 milionë euro, nga buxheti i shtetit, ndërsa që më pas ai në baza vjetore do të mirëmbahet nga mjetet financiare të taksave ekologjike, gjobat mjedisore, si dhe donacionet ndërkombëtare. Komunitatet e Kosovës do të përfitojnë nga ky fond; duke stimuluar pjesëmarrje më të madhe për të gjitha ato komuna që kanë projekte efektive të mbrojtjes dhe restaurimit të mjedisit natyror dhe atij të krijuar.



PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TE KOSOVES

# BUJQËSIA









## KONTEKSTI

Kosova ofron kushte të favorshme për zhvillimin e të gjithë sektorëve dhe nënsektorëve bujqësorë. Bujqësia paraqet një segment të rëndësishëm në zhvillimin e gjithmbarshëm, me kontribut prej 7.4% të BPV, por ka premisa të mëdha në rritjen e kontributit të saj në BPV mbi 10%.

Spektori i bujqësisë dominohet nga fermat e vogla, infrastrukturë dhe mekanizëm i vjetruar, rendimente të vogla për njësi të sipërfaqes. Me qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm të sektorit të bujqësisë, duke marrë parasysh potencialin që ka ky sektor dhe mundësinë që të jetë pjesë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të vendit, LDK-ja do të angazhohet fuqishëm për promovimin dhe mbështetjen e sektorit, duke filluar nga prodhimtaria primare, ruajtja, përpunimi dhe tregtimi, si produkte finale. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë do të bazohet në një program për bujqësi të qëndrueshme dhe intensive, strategji për mbrojtjen e prodhimeve vendore, program që mbështet prodhimin, përpunimin dhe punësimin, program që ofron mundësi për orientimin e prodhimit në sektorët në të cilët vendi ka avantazhe në raport me kapacitetin prodhues. Nisur nga fakti që Kosova tashmë është përcaktuar për një të ardhme në BE, ne gjithashtu do të orientohemi që politikat e zhvillimit të bujqësisë të përafrohen me Politikën e Përbashkëta Bujqësore (PPB).

Problemet kryesore të sektorit të bujqësisë lidhen kryesisht me sistemin e ujitjes, me madhësinë e tokave bujqësore, si dhe me mungesën e financimit të drejtpërdrejtë të aktiviteteve bujqësore.

# 15

# PLANI YNË PËR BUJQËSI

Në programin tonë politik, kemi theksuar nevojën për të përmirësuar kushtet e biznesit për fermerët. Për ta bërë këtë, ne kemi paraparë disa masa, siç është rritja e investimeve në bujqësi dhe zhvillimi i tregut të produkteve bujqësore në nivel vendi dhe atë ndërkombëtar. Gjithashtu, kemi planifikuar të rrisim nivelin e edukimit dhe trajnimit të bujqve për të siguruar se ata kanë aftësitë dhe njohuritë që i nevojiten për të menaxhuar biznesin e tyre me efikasitet. Projektet ona kryesore në këtë sektor janë:

## 15.1 SUBVENCIONET BAZUAR NË OUTPUT

Për të përmirësuar strukturën e fermës, rritur produktivitetin e fermave dhe agrobzineseve qeveria brenda mandatit do të kalojë në subencionim nga ajo bazuar në sipërfaqe në formën e bazuar në output. Kjo formë e subencionimit kërkon krijim të kapaciteteve dhe hartimin të qartë të procedurave. Në hartimin e politikave të tilla do të punohet ngushtë me fermerët, pikat grumbulluese dhe përpunuesit e produkteve bujqësore. Programi ynë parasheh rritjen e buxhetit për bujqësi dhe zhvillim rural për 100 milionë euro në katër vitet e ardhshme të qeverisjes. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rritjes së fondit për subvencione për kulturat me potencial për eksport, por edhe të atyre që e zavëndesojnë importin.

Në këtë kontekst, mbështetje do të fokusohet në pemët e imta (mjedra, boronica, aronia, e të ngjashme), bimët mjekuese aromatike (BMA-të), sektori i rrushit-verërave dhe sektori i perimeve, në këtë program, pa dyshim, që përfshihen edhe kulturat me rëndësi strategjike. Në mënyrë që të rrisim aftësinë konkurruese të këtyre nënsektorëve, programi ynë qeverisës parasheh përkrahje të veçantë të këtyre sektorëve prioritar me disa masa. Prodhuesëve dhe përpunuesëve të produkteve bujqësore, qeveria duhet t'u ndihmojë edhe në procesin e certifikimit e produkteve duke e bartë një pjesë të kostos së certifikimit. Kjo masë ka për qëllim rritjen e kualitetit të ushqimit, si dhe rrijen e konkurshmerisë në tregjet vendore e ndërkombëtare.

## 15.2 GRANTET

Qeveria do të vazhdojë me dhënien e granteve në bujqësi me fokus në mbrojtje të kulturave bujqësore sic janë mbulimi i kulturave me rrjeta mbrojtëse kundër breshërit, kapacitet grumbulluese, përpunuese të magzanimit dhe ruajtjes, si dhe grante për pajisje bujqësore.

Fokus i veçantë do t'i jepet reduktimit të plotë të burokracisë në procesin e aplikimit të granteve. Shpeshherë procedurat aplikuese janë jo vetëm të pakuptueshme e të komplikuar, por ata dhe marrin kohë përtej arsyeshmërisë operuese të fermerëve dhe bizneseve përkatëse.

## 15.3 FINANCIMI I NORMËS SË INTERESTI

Sektori i bujqësisë është një nga sektorët me financimin më të ulët nga sektori financiar. FKGK-ja do të ketë një dritare të veçantë për mbulimin e normës së interesit për kreditë që marrin për bujqësi. Kreditë merren nga bankat komerciale, ku rrisin për kthimin e kredisë e marrin vetë ato, vetëm normën e interesit e merr përsipër qeveria përmes një fondi të posaçëm në FKGK.

Kosotoja për vitin e parë do të jetë 5 milionë euro dhe mandej kjo do të rritet, varësisht prej volumit të kredive për bujqësi. Kjo masë nuk i përjashton fermerët edhe bankat që po të njëjtat kredi t'i sigurojnë në FKGK.

## 15.4 HEQJA E AKCIZËS NË NAFTË

Brenda mandatit qeveria do të përgatisë politikën dhe kapacitet për heqjen e plotë të akcizës në naftë për të gjithë fermerët në Kosovë. Kjo masë do të zëvendësojë masën e subencionimit të tanishëm që në parim është një procedurë shtesë burokratike.

## 15.5 CILËSIA E USHQIMIT

Plani ynë parasheh garantimin në shkallën më të lartë të shëndetit të qytetarëve dhe organizimi i sistemit të mbikëqyrjes së sigurisë ushqimore. Ky sistem do të shërbejë për mbrojtjen sa më të mirë të shëndetit të konsumatorëve nga sëmundjet, si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore shpeshherë me origjinë të pakontrolluar. Arritja e objektivave për sigurinë ushqimore do të mundësohet përmes zbatimit të prioriteteve si: a) Funkcionalizimi i laboratorëve aktualë, me qëllim të kryerjes së analizave të nevojshme për mbikëqyrjen e sigurisë ushqimore; b) kontrollimi dhe testimi i vazhdueshëm i ushqimeve që tregtohen në treg të destinuara për konsum njerëzor, si dhe të ushqimeve që përdoren për kafshë; c) Kontrollimi dhe testimi i vazhdueshëm i inpueteve bujqësore (farërave, plehrave dhe pesticideve) që importohen dhe tregtohen në tregun vendor, me qëllim të testimit të përmbajtëse dhe cilësisë së tyre; d) Kalimi i menaxhimit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë; dhe e) Koordinimi dhe harmonizimi i legjislacionit vendor me atë të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore.

## 15.6 SISTEMI I UJITJES

Plani ynë parasheh dyfishimi të sipërfaqes aktuale të tokave bujqësore nën ujitje. Në Kosovë aktualisht ujiten rreth 20 mijë hektarë të tokës bujqësore, apo rreth vetëm 4.8% të sipërfaqes totale të shfrytëzuar për bujqësi. Duke marrë parasysh që bujqësia intensive nuk mund të paramendohet pa ujitje, programi i LDK-së në qeverisjen e ardhshme katër vjeçare do ta ketë prioritet rritjen e sipërfaqeve të tokës bujqësore që mbulohen nga sistemet e ujitjes, me qëllim të rritjes së rendimentit dhe përmirësimit të strukturës së tokës.

Në këtë drejtim, funksionalizimi (rehabilitimi) i kanaleve ekzistuese të ujitjes është një nga masat kryesore që do të ndërmerret. Zgjerimi i rrjetit të ujitjes është një prioritet tjetër i kësaj mase. Investimet infrastrukturore do të fokusohen në zgjerimin e dy sistemeve kryesore të ujitjes, Ibër-Lepencit për mbulimin me sistem të ujitjes të fushave në Rrafshin e Kosovës, dhe Radoniqit për mbulimin me sistem të ujitjes të fushave në Rrafshin e Dukagjinit. Po ashtu parashihet projektimi dhe ndërtimi i sistemeve të reja të ujitjes, duke shfrytëzuar edhe një pjesë të madhe të lumenjve të Kosovës, siç janë: Drini, Lepenci, Ereniku, Lumbardhi, Sitnica, Drenica, Llapi e Morava.

Pilotprojekti për akumulimin e ujit (penda akumuluese), parashihen investime në akumulime të reja të ujit, që do të përdoren për ujitjen e tokave bujqësore, projekti do të realizohet kryesisht përmes shfrytëzimit të fondeve IPA-s.

## 15.7 SIGURIMET BUJQËSORE

Funksionalizimi i plotë i sigurimeve bujqësore dhe përfshirja e fermerëve në skema të sigurimit bujqësorë është projekt me prioritet në planin tonë. Bujqësia njihet si një “hambarë pa kulm” pasi që ballafaqohet me rreziqe të ndryshme nga moti. Ndryshimet globale klimatike vetëm që e kanë vështirësuar zhvillimin e avancimin e bujqësisë, përderisa temperaturat ekstreme kanë shkaktuar humbje të mëdha në vitet e fundit.

Produktet për sigurime bujqësore lansohen nga kompanitë e sigurimit, ajo çka mund të bëjë qeveria është mbulimi deri në 50% i kosotos së sigurimeve të kulturave bujqësore.

Prioritet i programit është funksionalizimi i sigurimeve bujqësore, për të realizuar këtë programi parasheh masat dhe hapat si: a) Hartimin e politikave për subvencionim të sigurimeve; b) Krijimi i Divizionit për Menaxhimin e Rrezikut. (në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë); c) Hartimi i listës së kulturave për të cilat qeveria do të bartë një pjesë të kostos së sigurimit bujqësor.

## 15.8 **PYJET**

Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural, aktiviteteve artizanale, bujtinave dhe ushqimeve tradicionale në zonat rurale dhe malore.

Qeveria do të angazhohet fuqishëm për zhvillimin e biznesit rural dhe aktiviteteve alternative në zonat rurale ku kushtet natyrore imponojnë kufizime për zhvillim të bujqësisë intensive. Prandaj programi ynë do të fokusohet në zhvillimin e aktiviteteve alternative të biznesit rural.

Objektivi i qeverisë së udhëhequr nga LDK-ja është përkrahja me grante investive deri në 80% të vlerës së investimit për zhvillim të biznesit të vogël në viset rurale i bazuar në burimet lokale, me qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës dhe zhvillimit të qëndrueshëm të viseve rurale.

## 15.9 **MBROJTJA DHE SHFRYTZIMI I QËNDRUESHËM I TOKËS BUJQËSORE**

Ndalimi i degradimit dhe ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore dhe stimulimi i fermerëve për shfrytëzimin e tokës bujqësore për prodhimtari.

Do të përmirësohet koordinimi me pushtetin lokal për të marr masa efektive për të ndaluar shkatërrimin e tokës bujqësore e që mund të jenë edhe nga ndotja. Gjithashtu do të përcillet zbatimi rigoroz të infrastrukturës ligjore dhe masat stimuluese për prodhuesit, për të vlerësuar efektin e ruajtjes së tokës. Sipas nevojës, do të ndahen fonde për rregullimin e tokave bujqësore (masat meliorative). Do të ndërmerren masat e nevojshme për vazhdimin e procesit të komasacionit. Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe zonimi i tokave bujqësore. Tatimimi i tokave bujqësore djerrinë dhe Mbrojtja e tokës nga eruzioni.

## 15.10 **MBROJTJA DHE VALORIZIMI I RESURSEVE PYJORE**

Qëllimi i masës: Mbrojtja nga degradimi i resurseve pyjore dhe pyllëzimi i sipërfaqeve të reja. Edhe tek pyjet sikurse të tokat bujqësore, për shkak të mos koordinimit të aktiviteteve në mes komunave dhe pushtetit qendror, vazhdon shkatërrimi i pyjeve dhe tokave pyjore (siç është rasti me gurthyesit). Është e rëndësishme që fillimisht të ndalet prerja e paligjshme dhe të rritet ndërgjegjësimi për rëndësinë e pyjeve dhe të industrisë pyjore. Pyllëzimin e sipërfaqeve të reja do ta trajtojmë si një nevojë urgjente. Prioriteti i veçantë do të jetë edhe ruajtja e pyjeve nga degradimi dhe investimet për gjelbërimin/ripyllëzimin e pyjeve. Do të rishikohet legjislacioni ekzistues, që do të mundësojë shfrytëzim racional të pyjeve, krahas pyllëzimit të vazhdueshëm të sipërfaqeve të reja.

## 15.11 **DIVERSIFIKIMI RURAL DHE KRIJIMI I VENDEVE TË REJA TË PUNËS**

Ka për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale dhe promovimin e shumëllojshmërisë së ekonomisë rurale.



PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

Turizmi rural, zhvillimi i agroturizmit duke mbështetur sektorët bujqësor në zonat malore me efekt të dyanshëm “bujqësi - turizëm”. Prodhimtaria tradicionale, mbështetje të iniciativave të prodhimitarisë tradicionale bujqësore, që do të kenë efekt në punësim të grave në zonat rurale. Prodhimtaria organike, promovimi dhe mbështetje financiare për ngritjen e sipërfaqeve me prodhim organik. Grumbullimi dhe përpunimi i bimëve malore për të targetuar tregun vendor dhe atë evropian.






PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TE KOSOVES

# KULTURA





## KONTEKSTI

Lidhja Demokratike e Kosovës e konsideron dhe e vlerëson kulturën si njërin prej shtyllave themelore të shtetit të Kosovës. Duke qenë urë lidhëse ndërmjet autoktones dhe universale, traditës e kujtesës me të sotmen, kultura përbën thelbin e identitetit të shtetit tonë.

LDK-ja, duke e ndjekur traditën e themeluesve dhe origjinën programore, në programin e saj politik, kulturën e vlerëson si fushë me interes vital për shtetin e Kosovës, përmes së cilës fuqizohet kohezioni i brendshëm dhe njëkohësisht përmirësohet imazhi i shtetit tonë.

Në kontekstin aktual dhe zhvillimet e tanishme në fushën e kulturës në Kosovë, veçanërisht në dy vitet e fundit, aktivitetet janë tejet të vogla, ka ngecje në të gjitha aspektet e organizimit të jetës kulturore. Ka munguar mbështetja e duhur financiare ndaj institucioneve kulturore nacionale, por edhe skenës së pavarur kulturore. Është thelluar shkalla e politizimit të procesit të zgjedhjes dhe emërimit të strukturave drejtuese dhe menaxhuese të institucioneve kulturore dhe këshillave drejtuese.

Centralizimi burokratik i institucioneve qendrore pothuajse e ka paralizuar punën efektive administrative dhe rrjedhimisht krijuese. Mungojnë investimet kapitale në objekte të reja dhe hapësira kulturore. Derisa, po ashtu, mungon një strategji e duhur për zhvillimin dhe promovimin e kulturës si dhe organizimin e funksionalizimin të diplomacisë kulturore.

Duke pasur parasysh problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti artistik, si rezultat i centralizimit të institucioneve kulturore, LDK-ja është e përkushtuar

për pavarësimin e institucioneve kulturore, qëndrueshmërinë dhe pavarësinë buxhetore të tyre; rishikim dhe avancim të legjislacionit në të gjitha fushat e kulturës, në përputhje me standardet më bashkëkohore evropiane, si dhe krijimin e mundësive sa më të mira për funksionimin e tyre.

# PLANI YNË PËR KULTURËN

Plani ynë parasheh qasje proaktive dhe synon zhvillimin dhe promovimin e kulturës dhe artit në nivel nacional dhe ndërkombëtar. Për LDK-në prioritet do të jenë investimet kapitale kulturore, pavarësimi i institucioneve kulturore, si dhe fuqizimi e përkrahja financiare e skenës së pavarur dhe të artistëve.

Njëkohësisht, LDK-ja prioritet me rëndësi do ta ketë po ashtu trashëgiminë kulturore, me theks të veçantë kujdesin për trashëgiminë e hershme dardane, atë materiale dhe shpirtërore. Derisa edukimi i hershëm në sistemin parauniversitar, promovimi dhe ndërkombëtarizimi i kulturës dhe artit, nëpërmjet diplomacisë kulturore, do të jenë pjesë përbërëse e fokusimit të programit për kulturën. Disa nga projektet më të rëndësishme në fushën e kulturës janë:

## 16.1 **TEATRI I OPERAS DHE BALETIT**

Projekti i Teatrit të Operës dhe Baletit “Dr. Ibrahim Rugova” ka një rëndësi të jashtëzakonshme për kulturën dhe artin në vend. Rrjedhimisht, është një nga projektet më të rëndësishme të programit të LDK-së. Ky teatër do të jetë një qendër e vlerave kulturore të vendit, që do të përfaqësojë një hapësirë të rëndësishme për zhvillimin e artit dhe të kulturës.

Ndërtimi i një teatri të kësaj natyre do të kontribuojë në zhvillimin e artit dhe kulturës në Kosovë, duke u bërë një hapësirë për zhvillimin e aktiviteteve artistike, kulturore dhe edukative. Sa i përket ndërtimit fizik, në bashkëpunim me komunën e Prishtinës, është planifikuar edhe hapësira fizike e ndërtimit të saj. Duke u bazuar në ekspertizën e planifikimit urbanistik, hapësira rreth Pallatit të Rinisë plotëson kushtet adekuate për realizimin të një projekti të tillë. Plani ynë parasheh ndarjen e 25 milionë eurove për ndërtimin e projektit në fjalë. Kohëzgjatja e ndërtimit të këtij projekti të rëndësishëm kulturor do të jetë katër vjet.

## 16.2 **NDËRTIMI I OBJEKTIT TË TEATRI KOMBËTAR TË KOSOVËS**

Lidhja Demokratike e Kosovës do të hulumtojë gjetjen e një lokacioni të përshtatshëm për të ndërtuar objektin e ri të Teatrit Kombëtar të Kosovës e më pas për të shpallur konkurs ndërkombëtar për projektimin dhe ndërtimin, sipas standardeve më bashkëkohore të projektimit arkitektonik dhe inxhinierik. Ndërsa ndërtesa aktuale e Teatrit Kombëtar të Kosovës do të shërbejë si godinë e Teatrit të Qytetit të Prishtinës. Rreth 10 milionë do të ndahen për ndërtesën e re të Teatrit Kombëtar. Ky projekt do të realizohet brenda katër viteve.

KULTURA

201

## 16.3 **NDËRTIMI I MUZEUT TË ARTIT BASHKËKOHOR**

Krijimi dhe ndërtimi i Muzeut të Artit Bashkëkohor në Kosovë është një hap i rëndësishëm në zhvillimin e kulturës dhe të artit në vend, meqë aty do të realizohen prezantime dhe promovime të veprave të artistëve bashkëkohorë vendorë dhe ndërkombëtarë. Për ndërtimin e Muzeut të Artit Bashkëkohor, LDK-ja do të bashkëpunojë me nivelin lokal dhe njohësit e planifikimit urban për të identifikuar lokacionin e saktë. Derisa, bashkë me Komunën e Prishtinës, do të përgatisim dokumentacionin për konkursin ndërkombëtar për projektimin e tij. Rreth 10 milionë euro do të jepen për përfundimin e punëve në ndërtimin e Muzeut të Artit Bashkëkohor. Ky projekt do të realizohet brenda katër viteve.

## 16.4 **THEMELIMI I QENDRËS SË LIBRIT**

Lidhja Demokratike e Kosovës e vlerëson si të domosdoshme themelimin e Qendrës së Librit, e cila do të bëhet një referencë dhe shtëpi e rëndësishme e kulturës në Kosovë. Qendra do të krijohet duke u mbështetur në disa shtylla programore, që do të kenë në fokus stimulimin e krijimtarisë letrare dhe leximin; mbështetjen për krijuesit përmes ofrimit të bursave dhe granteve letrare, si dhe ndërmjetësimin e veprimtarinë përkthyesë, përmes krijimit të Fondit të Përkthimit. Po ashtu, nëpërmjet kësaj qendre, LDK-ja mëton të rregullojë statusin e shkrimtarëve të afirmuar, përmes subvencionit të veprimtarisë së tyre dhe sidomos në fushën e pensionimit, duke iu njohur meritat e veçanta, në përkim me modelet e tjera të krijimtarisë artistike.



Qendra do të brenda dy viteve të para të qeverisjes së LDK-së dhe do të shfrytëzohen modelet më të mira evropiane për të bërë një referencë të rëndësishme kulturore nga përfaqësues më me ndikim kulturor brenda dhe jashtë vendit. Ky institucion, po ashtu, synon t'i unifikojë politikën në raport me librin shqip, me Shqipërinë e vendet e tjera ku jetojnë shqiptarët, meqë bëhet fjalë për një veprimtari unike dhe të përbashkët. Rreth 5 milionë do të ndahen për themelimin e Qendrës së Librit.

## 16.5 **THEMELIMI DHE NDËRTIMI I MUZEUT TË PAQES DHE TË REZISTENCËS**

Kosova, në fillim të viteve të 90-ta, përmes shumë lëvizjeve politike, humanitare, shoqërore dhe kulturore u bë një nga tregimet më të rëndësishme politike të kohës. Duke dëshmuar përpara botës vlera të larta politike e humane, unitet, kohezion dhe përkushtim për paqe, kjo periudhë sot përbën njërin nga tregimet më të rëndësishme politike e sociale në historinë e Evropës.

Lidhja Demokratike e Kosovës nëpërmjet themelimit të Muzeut të Paqes dhe të Rezistencës, i cili do të jetë i pari i këtij lloji, do të përfshijë veprimtarinë shoqërore, politike, humanitare të Kosovës gjatë viteve të 90-ta. Përqendrimi i vlerave esenciale të muzeut do të jetë veprimtaria e institucioneve paralele të Kosovës së atëhershme dhe institucioneve të kohës, si Shoqata Humanitare Bamirëse “Nënë Tereza”, Arsimin Paralel dhe Institucionet paralele në përgjithësi.

Muzeu i Paqes dhe i Rezistencës është i një rëndësie të madhe politike, kulturore e identitare, si dhe do të bëhet referencë themelore e shtetit të Kosovës. LDK-ja do të synojë që, nëpërmjet promovimit, ky Muze do të behët qendër e interesimit për turizëm kulturor në vendin tonë. Rreth 10 milionë euro do të ndahen për objektin e muzeut në fjalë.

## 16.6 **PAVARËSIMI I INSTITUCIONEVE KULTURORE NË KOSOVË**

Lidhja Demokratike e Kosovës është e përkushtuar për pavarësimin e institucioneve kulturore, qëndrueshmëri dhe pavarësi buxhetore të tyre; rishikim dhe avancim të legjislacionit në të gjitha fushat e kulturës në përputhje me standardet më bashkëkohore evropiane, për të krijuar mundësi sa më të mira për funksionimin e tyre. Në këtë drejtim, LDK-ja do të ndërmarrë të gjithë hapat për përmbylljen përfundimtare e të suksesshme të pavarësisë buxhetore për institucionet kulturore, në mënyrë që të garantohet pavarësi kompetencash në udhëheqje. Në kuadër të rishikimit dhe avancimit të bazës ligjore, LDK-ja do të hartojë Strategjinë Kombëtare të Kulturës, me një plan veprimi dhjetëvjeçar, që do të shërbejë si bazë për punën dhe veprimtarinë e institucioneve të kulturës.

## 16.7 **TRASHËGIMIA KULTURORE E KOSOVËS**

Baza politike e Lidhjes Demokratike të Kosovës në fushën e Trashëgimisë Kulturore lidhet me Strategjinë Kombëtare të Trashëgimisë 2017-2027, e cila parasheh dhe rregullon këtë fushë me interes vital për Republikën e Kosovës. Fokusi kryesor i LDK-së do të jetë kujdesi për trashëgiminë e hershme dardane, atë materiale dhe shpirtërore, ndërkaq prioritet është funksionalizimi i plotë i Parkut Arkeologjik Ulpiana dhe atij në Dresnik.

Mirëpo, për të shënuar suksese në zbulimet dhe gërmimet arkeologjike, Lidhja Demokratike e Kosovës synon të themelojë Muzeun Arkeologjik. LDK-ja e konsideron si tejet me rëndësi themelimin e Muzeut Arkeologjik të Kosovës dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e punimeve arkeologjike në Kështjellën e Artanës, në lokalitetin arkeologjik në Ulpianë, Dresnik të Klinës, si dhe në lokalitetin arkeologjik ‘Vendenis’, që ndodhet në fshatin Gllamnik të Podujevës, deri sa këto dy lokalitete arkeologjike ta arrijnë statusin “park arkeologjik”. Rreth 8 milionë euro do të jepen për Themelimin e Muzeut Arkeologjik.

## 16.8 QENDRA MULTIFUNKSIONALE PËR ART DHE KULTURË

Në Kosovë një numër i konsiderueshëm i objekteve me vlerë trashëgimore janë të braktisura dhe, për shkak të kohës, rrezikojnë të shkatërrohen. Me qëllim të shndërrimit të tyre në një vlerë të rëndësishme kulturore në vend, Lidhja Demokratike e Kosovës do të krijojë hartën e të gjitha këtyre objekteve në Kosovë e bashkë me qeverisjen lokale dhe komunitetin e artistëve do të projektojë ide kreative për shfrytëzimin e këtyre hapësirave për qëllime kulturore.

Shembulli i një praktikimi të tillë, është ish-ndërtesa e Bibliotekës “Hivzi Sylejmani”, e cila nga një pronë banimi, e ndërtuar më 1948, është shndërruar në Qendër për Praktikë Narrative, me përdorim multifunksional. Ndaj, Lidhja Demokratike e Kosovës në bashkëpunim me komunitetin artistik të komunave përkatëse, synon që t’i rivitalizojë e shndërrojë 10 qendra multifunksionale arti e hapësira performuese për artistë dhe planifikon të investojë 8 milionë euro.

## 16.9 EDUKIMI I HERSHËM PËRMES ARTIT DHE KULTURËS

Në bashkëpunim me Drejtoritë e Arsimit edhe me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, LDK-ja planifikon realizimin e programeve që mundësojnë edukimin e hershëm të fëmijëve/nxënësve përmes artit dhe kulturës. Duke realizuar programe të veçanta jashtëkurrrikulare (shfaqje, koncerte, ekspozita nëpër shkolla, por edhe vizita të organizuara e të rregullta në galeri, teatro, muze, kinema, etj.), synohet që të ndikohet në një edukim të hershëm të fëmijëve në lidhje artin dhe kulturën në përgjithësi, duke i kultivuar në moshë të re, jo vetëm si audiencë, por edhe si artistë potencialë të së nesërme.

Për një edukim të hershëm të nxënësve për artet skenike dhe audio-vizuale dhe për rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore, LDK-ja e vlerëson si të domosdoshme përfshirjen e lëndëve “Artet Skenike dhe audio-vizuale” dhe “Trashëgimia Kulturore e Kosovës” në kurrikulat e shkollave fillore dhe atyre të mesme. Varësisht nga rezultati i analizave paraprake, këto lëndë, fillimisht, mund të fillojnë si pilot-projekte në disa shkolla dhe në disa komuna të përzgjedhura, dhe më pas për t’u bërë obligative në kurrikulën shkollore. Përfshirja e këtyre lëndëve, si lëndë në shkollimin parauniversitar, do të krijonte kushte dhe mundësi, që një pjesë e konsiderueshme e profesionistëve të rinj, të shkolluar brenda dhe jashtë vendit, të angazhoheshin si mësimdhënës në këto lëndë.

PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# ADMINISTRATA PUBLIKE





# ADMINISTRATA PUBLIKE

## KONTEKSTI

Administrata Publike e Kosovës vazhdon të mbetet tejet e politizuar dhe me mungesë të kapaciteteve për të ofruar shërbime cilësore për qytetarët. Administrata është bërë një instrument që siguron punësimin e anëtarëve të partive apo të familjarëve, ose edhe të votuesve potencialë. Kjo qasje ka krijuar një administratë joproporcionale dhe të madhe krahasuar me funksionin dhe detyrat e saj, gjë që pastaj ka tejngarkuar financat publike, por edhe ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarët. Kapacitetet aktuale menaxheriale dhe planifikuese nuk mund të sigurojnë që politikat bazohen në analiza mbi vlerësimin e nevojave apo edhe të shpenzimeve efikase.

Një varg përpjekjesh për të reformuar Administratën Publike kanë dështuar për shkak të mungesë së vullnetit politikë për çuarjen përpara të reformës. Ristrukturimi i ministrive në anën tjetër është bërë pa një analizë të mirëfilltë dhe, përveç që nuk ka ndikuar në rritjen e efikasitetit të qeverisë, ka shkaktuar një varg problemesh në shërbimin civil. Numri i madh i agjencive dhe mënyra e organizimit e funksionimit të tyre, ku shumë agjenci kanë kompetenca të dublifikuara me disa ministri, shkakton kaos dhe mungesë të llogaridhënies dhe përgjegjësisë. Shumë prej tyre kanë shërbyer si mekanizëm punësimi për familjarë dhe militantë të partisë në pushtet. Procesi i racionalizimit të tyre ka ngecur për shkak të vullnetit të munguar politik, mospasjes së një vizioni të qartë dhe paaftësisë së qeverisë për të krijuar një administratë publike moderne dhe efikase.

Shumë prej nismave legjislativë të qeverisë aktuale, përveç që kanë penguar reformën në administratës publike, kanë bërë hapa tutje në rritjen e ndikimit politikë në administratën publike, në veçanti në shërbimin civil. Ligji për

Zyrtarët Publike shënon një hap prapa në depolitizimin dhe qëndrueshmërinë e administratës publike, pasi ka rritur pasigurinë e zyrtarëve publik, në veçanti të menaxhmentit të mesëm. Ky ligj nuk garanton se rekrutimi, ngritja në detyrë dhe shkarkimi nga pozita bëhet në baza meritore.

Ligji i Pagave të Sektorit Publik nuk krijoi kompensim bazuar në meritë duke shkaktuar një dekurajim për të punësuarit në sektorin publik dhe, si rrjedhojë, shumë shërbyes publikë vazhdojnë të braktisin sektorin publikë, sidomos punonjësit e sistemit shëndetësor. Hyrja e ligjit në fuqi është bërë pa përgatitjet e nevojshme, kategorizim të vendeve të punës bazuar në Katalogun e vendeve të punës.

Qeveria aktuale nuk ka një strategji të qartë dhe nuk ka bërë përpjekjet e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve të shërbimit civil. Instituti Kosovar i Administratës Publike (IKAP) nuk i ka kapacitetet e as fondet e mjaftueshme për të ofruar trajnime cilësore dhe të bazuar në hulumtim dhe analizë paraprake të nevojave për trajnime.

Ofrimi i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset ende nuk është i integruar dhe digjitalizuar dhe qytetarët vazhdojnë të presin në radhë nëpër sportele për marrjen e shërbimeve të nevojshme. Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative nuk po zbatohet përdërisa ende nuk kemi një Program për Parandalimin dhe Reduktimin e Barrës Administrative.

# PLANI YNË PËR ADMINISTRATË PUBLIKE

Lidhja Demokratike e Kosovës beson që Administratë pPublike duhet të bazuar në parimet: Përgjegjshmërisë, transparencës, efikasitetit, llogaridhënies, inovacionit dhe bashkëpunimit. Mbi këto parime do të hartojmë Strategjinë për Modernizimin e Administratës, Planifikim dhe Koordinim te Politikave, e cila do të përcaktojë objektivat e qarta për të ndërtuar një administratë efikase, duke rritur edhe transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë, si parime kyçe të një qeverisje të mirë dhe efikase. Strategjia po ashtu do të përcaktojë qartë mekanizmat implementues dhe monitorimin e zbatimit të objektivave të përcaktuara qartë.



## 17.1 STRUKTURA E QEVERISË

Riorganizimi i ministrive në Kosovë do të bëhet në mënyrë të qëndrueshme dhe me qëllim për të arritur një qeverisje më efektive dhe efektive. Mbi të gjitha, riorganizimi i qeverisë do të bëhet me qëllim të implementimit të programit tonë politik.

Fokusi ynë programor dhe, së këndejmi dhe financiar, në energji, në ambient dhe në teknologji informative, kërkon domosdoshëmrisht dhe strukturë organizative përcjellëse në këtë drejtim. Mbi të gjitha, në disa raste, fuzionimet e ministrive kanë dalë të jenë joefikase, së këndejmi ndarja e tyre dhe kthimi në organizim të mëparshëm është i paevitueshëm. Ndër të tjera, fuzioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme me atë të Administratës Publike ka rezultuar të jetë joefikas; sikurse fuzioni i Ministrisë së Infrastrukturës me atë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që ka rezultuar të jetë i panevosjshëm, duke e shndërruar zv/ministrin e njëri ministri në ministër faktit.

Në planin tonë, numri i ministrive do të rritet nga 15, sa janë, në 19. Në praktikë, dy ministri do të ndahen nga bashkimi jofunksional i tanishëm, përkatësisht Administrata Publike nga Punët e Brendshme, si dhe Infrastruktura nga Mjedisi e Planifikimi Hapësinor. Dy ministri do të krijohen të reja, ajo e Energjetikës dhe e Teknologjisë Informative. Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë, ndërsa, do të fuzionohet me Ministrinë e Ekonomisë.

Në planin tonë, organizimi i qeverisë do të jetë si në vijim: 1) Ministria e Punëve të Jashtme; 2) Ministria e Punëve të Brendshme; 3) Ministria e Financave dhe Punës; 4) Ministria e Drejtësisë; 5) Ministria e Mbrojtjes; 6) Ministria e Arsimit dhe Shkencës; 7) Ministria e Kulturës dhe Sportit; 8) Ministria e Infrastrukturës; 9) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; 10) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; 11) Ministria e Shëndetësisë; 12) Ministria e Administratës Publike; 13) Ministria e Pushtetit Lokal; 14) Ministria e Ekonomisë dhe Tregtisë; 15) Ministria e Energjetikës; 16) Ministria e Teknologjisë Informative; 17) Ministria e Integritimit Evropian; 18) Ministria e Zhvillimit Rajonal; 19) Ministria për Komunitete dhe Kthim; 20) Ministria e Familjes dhe Mirëqenies.

## 17.2 SHËRBIME TË INTEGRUARA DHE TË DIGJITALIZUARA

Eliminimi i procedurave përmes platformave të integritit të dhënave do të mundësojë të eliminohen pritjet dhe procedurat për pajisje me dokumente përkatëse, si për qytetarët, ashtu edhe për bizneset me të cilën synohet që aplikimi të bëhet online, duke rritur efektivitetin e shërbimeve. Njëkohësisht do të merren hapa konkretë në reduktimin e lejeve, licencave dhe autorizimeve që nevojiten për aktivitete në vendin tonë, si dhe për reduktimin në maksimum të afateve për to. Krijimi i një platforme për integrimin e të dhënave do të mundësojë një koordinimin me efikas ndërmjet institucioneve, duke integruar të dhënat në një sistem, ne do të kemi një platformë që do të kursejë në kosto, kohë dhe përmirësim të shërbimeve. P.sh pensionistët nuk do të kenë nevojë që të lajmërohen çdo 6 muaj, sepse, përmes sistemit të integruar, ne do të kemi të dhënat për statusin e tyre. Do të konsolidohet Platforma Open Data për të mundësuar që sistemi t'iu sigurojë qytetarëve informata të plota dhe të përditësuara për qeverinë, institucionet, politikën, procedurat, financat (përfshirë

këtu sigurimin e të dhënave në kohë reale mbi të hyrat dhe shpenzimet për të gjitha agjencitë), stafin dhe personelin e administratës publike - përfshirë të dhënat profesionale dhe kualifikimet e tyre. Gjithashtu do të investohet në ngritjen e kapaciteteve të Agjencisë Shoqërore të Informacionit, për të rritur sigurinë dhe mbrojtjen nga sulmet kibernetike.

Shuma investuese për krijimin dhe mirëmbajtjen e platformës do të jetë rreth 80 milionë euro dhe përfshinë të gjitha institucionet shtetërore. Një investimi i tillë, përveç që thjeshtëson dhe lehtëson marrjen e shërbimeve nga ana e qytetarëve dhe bizneseve, gjithashtu mundëson kursime jo vetëm në kohë, por edhe në financa, si për qytetarët, por edhe për institucionet e vendit, (siç është p.sh, kursimi i letrës), duke ndikuar kështu edhe mbrojtje të mjedisit.

### 17.3 **REKRUTIM I CENTRALIZUAR**

Plani ynë qeverisës parasheh ndryshimin e Ligjit të Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit të Administratës Shtetërore. Me ligjin për zyrtarët publikë do të krijohet Këshilli i Rekrutimit, i cili do të menaxhojë gjithë procesin e rekrutimit të shërbyesve civilë. Aplikimi do të bëhet online dhe do të jetë i centralizuar për të gjitha ministritë dhe institucionet varëse të qeverisë. Secilin aplikues që me sukses e kalon procesin e rekrutimit bëhet pjesë e rosterit (regjistrin) nga ku pastaj do të shpërndahen nëpër institucione varësisht nga kërkesa për profilin e caktuar. Ndërsa ngritja në karriere do të bëhet bazuar në vlerësimin e performancës që do të jetë në baza vjetore dhe ndërtimit të kapaciteteve profesionale që lidhen me vendin e punës (ndjekja e trajnimeve, certifikimet e nevojshme dhe të ngjashme).

### 17.4 **NGRITJE E KAPACITETEVE TË SHËRBIMIT CIVILË**

Për të ofruar shërbime sa më cilësore për qytetarët, LDK-ja në vazhdimësi do të investojë në ngritjen e kapaciteteve të shërbyesve civilë. Trajnimet në vendin e punës është një mundësi që do të ofrohet për shërbyesit civilë përmes Institutit Kosovarë për Administratë publike (IKAP). Do të rriten kapacitetet e IKAP-së, përfshi rritjen e fondeve për themelimin e departamentit për hulumtime dhe analiza për nevojën për trajnime. Në çdo fillim viti do të bëjë një analizë të nevojave për trajnime për shërbimin civilë dhe mbi këtë bazë do të hartojë programin e vet të trajnimeve. Qysh në vitin e parë të qeverisjes IKAP-ja do të anëtarësohet në RESPA, që do i ndihmonte IKAP-së të rrisë kapaciteteve e veta dhe cilësinë e trajnimeve që ofron për shërbyesit civilë.

### 17.5 **THEMELIMI I INSPEKTORATIT SHTETËROR**

Aktualisht në Kosovë funksionojnë 30 inspektorate në nivelin qendror, të shpërndarë nëpër institucione të ndryshme pa politika unike, koherente e të koordinuara. Përveç nivelit qendror, në secilën komunë veprojnë drejtori të veçanta të inspektorateve. Në gjithë sistemin e inspektimit, janë të punësuar mbi 630 zyrtarë publikë (mbi 270 në inspektoratet në kuadër të ministrive dhe mbi 360 në drejtoritë e inspektorateve nëpër komuna). Më tej, për shpenzimet e inspektorateve shkojnë mbi 6.7 milionë euro të buxhetit shtetëror (rreth 2 milionë euro në nivelin qendror dhe mbi 4.7 milionë euro në atë lokal).

Përmes Strategjisë për Reformimin e Sistemit të Inspektimeve, ne planifikojmë të bëjmë integrimin e të gjitha inspektorateve dhe krijimin e Inspektoratit Shtetëror nën të cilën do të bëhen inspektime të integruara dhe të specializuara. Centralizimi i gjithë sistemit të inspektimeve qendrore do të mundësojë rritjen e kapaciteteve, duke zvogëluar numrin e punonjësve të administratës dhe duke rritur numrin e inspektorëve, duke koordinuar më mirë punën e tyre dhe kështu duke rritë efikasitetin e punës. Plani ynë po ashtu parashih investime të posaçme në përdorimin e teknologjisë për të centralizuar punën e Inspektoratit. Kjo përfshinë përdorimin e një platforme online, për të koordinuar inspektimet, të ndajë dokumentacionin dhe të sigurojë një rrjedhë të komunikimit midis inspektorëve dhe drejtuesve të tyre. E gjithë kjo do të lehtësojë komunikimin midis inspektorëve dhe drejtuesve të tyre, si dhe mund të ndihmojë në menaxhimin më të lehtë të resurseve. Centralizimi i inspektoratit parashih rishikimin dhe plotësimin ndryshimi e rreth 60 ligjeve dhe një periudhë kalimtare prej dy vitesh pas miratimit të legjislatcionit.

## 17.6 **PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Shumë Institucione shtetërore të Republikës së Kosovës ende vazhdojnë të punojnë në objekte të vjetra apo të marra me qira. Aktualisht institucionet tona paguajnë rreth 12 milionë euro në vit vetëm për qira. Deri në fund të mandatit qeverisës ne synojmë që asnjë institucion shtetëror të mos jetë i vendosur në ndërtesa me qira. Qeveria jonë do të marrë në pronësi disa prej ndërtesa që aktualisht janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, siç është p.sh., ndërtesa e Radio-Kosovës, do bëjë investimet e nevojshme dhe t'i shfrytëzojë këto ndërtesa për akomodimin e institucioneve publike. Synim ynë është gjithashtu që të gjitha institucionet publike të investohet në izolim dhe vendosje e mjeteve efeciente të energjisë, me qëllim kursimin e energjisë, por dhe buxhetit të shtetit.

PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# QEVERISJA LOKALE



RRUGA E RE  
*për Kosovën*



# QEVERISJA LOKALE

## KONTEKSTI

Njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat. Për Lidhjen Demokratike të Kosovës vetëqeverisja në kuadër të pushtetit lokal është një nga prioritetet themelore dhe bazë për ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Kosovës.

Me programin e Lidhjes Demokratike të Kosovës për Qeverisjen Lokale përfshihen përgjegjësitë sipas parimeve të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale (KEVL), me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase dhe sa më afër qytetarëve.

Shërbimet momentale që ofrohen ndaj qytetarëve në një masë të konsiderueshme janë mjaft burokratike, jo efektive dhe me kosto mjaft të lartë institucionale. Burimet njerëzore nuk janë të motivuara për punë, në disa sektorë ka mungesë të kapaciteteve njerëzore profesionale, të cilat reflektojnë shumë në cilësinë e proceseve të planifikimit hapësinor, menaxhimit të zbatimit të projekteve infrastrukturore etj.

Komunat në Kosovë përballen në vazhdimësi me infrastrukturë të vjetruar teknike, me sisteme të brishta qeverisëse, të pareformuara konform nevojave dhe llojit të shërbimeve, pjesërisht të dixhitalizuara, si dhe mbi të gjitha shumë të kufizuara në ushtrimin e aktiviteteve zhvillimore.

Qeveria aktuale e Republikës së Kosovës nuk ka ndonjë plan të reformimit të sistemeve të vetëqeverisjes lokale. Ajo madje, përmes ministrive të ndryshme dhe agjencive rregullatorë, është duke centralizuar disa shërbime dhe aplikon kritere jo të barabarta në ndarjet buxhetore.

Vetëqeverisja lokale duhet të jetë një pushtet autonom i ofrimit të shërbimeve përmes sistemeve të reformuara konform nevojave dhe përgjegjësive të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (nenet: 12,123 dhe 124) dhe me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale - Pjesa I, specifikisht sipas elementeve të deklaruara në preambulen e KEVL, si: kontributi jetik i vetëqeverisjes lokale për demokracinë, administrimin efektiv dhe decentralizimin e kompetencave; roli i rëndësishëm i organeve vendore në ndërtimin e shtetit; dhe nevoja e organeve vendore që të zgjidhen në mënyrë demokratike dhe të gëzojnë autonomi të gjerë.



# PLANI YNË PËR QEVERISJE LOKALE

Për avansimin e shërbimeve që ofrohen nga pushteti lokal, programi ynë parasheh intervenime reformuese në disa nivele dhe procese të shërbimeve administrative, duke përfshirë: fuqizimin e kompetencave vetanake; decentralizimin e përgjegjësive të caktuara që shërbejnë në fuqizimin e shërbimeve lokale; fuqizimin e vendimmarrjes së komunave, llogaridhënies dhe efikasitetit të shërbimeve; si dhe dixhitalizimin e sistemeve të brendshme administrative dhe të shërbimeve ndaj qytetarëve. Në veçanti, projektet konkrete të planit tonë janë:

## 18.1 PROGRAMI KOMBËTAR PËR QEVERISJE LOKALE

Programi ynë për vetëqeverisje lokale, prioritet themelor ka fuqizimin e komunave në aspektin e kompetencave vetanake, qëndrueshmërisë financiare dhe fuqizimin e autonomisë për menaxhimin e financave publike, rritjes së transparencës dhe të logaridhënies.

Çështje mjaft themelore për komunat është fuqizimi i rolit të tyre në menaxhimin e pronave publike, duke ua kaluar edhe pronat e AKP-së, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve me interes publik. Lidhur me këte, do të përcaktohen procedura më të thjeshta për menaxhimin e pronave publike, si dhe komunave iu barten përgjegjësitë e plota ligjore për menaxhimin e tyre në përputhje me kompetencat e përcaktuara me nenin 123.3 dhe 124.1 të Kushtetutës dhe me Nenin 4 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Po ashtu, fokus i veçantë do t'i jepet dhe përcaktimit të kompetencave vetanake dhe fuqizimi i Komunave për menaxhimin e ndërmarrjeve publike komunale dhe rajonale, si dhe bartja e përgjegjësisë ligjore për ujë të pijshëm, çështjet e mbrojtjes së mjedisit etj. konform përgjegjësisë të përcaktuara me Nenin 123.3 dhe 124.1 të Kushtetutës dhe Nenin 4 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Komunat do të kenë përgjegjësi të plotë ligjore në menaxhimin e arsimit, shëndetësisë, planifikimit hapësinor etj., në përputhje me parimet e përcaktuara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe me Nenin 123.3 dhe 124.1 të Kushtetutës dhe Nenin 4 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

## 18.2 GRANTI I INVESTIMEVE KAPITALE

Me qëllim të parandalimit të ndikimeve politike nga niveli qendror në atë lokal, do të synojmë pavarësinë sa më të madhe financiare të komunave nga niveli qendror. Po ashtu, nëpërmjet planifikimit më të mirë do të eliminojmë dhe preferencat përkatëse varësisht nga mandatet qeveritare, që krijojnë më pas detyrime afatgjata për Republikën e Kosovës.

Programi ynë për vetëqeverisje lokale, prioritet themelor ka fuqizimin e komunave në aspektin e kompetencave vetanake, qëndrueshmërisë financiare dhe fuqizimin e autonomisë për menaxhimin. Do të krijohet granti specifik për investime kapitale në komuna, si grant i 4-të në përputhje me Nenin 123.3 dhe 124.1 të Kushtetutës dhe Nenin 4 dhe 9 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Ky grant do të menaxhohet në mënyrë autonome nga komuna, me qëllim që të rritet efikasiteti në realizimin e projekteve dhe të tejkalohen barrierat administrative me organet e nivelit qendror.

Projektet investive do të përcaktohen në përputhje me prioritetet strategjike të përcaktuara me dokumentet planore të komunave. Ndërlidhur me këtë do të forcohet transparenca e komunave, përgjegjësia dhe llogaridhënia. Ky decentralizim do të ketë ndikim në menaxhimin më efikas të procedurave për realizimin e projekteve me kohë më të arsyeshme dhe cilësinë e nevojshme teknike.

### 18.3 **VENDIMARRJA KOMUNALE**

Do të bëhet ndryshimi i legjislacionit për qeverisjen lokale, duke përvetësuar në tërësi parimet bazë të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe duke përcaktuar qartë marrëdhëniet ligjore ndërmjet organeve të nivelit qendror dhe organeve të pushtetit lokal. Do të bëhet rishikimi i kompetencave të zgjeruara të komunave në fushën e trashëgimisë kulturore.

Do të synohet po ashtu thjeshtësimi i procedurave për partneritet publiko privat. Komunitat ndeshen me pengesa të mëdha për arsye të procedurave aktuale në zhvillimin e PPP-së, andaj ato duhet të thjeshtësohen dhe shkurtohen me qëllim të fuqizimit të rolit vendimmarrës të komunave dhe llogaridhënies.

Fuqizimin e rolit vendimmarrës të komunave për përgjegjësitë ligjore, që kanë duke hequr rolin e konfirmimit të ligjshmërisë së akteve të komunave është po ashtu i domosdoshëm; meqë e njëjta praktikë sot për sot cenon autonominë e vendimmarrjes së komunave në njërën anë, ndërsa në anën tjetër suspendon parimin e dy shkallshmërisë në procesin e vendosjes administrative.

### 18.4 **RISHIKIMI FUNKSIONAL**

Kosova, si një shtet i ri, është u përballur me sfidat dhe mundësitë e vetëqeverisjes. Në qendër të kësaj sfide është roli dhe funksionaliteti i komunave. Ndërsa ato shërbejnë si institucione të vijës së parë që ndërveprojnë me qytetarët, ofrojnë shërbime publike dhe formësojnë zhvillimin lokal, diversiteti në madhësinë e tyre, përbërjen demografike dhe specifikat gjeografike kërkon një rishikim funksional gjithëpërfshirës. Një rishikim i tillë, i bazuar në të dhënat empirike dhe praktikën më të mira, mund të krijojë sisteme qeverisjeje më efikase, të barabarta dhe të përshtatura.

Pra, komunitat e Kosovës ndryshojnë shumë në karakteristikat e tyre. Disa janë qendra urbane me popullsi të dendur me nevoja komplekse për ofrimin e shërbimeve, ndërsa të tjerat janë kryesisht rurale, duke u përballur me sfida krejtësisht të ndryshme që lidhen me bujqësinë, përdorimin e tokës ose infrastrukturën rurale. Disa komuna janë gjeografikisht të shtrira me popullsi të shpërndarë dhe të tjera, të vogla por me popullsi të përqendruar. Një qasje e vetme për të gjithë për qeverisjen komunale, në këtë mënyrë, jo vetëm që pengon ofrimin efikas të shërbimeve, por gjithashtu humbet mundësitë dhe sfidat unike që paraqet secila komunë.

Në sistemin e tanishëm, të gjithak, përjashtuar kryeqytetin, kanë organizim dhe trajtim të njëjtë. Ndonëse jo të gjitha janë të njëjta. Ndonëse, për shembull, Komuna e Prizrenit dhe ajo e Dragashit janë në një territor të njëjtë, ato kanë karakteristika diametralisht të ndryshme. Kategorizimi i tyre do të ndihmonte fuqizim më adekuat të tyre. Le të themi, Komunitat turistike do të merrni fonde të turizmit; Komunitat e mëdha, do të merrnin fonde infrastrukturore; Komunitat me karakteristika bujqësore fonde përkatëse bujqësore.

Nevoja për një rishikim funksional lind nga disa faktorë kritikë:

a) Alokimi i burimeve: Ekziston një pabarazi e dukshme në alokimin e burimeve nëpër komuna. Pa një kategorizim të qartë bazuar në madhësinë, demografinë dhe gjeografinë, disa komuna mund të kenë burime të tepërta, ndërsa të tjerat nën burime. Kjo pabarazi mund të çojë në joefikasitet dhe pakënaqësi tek qytetarët që e perceptojnë shpërndarjen si të padrejtë.

b) Shërbimet e përshtatura: Komuna të ndryshme kanë nevoja të ndryshme. Qendrat urbane mund të kenë nevojë për një fokus në transportin publik, strehimin dhe kontrollin e ndotjes, ndërsa bashkitë rurale mund të kenë prioritet mbështetjen bujqësore, rrugët rurale dhe tregjet lokale. Duke i kategorizuar komunat në bazë të specifikave të tyre, bëhet e mundur që shërbimet dhe strategjitë të përshtaten me nevojat aktuale të komuniteteve.

c) Përfaqësimi dhe pavarësimi: Bashkitë më të mëdha, për sa i përket popullsisë, mund të kenë nevojë për një strukturë përfaqësuese të ndryshme nga ato më të voglat. Shkalla e autonomisë dhe kompetencave vendimmarrëse gjithashtu mund të ndryshojnë. Një rishikim funksional mund të udhëzojë kuadrin ligjor, duke siguruar që përfaqësimi të jetë i barabartë dhe që komunat të kenë autonominë e nevojshme që i përshtatet madhësisë dhe sfidave të tyre.

d) Bashkëpunimi Ndërkomunal: Komunat fqinjë me karakteristika të ngjashme mund të përfitojnë nga shërbimet e përbashkëta ose projektet bashkëpunuese. Një rishikim funksional mund të identifikojë sinergji të tilla, duke çuar në kursime të kostos dhe ofrim më efikas të shërbimeve.

e) Ngritja e kapaciteteve: Komunat më të vogla mund të përballen me sfida në tërheqjen e burimeve njerëzore të kualifikuara ose mund të mos kenë kapacitet për menaxhim kompleks të projekteve. Duke kategorizuar komunat, mund të iniciohen përpjekje të synuara për ndërtimin e kapaciteteve, duke siguruar që secila komunë, pavarësisht nga madhësia apo demografia e saj, të funksionojë në potencialin e saj optimal.

Mbi këto karakteristika, kategorizimi i komunave mund të bëhet në disa kritere. Ndër to, më specifiket janë:

a) Kategorizimi i bazuar në madhësi: Komunat mund të kategorizohen si të vogla, të mesme ose të mëdha bazuar në sipërfaqen e tyre të tokës. Kjo do të përcaktonte alokimin e burimeve për infrastrukturën, planifikimin e përdorimit të tokës dhe zhvillimin hapësinor.

b) Kategorizimi demografik: Dendësia e popullsisë, demografia e moshës dhe tregues të tjerë socio-ekonomikë mund të udhëheqin kategorizimin. Kjo mund të informojë politikat që lidhen me shërbimet publike, arsimin, shëndetin dhe kujdesin social.

c) Kategorizimi gjeografik dhe topografik: Komunat mund të jenë në rajone malore, fusha ose zona kufitare. Çdo gjeografi paraqet sfida unike - nga çështjet e lidhjes në rajonet malore deri te tregtia ndërkufitare në zonat kufitare.

Si përfundim, rishikimi funksional i komunave në Kosovë nuk është vetëm një ushtrim burokratik; është një hap themelor drejt qeverisjes së decentralizuar, efektive dhe të përgjegjshme. Duke kuptuar dhe respektuar veçantinë e secilës komunë, ndërkohë që sigurohet se ato janë të pajisura për të adresuar sfidat e tyre, Kosova mund të hapë rrugën për zhvillim holistik dhe gjithëpërfshirës në mbarë vendin. Një rishikim i tillë, i mbështetur nga kategorizimi ligjor, nuk është vetëm i nevojshëm, është imperativ për të ardhmen e kombit.

PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# MËRGGATA





## KONTEKSTI

Diaspora e Kosovës, e shpërndarë nëpër kontinente, është një dëshmi e qëndrueshmërisë, përshtatshmërisë dhe aspiratave të popullit tonë. Gjatë dekadave të fundit, faktorë të ndryshëm socio-politikë kanë katalizuar valët e emigrimit nga Kosova, duke çuar në një diasporë që sot, potencialisht, tejkalon popullsinë vendase të vendit. Ky komunitet i gjerë dhe i larmishëm, duke filluar nga migrantët për punë të gjeneratave të kaluara e deri te profesionistët e arsimuar të kohëve të fundit, ka një potencial të pashfrytëzuar që mund të jetë thelbësor për të ardhmen e Kosovës.

Ekonomikisht, roli i diasporës tashmë është evident dhe domethënës. Remitancat, e dërguara në shtëpi nga mërgimtarët, përbëjnë një shtytje jetësore vendimtare për shumë familje kosovare dhe shërbejnë si një injektim jetik i kapitalit në ekonominë e vendit. Por, përtej remitancave, qëndron një spektër më i gjerë mundësish ekonomike. Shumë në diasporë kanë arritur sukses të konsiderueshëm në fushat e tyre përkatëse, nga sipërmarrja dhe teknologjia tek artet dhe Akademia. Duke nxitur një mjedis të favorshëm për investime dhe bashkëpunim, Kosova mund të shfrytëzojë diasporën e saj, për të tërhequr investime të huaja direkte, partneritete teknologjike, madje edhe për të stimuluar turizmin. Për një vend që synon të diversifikojë ekonominë e vet dhe të vendoset në tregun global, diaspora mund të shërbejë si një kanal, duke e lidhur Kosovën me rrjetet, tregjet dhe mundësitë ndërkombëtare të biznesit.

Edukimi dhe transferimi i aftësive dallohen si një fushë tjetër premtuese. Një pjesë e konsiderueshme e diasporës përbëhet nga individë që kanë marrë arsim dhe trajnim në institucione të njohura botërore ose kanë shkëlqyer në mjediset e korporatave globale. Me krijimin e programeve të shkëmbimit të njohurive,



iniciativave të mentorimit dhe sipërmarrjeve bashkëpunuese akademike, Kosova mund ta shfrytëzojë këtë rezervuar të ekspertizës. Ndërveprime të tilla jo vetëm që mund të ngrisin standardet arsimore brenda Kosovës, por edhe të frymëzojnë një brez të ri të nxënësve, novatorëve dhe liderëve.

Kulturarisht, diaspora luan një rol të dyfishtë: ruajtjen e traditave kosovare dhe integrimin e tyre në vendet ku jetojnë. Ky shkëmbim kulturor mund të jetë një mjet i fuqisë së butë për Kosovën. Ndërsa diaspora prezanton trashëgiminë kosovare në mbarë botën, ajo krijon rrugë për turizëm kulturor, bashkëpunime artistike dhe një imazh pozitiv global për Kosovën.

Politikisht, ndikimi i diasporës është i shumanshëm. Në skenën ndërkombëtare, ata kanë qenë avokatë të vendosur për Kosovën, duke mbledhur mbështetjen për njohjen e saj dhe duke tërhequr vëmendjen ndaj sfidave dhe aspiratave të saj. Brenda vendit, mund të jenë burim idesh progresive, duke mbrojtur reformat dhe duke ofruar perspektiva të rafinuara nga përvojat e tyre globale.

Megjithatë, realizimi i këtij potenciali kërkon më shumë se njohje pasive. Ai kërkon angazhim aktiv, politika të përshtatura për të përfshirë dhe për të përfituar diasporën dhe përpjekje të vazhdueshme për të forcuar lidhjen mes tyre dhe atdheut. Sfidat, të tilla si pengesat burokratike në biznes, çështjet e shtetësisë së dyfishtë dhe sigurimi i përfaqësimit të tyre, duhet të adresohen.

Në thelb, diaspora e Kosovës është më shumë se një komunitet jashtë vendit; është një zgjatim i kombit. Ky komunitet, me përvojat, aftësitë dhe lidhjet e tij të ndryshme, mund të luajë një rol transformues në rrugëtimin e Kosovës. Duke vlerësuar dhe integruar diasporën në narrativën zhvillimore të vendit, Kosova jo vetëm që pranon migrimet e saj të kaluara, por gjithashtu po mbjell farat për një të ardhme bashkëpunuese dhe të begatë. Është një marrëdhënie simbiotike, ku Kosova dhe diaspora e saj mund të përfitojnë dhe potenciali kolektiv është i pakufishëm.

# PLANI YNË PËR DIASPORËN

Ruajtja, zhvillimi dhe kultivimi i identitetit të pjesëtarëve të diasporës, do të jetë objektiv i LDK-së, për pjesëtarët e diasporës. Përmes programeve të veçanta edukativo-arsimore, do të synohet ruajtja dhe zhvillimi i gjuhës amtare te të gjithë brezat që jetojnë jashtë vendit. Planet tona janë:

## 19.1 **THEMELIMI I AGJENCISË PËR DIASPORË**

Dikasteri i Diasporës do të shkëputet nga Ministria e Punëve të Jashtme, siç është aktualisht. Parashihet që të ketë një administratë të zvogëluar, që do të funksionojë si agjenci në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, duke bërë që marrëdhëniet me diasporën e Kosovës nëpër botë të trajtohen me prioritet.

## 19.2 **MËSIMI SHQIP**

Si pjesë e angazhimit tonë për mërgatën, do të synohet fuqizimi i mësimit plotësues shqip. Aktualisht, pjesa më e madhe e mësimit plotësues organizohet në baza vullnetare. Do të studiohet në veçanti modeli i mësimit online, nëpërmjet organizimit të klasëve nga Kosova, për fëmijët shqiptarë në mërgatë. Në këtë formë, do të arrihet edhe gjithëpërfshirje më e madhe, por njëkohësisht edhe kontroll më substancial në kurikulën e mësimit plotësues shqip.

## 19.3 **KORNIZA E INVESTIMEVE NGA DIASPORA**

Kosova ndodhet në majë të transformimit ekonomik. Diaspora, me lidhjet e saj globale të biznesit dhe potencialin kapital, është një gur themeli i këtij rrugëtimi. Lidhja Demokratike e Kosovës, duke e njohur rolin kryesor të diasporës sonë në sixhadenë ekonomike të vendit, propozon Kornizën e Investimeve dhe Biznesit të Diasporës (DIBF). Kjo iniciativë gjithëpërfshirëse do t'i japë përparësi reduktimit të proceseve të investimit, duke ofruar gjithashtu stimuj tërheqës. Përfitimet tatimore të përshtatura për investimet e diasporës do të sigurojnë rrjedhje më të mirë të kapitalit, ndërsa një tavolinë e dedikuar mbështetëse do të ofrojë udhëzime në çdo fazë, nga regjistrimi i biznesit deri tek lundrimi në nuancat e tregut vendor. Nëpërmjet DIBF-së, ne parashikojmë një simbiozë harmonike ku diaspora, ndërkohë që korr fitime konkurruese nga investimet e saj, luan gjithashtu një rol të drejtpërdrejtë në stimulimin e rritjes ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Duke e pozicionuar Kosovën në mënyrë të favorshme në skenën e biznesit global dhe duke siguruar që pengesat që dikur mbytn investimet e diasporës janë eliminuar, ne synojmë të ndërtojmë një urë ekonomike nga e cila përfiton kombi dhe diaspora e tij.

## 19.4 **SHKËMBIMI I NJOHURIVE**

Dija dhe ekspertiza janë ndër pasuritë më të mëdha të diasporës sonë. Shumë prej tyre kanë shkallëzuar shkallët e akademisë globale dhe hierarkive të korporatave. Lidhja Demokratike e Kosovës beson se ky rezervuar i dijes duhet të jetë në dobi të atdheut tonë. Prezantimi i Programit të Shkëmbimit dhe Mentorimit të Njohurive (KEMP), një platformë ku profesionistët dhe akademikët e diasporës bashkëpunojnë me institucionet kosovare. Përmes leksioneve të ftuar, punëtorive dhe iniciativave të mentorimit, KEMP-i synon të futë praktikat më të mira globale në sferën tonë akademike dhe profesionale. Ne parashikojmë një të ardhme ku një student në Prishtinë fiton njohuri nga një studiues kosovar në Silicon Valley dhe një startup në Kosovë bashkëpunon me një sipërmarrës kosovar në Evropë. Duke nxitur këtë ekosistem të njohurive, ne synojmë jo vetëm të ngrisim standardet, por edhe të frymëzojmë gjeneratën e ardhshme të novatorëve, mendimtarëve dhe liderëve në Kosovë.

## 19.5 AMBASADORËT KULTURORE

Kultura është shpirti i një kombi. Për diasporën kosovare është edhe një lidhje me rrënjët e tyre. Përderisa ata kanë përqafuar kulturat globale, thelbi i Kosovës mbetet i rrënjësor. Lidhja Demokratike e Kosovës synon ta përforcojë këtë thelb përmes Iniciativës së Ambasadorit Kulturor (CAI). Duke mbështetur ekspozitat kulturore të udhëhequra nga diaspora jashtë vendit, qofshin ekspozita arti, festivale muzikore apo ngjarje kulinarie, CAI kërkon të vendosë trashëgiminë e pasur të Kosovës në hartën botërore. Përtej festimeve të thjeshta, këto ngjarje do të shërbejnë si kanale për shkëmbimin kulturor dhe turizmin. Kur një valle kosovare luhet në Nju-Jork ose një pjatë tradicionale e shijuar në Berlin, nuk është thjesht një ngjarje; është një deklaratë e pasurisë dhe diversitetit kulturor të Kosovës. Përmes CAI-së, ne synojmë të nxisim ambasadorët kulturorë globalë që bartin frymën e Kosovës kudo që shkojnë.

## 19.6 POLITIKAT INTEGRUESE DHE TË KTHIMIT

Kthimet në shtëpi janë të thella. Shumë në diasporën tonë, në faza të ndryshme të jetës, mendojnë të kthehen në rrënjët e tyre. Për të siguruar që ky kthim të jetë i qetë dhe shpërblyes, Lidhja Demokratike e Kosovës prezanton Politikën e dedikuara për Integrimin dhe Kthimin e Diasporës (DIRP). Pavarësisht nëse është një kthim i përkohshëm apo një lëvizje e përhershme, DIRP-ja do të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse, nga vendosjet e punës dhe mundësitë e biznesit deri te programet e riintegrimit kulturor. Stimujt e veçantë për profesionistët e aftë synojnë ta bëjnë Kosovën një hapësirë pune tërheqëse. Duke shfrytëzuar aftësitë, përvojat dhe perspektivat globale të diasporës së rikthyer, ne synojmë të katalizojmë sektorë, si: teknologjia, akademia dhe artet. Përmes DIRP, Kosova nuk po i mirëpret vetëm fëmijët e saj në shtëpi; po përqafton një të ardhme të pasuruar nga përvojat e tyre globale.

## 19.7 DIASPORA NË KOSOVË

Organizimi i aktiviteteve edukativo-arsimore, me tema që do të jenë në funksion të edukimit të fëmijëve të diasporës sikurse, ekskursionet mësimore, kuizet e diturisë, festivali i fëmijëve të Diasporës, me qëllim që të krijohen ura lidhëse ndërmjet diasporës dhe Kosovës. Organizimi i ekskursioneve mësimore në Kosovë është i rëndësishëm dhe ndikon drejtpërdrejt te nxënësit në diasporë, u mundëson njohjen me Kosovën, pastaj thellimin e njohurive për identitetin e tyre, kulturën, historinë e vendit të tyre dhe, para së gjithash, mësimin e gjuhës amtare në shkollë. Gjatë qëndrimit në Kosovë, nxënësit do të vizitojnë vende, qytete, shkolla dhe monumente të ndryshme kulturore dhe historike në Kosovë, Shqipëri dhe në Maqedoni, Malin e Zi. Ekskursioni ka karakter njohës mësimor dhe zhvillohet brenda 3-5 ditëve.

## 19.8 BASHKËPUNIMI ME SHOQATAT SHQIPTARE

Shoqatat kulturore luajnë një rol thelbësor në ruajtjen e identitetit kulturor dhe kombëtar. LDK-ja do të angazhohet që të thellojë bashkëpunimin me shoqatat shqiptare në diasporë, të fuqizojë komunitetin përmes projekteve të përbashkëta me qëllim që të avansojë vlerat shoqërore që ta bëjë faktor të rëndësishëm diasporën tonë. Duke pasur parasysh nevojën e rritjes së prezencës institucionale në mesin e shoqatave shqiptare që veprojnë në diasporë në afirmimin e gjuhës, kulturës, traditës dhe historisë së kombit në mesin e brezave


të rinj, krijimi i një rrjeti të organizatave rinore në Diasporë, shihet si më se e nevojshme. Po ashtu LDK-ja do të përkrahë kandidatët e diasporës që garojnë për asamble komunale në rrethet ku jetojnë për të mirën e komunitetit shqiptar, pa marrë paraysh me cilin subjekt politik do të garojnë.

PROGRAMI POLITIK I  
LIDHJES DEMOKRATIKE  
TË KOSOVËS

# TREGTI DHE INDUSTRI









# TREGTI DHE INDUSTRI

## KONTEKSTI

Edhe pas mëse dy dekadave pas përfundimit të luftës, Kosova mbetet ndër ekonomitë më të varfëra të rajonit pavarësisht potencialit të saj zhvillimor. Deindustrializimi i viteve 1990, si dhe pasojat shkatërruese të luftës gjatë viteve 1998-1999 bënë që Kosova të hyjë në mileniumin e ri në një gjendje të rëndë ekonomike e sociale. Në mungesë të kapaciteteve industriale, periudha e rindërtimit gjatë dekadës së parë të pasluftës u karakterizua me aktivitet ekonomik pa ndonjë vlerë të shtuar kryesisht të mbështetur në konsum, remitenca, shpenzime qeveritare, si dhe ndihma ndërkombëtare.

Zhvillimi ekonomik fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite mbështetet në një model të reduktuar kryesisht në konsum ndërsa shumë pak në investime e prodhim. Për më tepër, deficitit tregtar gjithnjë e në rritje, si rezultat i bazës së ulët eksportuese, ka qenë dhe mbetet një nga sfidat më të mëdha ekonomike në vend. Sa për ilustrim, deficitit tregtar në vitin 2022 arriti pothuajse në 5 miliardë euro. Mungesa e një modeli ekonomik që do të eksploatonte potencialin industrial dhe përparësitë krahasuese të Kosovës kanë minuar mundësitë për zhvillim dhe rritje solide gjatë gjithë kësaj periudhe.

Gjatë dy dekadave të fundit ekonomia është rritur mesatarisht për 4% në vit, rritje kjo e pamjaftueshme për t'i adresuar sfidat socio-ekonomike dhe për të garantuar mirëqenie të gjithmbarshme. Pavarësisht faktit që vitet e fundit struktura e rritjes ka pësuar ndryshime të cilat shpërfaqin një rol të shtuar të investimeve private, prodhimit dhe eksporteve në rritjen ekonomike, problemet aktuale strukturore mbeten pengesë për një rritje të përshpejtuar dhe të qëndrueshme. Gjithashtu, politika aktuale tregtare fatkeqësisht nuk e

ka përcjellë ritmin e zhvillimeve në disa industri specifike në vend, duke i lënë prodhuesit vendorë në mëshirë të masave diskriminuese në tregjet eksportuese.

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të eksportuesve për penetrimin e tregjeve të reja, trajtimi jo i barabartë i tyre në ato tregje ka bërë që ta humbasin aftësinë e tyre konkurruese. Përmes një politike ekonomike në funksion të tregut dhe biznesit, programi i Lidhjes Demokratike të Kosovës synon transformimin ekonomik të bazuar në zhvillim industrial dhe rritje të eksporteve.

# PLANI YNË PËR TREGTI E INDUSTRI

Lidhja Demokratike e Kosovës në mënyrë sistematike dhe proaktive do të angazhohet për përkrahjen e sektorit privat si bazë për zhvillimin e mirëfilltë industrial dhe për të garantuar përshejtimin e rritjes ekonomike dhe konvergimit sa më të shpejtë në nivelin e mesatares së Bashkimit Evropian. Më konkretisht, LDK-ja do të punojë për një qeverisje të përgjegjshme, në përputhje me praktikën më të mirë, për ta bërë ekonominë e Kosovës konkurrense në nivel rajonal dhe global. Pra, duke krijuar parakushtet esenciale për eksploatim të potencialit ekonomik, programi i LDK-së do të jetë gurthemeli i një ndryshimi paradigmatic, që do të garantojë rritje ekonomike solide dhe ngritje të gjithmbarshme të mirëqenies socio-ekonomike në vend.

Duke u nisur nga sfidat e lartpërmendura dhe problemet strukturore me të cilat ballafaqohet vendi, Lidhja Demokratike e Kosovës, në kuadër të programit për industri dhe tregti, ndër prioritetet kryesore do të ketë a) forcimin e sektorit privat si parakusht për forcimin dhe rritjen e kapaciteteve industriale; b) rritjen e eksporteve dhe uljen e deficitit tregtar në vend; c) forcimin e rolit të misioneve diplomatike në funksion të përkrahjes së bizneseve eksportuese; d) uljen e barrierave në të bërit biznes, qoftë në lehtësimin e tregtisë së brendshme apo edhe asaj të jashtme; e) hapjen e tregut me vende dhe rajone përtej kontinentit Evropian; f) forcimin e lidhjeve mes komunitetit të biznesit në diasporë dhe atij vendor, dhe g) reformën e nevojshme institucionale për të garantuar rregulla të lojës dhe trajtim të barabartë në treg për të gjithë.

Për të realizuar programin e saj të zhvillimit industrial e tregtar dhe prioritetet që lidhen me këtë program, Lidhja Demokratike e Kosovës do të iniciojë dhe të jetësojë hapat dhe politikën në vijim:

## 20.1 HAPJA E TREGTISË ME TREGJE TË REJA

Lidhja Demokratike e Kosovës ka për synim që politikën tregtare ta vërë në funksion të plotë të ekonomisë së tregut dhe interesit ekonomik të vendit. LDK-ja do të angazhohet në fuqizimin e tregjeve aktuale Perëndimore; me fokus të vecantë në ato të Evropës.

Përveç kësaj, LDK-ja do të angazhohet në hapjen e tregjeve të reja. Thënë këtë, ndër hapat e parë të jetësimit të programit për industri dhe tregti do të jetë identifikimi i vendeve dhe rajoneve me perspektivë bashkëpunimi ekonomik e tregtar në kontinentin e Azisë dhe Afrikës. Aktualisht, bizneset eksportuese nga Kosova kanë filluar plasimin e mallrave në këto tregje, mirëpo, në mungesë të aranzhmaneve tregtare me këto tregje, shpeshherë ballafaqohen me pengesa të ndryshme, të cilat ua minojnë përparësitë konkurruese dhe krahasuese dhe kështu ua humbin aftësinë konkurruese.

Të dhënat nga shkëmbimet tregtare viteve të fundit tregojnë për një rritje të vazhdueshme të eksporteve në vendet aziatike, si dhe interesim të shtuar të eksportuesve për tregun afrikan. Produktet ushqimore dhe pijet e ndryshme aktualisht dominojnë eksportet në këto tregje. Duke marrë parasysh këtë interesim të bizneseve vendore, LDK-ja do të identifikojë tregjet individualisht apo rajonet me potencial bashkëpunimi tregtar për të iniciuar negociatat për marrëveshje tregtare, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e mëturësive të eksporteve si dhe zhvillimin industrial në vend. Varësisht nga potenciali eksportues në vende/rajone të caktuara, marrëveshjet do të dizajnohen për produkte/industri specifike (eng: "partial scope agreements") apo marrëveshje gjithëpërfshirëse ku do të trajtohen të gjitha mallrat, përfshirë ato industriale dhe bujqësore. Fillimi i negociatave do të bëhet në koordinim dhe përmes misioneve diplomatike që mbulojnë shtetet apo rajonet e caktuara në këto dy kontinente si dhe në konsultime të vazhdueshme me bizneset dhe shoqatat që përfaqësojnë interesat e tyre.

## 20.2 ZYRET MBËSHTETËSE NË MISIONET DIPLOMATIKE

Kosova aktualisht ka mbi 30 ambasada dhe zyra ndërlidhëse anekënd botës. I gjithë arsenalit diplomatik deri më tani ka qenë në funksion të agjendës së politikës së jashtme të Kosovës, duke e reduktuar kontributin e misioneve diplomatike në çështje protokollare gjatë vizitave të delegacioneve të ndryshme nga Kosova. Një nga detyrat primare të këtyre misioneve do të duhej të ishte përkrahja dhe promovimi i interesave ekonomike të vendit.

Në kuadër të programit për përmirësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve përfaqësuese të diplomacisë kosovare, LDK-ja gjithashtu synon që të krijojë dhe funksionalizojë ekipet mbështetëse ekonomike në misionet diplomatike anekënd botës. Këto ekipe do të udhëhiqen nga ekspertë të rangut të atashëve, roli i të cilave është promovimi i industrisë kosovare, investimeve dhe tregtisë, ndihma, përkrahja dhe këshillimi i bizneseve të cilat pretendojnë zgjerimin e aktiviteteve të tyre në vendet pritëse. Për më tepër, këto ekipe do të shërbejnë edhe si zyre ndërlidhëse e Odave Ekonomike dhe Shoqatave të bizneseve në vend gjithnjë në funksion të përkrahjes së sektorit privat. Fillimisht, ekipet do të funksionalizohen në ambasadat në vendet me potencial për rritje të

bashkëpunimit dhe atyre me të cilat sektori privat tashmë ka dëshmuar bashkëpunim të frytshëm ekonomik e tregtar.

## 20.3 POLITIKA FISKALE DHE ZHVILLIMI INDUSTRIAL

Politika fiskale aktuale e Kosovës, pavarësisht që mund të konsiderohet si e favorshme për sektorin privat në përgjithësi, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për një numër të jo të vogël të industrive përpunuese me theks të veçantë të atyre me potencial eksportues. Teoritë bashkëkohore ekonomike, por edhe evidenca empirike theksojnë rëndësinë e cilësisë në raport me lartësinë e të hyrave nga burimet e ndryshme të politikës tatimore. Pra, krahas stabilitetit makro fiskal rëndësi e madhe duhet t'i kushtohet edhe cilësisë së të hyrave (llojit të aktiviteteve të cilat taksohen) ngase aktivitetet tregtare ende dominojnë krahas industrisë vendore sa i përket kontributit në të hyrat buxhetore.

Andaj, LDK-ja synon që përmes programit të saj ta përmirësojë ambientin biznesor në vend, duke ua lehtësuar bizneseve prodhuese ushtrimin e aktivitetit të tyre. Në këtë kontekst, LDK-ja do ta eliminojë akcizën për lëndë të parë dhe pajisjeve në të gjitha industritë përpunuese si dhe lirim nga TVSH-ja për pajisje që nuk janë të liruara nga taksa doganore. Për më tepër, në mënyrë që të stimulohen bizneset eksportuese dhe kështu të ulët deficitin tregtar, do të aplikohen zbritjet në tatimet (eng. "tax credits") nga tatimi në korporata për pjesën e të hyrave nga eksportet.

## 20.4 TRUPA MONITORUESE TREGTARE

Kosova tashmë është futur në aranzhmane të ndryshme tregtare me vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Moldavinë (CEFTA), vendet e BE-së dhe Turqinë, ndërsa është në fazën fillestare të negociatave me Asociacionin Evropian për Tregti të Lirë (EFTA) ku bëjnë pjesë Zvicra, Norvegjia, Islanda, dhe Lihtenshtajni. Përderisa këto aranzhmane tregtare lehtësojnë tregtinë e mallrave në mes vendeve pjesëmarrëse, të njëjtat duhet të përcillen edhe me infrastrukturë adekuate ligjore, si dhe mekanizma që sigurojnë implementimin e marrëveshjeve respektive. Që nga hyrja në fuqi e marrëveshjes CEFTA 2006, nënshkruese e të cilës është edhe Kosova, shkëmbimi i mallrave është shoqëruar me pengesa të shumta qoftë të karakterit politik, apo edhe teknik në trajtën e barrierave teknike dhe jo tarifore. Për më tepër, disa industri në mënyrë sistematike janë ballafaquar edhe me praktika antikompetitive nga mallrat e importuara nga rajoni përmes çmimeve "dumping" dhe atyre të favorizuara përmes subvencioneve specifike në vendet e origjinës.

Pavarësisht krijimit të infrastrukturës ligjore përkatëse e cila trajton rastet e praktikave antikompetitive, të tilla praktika vazhdojnë të shfaqen dhe të njëjtat mbesin të pa adresuara si rezultat i paaftësisë institucionale dhe mungesës së një mekanizmi kompetent që do të siguronte rregulla të barabarta të lojës në treg. Vlen të theksohet që deri më tani çështjet e tilla janë trajtuar në kuadër të një grupi ndër-institucional këshillëdhënës (Komisioni për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe) i cili për shkak të natyrës së tij nuk e ka ekspertizën adekuate për eliminimin e këtyre praktikave në treg. Kështu, programi i LDK-së parashih krijimin e një mekanizmi të veçantë, me ekspertë të fushës, i cili do të ketë funksion të ngjashëm me Komisionin për Tregti Ndërkombëtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

## 20.5 POLITIKË E RE INDUSTRIALE

Zhvillimi industrial në dritën e zhvillimeve gjeopolitike të kohës, si dhe sfidave globale aktuale pothuajse nuk mund të paramendohet pa një politikë të kujdesshme dhe gjithëpërfshirëse industriale. Në këtë kontekst, LDK-ja do të angazhohet për hartimin e një kornize të mirëfilltë mbështetëse e cila do të jetë në funksion të zhvillimit dhe eksploatimit të përparësive krahasuese të industrisë kosovare, por gjithmonë duke shmangur çrregullimet në treg nga incentivat që mund të burojnë nga kjo kornizë. Politika industriale të cilën synon ta jetësojë LDK-ja konsiston kryesisht në masa dhe lehtësira të cilat do të aplikohen në mënyrë horizontale për të gjithë sektorët industrial dhe në raste specifike masa vertikale, të cilat kanë për synim forcimin e zingjirit të vlerës në industri specifike.

Në grupin e politikave horizontale hyjnë kryesisht investimet infrastrukturore dhe ato të targetuara në arsim, hulumtime dhe zhvillim, të cilat qëllim primar do të kenë përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe eliminimin e papunësisë me karakter strukturor. Për më tepër, duke pasur parasysh obligimet që Kosova ka karshi iniciativave rajonale lidhur me tranzicionin energjetik dhe ruajtjen e ambientit (Agjenda e Gjellbër e Ballkanit Perëndimor), është i pashmangshëm një plan nacional për përkrahje të industrisë vendore me qëllim të ballafaqimit sa më të lehtë me ndryshimet që imponojnë zotimet nga këto nisma rajonale. Sa për ilustrim, nga viti 2025 një pjesë e madhe e bankave komerciale të licencuara në Kosovë nuk do të financojnë asnjë investim atyre bizneseve që nuk kanë një plan të qartë tranzicioni që përbrendëson detyrimet e Kosovës karshi Agjendës së Gjellbër të Ballkanit Perëndimor.

Në këtë aspekt, LDK-ja do të iniciojë ndryshimet e nevojshme ligjore që hapin rrugë për rritjen e numrit të bizneseve të pavarura nga furnizimi me energji elektrike nga distributorët e licencuar dhe gjithashtu atyre që janë njëkohësisht gjenerues dhe konsumatorë të energjisë elektrike nga furnizuesit (eng. "prosumers"). Gjithashtu, në kuadër të masave në funksion të tranzicionit energjetik dhe kalimit nga modeli linear ekonomik në qarkor do të jetë edhe përkrahja direkte përmes skemave të voucher-ve, nga të cilat do të përfitojnë bizneset përmes shërbimeve të specializuara për t'i përgatitur ato sa më mirë në ballafaqimin me sfidat që vijnë me tranzicionin e gjellbër.

Gjithashtu, në kuadër të masave horizontale, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet digjitalizimit dhe digjitalizimit të industrisë përpunuese në vend. Thënë këtë, në mënyrë që industria vendore të zë hapin me industrinë konkurruese në rajon dhe më gjerë, programi ynë do të krijojë ura lidhëse në mes të sektorit vendor të teknologjisë informative dhe komunikimeve (TIK) dhe industrisë përpunuese në mënyrë që identifikimi dhe po ashtu adresimi i nevojave për digjitalizim të ketë karakter vendor. Këto ura do të krijohen përmes një skeme të veçantë të incentivave (vouchers apo incentiva të tjera fiskale) që inkurajon industrinë përpunuese të bashkëpunojnë me sektorin e TIK-ut, duke ndikuar në zhvillimin dhe rritjen e sektorit të shërbimeve dhe sektorëve prodhues njëkohësisht. Skema të ngjashme do të përdoren edhe për përkrahjen e bizneseve prodhuese për certifikimin e produkteve dhe përmeshjen e standardeve për tregjet e eksportit. Sa i përket masave me karakter vertikal, pra atyre që kanë fokus industri specifike, LDK-ja do të zhvillojë infrastrukturën e nevojshme për krijimin e cluster-ve industrial për ato industri në të cilat koncentrimi gjeografik i bizneseve në industri të njëjta është i nevojshëm për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të zingjirit të vlerës. Në këtë kontekst, do të funksionalizohen

zonat ekonomike dhe parqet e biznesit në Mitrovicë, Suharekë, Vushtrri dhe Lipjan. Për më tepër, në çdo rajon të Kosovës do të ketë një zonë industriale për të krijuar parakushtet për krijimin e cluster-ve në mënyrë organike nga sektorët me potencial në rajone të caktuara. Gjithashtu, ndër hapat e parë të jetësimit të këtij programi do të jetë edhe funksionalizimi i plotë i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, si platformë e nivelit më të lartë të dialogut publiko-privat në vend. Fatkeqësisht një platformë e tillë sot ekziston vetëm nominalisht, por pa ndonjë aktivitet apo vizion të qartë se si do të shërbejë ajo në funksion të rritjes së rolit të sektorit privat në zhvillimin ekonomik të vendit. Me funksionalizimin e këtij Këshilli, sektori privat do të bëhet pjesë integrale e procesit të zhvillimit të politikave publike në Kosovë.

Si pjesë integrale e politikës së re industriale do të jetë edhe promovimi i vazhdueshëm i investimeve përmes një strategjie efektive të bazuar në disa parime kritike. Kjo strategji e cila do të implementohet nga një agjenci me kompetenca ekzekutive do të ofrojë informacion të qartë dhe transparent për investitorët në lidhje me rregullat, rregulloret dhe stimujt në dispozicion. Në këtë aspekt programi do të jetë i bazuar në qasje të përqendruar tek investitori, duke përshtatur shërbimet për t'i përmbushur nevojat e ndryshme të investitorëve të huaj, si dhe duke eliminuar burokracinë e panevojshme dhe ofruar procedura të thjeshta dhe miqësore për investitorët. Për më tepër, do të përdoren stimuj me fokus në lehtësirat tatimore për t'u përafëruar me objektivat e zhvillimit ekonomik të programit, duke i bërë investimet në vend më tërheqëse dhe në funksion të paradigmës së re zhvillimore.

## 20.6 UNIONI I BIZNESEVE TË DIASPORËS

Kontributi i diasporës kosovare ka pasur një rol jashtëzakonisht të madh në ngritjen e mirëqenies socio-ekonomike në vend. Remitencat e dërguara nga diaspora ende mbeten një burim themelor i të ardhurave për ekonomitë familjare por edhe një potencial ende i pashfrytëzuar si duhet. Gjithashtu, investimet e diasporës, kryesisht në sektorin e patundshmërisë kanë pasur një ndikim jo të vogël në zhvillimin e këtij sektori në Kosovë. Megjithatë, potenciali i diasporës mbetet ende i paeksploatuar, potencial të cilin programi ynë synon ta vë në funksion të paradigmës së re zhvillimore në Kosovë. Duke pasur parasysh rëndësinë e rrjetëzimit të bizneseve të diasporës në mes vete, por edhe shtrirjes së bashkëpunimit me bizneset në Kosovë, komponentë e rëndësishme e këtij programi do të jetë themelimi i Unionit të Bizneseve të Diasporës. Përderisa, deri sot, iniciativat e ngjashme kanë pasur fushëveprim të kufizuar gjeografik, kjo platformë do të shërbejë si urë lidhëse mes bizneseve të diasporës anekënd botës dhe atyre në Kosovë. Gjithashtu, ky asociacion do të jetë anëtar me të drejta të plota të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, duke i bërë bizneset e diasporës pjesë aktive të dialogut publiko-privat dhe, kështu, për të hapur një kapitull të ri të përfaqësimit të diasporës në Kosovë.

## 20.7 INTEGRIMI EKONOMIK RAJONAL BRENDA PROCESIT TË BERLINIT

Rruga drejt anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian është e lidhur ngusht me bashkëpunimin rajonal dhe progresin integruar të Ballkanit Perëndimor, si grup vendesh me aspirata të ngjashme integruese, por heterogjen sa i përket nivelit të zhvillimit ekonomik e institucional. Andaj, BE-ja përmes të ashtuquajturit Procesi i Berlinit synon që të thellojë integrimin ekonomik



dhe tregtar të Ballkanit Perëndimor, duke synuar avancimin edhe të raporteve politike në mes vendeve në rajon para se BP-ja të jetë i gatshëm për anëtarësim të plotë në BE. Në kuadër të Procesit të Berlinit, në Samitin e Triestes në vitin 2017 u vunë bazat për krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal (TPR) ku të gjitha vendet e rajonit, përfshirë edhe Kosovën, u zotuan për jetësimin e këtij plani. Kjo iniciativë kishte avancuar tutje në Samitin e Sofjes, më 2020, ku të gjitha vendet kishin aprovuar Planin e Veprimet të TPR-së për katër vitet në vijim.

Në ndërkohë, me iniciativën e liderëve dhe qeverive të Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, ishte plasuar një nismë e re paralele e ashtuquajtur "Mini Schengen" që më vonë u riemërua si nisma për Ballkanin e Hapur (Open Balkan). Pavarësisht synimeve që ka një nismë e tillë konkurruese e Procesit të Berlinit, ajo vazhdon të kundërshtohet fuqishëm nga disa vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën.

Duke pasur parasysh zotimet që dalin nga Procesi i Berlinit dhe samitet respektive, LDK-ja do të angazhohet fuqishëm që çdo nismë e karakterit rajonal të jetë gjithëpërfshirëse, e zhveshur nga kalkulimet politike dhe, gjithashtu, të jetë produkt i një konsensusi të bazuar në respekt të ndërsjellë. Open Balkan nuk është e tillë. Për më tepër, LDK-ja do të promovojë iniciativat funksionimi i të cilave garantohet nga mekanizma tashmë të dëshmuara me karakter supranacional siç është Bashkimi Evropian, çfarë shohim tek Procesi i Berlinit dhe të cilin proces LDK-ja e mbështetë si të vetëm dhe në plotni.

# POLITIKA SOCIALE DHE PENSIONALE



RRUGA E RE  
*për Kosovën*



# POLITIKA SOCIALE DHE PENSIONALE

## KONTEKSTI

Sistemi pensional në Kosovë është vendosur në vitin 2002, duke bërë një prerje të menjëhershme në mes dy formave të rregullimit të sistemit pensional, pra duke bërë një kapërcim nga sistemi i gjeneratave në atë të vetëfinancimit dhe kështu duke lënë anash një gjeneratë të tërë të pensionistëve ekzistues. Për më shumë, edhe sistemi aktual pensional nuk është zhvilluar në mënyrë adekuate, duke lënë të krijohet një monopol mbi kursimet pensionale në Kosovë dhe si i tillë ka rezultuar si joefikas në mbledhjen e kursimeve nacionale.

Ky sistemi i mbrojtjes sociale i krijuar në Kosovë pas luftës, në tërësinë e tij, ka synuar të ofrojë një prag (standard) minimal të jetesës, sado pa dallime grupore, etnike etj., të paguar nga buxheti nacional. Ky prag minimal fillimisht ka përfshirë: a) Shërbimet sociale residuale (last resort); b) Ndihmën sociale; c) Pensionet bazë për gjithë të moshuarit 65-vjeç e lart; d) Pensionet për personat me paaftësi të plotë pune dhe e) Invalidët dhe familjarët e të vrarëve në luftë.

Transferet sociale (para të transferuara) kanë pasur për qëllim të mbulojnë vlerën e varfërisë ekstreme zyrtare në konsum (2,100 kalori për individ/ekuivalizuar për familje në rastin e ndihmës sociale); shërbimet sociale kanë synuar një mbrojtje institucionale minimale për rastet kur zgjidhjet në treg dhe brenda familjeve kanë munguar. Përveç garantimit të këtij standardi minimal, qëllimi tjetër i këtij sistemi të mbrojtjes sociale ka qenë që shpenzimet e përgjithshme sociale të mos bëhen barrë e rëndë për buxhetin dhe që kostoja e shpenzimeve të mos rritet njëjtë me rritjen e pritshme ekonomike.

Mirëqenia e mëtejme sociale, në kuptim të kujdesit social, mbrojtjes së të ardhurave dhe mbrojtjes shëndetësore është pritur të ofrohet nga tregu, si p.sh.

përmes kujdesit familjar dhe të sektorit të tretë (organizatave joqeveritare), rrogave nga puna në treg, kursimeve të obligueshme individuale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-ja, i njohur si Trust-i) dhe sigurimeve në sektorin e sigurimeve vullnetare pensionale dhe shëndetësore. Që nga atëherë, janë vërejtur tri zhvillime kryesore, që kanë shkuar edhe kundër qëllimeve, edhe kundër pritjeve të dizajnesve të këtij sistemi:

E para, partikularizmi. Përderisa nuk ka pasur ndryshime rrënjësore në sektorin e kujdesit/shërbimeve sociale dhe asistencës sociale, përkundër se ekonomia dhe kërkesat/rreziqet sociale kanë evoluuar (pra, është rritur nevoja për to), ka pasur shtim të vazhdueshëm të skemave të veçanta në sektorin e transfereve sociale të paguara nga shteti. Tani numërohen mbi 22 skema të tilla të veçanta, të cilat nuk targetojnë domosdoshmërisht individët dhe familjet e varfëra, por targetojnë grupe të ngushta jodomosdoshmërisht të varfëra. Kështu, përveç se skemat nuk janë universale, rrisin koston e buxhetit kombëtar në mënyrë të vazhdueshme, duke krijuar paqëndrueshmëri buxhetore në kuptim afatgjatë, demotivojnë interesin për punësim formal pasi lëshohen në mënyrë kategorike dhe jo duke u bazuar në punë, madje krijojnë edhe pabarazi sociale të financuara nga shteti dhe shërbejnë si argument për shtrim të vazhdueshëm të kërkesave për të drejta të ngjashme të grupeve të veçanta shoqërore.

E dyta, dështimet e tregut. Tregu nuk ka dhënë rezultatet e pritshme, për shkak se, si pasojë e shkallës së ulët të punësimit, kujdesi social në tregun privat (si kujdesi për fëmijët/child care, kujdestaria familjare për personat në nevojë etj.) është siguruar vetëm nga pjesa më e pasur e shoqërisë që ka kapacitet për ta financuar këtë lloj kujdesi privat, ndërsa kujdesi që ofrohet nga organizatat joqeveritare koncentrohet në qytetet më të mëdha, si: Prishtina dhe Prizreni; sigurimet vullnetare shëndetësore në treg nuk mbulojnë më shumë se 10% për qind të gjithë popullatës; sigurimet vullnetare pensionale në treg janë pothuajse të papërfillshme, ndërsa kursimet e obligueshme pensionale në FKPK (Trust) harxhohen mesatarisht brenda 3-4 viteve pas moshës së pensionimit dhe lënë të moshuarit pa të hyra të qëndrueshme pensionale. Gjithashtu, shkak i emigracionit të madh të të rinjve jashtë vendi, kapaciteti i familjeve për t'u kujdesur për anëtarët në nevojë është ulur.

E treta, transferet sociale nuk kanë kontrolluar rritjen e pabarazisë sociale. Ndonëse ligjërisht ekziston një lidhje ndërmjet transfereve shtetërore (si asistenca sociale, pensioni bazë, pensioni i aftësisë së plotë të kufizuar) me linjën zyrtare të varfërisë ekstreme (koston e 2,100 kalorive të ushqimit në ditë), kjo ndërlidhje në praktikë nuk ka pasur peshë, pasi vendimet e administratës shtetërore janë bërë në mënyrë ad-hoc, pa vazhdimësi, dhe pa reflektim automatik në linjën zyrtare të varfërisë ekstreme. Çfarë është më e rëndësishme, meqë këto transfere sociale kanë targetuar kryesisht varfërinë ekstreme dhe nuk kanë ndjekur dallimet reale në të ardhura përgjatë viteve, nuk kanë qenë në gjendje ta kufizojnë rritjen e ndjeshme të pabarazisë sociale në të hyra.

Këto zhvillime kanë shpërfaqur nevojën e kohës që Kosova më në fund të ketë një sistem të kodifikuar për skema pensional dhe sociale. Rrjedhimisht, LDK-ja beson se një sistem pensional i qëndrueshem dhe i barabartë, që garanton pensione stabile dhe të mjaftueshme për gjeneratat e ardhshme, por, në të njëjtën kohë, përkujdeset për pensionistët ekzistues, është i domosdoshëm për Kosovën.

# PLANI YNË PËR POLITIKËN SOCIALE DHE PENSIONALE

Lidhja Demokratike e Kosovës, në mënyrë sistematike dhe proaktive, do të angazhohet për përkrahjen e sektorit privat si bazë për zhvillimin e mirëfilltë Ky propozim i LDK-së ka për qëllim të ofrojë një pako politikash, që, pastaj, do të përkthehen në legjislacion që garanton përmirësimin rezultatet e mësipërme dhe do t'i shërbejë rritjes së punësimit përmes zgjidhjeve të qëndrueshme, të cilat, përveç nevojave të vendit, trashëgimisë institucionale të pasluftës, informohen edhe nga literatura shkencore dhe praktikat më të mira të shteteve evropiane.

Qëllimet kryesore të programit tonë janë: a) Rritja e qëndrueshmërisë së shpenzimeve qeveritare për fushën e mbrojtjes sociale; b) Parandalimi i praktikave të shpenzimit të mëtejshme përmes skemave popullore duke vendosur një qasje që nxit punësimin dhe jo pasivitetin ekonomik; c) Rritja e qëndrueshmërisë, cilësisë dhe garancisë në të ardhura pensionale; d) Rritja e solidaritetit shoqëror për individët të cilët përballen me rreziqe të zakonshme, si: sëmundja, papunësia, invaliditeti në punë, përjashtimi social etj.; dhe e) Ulja e pabarazisë sociale dhe e varfërisë.

## 21.1 PASTRIMI I LISTËS SË PENSIONEVE

Listat e pensionistëve aktualë duhet të jetë e saktë, duke përfshirë të gjithë ata që duhet të marrin pensione nga Kosova, si dhe duke llogaritur përvojën e punës për secilin pensionist.

Lidhja Demokratike e Kosovës e njeh rëndësinë jetike të ruajtjes së integritetit dhe saktësisë së sistemit tonë pensional. Synimi ynë është identifikimi i përfituesve të rremë, veçanërisht brenda kategorive të tilla si veteranët dhe invalidët e luftës, me qëllim të largimit të tyre nga lista e rritjes së përfitimit për veteranët e invalidët e vërtetë. Keqinterpretime të tilla jo vetëm që çnderojnë sakrificat dhe nevojat e vërteta të qytetarëve tanë, por gjithashtu çojnë në keqpërdorime të konsiderueshme të fondeve publike. Si pjesë e programit, LDK-ja angazhohet që të bëjë një rishikim të plotë dhe transparent të të gjithë përfituesve të pensioneve; duke përfshirë në veçanti grupet e interesit dhe organizatat përfaqësuese. Synimi ynë është të identifikojmë dhe korrigojmë çdo mospërputhje, duke u siguruar që sistemi të jetë i drejtë, i saktë dhe t'u shërbejë atyre që kanë vërtetë të drejtë. Nëpërmjet kësaj nisme, ne synojmë të ruajmë burimet publike dhe të ruajmë nderin dhe dinjitetin e të gjithë përfituesve legjitimë.

## 21.2 ARKITEKTURË E RE PENSIONALE

Ndërtimi i një arkitektуре të re për sistemin pensional të Kosovës është e domosdoshme. Kjo arkitekturë do t'i ketë katër shtylla kryesore: Shtylla A, Shtylla B, Shtylla C, dhe Shtylla D; nga tri sa i ka sot, dhe kështu do të fillojë t'i ngjajë shteteve të Evropës, ku financimi bëhet nga buxheti kombëtar, sigurimet sociale, dhe kursimet e sigurimet vullnetare në treg.

Në kuadër të Shtyllës A do të hyjnë të gjitha të drejtat në transfere/sigurime, të cilat do të financohen nga buxheti i shtetit, për të cilat kriteret e përzgjedhjes së përfituesve dhe realizimit të të drejtave janë të rregulluara ose rregullohen me ligje të veçanta. Në kuadër të Shtyllës B do të hyjnë të gjitha financimet nga sigurimet sociale si pensioni i moshës, invalidor i punës, familja; mbrojtja prindërore, mbrojtja nga papunësia e pushimi mjekësor. Në Shtyllën C janë kontributet obligative pensionale, të definuara me ligj; gjersa në Shtyllën D përfshihen sigurimet vullnetare pensionale dhe shëndetësore në treg, si dhe beneficionet që dalin prej tyre, të rregulluara nga Banka Qëndrore e Kosovës (BQK).

Për mbulimin në Shtyllës B, do të përcaktohet një normë shtesë për secilin të punësuar dhe punëdhënës në Kosovë. Synohet që kontribut shtesë t'ë jetë nga 1.5% deri në 2.5%. Këtij hapi duhet t'i paraprijnë reformat në përmbylljen e formalizimit të tregut të punës.

Me kontributet e tanishme pensionale (nga i punësuari) në Trust prej 5%, me sigurime shtesë shëndetësore prej 3.5% dhe me një normë shtesë kontribimi prej 1.5-2.5%, kontributi i gjithëmbarshtëm i një të punësuarit në skema jo tatimore arrin në 10%; që sërish mbetet ndër normat më të ulëta në rajon dhe në Evropë.

Po ashtu, në bazë të listës së re të pensioneve dhe fondit të mbledhur nga kontributet shtesë, do të caktohet pagesa për të gjithë pensionerët në listë, duke e kufizuar pagesën në fondin e mbledhur, për të mos shkaktuar probleme fiskale



të tjera. Të gjithë ata që kanë kontribuar për një periudhë më gjatë se dhjetë vjet në llogarinë e tyre personale të kursimit, do të kenë të drejta të kufizuara për të marrë pagesa nga Shtylla B.

### 21.3 HAPJA E TREGUT PENSIONAL

Hapja e tregut pensional obligativ, duke lejuar konkurrencë në Shtyllën C dhe duke siguruar një efikasitet të shtuar, si në menaxhimin e kursimeve pensionale, por edhe në rritjen e shumës së grumbulluar. Me hapjen e tregut pensional, do të sigurohej ardhja e investitorëve të huaj me renome ndërkombëtare, ngritja e kapaciteteve për grumbullimin e kontributeve pensionale, diversifikimi i riskut të asocuar me mbajtjen e gjitha kursimeve pensional në një fond pensional dhe, në fund, edhe aftësinë e të njejtave për të menaxhuar kursimet pensionale në mënyrë që vlera e tyre të ngritet me anë të investimeve të drejta dhe më të mëdha në tregun lokal financiar, dhe si hap i tretë

Po ashtu, siç është elaboruar deri më tani, LDK-ja beson se një përqindje e fondeve, që do të mblidhen nga Trusti dhe kompanitë e tjera, duhet të investohen në Kosovë. Krijimi i instrumenteve për këto investime do të jetë një ndër prioritetet e LDK-së. Një politikë e tillë përvec krijimit të projekteve të mëdha kapitale, ofron edhe kthim më të madh tek kontributdhënësit.



# SEKTORI FINANCIAR





# SEKTORI FINANCIAR

248

## KONTEKSTI

Sektori financiar, përgjatë viteve, është konsideruar si një ndër kontribuuesit e rëndësishëm në zhvillimin e sektori privat vendor. Megjithatë, ekzistojnë segmente të cilat vazhdojnë të karakterizohen me mungesë të zhvillimit, në krahasim me vendet e rajonit. Kështu, ndërmjetësimi financiar mbetet ndër më të ulëtat në rajon, përkundër kapacitetit të sektorit financiar, për të kredituar më shumë e, po ashtu, edhe si rezultat i mungesës së alternativave në treg, duke pasur parasysh mungesën e legjislacionit për fondet investive si alternativë kundrejt bankave. Kostoja aktuale e financimit nga bankat vazhdon të jetë relativisht e lartë, pikërisht për shkak të mungesës së alternativave për financim dhe bashkinvesim.

Sistemi i pagesave vazhdon të ketë kosto të lartë për klientët edhe si rezultat i mungesës së Qendrës Kombëtare për Procesim të Pagesave (QKPP). Për më tepër, aktualisht, sistemi bankar nuk ka konkurrencë në llogaritë bankare dhe në shërbime bazike, pasi që institucionet mikrofinanciare (IMF), institucionet financiare jobankare (IFJB) dhe operatorët e parave elektronike, të bazuar në teknologjinë financiare (Fintech dhe e-money), nuk kanë qasje në llogari bankare dhe në sistemin IBAN (Internatinal Bank Account Number). Krijimi i qasjes në llogari bankare për IMF, IFJB dhe e-money fintech do të krijonte konkurrencë të drejtpërdrejtë ndaj bankave dhe, përmes konkurrencës, do të ndikonte në uljes e çmimeve në treg. Gjithashtu, konform dispozitave rregullative të vendeve të BE-së, mund të krijohen mekanizmat për pranim të depozitave në masë të limituar (kundrejt rritjes së kapitalit) edhe për IMF, IFJB dhe e-money fintech. Industria e sigurimeve duhet të liberalizohet plotësisht në tregun e produkteve të detyrueshme dhe të shqyrtohet mundësia që profesione me rrezikshmëri të detyrohen të jenë të mbuluara me policë sigurimi (p.sh.

punonjësit e ndërtimtarisë) e, po ashtu, të ulet varshmëria e industrisë në produkte të detyrueshme.

---

249

Përtej sektorit financiar, problematik dhe me mungesë të efektit të pritur në treg është edhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK-ja). Kjo për shkak të legjislacionit konservativ, i cili prioritet i jep minimizimit të riskut për FKGK-në, kundrejt misionit për të përkrahur segmentet, të cilat kanë vështirësi në qasje në financa. Sa i përket sistemit pensional, do të rivlerësohet mundësia e krijimit të mekanizmave që, përveç letrave me vlerë të Qeverisë, mjetet e sistemit pensional të kenë opsionin e investimeve në vend, gjithmonë duke synuar kthimin maksimal për kontributdhënësit.

Për të zhvilluar më tej kontributin e sistemit financiar vendor në zhvillim ekonomik, është tejet e rëndësishme që të rikthehet pavarësia e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK-ja) të eliminohen ndërhyrjet politike që janë realizuar përgjatë viteve.

# PLANI YNË PËR SEKTORIN FINANCIAR

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, sektori financiar ka potencial shumë më të madh eksplorues se sa ai që dëshmon në gjendjen e tanishme. Prandaj, një çerek shekulli pas nisjes së hapave të parë në këtë drejtim, është e domosdoshme kapërcimi në nivele të reja organizimi; me fokus të veçantë në rritjen e kapaciteteve investive në vend.

Një ndër orientimet kryesore të planit tonë ka të bëjë dhe me parimin e pavarësisë së operimit të Bankës Qendrore të Kosovës. Kjo pavarësi është e rëndësishme për të siguruar që faktorët e tregut përcaktojnë prioritetet e financimit dhe të cilat janë të bazuara në analiza të profesionistëve të fushës. Përgjatë viteve, janë identifikuar ndërhyrje të vazhdueshme në sistem dhe në treg, të cilat mund të cenojnë integritetin e sistemit financiar. Projektet tona kryesore janë:



## 22.1 QENDRA KOMBËTARE PËR PROCESIMIN E PAGESAVE

Sistemi aktual i pagesave në Kosovë, edhe pse funksional, karakterizohet me kosto të larta në realizimin e transaksioneve, përfshirë transaksionet me kartelë bankare, teknologjinë përcjellëse për këto transaksione, si POS-i (Point of Sale) e deri te transaksionet ndërbankare. Kostoja e lartë e këtyre produkteve vjen edhe si rezultat i investimeve individuale të secilit institucion financiar në krijimin e mekanizmave për realizim të transaksionit (si p.sh. POS-i).

Krijimi i QKPP-së është provuar të realizohet disa herë nga sektori privat, por, deri më tani, nuk është realizuar. Krijimi i këtij sistemi nga sektori privat krijon varshmëri të të gjithë sistemit ndaj një operatori privat, i cili do të përfundojë duke pasur pozitë monopoli dhe mundësi ndikimi në çmimet e tregut. Realizimi në formatin ekzistues është shumë i kushtueshëm për bizneset dhe klientët e sistemit financiar, pasi që konfirmimi i informatës të disponueshmërisë së mjeteve në llogarinë bankare gjithmonë përcillet me një rrugëtim tejet të gjatë, nga kartela në Kosovë, deri në qendrën procesuese të Visa ose MasterCard dhe kthehet si informatë te banka dhe biznesi për të realizuar transaksionin. E ky rrugëtim i informatës përmban tarifa dhe kosto nga qendrat procesuese të Visa ose MasterCard. Sistemi i ri i QKPP-së, synon që të evitohet rrugëtimi i gjatë dhe tarifa për të konfirmuar informatën e disponueshmërisë së mjeteve nga prodhuesi i kartelës bankare, konfirmim pa tarifë dhe pa kosto nga banka që ka alokuar llogarinë ndaj klientit.

## 22.2 LIGJI PËR FONDET INVESTIVE

Aktualisht në Kosovë e vetmja alternativë financuese por edhe investuese në formë të depozitave për biznese dhe individ është sistemi bankar. Depozitat, megjithatë, për shumë vite me radhë, nuk kanë sjellë përfitime, për klientët për shkak të normës së ulët vjetore të interesit në depozita, e cila përgjatë viteve ishte e ulët deri në 0.8%. Kundrejt kësaj, bizneset të vetmin burim të financimit përgjatë viteve e kanë vetëm sistemin bankar, i cili është karakterizuar me financim të qëndrueshëm për ekonominë, por, kur merret parasysh fakti se historiku kreditor është i kufizuar e, mbi të gjitha, bizneset e reja nuk kanë në historik të ndërtuar, vështirësohet në masë të konsiderueshme financimi. E, po ashtu, ky financim përgjatë viteve është karakterizuar me kosto të lartë, kosto kjo e cila do të ngritet më tej si rezultat i kushteve të financimit në tregjet ndërkombëtare.

Krijimi i legjislacionit për Fondet e Përbashkëta Investuese dhe për Investime të Përbashkëta do të krijojë një mundësi që kapitali që u përket një numri më të madh të investuesve të përdoret për projekte të shumta investive dhe secili investitor të mbajë kontrollin në pjesëmarrjen e tij. Megjithatë, struktura e vendimmarrjes lidhur me projektet investuese zakonisht ndërmerret prej menaxhmetit profesional dhe me ekspertizë, që paraqet një rëndësi të madhe në avantazhet e fondeve investive. Avantazhi i fondeve investuese është edhe kostoja e ndërlidhur me tarifën si dhe kostoja e financimit.

## 22.3 SISTEMI I PAGESAVE

Aktualisht sistemi ekzistues financiar lejon qasje në llogari bankare vetëm për banka. Ky kufizim i qasjes në sistem të pagesave për IMF/IFJB-në dhe për Fintech ka kufizuar konkurrencën në fushën e pagesave. Mbi të gjitha, përkundër

zhvillimit të Fintech në vend dhe licencimit të një numri të konsiderueshëm të institucioneve Fintech, bankat vendore në shumë raste nuk i lejojnë këto institucione të kenë llogari bankare në to, duke i kufizuar të gjithë klientët e tyre të qasen në Fintech.

Krijimi i hapësirës për të pasur llogari bankare për këto institucione, do të evitonte bllokadën e shkaktuar të rritjes së konkurrencës në fushën e pagesave nga bankat, sepse ky lejim i qasjes do të mundësonte që procesimi i pagesave të bëhet pa ndërmjetësim të bankave komerciale, por vetëm me procesim të tyre, përmes sistemit të pagesave të BQK-së. Kjo hapje e tregut të pagesave edhe për IMF/IFJB dhe për Fintech do të reduktonte në masë të madhe koston e pagesave në vend, sidomos pagesave me vlerë të vogël.

Për të pasur efekt të lartë, është e nevojshme që edhe për IMF/IFJB të krijohet baza ligjore që të lejohet qasja e kufizuar në mjete të klientëve (p.sh. depozitë në vlerë të vogël, në rreth 1000 euro), për qëllim të realizimit të pagesave. Gjithashtu, ky lloj të jetë e detyrueshme që depoziti të qarkullohet, që të mos trajtohet si kursim, por vetëm si mekanizëm pagese. Kjo do të realizohej duke rritur kërkesat për kapital të këtyre institucioneve, për të mbrojtur klientët e sistemit financiar.

Hapja e tregut do të kontribuonte në përmirësimin e përgjithshëm të qasjes në financa në vend e, po ashtu, do të rriste edukimin financiar. Gjithashtu, efekt tjetër pozitiv do të ishte edhe reduktimi në masë të madhe i përdorimit të parasë së gatshme (keshit) në ekonomi. Reduktimi i përdorimit të parasë së gatshme (keshit) është njëri ndër mekanizmat më efektiv për reduktimin e ekonomisë joformale, si dhe luftimit të shpëlarjes së parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit.

## 22.4 FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

Struktura aktuale ligjore dhe rregullative për Fondi Kosovare për Garanci Kreditore (FKGK) sugjeron se politikat e fondit kanë prioritet evitimin e riskut kreditor kundrejt financimit të bizneseve, të cilat kanë probleme në qasjen në financa. Megjithatë, reduktimi i riskut investiv është parim i qëndrueshëm, në ekonominë e Kosovës efekti i prezencës së FKGK-së, mbetet i limituar në aspektin e financimit të ndonjë segmenti që hasë në vështirësi të financimit. Kjo konfirmohet edhe me faktin se struktura e ekspozimeve të FKGK-së është e njëjte me atë të sistemit bankar, që nënkupton se janë garantuar kredi që edhe me mosekzistencën e FKGK-së, këto segmente do të mbeteshin të financuara. Gjithashtu, se nuk janë tejkuluar margjinat e financimit ekzistues, konfirmohet edhe nga fakti se kreditë e joperformuese në garantimet FKGK-së janë 1.5%; dukshëm më të ulëta se të sistemit financiar vendor që janë në rreth 2.5%. Gjithashtu, shumica e garancive aprovohen për biznese që nuk kanë hasur në probleme të financimit, si për shembull, bizneset që merren me aktivitet të kredisë.

Me qëllim të tejkalimit të misionit aktual të FKGK-së, është e nevojshme të ndërmerren veprime në ndryshim të legjislacionit, me qëllim që, konform objektivave strategjike të zhvillimit ekonomik vendor, të jenë të orientuara edhe politikat garantuese të FKGK-së, duke garantuar sektorë strategjikë, si: prodhimi, energjia, teknologjia informative, bujqësia dhe biznese start-up të

kënë prioritet apo ekskluzivitet në garantimin e financimit. Po ashtu, kostoja aktuale e aplikimit nga sistemi financiar në FKGK është e lartë dhe nuk krijon mekanizëm motivues për aplikime të shpeshta nga sistemi. Të gjitha këto ndryshime duhet të përcillen me rritje të financimit për FKGK-në nga Qeveria, me qëllim të rritjes së efektit në ekonomi të FKGK-së.

## 22.5 TREGU I SIGURIMEVE

Sektori i sigurimeve përgjatë viteve është ballafaquar me mospërbushje të kriterëve ligjore të funksionimit. Përkundër disa përmirësimeve, është e nevojshme që ky segment të zhvillohet më tej dhe të jetë, i orientuar në penetrim të tregut me produkte vullnetare. Për të arritur këtë, është e nevojshme që të avansohet legjislacioni i sektorit të sigurimeve, me qëllim që të zbatohen kriteret e njëjta rregullative sikur në vendet e BE-së e, po ashtu, që të liberalizohet plotësisht tregu i produkteve të detyrueshme. Gjithashtu, duhet të avansohet legjislacioni për dëmet jomateriale që palët e dëmtuara të kenë kompenzim nga sigurimi konform kushteve kontraktuale dhe ligjore. Po ashtu, është e nevojshme që të ndërmerren analiza për të vlerësuar profesionet që bartin rrezikshmëri të lartë të kenë të detyrueshme policën e sigurimit shëndetësor, ndër to, ndërtimtaria e sektori i minierave.

